



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Kavajë”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI
Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

“BASHKIA KAVAJË”

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHËSE EKZEKUTIVE	4
II. OPINIONI I AUDITIMIT	13
III. HYRJA.....	13
1. Objektivat e auditimit.....	16
2. Qëllimi i auditimit	17
3. Identifikimi i çështjes.....	17
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	17
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	18
6. Kriteret e vlerësimit	18
7. Standardet e auditimit	19
8. Metodologjia e auditimit	19
9. Dokumentimi i auditimit	21
IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	21
Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	21
2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	22
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	39
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.....	82
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	101
2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	152
2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	174
2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	185
V. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	207
VI. ANEKSE.....	234

Lista e shkurttimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
TAK	Titullari i Autoritetit Kontraktor

I.PËRMBLEDHËSE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 10.03.2023 deri në datën 05.05.2023, në subjektin Bashkia Kavajë, për periudhën nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërie*” duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2022, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike dhe menaxhimit të të ardhurave, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë periudhës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikatat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, shpërblim të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Kavajë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, grupi i auditimit konkludon në një opinion të **modifikuar/kualifikuar** për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2022), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet ka dalë me opinion të **modifikuar/kualifikuar**.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raport Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u	E Lartë	24-41	Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë Juridike të ngrejë grupin e punës për

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:</p> <p><u>“Mjedisi i kontrollit”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. - Në Rregulloren e brendshme mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës “Sektorin e Menaxhimit të Aseteve”, “Drejtorisë së Projekteve Strategjike të Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës” dhe të specialistit të IT. <p><u>“Menaxhimi i Riskut”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut. - Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. - Nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit. - Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. <p><u>“Aktivitetet e Kontrollit”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Kavajë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. - Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. <p><u>“Informimi dhe komunikimi”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i raportimit, nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisive të varësisë të saj. <p><u>“Monitorimi”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti. - Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. 			<p>kryerjen e planit të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
2.	Nga auditimi i kryer në Bashkinë Kavajë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se sektori i Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga Klsh-ja.	E mesme	24-41	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kavajë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga Klsh-ja, për të pasqyruar aktivitetin e drejtorive për mbarëvajtjen e punës në bashki.
3.	<p>Nga auditimi i hartimit të PBA-ve 2022-2024 si dhe i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit vjetor 2022, u konstatua se:</p> <p>a. Dokumenti i PBA paraqitet i mangët pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, - Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor. - Nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kavajë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, për të cilët nuk ka urdhër për ngritjen e EPM (Ekipet e menaxhimit të programeve) për përgatitjen e PBA dhe buxhetit vjetor 2022. - Nuk janë respektuar afatet kohore në miratimin nga ana e Këshillit të dokumenteve të projekt buxhetit afatmesëm. - Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, nuk është bërë detajimi për çdo program i detyrimeve. <p>b. Buxheti për vitin 2022 është realizuar 2,056,431 mijë lekë nga 1,400,833 mijë lekë të planifikuara 2,667,949 lekë ose në masën 77%.</p> <p>c. Për vitin 2022, të ardhurat janë realizuar në masën 112%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksë e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 705,828 mijë lekë. d. Për vitin 2022 është përgatitur raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit, por jo në mënyrë periodike për çdo 4-mujor.</p>	E Mesme	41-84	<p>Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe në bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që planifikimi i shpenzimeve buxhetore PBA dhe të vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesat me publikun me palët e interesit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. - Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që, me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet. - Drejtoria e Burimeve Ekonomike të përgatisë raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit (4 mujore), jo vetëm vjetore, duke i paraqitur në KB dhe krahas tyre të paraqesë dhe një material për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar.
4	Detyrimet e prapambetura të palikujduara të raportuara në MFE në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 837,517,800 lekë, të cilat nuk rakordojnë me	E lartë	41-84	Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>gjendjen e llogarive të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit për vlerën 71,755,707 lekë. Gjithashtu në vlerën e detyrimeve të raportuara në MFE nuk është përfshirë vlera e detyrimeve të lindura nga shpronësimet në shumën 12,243,728 lekë.</p> <p>Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 43 % kundrejt fondeve të miratuara, ku Bashkia Kavajë mund të konsiderohet në vështirësi financiare, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është mbi nivelin prej 25 %. Pra nga Bashkia Kavajë nuk është bërë një punë e mjaftueshme për daljen nga situata e vështirësisë financiare</p>			<p>funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.</p>
5	<p>Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjellbërim-ndriçim, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të vitet 2021 vlera e debitore është 681,029,206 lekë. Gjatë vitit 2022 vlera e debitore taksave dhe tarifave e krijuar është 104,306,503 lekë për 11,138 subjekte gjithësej. Në fund të vitit 2022 vlera debitorëve në mënyrë progresive për taksë dhe tarifa është në vlerën 705,827,865 lekë.</p>	E lartë	41-84	<p>-Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale, i studiuar dhe i argumentuar, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimit të tyre.</p> <p>- Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë, për arkëtimin nga tatimpaguesit të vlerës debitore prej 705,827,865 lekë të marrë të gjitha masat, që përveç nxjerrjes së njoftimit të vlerësimit tatimor, paralajmërimin e masave shtërnguese si dhe njoftimet e bllokimit bankar në bankat e nivelit të dytë për një pjesë të debitorëve të ndjekë të gjitha rrugët ligjore.</p>
6	<p>Për planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga kategoria “familjar për taksën e ndërtesës, dhe tarifave pastrim-shërbimi, DAV Bashkia Kavajë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”. Pra planifikimi i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar” nuk është bërë i saktë, pasi nga informacionin i Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë Kavajë rezultoi se, në regjistrin e kësaj kategorie tatimpaguesish nuk janë përfshirë 12357 familje për Qytetin e Kavajës 11,329 familje, Nga përlllogaritjet për Qytetin e Kavajës vetëm për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, për numrin e prej 11,329 familjeve të pataksuara, është planifikuar 30,398,220 lekë më pak të ardhura.</p>	E Lartë	41-84	<p>Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë të marrë masa për plotësimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme të regjistrit të taksapaguesve vendorë të kategorisë “Familjar” për Bashkinë Kavajë dhe NJA si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real. Gjithashtu të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Përsa i përket arkëtimit për familjarët për taksën e ndërtesës e truallit, tarifat pastrim-ndricim-gjelbërim-arsim konstatohet se vlera debitore progresive në Bashkinë Kavajë dhe NJA në celje të vitit 2022 është 305,659,846 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 262,750,741 lekë, që i përkasin 10,677 familjeve debitore, nga të cilat 6417 familje për vlerën 30,448,469 lekë janë debitorë të krijuar brenda vitit 2022.			
7	Përsa i përket arkëtimit të taksës bujqësore u konstatua se detyrimet debitore progresive për Bashkinë Kavajë dhe NJA në celje të vitit 2022 janë në vlerën 173,843,504lekë dhe në fund të vitit 2022 janë në vlerën 197,571,584 lekë, ndërsa vetëm gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime debitorë në vlerën 31,947,682 lekë , që i përkasin 6846 familje fermere debitore. Krijimi dhe rritja e debitorëve në lidhje me arkëtimin e taksës bujqësore, ka ardhur për arsye se familjet fermerenuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre	E Lartë	41-84	Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë në bashkëpunim dhe me specialistët në NJA të Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike të marrë masa për saktësimin e të dhënave për tokën bujqësore e dhënë në përdorim/pronë si dhe përditësimin e regjistrit të taksapaguesve fermerë për taksën bujqësore për Bashkinë Kavajë dhe NJA, si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real dhe të argumentuar. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat e tokës ndaj familjeve fermere debitorë.
8	Nga subjektet e licencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve për vitin 2022 në 7 raste të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në mungesë të autorizimit të licencimit për ushtrim aktiviteti dhe 1 subjekt është I mbyllur por ka detyrim të prapambetur, gjë që ka sjellë mosarkëtimin e të ardhurave nga tarifa e licencimit pavarësisht njoftimeve, duke sjellë të ardhura të munguara në vlerën prej 5,800,000 lekë.	E Lartë	41-84	Drejtoria e Mbrojtjes të Konsumatorit dhe Mjedisit të shqyrtojë dokumentacionin e 8 subjekteve debitore dhe të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur të tarifës së autorizimit prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Kavajë për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022, si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur arkëtimet e plota brenda afatevenë kontabilitet e në inventarin fizik.
9	Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kavajë me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe	E Lartë	41-84	Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Kavajë, të marrë masat dhe të

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	DAV Bashkia Kavajë, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj), duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën 13,009,282 lekë			ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 13,009,282 lekë dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave dhe nëse në rastet ku është e pamundur arkëtimi i debitorëve të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke parë dhe si mundësi anulimin e kontratave.
10	Në paketën fiskale për vitin 2022, konkretisht në Kreun II.5 “Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit”, është përcaktuar niveli i tarifës 300 lekë/m ² /3 muaj, ku sipas këtij dokumenti Bashkia Kavajë e ka konsideruar sezonin turistik 3 muaj, ndërkohë që me ndryshimet e dispozitave ligjore rezultojnë se aktiviteti i stacionit të plazhit minimalisht duhet të zgjasë 5 muaj në vit, që do të thotë 2 muaj më tepër nga çfarë ka përcaktuar Bashkia Kavajë në paketën fiskale. Kjo situatë ka ndikuar në planifikimin e gabuar të kësaj takse, e për pasojë ka sjellë reduktimin e të ardhurave në fakt nga dhënia me qira e hapësirës së plazhit në vlerën 26,797,800 lekë.	E Mesme	41-84	Drejtoria e Kadastrës Urbane e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke bërë ndryshimin në paketën fiskale të kohëzgjatjes së qiradhënies së hapësirës së plazhit (minimalisht 4-5 muaj me çmimin 100 lekë/m ² /muaj) me qëllim rritjen e të ardhurave që arkëtohen nga tarifa e qiradhënies për objektin e mësipërm, si dhe eliminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e Bashkisë Kavajë.
11	Gjendja e llogarisë 411 “Personeli, paradhnie, deficite, gjoba” paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 1,907,396 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,839,350 lekë. Gjendja e kësaj llogarije në rastin konkret paraqet vlerat debitore për kopshtet, cerdhet dhe ujsjellësi. Llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitore të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit.	E lartë	84-103	Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 1,907,396 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2023 me artikujt kontabël në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.
12	Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhnie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 91,540,628 lekësi në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022, për të cilin nuk ekziston asnjë analizë dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson kjo vlerë.	E lartë	84-103	Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël, pasi të realizojë analizën e gjendjes së kësaj llogarije nëpërmjet shqyrtimit dhe zbrërthimit të dokumentave financiare të viteve të kaluara.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
13	<p>Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 681,029,205 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë me një rritje në vlerën 27,637,812 lekë. Referuar analizës së kësaj llogarije rezulton se në gjendjen e saj janë përfshirë debitorët nga taksat dhe tarifat për të gjithë taksapaguesit, debitorë nga kopshte e cerdhe dhe tarifat e licencimit të karburanteve si dhe debitorë nga gjobat e IMTV, por nuk janë kontabilizuar debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.</p>	E lartë	84-103	<p>Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë, duke përfshirë në gjendjen e llog.468 “debitorë të ndryshëm” debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.</p>
14	<p>Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuar për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur.</p>	E lartë	84-103	<p>Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë vlerën prej 122,396,352 lekë AA jo materiale duhet të realizojë inventarin kontabël sipas investimeve përkatëse dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.</p>
15	<p>Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) ta klasës për vitin 2022 është në vlerën 5,401,479,838 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2022 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Për Inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: llog.210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 35,028,041 lekë; llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 10,971,000 lekë, llog.212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,522,137,366 lekë ; llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,436,901,550 lekë; llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla</p>	E lartë	84-103	<p>Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të marrë masa që të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit dhe duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve në llogaritë përkatëse sipas nomenklaturës llogarive të planit kontabël publik, të bëjë rakordimin e inventareve të tyre si dhe përcaktimin e plotë të vlerës së plotë të cdo aktivi që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe pakësimet, shoqëruar me</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>pune” në vlerën 65,120,148lekë; llog.215“Mjete Transporti” në vlerën 80,921,253lekë; llog.218“<i>Inventar Ekonomik</i>” në vlerën 121,834,343 lekë nuk ka analiza të sakta e të plota dhe konstatohen gabime në klasifikimet kontabël të aktiveve në gjendjet e llogarive respektive.</p>			<p>korrektimet kontabël për amortizimet, si dhe duke i finalizuar me evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.</p>
16	<p>Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi I fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, Bashkia Kavajë”, “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, “Riforcimi I njërive individuale të banimit dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë”, “Riforcimi I njërive individuale të banimit dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, Qyteti Kavajë”, zhvilluar në periudhën 2021-2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.</p>	E lartë	103-155	<p>Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.</p>
17	<p>Nga auditimi rezultoi se në 6 raste, në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 2,095,628,721 lekë.</p>	E lartë	103-155	<p>Titullari i AK Bashkia Kavajë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.</p>
18	<p>Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e disa lejeve si vijon:</p> <p>a. Nga kontrolli në sistemin e-leje për 2 leje ndërtimi lartësia e katit përdhe në projektin e miratuar është më madhe se lartësia e lejuar në planin e përgjithshëm vendor.</p> <p>b. 6 leje ndërtimi janë në mospërputhje me planin e përgjithshëm vendor konkretisht me numrin e lejuar të kateve ose numrin maksimal.</p> <p>c. Për 5 leje ndërtimi nuk është respektuar distanca midis objektit dhe kufirit të pronës.</p>	E lartë	177-188	<p>Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, ku të jenë respektuar kushtet e përcaktura në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm për distancat nga objektet, nga rrugët kryesore, nga kufitarët, numrin dhe lartësitë e kateve, si dhe të kenë marrë miratimin nga AZHT.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>d. Për një leje ndërtimi planvendosja e mirataur nuk është e saktë pasi nuk është pasqyruar objekti kufitar 5 katësh që ndodhet në perëndim të këtij objekti.</p> <p>e. Për 2 leje ndërtimi kontrata e lidhur mes palëve dhe projekti i miratuar nuk përputhen.</p> <p>f. Për 2 leje ndërtimi nuk është respektuar koeficienti i shfrytëzimit të territorit.</p> <p>g. Për një leje ndërtimi u konstatua se ka një ngritje të kuotës 0.00 në 1.5 metër nga kuota e sistemimit.</p> <p>h. Për një leje ndërtimi projekt propozimi nuk ka marrë miratimin nga AZHT.</p>			
19	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, “Rikualifikimi i qendrës Kulturore “A.M” dhe “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, rezultuan diferenca në volume të punimeve të kryera, me pasojë dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Kavajë.</p>	E lartë	155-177	<p>Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerave përkatëse të dëmit ekonomik nga OE përkatës, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratat “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, “Rikualifikimi i qendrës Kulturore “A.M” dhe “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, vlera që përfaqësojnë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **“Opinion të modifikuar/kualifikuar”**, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduar të vitin 2022.

- Në auditimin e përputhshmërisë në fushën e shpenzimeve operative (602), investimeve (231), të fondit të pagave (601) dhe menaxhimit e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Kavajë bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali materiale por jo të përhapura, që janë baza për dhënien e një **“Opinion të modifikuar/kualifikuar”**, pasi kriteret nuk janë vendosur në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe se OE/BOE të shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST miratuara nga AK, në mos zbatimi e plotë të procedurave ligjore për shlyerjen në vlerë 837,517,800 lekë të detyrimeve të prapambetura të raportuara në MFE në fund të vitit 2022.

II.OPINIONI I AUDITIMIT

1. Opinioni i auditimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Kavajë për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një **opinion të modifikuar (me rezervë)** për llogaritë vjetore të Bashkisë Kavajë, duke arritur në përfundimin se anomali të e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2022, të shprehura në bazën për opinion.

Baza për opinionin:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinion të modifikuar (me rezervë)**¹. Në dhënien e opinionit ne jemi mbështetur në vlerën e materialitetit prej *33.314 milion lekë*, si dhe në anomali të e mëposhtme:

- Gjendja e llogarisë 411 “*Personeli, paradhenie, deficite, gjoba*” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,839,350 lekë. Gjendja e kësaj llogarije në rastin konkret paraqet vlerat debitore për kopshtet, cerdhet dhe ujsjellësin. Kjo vlerë i përket gjendjes debitore të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në kredi të llog.4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në pasiv të bilancit.

- Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë. Referuar analizës së kësaj llogarije rezulton se në gjendjen e saj janë përfshirë debitorët nga taksat dhe tarifatat për të gjithë taksapaguesit, debitorë nga kopshte e cerdhe dhe tarifatat e licencimit të karburanteve si dhe debitorë nga gjobat e IMTV, por nuk janë kontabilizuar debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

¹Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022, kapitulli 4.2, fq 54: “**Një opinion i modifikuar** jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënien e opinionin, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultatit financiar. (ISSAI 1700.7)”. Një “Opinion me rezervë”, jepet në rastet kur:

- audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se:

anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

-Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik.. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur.

- Nga shqyrtimi i analizave të llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2022 u konstatua se:

Pasqyrat financiare për llogaritë e mëposhtme, nuk japin siguri se pasqyrojnë vlerën e saktë të aktiveve, pasi për inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 35,028,041 lekë; llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 10,971,000 lekë, llog.212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,522,137,366 lekë ; llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 3,436,901,550 lekë; llog.214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 65,120,148lekë; llog.215 “*Mjete Transporti*” në vlerën 80,921,253 lekë; llog.218 “*Inventar Ekonomik*” në vlerën 121,834,343 lekë nuk ka analiza të sakta e të plota dhe konstatohen gabime në klasifikimet kontabël të aktiveve në gjendjet e llogarive respektive. Gjithashtu ka paqartësi në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivit, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve dhe pakësimet të secilit aktiv. Në këto inventare kontabël janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2022 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo emërtesë aktiv. Mungon regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme, që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

- Shuma prej 765,762,093 lekë e gjendjes së llog. 401- 408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në vlerën 150,519,732 lekë dhe llog.467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në vlerën 615,242,361 lekë nuk rakordon me vlerën prej 837,517,800 lekë të detyrimeve të prapambetura të raportuara në MFE në fund të vitit 2022.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Kavajë.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që

jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

2. Opinioni mbi përputhshmërinë

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 4000 shprehim një **opinion të modifikuar**² për përputhshmërinë, për periudhën e auditimit nga data 01.10.2021 deri më datën 31.12.2022, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale, por jo të përhapura.

Baza për opinionin:

- Nga verifikimi rezulton se GMS I ngritur në Bashkinë Kavajë nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.
- Detyrimet e prapambetura të palikujduara të raportuara në MFE në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 837,517,800 lekë, të cilat nuk rakordojnë me gjendjen e llogarive të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit për vlerën 71,755,707 lekë.
- Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 43 % kundrejt fondeve të miratuara dhe kundrejt shpenzimeve faktike është 57%, situatë e cila tregon se, Bashkia Kavajë mund të konsiderohet në vështirësi financiare, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është mbi nivelin prej 25 %..
- Në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet “Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi I fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, Bashkia Kavajë”, “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-^{re}”, “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, Qyteti Kavajë”, zhvilluar në periudhën 2021 - 2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
- Në 6 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 2,095,628,721 lekë.
- Nga auditimi i lejeve të ndërtimit nëpërmjet sistemit e-leje, janë gjetur shkelje ligjore në lidhje me respektimin e koeficientit të shfrytëzimit, numrin e kateve të lejuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, lartësitë e kateve, etj..
- Për një periudhë 18 mujore nga fillim viti 2021 e deri në korrik 2022 rastet e konstatuara me ndërtime në kundërshtim me ligjin janë shumë të larta, shkak ky i menaxhimit të dobët nga drejtuesit e IMTV-së për këtë periudhë, e që për pasojë ka sjellë efekte negative në këtë drejtim. Mos mbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore sjell pasoja negative jo vetëm në mbrojtjen e territorit , por edhe në shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja informale.

² “Opinion i modifikuar”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në veprimtarinë e njësive vendore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kavajë:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Kavajë.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

III.HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 207/1 Prot, datë 10.03.2023, i ndryshuar me shkresën nr. 207/2, datë 12.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 10.03.2023 deri në datën 05.05.2023, në subjektin Bashkia Kavajë u krye “Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 dhe Auditimi i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022”. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

A.Z – Përgjegjës Grupi

I.Sh– Anëtare

K. F – Anëtare

R. L– Anëtar

E.Rr - Anëtar

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Raport Përfundimtar i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Kavajë.

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Kavajë kishte si objektiva kryesore:

Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;

Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Kavajë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raport Përfundimtari i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Kavajë dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

³Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Kavajë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Kavajë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;

Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;

Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

“VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.

VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;

VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;

Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Kavajë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;

ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.

ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";

ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Kavajë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale⁴.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-J^a aplikon⁵.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

⁴ ISSAI 1315

⁵ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin “Bashkia Kavajë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Kavajë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Zona Gjeografike: Bashkia e Kavajës kufizohet në veri nga Bashkia Durrës, në lindje nga Bashkia Tiranë, në jug nga Bashkia Rrogozhinë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Qendra e kësaj Bashkie është qyteti i Kavajës.

Bashkia e Kavajës është pjesë e Qarkut Tiranë dhe përbëhet nga 5 njësi administrative të cilat janë: (Kavaja, Synej, Luz i Vogël, Golem dhe Helmas). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 32 fshatra.

Qendra e Bashkisë	NjA	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë
	Synej	Synej, Butaq, Rrikaj, Hajdaraj, Peqinaj, Rrakull, Bago
	Luz i Vogël	Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerimaj
	Golem	Golem, Kryemëdhënj, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qerret, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonas, Karpen i Ri

	Helmas	Helmas, Zikular, Lis-Patros, Shtodhër, Cetë, Momël, Habilaj, Collakaj, Kryezi, Cikallesh
--	--------	--

Organizimi i Bashkisë Kavajë:

Bashkia Kavajë ka nën varësi njësitë shpenzuese:

Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve;

(Sektori i Çerdhes së Qytetit në Drejtorinë e Shërbimit Social)

Drejtoria Ekonomike e Arsimit;

(Agjencia e Arsimit Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Para Universitar dhe Qendrat Kulturore)

Drejtoria Ekonomike e Kulturës;

(Drejtoria e Kulturës)

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;

Sektori M.Z.SH (Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi)

Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore;

(Drejtoria e Kadastrës Urbane Dhe Menaxhimit të Aseteve Publike)

Sport Klub B.

(Sektori i Shumë Sporteve)

Administrata e Bashkisë Kavajë dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të saj, përbëhen nga:

-Këshilli Bashkiak (punonjës), Sekretari i Këshillit (1), Punonjës Sekretarie (1);

-Kryetari (1), Zv. Kryetari (3), Drejtori (13), Sektorë (36), 6 Njësi me funksione të ndryshme, Njësia e prokurimit, Auditimit të brendshëm, Njësi Administrative (4); Policia Bashkiake (1 Kryeinspektor), Inspektor (1), Policë (22), Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (1 Kryeinspektor), Specialist (1), Inspektor (8), Gjendja Civile (1 Përgjegjës) dhe Punonjës/Specialist (6), Qendra Kombëtare e Biznesit (4 Specialist), Punonjës të shërbimit publik (70);

Funksionet kryesore të Bashkisë Kavajë kryhen në fushën e:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
- Shërbimeve sociale.
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
- Mbrojtjes së mjedisit.
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.
- Zhvillimit ekonomik vendor.
- Sigurisë publike.

REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-s

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nësesistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;

- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Kavajë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Kavajë nuk ka Kod të Etikës, por në nenet 35 dhe 36 të Rregullores së Brendshme, janë përfshirë 17 rregulla të etikës, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojë cdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë hartuar rregullore, ku një rregullore me nr.3726 prot., datë 02.12.2021 “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Kavajë” dhe me nr.3727 prot., datë 02.12.2021 “Rregullore për hartimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja”. Në Rregulloren e Brendshme në nenin 35 janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjisllacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Për shkeljet e administrative në lidhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit publik” në nenin 90 të Rregullores së Brendshme janë parashikuar përgjegjësit administrative dhe sanksionet. Për cdo vit është hartuar raporti i Njesisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, me shkresat përkatëse, depozituar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI) me shkresë nr.126 prot., datë 12.01.2022. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e protokoll-arkivit), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë, në strukturën e cila do të trajtoj ankesat dhe kërkesat, strukturë e cila nuk është përcaktuar. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 34 të Rregullores së Brendshme.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat e dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkyetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull jo

gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore, por raportimi është realizuar për periudha 3-mujore e 6-mujore. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial. Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Audit i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Kavajë me Vendimin e Kryetarit nr.3223, datë 02.12.2016.

-Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave të rrumbullakëta me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për degjesat me publikun.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

-Bashkia Kavajë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

-Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

-Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Në 3 raste të testuara të rekrutimit rezultoi se ishin kryer procedurat në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmbanë dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose tëspecializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Ka një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha

të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Kavajë është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave.

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për cdovit. NA për cdo vit nuk ka nxjerrë Urdhrat e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.

Në lidhje me parimin 5 “ Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”. Në Rregulloren e Brendshme në pikën (12.2) të nenit 12 është parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “kodi i Procedurave Administrative”si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokoli i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”Titullari i Bashkisë nuk ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2022 për hartimin e PBA 2021-2023 nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik. Në rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, duke përfshirë dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS),për të cilin nuk përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij:

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk e kryer detyrat si:

-Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

-Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva. **Bashkia Kavajë** në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Kavajë.

Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe nëdëgjesat me publikun. Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”. Në Bashkinë Kavajë ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e kordinatorit të riskut, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Është hartuar rregjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, por jo për të gjitha Drejtoritë janë evidentuar rrisqet dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë. Duke mos u përcaktuar kordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

Krahas vlerësimit të riskut ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë rrisht për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e kordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “ Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Kavajë në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga rishikimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “ Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj)- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga

Përgjegjësi i Financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë(NA). Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit përbëhet nga 12 punonjës, 1 drejtor, 2 përgjegjës Sektori.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Në Rregulloren e Brendshme “ “Specialisti i Arshivës,” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshmenë detyrat e drejtorisë Ekonomike nenet 62-72, por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pikësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Kavajë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme mungojnë detyrat dhe përgjegjësitëe specialistit të IT, funksion i cili është i Sektorit të Programeve të Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës pranë Drejtorisë së Projekteve Strategjike të Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës. Sipas të dhënave të siguruara nëpërmjet intervistës së bërë me specialistin e IT rezulton se ka vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterat e bashkisë. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, fireëall-et, kufizimin e ndërhyrjeve në të dhënat e IT. Faqja Zyrtare e bashkisë Kavajë në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste të dëmtimit të tyre.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për

funksionimin e drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm sipas strukturës organizative, të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenet 62-72 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Burimeve Ekonomike për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtoria e Shërbimeve Publike, Transportit, Infrastrukturës dhe Mjedisit. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive neni 62 dhe 63 të rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilzimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimine listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtoria. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jep opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtesit në Bashkinë Kavajë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit. Ka Raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo 3 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe MFE.Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 është në vlerën 3 mijë lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

- Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Kavajë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel dhe me program kontabiliteti “Alfa”, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimet apo evidentiminë SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistet e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel dhe program të veçantë që i menaxhon Drejtoria e Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me

Degën e Thesarit Kavajë për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Mbahen akt-rakordimet me Agjentët Tatimorë si Ujësjellësi, DRT, AKSH etj. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumenta financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Përaktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimikryhen procedurat për nxjerrjen jashtëpërdorimit në bazë të disponitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm. Ka faqen e saj zyrtare. Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 13 “Informimi publik”, neni 13 “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të administratës së Bashkisë, neni 14 “Marrëdhëniet me Këshillin bashkiak”, neni 16 “Marrëdhëniet me publikun, transparenca e njësive të vetëqeverisjes vendore”. Në rregulloren e brendshme në nenin 15 janë përcaktuar procedurat e komunikimit me median.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohet çdo 3 muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmet të mundshme. Në përdorimin e emailit zyrtar kanë akses të gjithë punonjësit, por komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Kavajë janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

- Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Nga Bashkia Kavajë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen e objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia, monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave,

- Për **vitin 2022** me shkresën nr.1733 prot., datë 03.05.2023, janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë Bashkia Kavajë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit nëpyetësorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.
4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet: Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Në Bashkinë Kavajë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime si nga KLSH ashtu dhe nga Njesia e Auditit të brendshëm.

- Në Bashkinë Kavajë aktivitetet e vlerësimit të njesisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshme dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm për të gjitha subjektet e audituara duke e trajtuar atë si pike të vecante .

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetaren e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

-Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës “Sektorin e Menaxhimit të Aseteve”, “Drejtorisë së Projekteve Strategjike të Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës” dhe të specialistit të IT.

“Menaxhimi i Riskut”

Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve e për pasojë dhe mungesës së veprimtarisë së tij, ka sjellë mos identifikimin e vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kavajë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të

dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016

Titulli i gjetjes: Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës “Sektorin e Menaxhimit të Aseteve”, “Drejtorisë së Projekteve Strategjike të Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës” dhe të specialistit të IT.

“Menaxhimi i Riskut”

Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve e për pasojë dhe mungesës së veprimtarisë së tij, ka sjellë mos identifikimin e vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë

nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kavajë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria Ekonomike, gjatë planifikimit të buxhetit, të marrë masa për planifikimin e trajnimeve të punonjësve, në mënyrë të tillë për mabrëvajtjen e punës në bashki, sa i përket pozicioneve të punës përkatëse për secilin punonjës.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë Juridike të ngrejë grupin e punës për kryerjen e planit të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

2. Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

-Organizimi dhe funksionimi i strukturës së sektorit të Auditit të brendshëm:

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Kavajë, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, funksionon në nivel Sektorit .

Per vitin 2022 struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është miratuar me Vendim të Titullarit të Njesisë Publike nr.01,datë 05.01.2022 me përberje 3 (tre) punonjës ,Përgjegjës 1(një) ,Specialistë 2 (dy).

Në mbështetje të ligjit nr.114 , datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10 pika 2 varësia direkte e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është nga titullari i institucionit (Kryetari i Bashkisë).

-Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njesisë së auditimit tëbrendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës se burimeve njerëzore në Bashkinë Kavajë, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2022, është organizuar me 3 punonjës, në nivel sektori me strukturë 1 përgjegjës sektori dhe 2 auditues. Punonjësit e Njesisë janë të gjithë me arsim të lartë dhe konkretisht dy punonjës (përgjegjësi dhe një auditues) janë të diplomuar në fushën e ekonomisë dhe një auditues është i diplomuar në Inxhinieri Matematike, në Analizë Sistemesh , gjithashtu i gjithë stafi është i certifikuar dhe është me përvojë pune në fushën e auditimit.

Përgjegjësja e Njesisë është e certifikuar me përvojë pune në auditim mbi 29 vite dhe përvojë profesionale 33 vite, një auditues i certifikuar me 18 vite në auditim dhe 38 vite përvojë profesionale dhe një auditues i certifikuar me 3 vite në auditim dhe përvojë profesionale 6 vite.

Gjatë vitit 2022 nga punonjësit e Njesisë së Auditimit të Brendshëm janë ndjekur trajnimet e vijueshme dhe të detyrueshme organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtoria Njësia e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Struktura e kësaj njësie auditimi, ne formë tabelore për periudhën e audituar për vitin 2022, paraqitet si me poshtë:

Tabela nr.1: Punonjësit e Njesisë së Auditit të Brendshëm

Burimi: Njësia e Auditit të Brendshëm.

Nr	Periudha	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
	Për vitin 2022						
1	Z.SH	Përgjegjës Nj.AB	Ekonomiste	33	29	Në vitin 2010	Po
2	F.T	Spec. Auditit	Ekonomiste	38	18	Në vitin 2010	Po
3	E.T	Spec. Auditit	Inxhiniere	6	3	Në vitin 2021	Po

Burimi:Përpunuar nga grupi i Klsh-së

Dokumentacioni bazë mbi të cilën ushtron aktivitetin Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Grupi i auditimit shqyrtoi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit te veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, ku konstaton se dokumentacioni baze mbi te cilën ushtron veprimtarinë NjAB, është si me poshtë:

1.Karta e Auditimit të Brendshëm(e përditësuar) në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Bashkia Kavajë, është miratuar me shkresën nr. 3213 Prot., datë 19.10.2021, dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 3213/1 prot, datë 19.10.2021.

2. Plani strategjik si dhe plani vjetor, për vitin 2022, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të MABP, si dhe te nenit 14, te ligjit nr.

114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm (kap. III).

-Plani Vjetor i Auditimit për Vitin 2022 është miratuar me shkresë nr.3124 Prot., datë 12.10.2021, gjithashtu është hartuar dhe miratuar Plani-Strategjik i Auditimit për periudhën 2022-2024 me shkresë nr.3184 Prot, datë 19.10.2021 si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr.2697/1 Prot , datë 19.10.2021. *Planet vjetore të auditimit* si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kritere e procedura të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

Në planet vjetore të auditimit janë përfshirë për auditim sistemet me risk të lartë, të mesëm dhe të ulët ku drejtimit kryesore të auditimit kanë qënë:

-Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, si nga audituesit e brendshëm po kështu dhe nga auditimet e realizuara nga audituesit e jashtëm (KLSH).

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në përputhje me legjislacionin, për arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës së njësive qeverisjes vendore.

-Vlerësimi i veprimtarisë së entitetit mbi menaxhimin efektiv të financave të Institucionit, menaxhimi i taksave, tarifave vendore të ardhurave dhe borxhit, menaxhimi i shërbimeve publike, si dhe menaxhimi i burimeve njerëzore si aset me peshë me potenciale në impaktit që jep në implementimin e veprimtarisë së Njësive.

-Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura.

-Vlerësimi i veprimtarisë së sektorit të ndihmës ekonomike

-Vlerësimi i rregullshmërisë ligjore baze dhe mbështetëse si dhe rregullorja që drejton veprimtarinë e subjektit.

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, referuar kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar **Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësozin e vetëvlerësimit** për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 352/1 prot, datë 13.02.2023. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është hartuar **Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë** dhe performancës së auditimit të brendshëm i cili është i miratuar me shkresë nr.3887 prot ,datë 15.12.2021 dhe dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 3887/1 prot, datë 15.12.2021, i cili përcakton nëse procedurat janë zbatuar në përputhje me standartet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, kartën, rregulloren e brendshme dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për fushën e auditimit të brendshëm.

Veprimtaria e AB për periudhën 2022, i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB, e cila paraqitet si me poshtë:

I. Është realizuar angazhim **“Auditimi i kombinuar”**, në Bashkinë Kavajë, në zbatim të planit vjetor 2022, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 3124 prot, datë 12.10.2021, dhe programit të angazhimit me nr. 4090/1 prot, datë 25.11.2022, ku është audituar **“Vlerësimi i sistemit mbi detyrimet e prapambetura”**, për periudhë auditimi deri më 31.12.2021.

Qëllimi i kryerjes së këtij auditimi ishte Vlerësimi paraprak i lindjes së detyrimeve financiare të prapambetura, klasifikimi i tyre sipas standarteve të kontabilitetit publik dhe kohës së krijimit të

detyrimeve për çdo kategori, monitorimi i shlyerjes, si dhe përgatitjen e planit të masave për parandalimin e krijimit të këtyre detyrimeve në të ardhmen.

Nga vlerësimi i kryer nga grupi i auditimit të brendshëm të Bashkisë Kavajë, është konstatuar se: **A- Në Bashkinë Kavajë**, gjendja e detyrimeve të prapambetura deri me datën 31.12.2021, është në vlerën prej **730.464.832 lekë** i cili përbëhet nga :

I- Borxhe (a+b)	35,628,212 Lekë
a- Hua afatgjatë	35,628,212 Lekë
b-Hua afatshkurtër	-
II- Detyrime (a+b+c)	694,836,620 Lekë
a-Shpenzime korrente	582,159,641 Lekë
b- Shenzime kapitale	52,148,568 Lekë
c-Vendimegjyqësore	60,528,411 Lekë
III- Totali (I+II)	730,464,832 Lekë

Sic shihet zëri “Mallra dhe Shërbime” zë peshën më të madhe të stokut të detyrimit me rreth 79,7 %, zëri “Investime” me rreth 7,2 %, “Vendime Gjyqësore” me rreth 8,2% dhe zëri “ Borxhi” me 4,9 %. Këto detyrime janë krijuar si rezultat i paaftësisë paguese e cila ndër të tjera është edhe si pasojë e mosrealizimit ndër vite të planit të të ardhurave .

B-Nga evidenca vjetore “ Mbi situatën financiare të Bashkisë Kavajë për vitit 2021 “ rezulton se raporti i stokut të detyrimeve (**730.464.832 Lekë**) / me totalin e shpenzimeve të miratuara (**1.240.120.709 lekë**) është **58.9%** domethënë është **> 25%**. Pra Bashkia Kavajë ndodhet në **Situatën e “Vështirësisë Financiare “**

Si konkluzion, nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk është zbatuar me përpikëmeri Udhëzimi nr.26 , datë 27.09.2019 “Procedurat për Menaxhimin e Vështirësisë Financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore “ si dhe nuk është kryer një analizë e thelluar e detyrimeve të krijuar ndër vite nga pamjaftueshmëria e aftësisë paguese, si dhe shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në krijimin e situatës së “Vështirësie Financiare “.

II. Është realizuar angazhim **“Auditimi i kombinuar”**, në Bashkinë Kavajë, në zbatim të planit vjetor 2022, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 3124 prot, datë 12.10.2021, dhe programit të angazhimit me nr. 3678/1 prot, datë 24.10.2022, ku është audituar **“Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të taksave, tarifave vendore të ardhurave dhe borxhit ”**, për periudhë auditimi deri më 31.12.2021. **Qëllimi** i kryerjes së këtij auditimi ishte vlerësimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Taksave ,Tarifave Vendore , të Ardhurave dhe Borxhit për programimin , realizimin e të ardhurave dhe për ndjekjen e detyrimeve debitore (Borxhit), si dhe për të dhënë rekomandime për përmirësimin e punës në të ardhmen .Nga vlerësimi i kryer nga grupi i auditimit të brendshëm të Bashkisë Kavajë, është konstatuar se: **A- Në Bashkinë Kavajë** për periudhën Janar – Dhjetor 2021 të Ardhurat e Planifikuara janë 543.380.000 lekë dhe të Realizuara 418.673.614 lekë ose 77% , pra kemi një mosrealizim prej 124.706.386 lekë . Nga Drejtoria e Taksave ,Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit të analizohen mangësitë e konstatuara lidhur me mosrealizimin e të ardhurave për çdo zë si dhe të hartohet një plan masash i detajuar për realizimin e tyre. Gjithashtu të rritet bashkëpunimi me Drejtoritë e tjera në veçanti me Drejtorinë e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit si dhe me Njësitë Administrative të cilët kanë detyrim ligjor realizimin e të ardhurave të Bashkisë .

B-Referuar evidencës vlera debitore deri me datë 31.12.2021 është **681,029,205 lekë** ku vlerën më të madhe e zënë : Detyrimet e Biznesit të Vogël , Biznesit të Madh dhe Fshatrat Turistik Golem prej 485.852.349 lekë ose 71.3% të gjendjes debitore. Nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore , të Ardhurave dhe Borxhit të ndiqen të gjitha rrugët administrative ligjore për arkëtimin e

detyrimeve të paarkëtuara nga subjektet fizikë / juridikë. Nëse edhe pasnjofimeve zyrtare bizneset , nuk pranojnë të paguajnë detyrimet , të merren masa administrative aposekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kalëzim penal.

Gjatë periudhes Janar – Dhjetor 2022Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Bashkisë Kavajë ka realizuar 8 (tetë) misione auditimi nga 8 (tetë) misione auditimi të planifikuara sipas Planit Vjetor të miratuar nga Titullari i Njësies Publike me shkresën nr. 3124 Prot, datë 12.10.2021 , nga ku **6 Auditime të Kombinuara dhe 2 Auditime Përputhshmërie .**

1.Nga auditimi i pranimit, vlerësimit dhe zbatimit të rekomandimeve në *Bashkinë Kavajë*, u konstatua se për vitin 2022 janë dhënë gjithsej 52 rekomandime të detajuara si mëposhtë vijon :

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, janë dhënë dhe pranuar gjithsej 8 rekomandime, nga të cilët 8 rekomandime janë në proces zbatimi.

- Rekomandime të karakterit organizative, janë dhënë dhe pranuar gjithsej 8rekomandime, nga të cilët 8 rekomandime janë në proces zbatimi.

- Rekomandime të karakterit për arkëtim, nuk është dhënë asnjë rekomandim.

- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, nuk është dhënë asnjë rekomandim.

- Rekomandime të karakterit të tjera, janë dhënë dhe pranuar 36 rekomandime, nga të cilat janë në proces zbatimi 36 rekomandimet.

1.Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm.

Nga ana e Njësies së Auditimit të Brendshëm Bashkia Kavajë, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të AB kapitulli IV, pika 4.1.1 “*Planifikimi i një angazhimi*”, ku nga ana e grupit të auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake të subjektit që do të auditohet me subjektin, veprime të cilat janë të dokumentuara me shkrim në procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të angazhimit. Gjate kryerjes së angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si Autorizimin për fillimin e auditimit, Njoftimin paraprak për fillimin e angazhimit, takimin fillestar, deklaratën e konfliktit të interesit, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejttimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj. Janë respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.6 “*Përgatitja e programit të angazhimit...*”, ku për të arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si fusha prioritare duke planifikuar, auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ndjekjen e detyrimeve debitore (borxhi), menaxhimi i burimeve njerëzore, vlerësimi i sistemit mbi detyrimet e prapambetura etj., pra rezulton se janë zbatuar drejt kriteret, lidhur me fushat prioritare për auditimin e subjekteve, pasi ato kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimtarisë në përputhje me risqet e subjekteve. Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimit dhe grupin e punës.

2.Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.

Nga NJAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një

misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj. Për rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare. Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kap. II te MAB. Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të kapitullit VI “*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, e konkretisht:

1. Autorizimi

2.Njoftimi paraprak për auditim, duke përcaktuar periudhën që do të kryhet auditimi.

3.Hartimi i Planit të Angazhimit, miratuar nga Titullari në të cilën janë evidentuar:

Tematika e Auditimit, Referencat Ligjore, Grupi i Auditimit, Afati i kryerjes së procesit të Auditimit.

4.Takimi i Hapur.

5.Deklarata e Konfliktit të Interesit të Audituesit të Brendshëm.

6.Formulari i Vlerësimit të Mjedisit të Kontrollit.

7.Formulari i Vlerësimit të Rrisqeve.

8.Testet Individuale

9.Në përfundim të procesit të auditimit, grupi i auditimit në bazë të shënimeve të marra gjatë procesit të auditimit harton Projekt - Raportin e Auditimit së bashku me Shkresën Përcjellëse të miratuar nga Titullari i Njësise Publike.

10.Në Takimin Pajtuës janë ballafaquar faktet e konstatuara, pas sqarimit të problematikave.

11.Përpilon Planin e Veprimit të Sygjeruar.

12.Eshtë bërë Hartimi i Raportit–Final së bashku me Shkresën Përcjellëse të miratuar nga Titullari i Njësise Publike.

13.Plani i Veprimit nga subjekti i audituar ku janë përcaktuar:

Niveli i rekomandimit, Afatët për zbatimin e rekomandimeve, Personat përgjegjës.

14.Memorandumi e cila përfshin përfundimet e auditimit së bashku me Shkresën Përcjellëse të miratuar nga Titullari i Njësise Publike.

15.Regjistri i Rekomandimeve të lëna për çdo subjekt të audituar.

16.Feed-back.

17.Nga P/Njësise së Auditimit të Brendshëm për çdo subjekt të audituar është bërë Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë.

18. Sigurimi i Cilësisë, Monitorimi i Vazhdueshëm

19.Inventari i Dosjes dhe Arshivimi i saj.

3.Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese.

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i punës konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

4. Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese.

Nga njëësia e AB të bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim. Mbi rezultatet e auditimit për vitin 2022, të dhënat janë dhe në pasqyrat shoqëruese bashkëlidhur materialit.

Konkluzion: Nga auditimi i kryer në Bashkinë Kavajë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se sektori i Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga Klsh-ja.

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kavajë, përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022.

Situata: Nga auditimi i kryer në Bashkinë Kavajë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se sektori i Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga Klsh-ja.

Kriteri: Nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyrojnë aktivitetin e drejtorive.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kavajë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga Klsh-ja, për të pasqyruar aktivitetin e drejtorive për mbarëvajtjen e punës në bashki.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.1. Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

➤ **Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor**

• **Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2022-2024**

PBA 2022-2024 është përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat

e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzime korrente, investime dhe të ardhurat. Theksojmë se për investimet nuk janë paraqitur në mënyrë të detajuar në nivel projekti referuar dhe burimeve të financimit, duke llogaritur kostot. PBA 2022 është miratuar me VKB nr 109, datë 23.12.2021. Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresat përkatëse.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të hartimit të PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Kavajë nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore si:

- Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 29 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde”.

- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor (e cila duhej miratuar brenda datës 31 dhjetor të vitit përkatës), në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33/1 i cili përcakton; “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2022-2024 dhe buxheteve vjetore, rezulton se nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kavajë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse në kundërshtim të cilët nuk ka urdhër për ngritjen e EPM (Ekipet e menaxhimit të programeve) për përgatitjen e PBA dhe buxhetit vjetor 2022 në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, pasi mungojnë dokumentet e evidentimit të kryerjes së këtyre konsultimeve. Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ndërmarrja e shërbimeve dhe ujësjellësi, etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohej buxheti.

- Nuk janë respektuar afatet kohore në miratimin nga ana e Këshillit të dokumenteve të projekt buxhetit afatmesëm dhe nuk është bërë publikimi i këtij dokumenti brenda datës 5 korrik.

- Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/ç, 33/1, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024).

- Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Buxheti vjetor për vitin 2022 është miratuar me Vendim të KB nr. 109, datë 23.12.2021 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tirane me shkresën nr.2043/1, datë 30.12.2021, konkretisht sipas pasqyrës së mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i viti 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëg. nga viti paraardhës (pa destinacion)	30,000	
2	Transferta pakush. trashëg.viti paraardhës	0	
3	Trashëguar nga Transferta specifike	22,811	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	505,034	
5	Transferta e pakushtëzuar	226,373	
6	Transferta specifike	208,651	
8	Paga (600)		386,715
9	Sigurime shoqërore (601)		64,631
10	Shpenzime operative (602)		408,433
11	Fondi rezervë		7,047
12	Fondi I kontigjencës		7,047
13	Investimet (230 +231) nga Të ardhurat e Tr. Pakush.		103,320
14	Transferta buxhetore familjare llog.604		7,530
	Emergenca Civile		8,217
Totali i buxhetit		992,939	992,939

Sipas tabelës së mësipërme buxhetii vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa deficite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 992,939 mijë lekë.

Buxheti nuk është hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë dhe njësitë vartëse etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohet buxheti.

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA-ja 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar viti 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhur, grant i pakush. e spec.)	451,345	412,339	39,006
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtëz e specifik)	438,273	411,849	26,424
3	Investime Bashkia (nga të ardhura dhe grant i pakushtëzuar)	103,320	99,150	4,170
4	Investime nga FZhSh	0	0	0
Total i planit fillestar		992,938	923,338	+69,600
	Shtesat nga Pushteti Qendror	-	-	0
1	Investime grant i kushtëzuar	-	-	0
2	Shpenzime për pagat (600+601)	-	-	0
3	Shpenzime (602.604.609)	-	-	0
	Grant i kushtëzuar (230-231)	-	-	0
Gjithsej				

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2022 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2022-2024, rezulton se ka diferencë prej + 69,600 lekë mbi tavanin e përcaktuar në PBA.

Me VKB nr. 15 datë 22.02.2022 të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë e shkresën nr.prot.348/1 datë 01.03.2022 është bërë rishkimi I buxhetit në lidhje me rishpërndarjen e të ardhurave të trashëguara, duke sjellë shtesa ndaj planit fillestar në burime financimi dhe shpenzime.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i viti 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëg. nga viti paraardhës	62,605	

2	Transferta pakush. trashëg.viti paraardhës	57,768	
	Transferta pakush. trashëg.fondi I rindertimit	371,083	
3	Trashëguar nga Transferta specifike	72,526	
8	Paga (600)		14,453
9	Sigurime shoqërore (601)		3,657
10	Shpenzime operative (602)		118,914
11	Fondi rezervë		0
12	Fondi I kontigjencës		0
13	Investimet (230 +231) nga Të ardhurat e Tr. Pakush.		251,003
14	Transferta buxhetore familjare llog.604		169,299
	Emergenca Civile		6,656
Totali i buxhetit		563,982	563,982

➤ **Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti fillestar me shtesat e trashëguar për vitin 2022 është 1,556,921 mijë lekë.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kavajë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Bashkia Kavajë dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë ka pësuar ndryshime gjatë vitit, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Kavajë.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, investime për rindërtimin nga pasojat e tërmetit etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Kështu **në vitin 2022** kanë ndodhur 4 ndryshime në vlerën 46,051 mijë lekë si dhe një shtesë fondi në vlerën 146,128 mijë lekë nga MFE për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në llog.602 “Mallra e shërbime” të krijuara sipas programeve përkatëse. Pra kemi pak lëvizje të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor Ndryshimet buxhetore për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Buxheti Fillestar		VKB	VLERA	Llog.	Emertimi I zerit	Pakesohet	Shtohet
Nr/ datë miratimi	Vlera	VKB nr.88 dt.15.09.2022	35,100,000	230	Hartim I Planit Vendor te Menaxhimit te Mbetjeve	1,154,845	
VKB nr. 109 dt 23.12.2021	992,939.0					5,155,000	
V.K.Bnr.15, dt 22.02.2022	563,982,055			230	Hartim I Vlersimit Strategjik Mjedisor	700,000	
				230	Hartim I Projektit Zbatimit per Vend depozitim	700,000	
				602	Menaxhimi Mbetjeve	20,000,000	
				230	Studim Projektim	5,000,000	
				602	Mirmbaj e kaldajae sisteme hidraulike te institucio ne varesi te bashki	1,200,000	
				602	Blerje Asfalti	6,000,000	
				602	Pagesa per energjine elektrike		19,600,000
				602	Pagesa per energjine elektrike		1,154,845
					Totale	35,100,000	35,100,000
		urdheri nr.300 dt1.08.2022	5,591,471	231	Parku rekreativ Faza IV	5,000,000	
				231		591,471	
				602	Shpronese unaza Lindore		4,000,000
				602	Blerje materiale		591,471
					Totale	5,591,471	5,591,471
		VKB 29 d.23.03.2022	1,259,190	602		1,259,190	
				232			1,259,190
					Totale	1,259,190	1,259,190
		Urdh300/1dt.14.10.2022	4,100,000	602	Riparim Automjetesh	4,100,000	
				231	Blerje minieskavator		4,100,000
VKB R.116 DT.14.12.2022	146,128,000			602	Programi 1110 detyrime të prapambetura		45,111,768
				602	Programi 3140		243,200
				602	Programi 6140		10,163,802
				602	Programi 6440		1,737,680
				602	Programi 1710		2,000,000
				602	Programi 5100		29,155,405
				602	Programi 6260		6,454,586
				602	Programi 8220		1,122,180
				602	Programi 9120		1,342,800
				602	Programi 10430		410,400
				231	Investime dety te prambetura 4520		18,386,179
				602	Programi 8130		6,000,000
				602	Programi 5100		14,000,000

Burimi: Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Kavajë

➤ **Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kavajë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Kavajë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi I llogarive ekonomike	Plan	Fakt	Realizimi në përqindje
1	Paga 600	408,588	372,057	91%
2	Sigurime shoqërore 601	69,536	62,026	89%
3	Shp.Oper.602+F.Rezervë	630,465	548,763	87%
4	Kredia+Interesi 166-651 (CEB)	2,000	0	0%
4	K. Q Emergj Civile 604	14,012	0	0%
5	Nd/Ekonom invalid 606+te tjera (ndihma nga të ardhurat e Bashkise dhe grantet)	721,677	583,024	81%
	a. Nd/Ekonom invalid 606+te tjera	261,238	259,226	99%
	b. Bonus qeraje+bursa+ndihme financiare+bonuse nga rindertimi	460,439	323,798	70%
6	Investime 230-231	821,671	490,561	60%
	Totale	2,667,949.00	2,056,431.00	77%

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2022** fondet buxhetore janë realizuar 2,056,431 lekë nga 2,667,949 lekë të planifikuara, ose në masën 77%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar realizimi në masë të ulët në zërit të buxhetit llog.231 “Shpenzimet për investime” në masën 60%, pasi fondet e alokuara nga Ministria e Rindertimit janë celur vetëm 20% e vlerës të investimit.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për paga, ndjekur nga shpenzimet për investime dhe shpenzimet operative, tregues të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI	Përqindja e shpenzimeve ndaj totalit viti 2022 Bashkia
1.	Shpenzimet operative	41%
2.	Investime	14%
3.	Shpenzime për paga	45%
4	Investime 230-231 FZHR	0

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës

Me miratimin e buxhetit është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2022 është planifikuar në masën 14.092 mijë lekë, i cili nuk është përdorur .

Miratimi i realizimit faktik i buxhetit

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Kavajë nuk është hartuar raporti për buxhetin faktik të vitit 2022 i shoqëruar me një analizë faktoriale për realizimin e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

➤ Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2022 është përgatitur raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit, por jo në mënyrë periodike për çdo 4-mujor, në kundërshtim me ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”, me ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65.

Titulli gjetjes: Mbi mangësitë e konstatuara në programimin, realizimin dhe monitorimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.

Situata:

Nga auditimi i hartimit të PBA-ve 2022-2024 si dhe i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit vjetor 2022, u konstatua se:

a. Dokumenti i PBA paraqitet i mangët pasi:

- Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik,
- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor.
- Nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kavajë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, për të cilët nuk ka urdhër për ngritjen e EPM (Ekipet e menaxhimit të programeve) për përgatitjen e PBA dhe buxhetit vjetor 2022.
- Nuk janë respektuar afatet kohore në miratimin nga ana e Këshillit të dokumenteve të projekt buxhetit afatmesëm.
- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, nuk është bërë detajimi për çdo program i detyrimeve.

b.Buxheti për vitin 2022 është realizuar 2,056,431 mijë lekë nga 1,400,833 mijë lekë të planifikuara 2,667,949 lekë ose në masën 77%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 606 “Transfertat tek individet” në masën 81%, pra kemi akordim fondesh me rezervë pushteti qendror dhe zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 60%, nga mos realizimi i projekteve në vlerë të plotë, marrjes së angazhimeve dhe lidhjeve të kontratave si dhe financimeve vonesë.

c.Për vitin 2022, të ardhurat janë realizuar në masën 112%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën **705,828**mijë lekë.Referuar këtyre treguesvetë të ardhurave të realizuara konstatohet se, financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën 74% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, fondet e rindërtimit dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 24% nga të ardhurat e veta.

d.Për vitin 2022 është përgatitur raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit, por jo në mënyrë periodike për çdo 4-mujor.

Kriteri:

Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/ç,33/1,34,35, 36,37,39,40,41,48, me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024, me ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 65, meUdhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 161.

Impakti:

Mos programim të buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash reale përtej mundësive të financimit, duke sjellë mos uljen e detyrimeve prapambetura ndaj të tretëve.

Shkaku:

Punë e pamjaftueshme nga drejtuesit e programeve dhe veçanërisht sektori i buxhetit

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe ne bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që planifikimi i shpenzimeve buxhetore PBA dhe të vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesat me publikun me palët e interesit.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomiketë marrë masa që, me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të përgatisë raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit (4 mujore),jo vetëm vjetore, duke i paraqitur në KB dhe krahas tyre të paraqesë dhe një material për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

- Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të pa likuiduara

Detyrimet e raportuara në MFE në fillim të periudhës ushtrimore 2022 dhe lëvizjet dhe të mbetura në fund të vitit 2022 paraqiten në mënyrë të përmblëdhur në tabelën e mëposhtme:

Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31/12/2021/lekë	Detyrimi I krijuar në periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2022/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022 lekë
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
INVESTIME	52,148,568	27,390,153	79,538,721	47,104,904	32,433,817
Investime nga AKUM	89,583,459	0	89,583,459	38,773,851	50,809,608
Mallra dhe shërbime	582,159,641	325,561,662	907,721,303	234,691,312	673,029,991
Vendime gjyqësore	60,528,411	28,241,097	88,769,508	43,153,336	45,616,172
Të tjera- hua afatgjate	35,628,212	0	35,628,212	0	35,628,212
Totali :	820,048,291	381,192,912	1,201,241,203	363,723,403	837,517,800

Vlera e detyrimeve të raportuara në MFE prej 837,517,800 lekë, nuk rakordon me gjendjen e llog. të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit. Kjo vlerë analizohet si më poshtë:

- Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për investime (llog.231) në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Objekti	Kreditori	Numri i Faturave	Detyrime 31.12.2021	Shtesat 2022	Likujduar viti 2022	Detyrime 31.12.2022
1	Rikonstruksion Rruga Cameria	NDERT ,RRUGA	5	6,156,680	-	-	6,156,680
2	Rik. Rruga Arnisa Ilire	N.shpk	1	984,140	-	-	984,140
3	Ndricimi i Unazes (ulliri-axhensia)	D.shpk	1	1,910,429	-	1,910,429	-
4	Rik i rruges Sheh Demir Kazazi (2017 A.Metolli)	C.shpk	3	8,684,757	-	8,437,397	247,360
5	Rik.i Cerdhes Nektari i jetes Shtese	J.shpk	1	1,952,050	-	-	1,952,050
6	Rik. Rruga Cezmja e Sharres	K.shpk	2	1,637,600	-	-	1,637,600
7	Rik I rruges kryesore I fshatit Qerret	K	1	2,308,372	-	1,000,000	1,308,372
8	M.Punim Rik I Sheh Demir Kazaz & Murat Kavaj	N.M	1	32,400	-	-	32,400
9	M.Punimesh Rik I Trotareve Rruga Zguraj	Tr Sh.p.k.	1	84,000	-	-	84,000
10	M.Punimesh Rik I Rruges B	J. Ko	1	35,599	-	-	35,599
11	M.Punimesh Rik I Rruges Dhimiter Pjeshkazini	N.M	1	30,000	-	-	30,000
12	M.Punimesh Sistemim Asfaltim sheshi te Agjensia	L K	1	8,640	-	-	8,640
13	M.Punimesh Ndertimi I kopshtit Lagja nr 4	A, S	1	288,000	-	-	288,000
14	M.Punimesh Rik I Rr. Kazaz e sheshi I pallatit L	R, sh.p.k.	1	22,800	-	-	22,800
15	M.Punimesh Rik I Rruges Tironcave	S. Projekt	3	1,380,000	-	-	1,380,000
16	M.Punimesh Rik I Rruges Kla -Xhu	A.Engineering	2	1,368,000	-	-	1,368,000
17	M.Punimesh Rik I Trotareve Fshati Cete	N.M	1	21,720	-	-	21,720
18	Ndertimi I shkolles 9 Vjecare Golem	U shpk	1	10,355,827	-	10,000,000	355,827
19	M.Pun Rik linja pus depo 500 m3 ndert pus7 Cerm	D. shpk	1	315,428	-	-	315,428
20	Vazhdim I punimeve per rik e shetitores nr.2 dhe pajisja e disa rrugeve me polica te shtrira	B X	1	555,528	-	555,528	-
21	Stud proj rrjet kanal ujera te zeza te qytetit Kavaje	Gj.&C	1	76,120	-	76,120	-
22	F.V pajisje ndricimi rrugor LED sit nr.2	B. B shpk	1	5,473,004	-	3,913,400	1,559,604
23	M.Punim objekt"Rehab shkoll Aleksande Mosiu	M K	1	339,600	-	-	339,600
24	Rikonstruksion shetitorja nr.2	B, X	1	8,719,688	-	8,719,688	-
25	Kolaudim "Ndertimi shkolles 9 Vjecare Golem	G	1	113,300	-	113,300	-

26	Rikonstruksion I rrjetit per furnizim me uje Kj	G Company	1	84,001,915	-	40,000,000	44,001,915
27	Rikonstruksioni I linjes se puseve Cerme	B. shpk	1	4,457,276	-	-	4,457,276
28	Rip impiant ujera zeza kj e ujesjellesi I fshatit luz	A. K	1	393,120	-	-	393,120
29	Kolaudim I Rik Rruges Varreza-Synej	B Engieering	1	22,680	-	-	22,680
30	Kolaudim Rikonstruksion I Rruges Rrakull Synej	G	1	3,354	-	-	3,354
31	Shpronosim I unazes Lindore		1	-	15,134,372	2,890,641	12,243,731
32	RIKONSTRUKSION I RRUGEVE TE QYTETIT	B shpk	1	-	6,661,260	4,000,000	2,661,260
33	Kolaudi"Vazhdim i punimeve rik shetitorja nr.2 dhe pajisja me disa rruge me polica te shtrira	M.K	1	-	30,000	-	30,000
34	Mbikqyr"Rindertim i godines se bordit te kullimit	c group	1	-	346,121	-	346,121
35	Mbikqyrja"Rikonst i shkolles 9 vjecare R.C	I	1	-	956,148	-	956,148
36	Mbikqyr"Rikons i shkoll Mesme Aleksander Moisiu	I	1	-	1,085,750	1,085,750	-
37	Furnizimi me uje i zonave bregdetare	B shpk	1	-	2,251,878	2,251,878	-
38	Ndertim muri mbajtes Fshati Kryemedhenj	Sh	1	-	3,154,920	3,154,920	-
TOTALI				141,732,027	29,620,449	81,616,503	83,243,425

Nga analiza e faturave të palikujduara për investime rezulton se, ka një mori faturash, të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre, kjo për efekt të mungesës së fondeve nga mosrealizimi i të ardhurave vendore. Nga analiza e këtyre detyrimeve rezulton që, ***në fund të vitit 2022 kanë mbetur pa u likujduar 30 fatura në vlerën 83,243,425 lekë.*** Në këtë vlerë janë përfshirë dhe faturat e palikujduara për investimet e kryera për ndërtim të Ujssjellësave dhe rindërtimet nga dëmtimet nga tërmeti të financuara nga AKUM dhe Ministria e Rindërtimit në vlerën 50,809,608 lekë. Këto fatura në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Operatori Ek	Emertimi i Objektivit të investimit	Vlera e faturës
D.shpk	M.Punimesh Rikonstruksioni linjave te puseve 281/282/283 depos 500 m3 ndertimi I pusit 7 Cerme	315,428
M.K	M.Punimesh me object "Rehabilitim I shkolles mesme Aleksander Mosiu	339,600
G Company	Rikonstruksion I rrjetit per furnizim me uje Kj	44,001,915
B	Rikonstruksioni I linjes se puseve Cerme	4,457,276
A.K 2	Riparim I impiantit te ujerav te zeza kj dhe ujesjellesi I fshatit luz	393,120
c group	Mbikqyrja"Rindertim i godines se bordit te kullimit	346,121
I	Mbikqyrja"Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare R.C	956,148
TOTALI		50,809,608

• Detyrimet e krijuara ndaj të tretëve për fatura të palikujduara për mallra e shërbime (llog.602) në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Objekti	Kreditore	Numri Fatura	Detyrime 31.12.2021	Shtesat 2022	Likujduar viti 2022	Detyrime 31.12.2022
1	Taksa vjetore e mjeteve	DPSHTRR	2	5,920.00	-	5,920	-
2	Sherbim pastrimi gyteti Kj	A.I.C	18	44,382,662.00	50,679,900	95,062,562	-
3	Sherbim pastrimi NJ.A.Golem	A.I.G.C	17	42,631,896.00	53,548,320	76,832,801	19,347,415
4	Sherbim pastrimi NJ.administrative	E.hpk	2	-	20,682,144	20,682,144	-
5	Sherbim i mirembajtjes dhe gjelberimit	G. shpk	1	-	11,562,283.00	11,562,283	-
6	Akt ekspertize	instituti Ndertimit	6	1,136,920.00	-	1,136,920	-
7	Sherbim interneti	N. Tv	4	190,000.00	56,000	246,000	-
8	Sherbim postar	Dega Postes	2	-	26,070	26,070	-
9	Krijim faqe ëeb dhe aplikacioni i bashkise	E S	1	-	1,153,200	1,153,200	-
10	Hartim projektit teknologjik per intalimin e pajisjeve dhe eneve nen presion	F E A	1	234,000.00	-	234,000	-
11	Lidhje e re energjie	Ossh	1	533,746.00	-	533,746	-
12	Akomodim ne hotel e trajtim me ushqim	F resort	1	625,680.00	-	-	625,680
13	Miratim I projektit teknologjik...	E shpk	2	238,000.00	-	238,000	-
14	Miratim I projektit teknologjik...	N Control	1	-	240,000	240,000	-
15	Sherbim i riparimit te pajisjeve te zyres`	R A	1	-	98,000	98,000	-
16	Vula zyrtare	Drejtoria Pergjithsh Shtetit	1	3,600.00	-	3,600	-
17	Blerje lodrash per festat e fundvitit	5 Gr	1	-	417,600	417,600	-
18	Blerje tonera dhe leter A4	A K	1	-	287,760	287,760	-
19	Router RBAC2	A	1	9,500.00	-	-	9,500
20	Furnizimi me shtypshkrime	Sh letrave me Vlere	4	74,100.00	160,200	100,500	133,800
21	Blerje materialesh pastrimi	M V	1	624,480.00	-	624,480	-

22	Furnizimi me karburant	K	7	1,800,718.00	6,569,591	8,370,309	-
23	Furnizimi me ushqime kopsht+cerdhe	N shpk	15	1,587,916.00	2,101,418	3,689,334	-
24	Bler materiale riparim trotuare e sheshe	B 2003	10	1,023,600.00	-	1,023,600	-
25	Blerje materiale hidraulike	D.Xh	1	174,000.00	-	174,000	-
26	Blerje materiale per vendosje kangjellash	N	1	170,400.00	-	170,400	-
27	Blerje materiale per prodhim pllaka varri	T.K	3	477,600.00	1,101,470	1,579,070	-
28	Blerje pajisje zyre	T. K	1	297,468.00	-	297,468	-
29	Blerje boje per lysterje godinash	B sha	1	1,742,160.00	-	1,742,160	-
30	Furnizimi me karburant	G Center	1	1,931,040.00	1,336,500	3,267,540	-
31	blerje artikuj festiv	A	1	-	109,200.00	-	109,200
32	Realizimi dekorit per festat e fundvitit	2 Gr shpk	1	-	920,400.00	920,400	-
33	Blerje gaz i lengshem	B Gaz	2	-	156,514.00	156,514	-
34	Blerje pajisje dhe aksesore audio	A& D	1	-	300,000.00	-	300,000
35	Blerje materiale ndihmese	M.D	1	-	24,979.00	24,979	-
36	Blerje tub bakri	Sr G	1	-	118,440.00	118,440	-
37	Blerje shtypshkrimesh	R gr	1	-	119,640.00	-	119,640
38	Blerje materiale hidraulike	H shpk	1	-	666,000.00	666,000	-
39	Blerje materiale pastrimi	M shpk	1	-	696,000.00	-	696,000
40	Blerje tonera dhe kancelari	L D	1	-	933,332.00	933,332.00	-
41	Blerje stabilizant	S shpk	1	-	1,174,000.00	1,174,000.00	-
42	Blerje pajisje zyre	T K	1	-	318,900.00	-	318,900
43	Blerje stimujsh	M T	1	-	40,000.00	40,000.00	-
44	Blerje tonera dhe artikuj kancelarie	i. office	1	-	212,400.00	212,400.00	-
45	Blerje shirit kufizurs	M D	1	-	5,000.00	5,000.00	-
46	Blerje Aparat fotografik	H CONstruction	1	-	240,000.00	240,000.00	-
47	Organizim eventi kulturor	XHt	1	-	90,000.00	90,000.00	-
48	Blerje goma makine	V.shpk	1	-	64,000.00	64,000.00	-
49	Furnizimi me energji elektrike	FSHU	151	482,050,135.00	169,319,721.00	-	651,369,856
	TOTALI			581,945,541	325,528,982	234,444,532	673,029,991

Nga analiza e faturave të palikujduara për mallra e shërbime rezulton se, ***në fund të vitit 2022 kanë mbetur pa u likuiduar 177 fatura në vlerën 673,029,991 lekë.*** Peshën më të madhe në këto fatura e zënë detyrimet ndaj FSHU për shpenzime për blerje enrgji elektrike, që i përkasin 151 faturave në vlerën 651,369,856 lekë, të krijuara në vitin 2022 në vlerën 169,319,721 lekë dhe para vitit 2022 në vlerën 482,050,135 lekë.

- Pjesë e detyrimeve janë dhe 57 Vendimet Gjyqësore të formës së prerë që nga viti 2016 deri në vitin 2022 për konflikte të krijuara ndër vite me objekt mosmarrëveshje kontraktuale, dëmshpërblime për largime nga puna në mënyrë të paligjshme etj. Detyrimet nga Vendimet e Gjykatësnë mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Vendimi gjyqesor nr,dt	Emri i kreditorit Përfitues	Emri përfitues nga VGJ	Pa Likuiduar 30.12.2021	Shtesa viti 2022	Likuiduar viti 2022	Pa Likuiduar 30.12.2022
1	2500 dt 09.09.2016	E SHPK	V. A	726,316	-	-	726,316
2	2563 dt 19.09.2016	P.B OFFICE	TK	3,663,000	-	-	3,663,000
3	3205 dt 01.12.2016	B,S-M	Sh.K	3,433,000	-	1,000,000	2,433,000
4	975 dt 31.03.2017	E.G	FSHF	14,500,000	11,000,000	3,000,000	22,500,000
5	4839 dt 03.11.2017	E.SHPK	G.G	8,730,885	-	8,730,885	-
6	1598 dt 10.05.2018	R. B.S	S shpk	1,406,751	-	-	1,406,751
7	11-2018-118 dt 22.07.2019	E.G.fS	A.P	26,400	-	-	26,400
8	82/2017/724-518 dt 24.05.2017	P.B	E.M	1,088,624	-	200,000	888,624
9	12-2019-1089/94 dt 31.05.2019	E Group	E shpk	962,090	-	962,090	-
10	859 dt 18.10.2019	Zyra perm b	B shpk	5,415,253	411,213	5,826,466	-
11	1133 dt 30.09.2019	Zyra Permbarimore Shteterore	C shpk	700,000	-	700,000	-
12	199 dt 28.10.2019	Zyra Permbarimore	K	9,000,000	2,371,276	11,371,276	-
13	82-2018-1441/325 dt 16.10.2019	Ekzekutim vendimi Gjygsor	M V	800,000	-	550,000	250,000
14	10-2019-2226/748 dt 17.12.2019	Ekzekutim vendimi Gjygsor	B.H	692,670	-	-	692,670
15	390/502 dt 10.10.2019	G. M.	D.E	74,000	-	74,000	-
16	420/114 dt 26.09.2019	Ekzekutim vendimi Gjygsor	F.C	193,800	-	193,800	-
17	509(86-2020-585) dt 05.03.2020	G. F	LL.N	200,000	-	200,000	-
18	49(185) dt 11.06.2020	G.M	E.GJ	689,920	-	339,920	350,000

19	264-100 dt 15.01.2019	G.M	F,B	400,000	-	400,000	-
20	1-2020-899(262)dt 29.07.2020	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	I.K	766,200	-	330,000	436,200
21	264-633 dt 04.04.2018	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	A.K	281,680	-	281,680	-
22	264-834 dt 29.05.2018	G.M	Q.R	387,240	-	387,240	-
23	718/2 dt 06.10.2020	G.M	XH.SH	795,122	-	345,122	450,000
24	2656 dt 10.10.2019	G.M	V.X	951,590	-	-	951,590
25	714/221 dt 04.05.2018	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	A.GJ	300,000	-	300,000	-
26	424 dt 21.05.2019	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	E.D	1,404,100	-	604,100	800,000
27	10-2020-1322/365dt 27.10.2020	G.M	Z.M	197,640	-	197,640	-
28	10-2020-176(59) dt 03.02.2020	G.M	H.C	209,520	-	209,520	-
29	169/10-2020-545 dt 07.05.2020	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	D.T	303,360	-	303,360	-
30	12-2020-(876)850 dt 16.07.2020	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	A.Z	500,000	-	500,000	-
31	102020-1356/372 dt 29.10.2020.	M. H	R.M	168,000	-	-	168,000
32	12-2020-536/151 dt 27.04.2020	R.S	E.M	553,158	-	553,158	-
33	12-2018-630/182 dt 20.04.2018	G.M	Z.M	512,880	-	512,880	-
34	12-2018-1318/381dt 20.07.2018	G.M	A.H	217,212	-	217,212	-
35	10-2021-868(293) dt 11.05.2021	G.M	I.P	278,000	-	278,000	-
36	12-2020-1501/584 dt 29.10.2020	G.M	I.GJ	-	664,579	250,000	414,579
37	10-2021-1741(483) dt 11.10.2021	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	A.K	-	536,040	150,000	386,040
38	239 date 07.07.2021	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	V.SH	-	174,191	174,191	-
39	10-2022-411/107 date 02.03.2022	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	F.C	-	450,346	450,346	-
40	10-2021-1969(539) dt 09.11.2021	G.M	R.V	-	310,600	100,000	210,600
41	3590 date 17.11.2021	K.B.S	IKMT	-	1,792,000	-	1,792,000
42	12-2019-2392/618 dt 27.12.2019	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	Z.C	-	563,240	563,240	-
43	12-2021-690(158) dt 21.04.2021	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	I.D	-	840,000	-	840,000
44	12-2021-215(61) date 08.02.2021	E.A	K.S	-	1,059,520	200,000	859,520
45	12-2020-391(13)date 20.02.2020	G.M	E.XH	-	1,000,390	1,000,390	-
46	10-2022-561/153 date 24.03.2022	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	D.G	-	589,400	430,000	159,400
47	12-2018-1781/539 dt 18.10.2018	G.M	R.C	-	223,720	223,720	-
48	10-2022-509/134 date 17.03.2020	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	A.D	-	380,124	-	380,124
49	12-2020-1464(575)dt 27.10.2020	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	B.S	-	802,860	-	802,860
50	10-2022-837(229)date 05.05.2022	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	SH.P	-	256,648	-	256,648
51	12-2021-680(155)date 20.04.2021	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	Q.M	-	450,060	100,000	350,060
52	10-2022-409/105 date 02.03.2022	E.B.O	S.XH	-	891,923	100,000	791,923
53	12-2022-1087/208 dt 28.07.2022	G.M	J.S	-	844,342	-	844,342
54	12-2018-1938/595 dt 02.11.2018	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	S.G	-	1,074,295	300,000	774,295
55	10-2022-717(195)date 13.04.2022	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	J.T	-	476,360	150,000	326,360
56	12-2022-394(69)date 11.03.2022	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	B.K	-	529,930	-	529,930
57	12-2020-1868(714)dt 21.12.2020	Ekzekutim vendimi Gjyqesor	I.C	-	548,040	-	548,040
TOTALI				60,528,411	28,241,097	42,760,236	45,616,172

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me likuidimin e Vendimeve Gjyqësore nga Bashkia Kavajë vërehet se në celje të vitit 2022 vlera e detyrimeve gjyqësore është 60,528,411 lekë gjatë vitit 2022 shtesat janë 28,241,097 lekë dhe vlera e likuiduar është 42,760,236 lekë. Në **fund të vitit 2022 ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 45,616,172 lekë.**

Pjesë e borxhit të Bashkisë Kavajë është edhe vlera e kredisë e pashlyer për ndihmesën e qytetarëve të pastrehë me kredi të buta në bazë të programit të strehimit të akorduar nga C. Kjo kredi është akorduar në vitin 2014 në vlerë totale prej 662,000 euro principal dhe 28,73 interes nga shqyrtimi i të dhënave për transhet, e detyrimet e lindura principal dhe interesa si dhe pagesat e kryera të shpërndara në vite rezulton se, është paguar principal dhe interes sipas transheve të planifikuar detyrimi deri në fund të vitit 2020. Ka mbetur pa u paguar detyrimi i kredisë për strehimit për vitet 2021 dhe 2022 në vlerën 35,628,212 lekë, vlerë e cila rakordon me raportimin e detyrimeve në MFE në zërin “Hua afatgjatë”

- Pjesë e detyrimeve janë dhe detyrimet si rezultat i shpronësimeve për interesa publike për ndërtimin e Unazës Lindore për 14 individë në vlerën 12,243,728 lekë, vlerë e cila nuk është përfshirë në detyrimet e raportuara në MFE, ku në mënyrë të detajuar, sipas objekteve dhe individëve privat paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Evidenca e shpronësimeve publike (detyrimi deri 31.12.2022)

Nr	Pershkrimi I objektit	Emer Mbiemer	Detyrimi Vlera Leke	Likujdimi	Detyrimi mbetur 31.12.2022
				2022	
1	Shpronësimi i Unazes Lindore	H	1,549,000	134,213	1,414,787
2	Shpronësimi i Unazes Lindore	E	1,192,730		1,192,730
3	Shpronësimi i Unazes Lindore	G.Gj	2,385,460		2,385,460
4	Shpronësimi i Unazes Lindore	R.Gj	1,789,095	198,788	1,590,307
5	Shpronësimi i Unazes Lindore	Shtet (S,Gj)	0		0
6	Shpronësimi i Unazes Lindore	E.M	348,525		348,525
7	Shpronësimi i Unazes Lindore	B.M	470,896		470,896
8	Shpronësimi i Unazes Lindore	M.M	390,348		390,348
9	Shpronësimi i Unazes Lindore	M/C	557,640	557,640	0
10	Shpronësimi i Unazes Lindore	N.B	319,868		319,868
11	Shpronësimi i Unazes Lindore	N.K	1,394,100		1,394,100
12	Shpronësimi i Unazes Lindore	E.SH	1,208,220		1,208,220
13	Shpronësimi i Unazes Lindore	D.S	116,175		116,175
14	Shpronësimi i Unazes Lindore	Y.T	468,572		468,572
15	Shpronësimi i Unazes Lindore	H	2,943,740	2,000,000	943,740
Totali			15,134,369	2,890,641	12,243,728

- Gjatë vitit 2022, për likujdimin e detyrimeve të prapambetura në Buxhetin e Bashkisë janë bërë shtesë fondesh në vlerën 146,128,000 lekë, ku 20,000,000 nga të ardhurat e Bashkisë me rritje limiti dhe nga Pushteti Qendror me shkresën MFEnr.prot 22369 datë 05.12.2022 në bazë të Aktit Normativ nr.17 datë 01.12.2022 me anë të akordimit të fondeve në vlerën 126,128,000 lekë.

- Detyrimet e raportuara në MFE në fillim të periudhës ushtrimore 2022 dhe lëvizjet dhe të mbetura në fund të vitit 2022 paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën emëposhtme:

Konkluzion:Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vitedhe gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Referuar raportimit të detyrimeve në MFE në fillim të vitit buxhetor 2022 detyrimet e prapambetura kanë vlerën 820,048,291 lekë. **Gjatë vitit 2022** janë krijuar detyrime në vlerën 381,192,912 lekë dhe është likjuar vlera prej prej 324,949,552 lekë (pra 56,243,360 lekë të krijuara në vitin 2022 dhe të mbetur për likujdim për vitin e ardhshëm). *Në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u likjuar në mënyrë progresive vlera prej 837,517,800 lekë.*

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Nr	Emërtimi I llogarive ekonomike			Realizimi në përqindje
		Plan	Fakt	
1	Paga 600	408,588	372,057	91%
2	Sigurime shoqërore 601	69,536	62,026	89%
3	Shp.Oper.602+F.Rezervë	630,465	548,763	87%
4	Kredia+Interesi 166-651 (CEB)	2,000	0	0%
4	K. Q Emergj Civile 604	14,012	0	0%
5	Nd/Ekonom invalid 606+te tjera (ndihma nga të ardhurat e Bashkise dhe grantet)	721,677	583,024	81%
	a. Nd/Ekonom invalid 606+te tjera	261,238	259,226	99%
	b. Bonus geraje+bursa+ndihme financiare+bonuse nga rindertimi	460,439	323,798	70%
6	Investime 230-231	821,671	490,561	60%
Totali		2,667,949	2,056,431	77%

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se **detyrimet e papaguara (të akumuluar)** në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën **837,517,800 lekë** dhe **fondet e miratuara** për shpenzime të këtij viti janë në

vlerën **1,946,272,000 lekë** (2,667,949,000 lekë totali i planifikuar –721,677,000 lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditet). Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 43 % kundrejt fondeve të miratuara dhe kundrejt shpenzimeve faktike është 57% (2,056,431,000 totali i shpenzimeve faktike -583,024,000 shpenzimet për transfert tek individët=1,473,407,000). Kjo situatë tregon se, Bashkia Kavajë mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është mbi nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Bashkia Kavajë ka vite, që është në vështirësi financiare, pasi nuk është bërë një punë e mjaftueshme për daljen nga situata e vështirësisë financiare.

Titulli gjetjes: *Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara*

Situata:

Detyrimet e prapambetura të palikujduara të raportuara në MFE në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 837,517,800 lekë, të cilat nuk rakordojnë me gjendjen e llogarive të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit për vlerën 71,755,707 lekë. Gjithashtu në vlerën e detyrimeve të raportuara në MFE nuk është përfshirë vlera e detyrimeve të lindura nga shpronësimet në shumën 12,243,728 lekë. Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite dhe gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në celje të vitit buxhetor 2022 detyrimet e prapambetura kanë vlerën 820,048,291 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime në vlerën 381,192,912 lekë dhe është likuiduar vlera prej prej 363,723,403 lekë, duke mbetur 17,469,509 lekë. Peshën më të madhe të detyrimeve të prapambetura e përbëjnë detyrimet për 177 fatura të palikujduara për mallra e shërbime në vlerën 673,029,991 lekë, ku 151 fatura janë për furnizimin me energji elektrike në vlerën 651,369,856lekë të krijuara në vite nga bashkia dhe ish-komunat, që pasohet nga detyrimet e mbetura pa likuiduar për vendime gjyqësore në vlerën 45,616,172 lekë, detyrimet për fatura të palikujduara për investime në vlerën 83,243,425 lekë dhe detyrimin e pa shlyer në vlerën 35,628,212 lekë për “Huanë afatgjatë” të marrë për programin e strehimit.

Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 43 % kundrejt fondeve të miratuara, ku Bashkia Kavajë mund të konsiderohet në vështirësi financiare, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është mbi nivelin prej 25 %.Për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në Buxhetin e Bashkisë janë bërë shtesë fondesh në vlerën 146,128,000 lekë, ku 20,000,000 nga të ardhurat e Bashkisëdhe 126,128,000 lekë shtesë fondi nga Pushteti Qendror, fonde këto që kanë një peshë specifike të ulët në vlerën e detyrimeve prej 837,517,800lekë. Pra nga Bashkia Kavajë nuk është bërë një punë e mjaftueshme për daljen nga situata e vështirësisë financiare.

Kriteri:

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3, me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 52, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 meligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni

56.Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 3.3,

Impakti:

Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penaltetesh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura.

Shkaku:

Punë e pamjaftueshme nga drejtuesit e programeve dhe veçanërisht sektori i buxhetit.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.Gjithashtu të përgatitet një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe paraqitja në Këshillin Bashkiaknjë material për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale dhe sipas programeve, dhe të hartojë një grafik likuidimi, duke zbatuar radhën e pagesave,ku të shqyrtohen të gjitha mundësitë dhe rriten burimet e financimit, duke përdorur fondin rezervë dhe të kontingjencës, rishikimin e buxhetit, rritjen e nivelit të të ardhurave si dhe negocimin me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të palikuiduara.

➤ Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxheteve vjetore janë miratuar dhe projektet për investime. Këto projekte për investime janë programuar që në PBA përkatëse. Fondet për investime janë realizuar 490,561 mijë lekë nga 821,671 mijë lekë të planifikara ose në masën 60%. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, Ministria e Rindërtimit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), kështu:

- Për **vitin 2022** janë planifikuar dhe realizuar fonde për investime:

a.Me burim financimi të ardhurat e veta (ardhurat e veta + transfertat e pakushtëzuar) janë realizuar 22 projekte investimesh me vlerë kontrate 123,672,916lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar në datë 31.12.2022 vlera prej 24,884,084 lekë. Për këto 5 investime janë lidhur kontratat në vitin 2022 dhe për 17investime janë lidhur kontrata para vitit 2022, por që ka vazhduar realizimi dhe financimi dhe në vitin 2022, në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti i kontratës	Kontrata me subjektin			Subjekti i kontraktuar	Paguar sipas periudhave			Mbetja 30.12.2022
		Nr. /datë lidh kontratës	Afati	Vlerë kontrate me TVSH		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	
1	Rehabilitim i ndricimit rrugor me sistem LED	227/1 Dt.25.01.2021	4 muaj	73,646,400	B		38,568,576	18,000,000	17,077,824
2	Vazhdimi punimeve shetirojtja nr 2	4075/2 dt 11.11.2020	15 dite	23,275,216	B-x	7,000,000	7,000,000	9,275,216	-
3	Blerje Pemesh	2884/1 dt 29.08.2022	6 muaj	16,116,000	G 2000			10,971,000	5,145,000

4	Rikonstruksion rruget e qytetit	790/2 dt.04.04.2022	1 muaj	6,661,260	B shpk	-	-	4,000,000	2,661,260
5	Ndertimi i murit mbajtës Fshati Kryemedhenj	202/1 dt.07.03.2022	30 dite	3,734,040	Sh 07		-	3,734,040	-
6	Blerje aparati fotografik			240,000	H C			240,000	
7	Rikon i Kino-Teatrit "Aleksander Moisiu" 20%	507/3 dt.04.06.2021		41,046,891	D Construks			4,912,323	
8	Blerje varesë rrobash			40,000	B shpk			40,000	
9	Blerje paisje ajri kondicionuar 20% tvsh	03/1 dt.15.02.2022			S Group			327,400	
10	Blerje makina	45/1 dt.14.02.2022		4,788,000	A shpk			4,788,000	
11	Blerje paisje zyre			297,468	T.K			297,468	
12	Rikonstruksion i rr.Sheh Demir Kayayi				shpk			2,992,653	
13	Rikonstruksion i rr.Varrezat Hajdaraj	1412/2 dt.10.05.2017		8,025,000	shpk			5,444,744	
14	Shpronësimet toke per varrezat			3,581,823				3,581,823	
15	Shpronësimet unaza lindore							2,890,641	
16	Ndertimi i shkolles 9 Vjecare Golem	2211/2 dt.04.07.2019		42,366,843	U shpk	18,693,638	13,673,205	10,000,000	-
17	Kolaudim punimesh Shkolla 9 vjecare golem	5000/1 dt.22.12.2020		113,300	shpk			113,300	-
18	Mobilim i Shkolles se mesme Profesionale	995/4 dt.17.05.2022		12,552,000	B shpk			12,552,000	-
19	Transferim Kapitali				A shpk			1,259,190	
20	Rikualifikim i rruges fshati Qerret	1791/2dt 27.05.2019		13,483,111	K			1,000,000	
21	Ndicimi i urazesh	758/3 dt.03.09.2013			D shpk			1,910,429	
22	Mbikqyrje punimesh sistemi Led			700,956	D			434,593	
Totali i vitit 2022				250,668,308		7,000,000	45,568,576	98,764,820	24,884,084

b.Me burim financimi të fondet e akorduara nga Ministria e Rindërtimit për investime për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga pasojat e tërmetit, ku janë realizuar 9 projekte me vlerë kontrate 2,147,814,080 lekë dhe ka mbetur pa u likuaduar në datë 31.12.2022 vlera prej 1,184,929,415 lekë. Për 5 projekte janë lidhur kontratat në vitin 2022 dhe për 4 projekte janë lidhur kontratat në vitin 2021, por që ka vazhduar realizimi dhe financimi dhe në vitin 2022. Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti i kontratës	Fonde të Planifikuara	Kontrata me subjektin			Subjekti i kontraktuar	Paguar sipas periudhave		Mbetja datë 31.12.2022 Në lekë
			Nr. /datë lidh kontratës	Afati	Vlerë kontrate paTVSH		Viti 2021	Viti 2022	
Rindert	R,M	153,041,206	479/5 dt 24.03.2021	12 muaj	150,717,562	E.S hpk	148,162,783	2,411,208	143,571
"	Mbikqyrje M		810/4dt 09.04.2021	12 muaj	1,206,389	I		1,085,750	120,639
"	R,M		28.7.2022 e 31.1.2023	7 dite	181,377	S SHPK	-	66,000	115,377
Rindert	R,M	119,025,106	612/4 dt 12.04.2021	10 muaj	116,413,160	B	96,405,722	19,774,143	233,295
Rindert	R,XH	139,632,943	536/4 dt 09.04.2021	12 muaj	137,000,000	S T shpk	85,443,972	16,211,848	35,344,180
Rindert	Shemb object demtuar nga termeti e transp materiale	43,000,000	377/5 dt 31.03.2021	30dite	51,139,183	N.SH	42,615,986	-	8,523,197
Rindert	Rik Mjedise perbashk ndertes	349,125,000	1003/4 dt14.05.2021	12 muaj	342,476,805	.shpk	329,113,404	13,002,340	361,061
"	Mbikq. Rik Mjedis perbashk		1272/5 dt 26.07.2021	12 muaj	2,500,000	4 Group	1,800,000	700,000	-
"	KolauRik Mjedis perbashk		51/1 date 30.11.2022	7 dite	307,641	G	-	-	307,641
Rindert	Rindert i Staci Zjarrfikes	79,301,115	881/3 dt 12.04.2022	5 muaj	77,663,390	G.SH	-	15,860,223	61,803,167
Rindert	Rindert Godin Bord Kullim	147,910,311	1236/2 dt 20.05.2022	7 muaj	145,250,480	Sh.shpk		29,582,062	115,668,418
Rindert	Riforc ndertes klasif demtuar Ds4 qyteti	529,942,524	2891/4 dt 24.10.2022	18 muaj	528,843,954	F.G		103,174,863	425,663,091
Rindert	Riforc ndertes klasif demtuar Ds4 qyteti Faza I -re	594,823,787	2296/8 dt 26.09.2022	18 muaj	594,114,139	G		89,117,121	504,997,018
	Hartim Projektim Rindertimi kopsht dhe cerdhe luz I vogel	2,158,261	3043/4 dt.20.10.2022		2,100,000	shpk		431,652	1,668,348
	Hart- projekt ish nenprefektu	5,231,626	2896/4 Dt.05.10.2022		5,111,500	I hpk		1,022,300	4,089,200
Totali i vitit 2022					2,155,025,580		703,541,867	292,439,510	1,159,044,203

c. Me burim financimi të fondet e akorduara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) për investime për ndërtimin dhe rikonstruksionin e Ujësjellsave dhe rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve dhe me financim nga UNDP për mobilim shkollash, ku janë realizuar 6 projekte investimesh me vlerë kontrate 1,129,526,199 lekë dhe ka mbetur pa u likuaduar në datë 31.12.2022 vlera prej 484,513,840 lekë. Për këto projekte janë lidhur kontratat 1 në vitin 2020 dhe 2 në vitin 2021, por që ka vazhduar realizimi dhe financimi dhe në vitin 2022. Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

N r.	Objekti i kontratës	Kontrata me subjektin			Subjekti i kontraktuar	Paguar sipas periudhave			Mbetja 30.12.2022
		Nr. /datë lidh kontratës	Afati	Vlerë kontrate me TVSH		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	
1	Rik i rrjet shpërnd furniz ujë qytet Kavaj e ndërt depo uji re, Faza II	1534/2 dt 07.05.2020	12 muaj	789,941,722	G	258,282,576	190,000,000	40,000,000	301,659,146
	Mbikq:"Rik i rrjet shpërnd furniz ujë qytet Kavaj e ndërt depo uji re, Faza II	1534/1 dt 07.05.2021	12 muaj		A,M		700,000	400,000	- 1,100,000
	Kolaudim: Rik i rrjet shpërnd furniz ujë qytet Kavaj e ndërt depo uji re, Faza II	3892/1 dt 26.12.2022	10 dite	807,241	F.SH			807,241	-
2	Furniz uje ne zonat bregdetare,Plazhi Gjeneral-Bardhor-Karpen-Synej Bashkia Kavaje,Loti I	509/3 dt 12.05.2021	8 muaj	188,549,796	B D Company	-	65,000,000	38,365,927	85,183,869
	Mbikq"Furnizime uje zonat bregdetare,Plazhi Gjeneral-Bardhor-Karpen-Synej B.Kavaje,Loti I	1128/4 dt 27.05.2021	8 muaj	2,580,660	C. Shpk		639,086	500,000	1,441,574
3	Riparimi impiantit te ujerave te zeza Kavaje & ujesjell fsh Luz lidhjet e matesa familja B. Kavaj	508/3 dt 23.04.2021	12 muaj	145,235,380	A Konstruktion	-	35,006,880	15,000,000	95,228,500
	"Mbikq :Ripar impiantit ujera te zeza KJ & ujesjell fsh Luz lidhjet e matesa familja B. Kavaj	1129/4 dt27.05.2021	12 muaj	2,411,400	Gj shpk		488,398	300,000	1,623,002
4	Mobilim per shkoll 9 v M. Babamusta 20% tvsh			1,839,213	U			1,839,213	
5	Mobilim per shkollen 9 v Figjiri Kurti 20% tvsh			2,068,328	U			2,068,328	
6	Stud- projekt te rrjetit te ujerave te zeza Kavaje	3003/5 dt.02.10.2020		76120	Gj shpk			76,120	
Totali i vitit 2022				1,133,509,860		258,282,576	291,834,364	99,356,829	484,036,091

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e projekteve të investimeve me fondet e vëna në dispozicion nga Bashkia Kavajë, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Bashkia për këto investime ka marrë angazhime buxhetore disa mujore, të cilat janë regjistruar kundrejt planit vjetor në sistemin Informatik financiar të Qeverisë nëpërmjet Degës së Thesarit Kavajë.

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Kavajë. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Kavajë dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotëme qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

➤ *Burimet e financimit të buxhetit vjetor*

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme: në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Bashkia		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	408589	372057	91
	grand i kushtëzuar	7,420	7,142	96
a	grand i pakushtëzuar + transfertat specifike	234,063	209,690	90
b	te ardhura	167,106	155,225	93
2	Sigurime shoqërore 601	69,535	62,026	94
	grand i kushtëzuar	1,248	1,189	95
a	grand i pakushtëzuar + transfertat specifike	40,381	35,972	89
b	te ardhura	27,906	24,865	89
3	Shpenz.operative 602+ F.rezerve	1,036,839	832,247	80
	grand i kushtëzuar	268	140	52

a	grand i pakushtëzuar + transferta specifike	680157	506368	74
b	te ardhura	356414	325739	91
4	K.Qarkut Emergj.civile 604	28105	0	0
a	grand	14012	0	0
b	te ardhura	14093	0	0
5	Nd ekonomike invalid 606	303211	299539	99
a	grand i kushtëzuar	303211	299539	99
7	Investime 230-231	821670	490562	60
I	Buxheti i bashkisë Grant +te ardhura)			
a	grand i pakushtëzuar + transferta specifike	692417	365015	53
b	te ardhura	28120	26190	93
II	Ministritë e linjës + FZHR	101133	99357	98
	Bashkia	2,667,949	2,056,431	77

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo Bashki ka përballuar në fakt shpenzimet për të gjitha zërat në masën 74% nga transferta e pakushtëzuar e transfertat e tjera dhe 26% nga të ardhurat e veta.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj.A.K me detyrë ish-Drejtores e Drejtorisë së Burimeve Ekonomike (për periudhën 01.01.2022-12.06.2022), z. A.T me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike (për periudhën 18.06.2022 e në vazhdim) dhe z. I.C me detyrë Specialist i Buxhetit në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike (për periudhën 01.01.2022-15.12.2022)

2.6 Burimi i krijimit të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitatat ligjore.Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve.Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progressive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Për auditimin e kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Kavajë për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022. Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj.
- Dokumentacioni i Sektorit të Financës dhe Tatim-Taksave në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, database në Exel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues.
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranifaturimit dhe specialistët e kontrollit në terren.
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga inspektorët e borxhit shoqëruar me evidenca dhe korrespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve.
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat. Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, si për taksat ashtu edhe për tarifave vendore, të mbajtura nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB) Pasqyra financiare për vitit 2022. Miratimi i buxhetit në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2022.
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara.
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (*këtu e vijim DTTVAB*)
- Korrespondenca me Institucione të ndryshme për të ardhurat që i takojnë Bashkisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se rregullshmëria e veprimeve të kryera nga sektori i të ardhurave, për vjeljen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera, paraqitet si më poshtë:

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*)

Në Bashkinë Kavajë është bërë miratimi i strukturës organike të Bashkisë me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.01, datë 05.01.2022. Drejtorja e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB), Bashkia Kavajë, kanë strukturën e saj **28 punonjës** dhe është e ndarë në: Sektorin e të ardhurave nga biznesi për Qytetin Kavajë, Sektorin e Borxhit, Sektorin e Terrenit, Sektorin e Turizmit në NJA Golem, Zyrat e taksave për njësitë administrative Synej, Luz i Vogël dhe Helmas. Struktura e DTTVAB Bashkia Kavajë dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Date fillimi	Ndryshimi gjatë 2022 nëse ka pasur
1	R.I	Drejtor	Nga 01.10.2021	Nuk ka ndryshime
SEKTORI I TË ARDHURAVE NGA BIZNESI NJ.A KAVAJE				
2	M.H	Përgjegjese Sektorin e të Ardhurave		Nuk ka ndryshime
3	J.N	Specialist i të Ardhurave	Deri me 18.01.2022	Urdhër Transferimi nr.33, datë 18.01.2022
3/1	S.SH	Specialiste e të Ardhurave	18.01.2022 deri më 01.09.2022	Urdhër Transferimi nr.34, datë 18.01.2022 Urdhër Transferimi nr.14/1, date 01.09.2022
3/2	G.L	Specialist i të Ardhurave	Nga 01.09.2022	Urdhër Transferimi nr.301, date 01.09.2022
4	A.SH	Specialiste e të Ardhurave		Nuk ka ndryshime
5	R.K	Specialist për Taksën Familjare		Nuk ka ndryshime
SEKTORI I BORXHIT NJ.A KAVAJE				
6	M.C	Përgjegjese Sektorin e Borxhit	Nga 01.10.2021	Nuk ka ndryshime
7	A.A	Specialiste e të Ardhurave		Nuk ka ndryshime
8	E.K	Specialist Borxhi	Nga 21.07.2021	Nuk ka ndryshime
9	A.C	Specialist Borxhi	06.10.2021 deri më 18.10.2022	Urdhër Largimi nr.368, date 18.10.2022
9/1	L.S	Specialist Borxhi	Nga 18.10.2022	Urdhër Punesimi nr.369, date 18.10.2022
SEKTORI I TERRENT				
10	S.M	Përgjegjese në Terren		Nuk ka ndryshime
11	M.A	Inspektor		Nuk ka ndryshime
12	A.P	Inspektor		Nuk ka ndryshime
13	L.G	Inspektor		Nuk ka ndryshime
14	M.B	Inspektor		Nuk ka ndryshime
15	K.C	Inspektor	Nga 01.04.2022	Urdhër Transferimi nr.108 datë 01.04.2022
16	A.P	Inspektore		Nuk ka ndryshime
17	Z.H	Shofer		Nuk ka ndryshime
18	G.E	Juriste	Nga 04.01.2022 deri më 01.03.2022	Urdhër Transferimi nr.22, date 04.01.2022 Urdhër Transferimi nr.22/1, date 01.03.2022
18/1	Y.SH	Juriste	Nga 11.03.2022	Urdhër Punesimi nr.83, date 11.03.2022
NJESIA ADMINISTRATIVE GOLEM				
19	G.T	Përgjegjese i sektorit të Turizmit	Nga 05.01.2022	Urdhër punësimi nr.07, datë 05.01.2022
20	S.SH	Specialiste e të Ardhurave nga Biznesi	Deri me 18.01.2022	Urdhër Transferimi nr.34, datë 18.01.2022
20/1	J.N	Specialist i të Ardhurave nga Biznesi	Nga 18.01.2022	Urdhër Transferimi nr.33, datë 18.01.2022
21	J.H	Specialist i të Ardhurave nga Biznesi		Nuk ka ndryshime
22	SH.K	Specialist për taksën e tokës dhe taksën familjare		Nuk ka ndryshime
23	R.SH	Inspektor per zonen e Golemit		Nuk ka ndryshime
24	SH.C	Inspektor per zonen e Golemit		Nuk ka ndryshime
25	TH.D	Specialist taksash NJ.A Helmas		Nuk ka ndryshime
26	A.C	Specialist taksash NJ.A Luz i Vogël		Nuk ka ndryshime
27	A.L	Inspektor ne terren Luz i Vogël		Nuk ka ndryshime
28	E.C	Specialiste taksash NJ.A Synej		Nuk ka ndryshime

Shenim: Specialistët e tatimeve kryejnë dy funksione si faturimin, njoftimet dhe ndjekjen në terren.

- *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

Për vitin 2022, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Kavajë është miratuar me VKB nr. 59, datë 24.12.2020, “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe bazuar në akt-rakordimet me Degën e Thesarit Kavajë, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë Kavajë për 2022 paraqitet i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Nr.	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	%
1	Tatim mbi te ardhurat personale	4500	10912.099	242%
2	Tatim i Thjeshtuar i Biznesit	2315	1119.429	48%
3	Taksa mbi token bujqesore	20380	17252.724	85%
4	Taksa mbi Ndertesen	87049	108714.5631	125%
5	Taksa mbi kalimin pasurise se paluajtshme ZVRRP	10027	22567.93849	225%
6	Takse e zenies se hapesires publike	45000	39137.6	87%
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	166912	159972.402	96%
8	Taksa per fjetjen ne hotel	18000	30074	167%
9	Taksa per therjen e bagetive	0	1391.81	0%
10	Takse per Reklamat	5000	4884.385	98%
11	Taksa e Tabeles	702	539.621	77%
12	Taksa per shfrytezimin e lendeve drusore	1700	264.369	16%
13	Taksa per truallin	12100	15207.8856	126%
14	Taksa e pervitshme e automjeteve	16594	18657.309	112%
15	Te ardhurat nga Renta Minerare	150	68.388	46%
TOTALI I:		390429	430364.5231	110%
1	Të ardhura nga Qira për Tokën	0	301.704	0%
2	Të ardhura nga Qira për Troje	5800	3690.80775	64%
3	Të ardhura nga Qira për Ndërtesat	0	2659.922	0%
4	Të ardhura nga ndërmarrjet e tjera	0	1261.678	0%
5	Të ardhura nga vërtetime e shërbime	0	1143.4906	0%
6	Të ardhura për dhënie leje ushtrim aktiviteti	2675	679.6	25%
7	Tarifë arsimore	4243	6505.8	153%
8	Tarifë pastrimi dhe higjienë	47000	66814.706	142%
9	Kontribute mirëmbajtje (Amortizim rruge)	1200	1250	104%
10	Tarifë shërbimi (a+b)	17000	26802.0794	158%
11	Tarifë shërbime funerale	0	2416.5	0%
12	Të ardhura nga kopshtet	5063	2538.28	50%
13	Të ardhura nga çerdhet	4571	1448.287	32%
14	Të ardhura nga qendrat e formimit profesional	131	0	0%
15	Të ardhura nga parkingu	1300	580	45%
16	Të ardhura nga shërbimi MNZ	2400	1341	56%
17	Sporti , biletat	720	37	5%
18	Të tjera Gjoba (a+b)	7502	4852.752	65%
20	Tarifë ujitje/vaditje toke	12000	0	0%
21	Leje karburanti	3000	7100	237%
22	Mbledhje gjethe dafine/shfrytezim toke	0	0	0%
23	Sekuestrime dhe Zhdemtime/Ndotje akustike	0	2225.9	0%
25	Sponsorizime (OJQ)/Grante nga Buxheti i Shtetit		200	
TOTALI II:		114605	133849.5068	117%
TOTALI I + II:		505034	564214.0299	112%

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 505,034,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 564,214,030 lekë ose në masën 112%. Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, ndërkohë që edhe në vitin paraardhës realizimi i disa taksave ka qenë më në nivel më të lartë se plani. Kjo tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real si dhe kur nuk është i mundur për një planifikim me baza reale, por si minimum duhet ti referohej realizimit në vitet para vitit ushtrimor. Planifikimi i të ardhurave është bërë me rezerva e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore. Pra ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Më poshtë po analizojmë planifikimin e disa zërave të të ardhurave, kështu:

a. Taksat dhe tarifatat e paraqitura me realizim mbi planin si:

-Taksa mbi te ardhurat personale është realizuar 10,912 mijë lekë nga 4,500 mijë lekë e planifikuar ose në masën 242%,

-Taksa mbi ndertesen është realizuar 108,714 mijë lekë nga 87,049 mijë lekë e planifikuar ose në masën 125%,

-Taksa mbi kalimin pasurise se paluajtshme ZVRRP është realizuar 22,567 mijë lekë nga 10,027 mijë lekë e planifikuar ose në masën 225%,

-Taksa per fjetjen ne hotel është realizuar 22,567 mijë lekë nga 10,027 mijë lekë e planifikuar ose në masën 167%,

-Taksa per therjen e bagetive nuk është planifikuar, ndërsa realizimi është 1,392 mijë lekë, pavarësisht se në paketën fiskale është parashikuar.

-Taksa mbi truallin është realizuar 15,208 mijë lekë nga 12,100 mijë lekë e planifikuar ose në masën 126%,

-Taksa e pervitshme e automjeteve është realizuar 18,657 mijë lekë nga 16,594 mijë lekë e planifikuar ose në masën 112%,

-Tarifë arsimore është realizuar 6,506 mijë lekë nga 4,243 mijë lekë e planifikuar ose në masën 153%,

-Tarifë pastrimi dhe higjene është realizuar 6,6815 mijë lekë nga 47,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 142%,

-Tarifë shërbimi është realizuar 26,802 mijë lekë nga 17,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 158%,

-Leje karburanti është realizuar 7,100 mijë lekë nga 3,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 237%,

-Të ardhura nga Qira për Tokën nuk është planifikuar, ndërsa realizimi është 302 mijë lekë, pavarësisht se këto tarifa janë përcaktuar në paketën fiskale dhe në kontrata të lidhura dhe si rrjedhojë janë të ardhura të parashikueshme.

Të ardhura nga Qira për Ndërtesat nuk është planifikuar, ndërsa realizimi është 2,660 mijë lekë, pavarësisht se se këto tarifa janë përcaktuar në paketën fiskale dhe në kontrata të lidhura dhe si rrjedhojë janë të ardhura të parashikueshme

Të ardhura nga ndërmarrjet e tjera nuk është planifikuar, ndërsa realizimi është 1,262 mijë lekë, pavarësisht se se këto tarifa janë përcaktuar në paketën fiskale dhe në kontrata të lidhura dhe si rrjedhojë janë të ardhura të parashikueshme.

Të ardhura nga vërtetime e shërbime tjera nuk është planifikuar, ndërsa realizimi është 1143 mijë lekë, pavarësisht se se këto tarifa janë përcaktuar në paketën fiskale.

b, Taksat dhe tarifatat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:

-Tatim i Thjeshtuar i Biznesit është realizuar 1,119 mijë lekë nga 2,315 mijë lekë e planifikuar ose në masën 48%,

-Taksa e tabelës është realizuar 540 mijë lekë nga 702 mijë lekë e planifikuar ose në masën 77%,

-Taksa mbi tokën bujqësore është realizuar 17,253 mijë lekë nga 20,380 mijë lekë e planifikuar ose në masën 85%,

-Takse e zenies se hapesires publike është realizuar 39,138 mijë lekë nga 45,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 87%,

-Taksa per shfrytezimin e lendeve drusore është realizuar 264 mijë lekë nga 1,700 mijë lekë e planifikuar ose në masën 16%,

-Te ardhurat nga Renta Minerare është realizuar 68 mijë lekë nga 150 mijë lekë e planifikuar ose në masën 46%,

- Të ardhura nga Qira për Troje* është realizuar 3691 mijë lekë nga 5,800 mijë lekë e planifikuar ose në masën 64%,
- Të ardhura për dhënie leje ushtrim aktiviteti që prodhojnë ndotje* është realizuar 680 mijë lekë nga 2,675 mijë lekë e planifikuar ose në masën 25%,
- Të ardhura nga kopshtet* është realizuar 2,538 mijë lekë nga 5,063 mijë lekë e planifikuar ose në masën 50%,
- Të ardhura nga cerdhet* është realizuar 1,448 mijë lekë nga 4,571 mijë lekë e planifikuar ose në masën 32%,
- Të ardhura nga parkingu* është realizuar 580 mijë lekë nga 1,300 mijë lekë e planifikuar ose në masën 45%,
- Të ardhura nga shërbimi MNZ* është realizuar 1,341 mijë lekë nga 2,400 mijë lekë e planifikuar ose në masën 56%,
- Të tjera Gjoha (a+b)* është realizuar 4,853 mijë lekë nga 7,502 mijë lekë e planifikuar ose në masën 65%,
- Tarifë ujitje/vaditje toke* është realizuar 0 lekë nga 12,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 0%, Referuar krijimit dhe realizimit të të ardhurave konkludohet se programimi i të ardhurave nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pra planifikimi i të ardhurave nuk është bërë mbi baza reale dhe i studiuar apo i argumentuar në lidhje me shfrytëzimin e të gjitha burimeve të të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimit të këtyre detyrimeve debitore.

- *Të dhënat mbi regjistrimin e subjekteve tatimpaguese dhe statusi i subjekteve aktiv dhe të mbyllur.*

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit gjendja e subjekteve tatimpagues në territorin në juridiksionin e Bashkisë Kavajë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Lloji	2022
1	Biznesi i Madh	550
2	Biznesi i Vogël	1277
3	Ambulant	5
4	Institucione	16
6	Familje	12116

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për periudhën objekt auditimi në territorin e Bashkisë Kavajë evidentohen aktive 550 subjekte të biznesi të madh, 1277 subjekte të biznesit të vogël, 5 subjekte të biznesit ambulant, 16 institucione dhe 12116 familje tatimpagues. Nga korespondenca me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve në bazëtë imail të datës 16.01.2023 dërguar në bazë të shkresë-kërkesës Bashki Kavajë me nr.prot.134 datë 10.01.2023 rezulton se nr. i bizneseve aktive është 1659 subjekte të biznesit të madh e dhe të vogël nga 1827 subjekte që ekzistojnë në rregjistrin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kavajë, numër ky që tregon se në bashki janë regjistruar se ka subjekte me nipte sekondare..

- *Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;*
 - *Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022 dhe vitin 2022.*

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë të punimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin,

individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të vitit 2021 vlera e debitorëve është **681,029,206 lekë**. **Gjatë vitit 2022 vlera e debitorëve taksave dhe tarifave është krijuar është 104,306,503 lekë për 11,138 subjekte gjithësej. Në fund të vitit 2022 vlera debitorëve në mënyrë progresive për taksa dhe tarifa është në vlerën 705,827,865 lekë.** Vlera e debitorëve në mënyrë të përmbledhur, ecuria për vitin 2022 (vlera e trashëguar nga vitet e mëparshme, vlera e krijuar brenda vitit, si dhe vlera në mënyrë progresive në fund të vitit 2022) paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në fillim të vitit 2022 (trashëguar nga vitet e mëparshme)	Nr	Principal	Kamat-Vonesë	Gjithësej
<i>Biznesi i Madh + Vogël</i>	1760	223,846,986	9,297,144	233,421,754
<i>Familjar</i>	10562	173,561,303		173,843,504
<i>UK Sh.A Kavajë</i>				
<i>Fshatrat Turistikë</i>	1003	252,430,595		252,430,595
<i>Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale</i>				
<i>Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit</i>				
<i>Qira të ndryshme</i>		13,932,123		13,932,123
<i>Karburante</i>	5	7,401,230		7,401,230
TOTAL		681,029,206		681,029,206

Krijuar brenda vitit 2022	Nr	Principal	Kamat-Vones	Gjithësej
<i>Biznesi i Madh + Vogël</i>	433	45,820,062	4,056,489	49,876,551
<i>Familjar+takse toke</i>	9671	31,947,682		31,947,682
<i>Fshatrat Turistikë</i>	973	6,871,064		6,801,824
<i>Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale</i>		0		0
<i>Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit</i>	37	12,700,000		12,700,000
<i>Qira Plazhi</i>		0		0
<i>Qira të ndryshme</i>	20	1,511,206		1,511,206
<i>Karburante</i>	4	1,400,000		1,400,000
TOTAL				104,237,263

Në fund të vitit 2022	Arkëtuar debitorë për periudhë 11-21	Shtesa debitorë 11-21 gjoha Synej	Progresive
Biznesi I Madh + Vogël	23,508,576	1,050,901	260,840,630
Familjar+ 60akes toke	8,219,602		197,571,584
UK Sh.A Kavajë	0		0
Fshatrat Turistikë	39,316,012		219,916,406
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	0		0
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	0		12,700,000
Qira Plazhi	0		0
Qira të ndryshme	3,444,284		11,999,045
Karburante	6,001,230		2,800,000
TOTAL	80,489,704	1,050,901	705,827,665

Debitorët sipas Njësive Administrative paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Njësia Administrative	Në fillim të vitit 2022	Krijuar brenda vitit 2022	Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2021	Shtesa debitorë për periudhën 2011-2022	Progresive deri në 31.12.2022
	Vlerë	Vlerë	Vlerë		Vlerë
Golem	489,442,821	56,426,109	59,912,396		485,956,533
Helmas	29,404,812	5,086,827	5,820,858		28,670,782
Kavajë	91,279,148	26,423,099	11,249,769		106,452,478
Luz i Vogël	37,256,596	7,061,698	3,506,682		40,811,612
Synej	33,645,829	9,239,530	0	1,050,901 (gjoha)	43,936,260
Total	681,029,206	104,237,263	80,489,705	1,050,901	705,827,665

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të debitorëve sipas NJA rezulton se vlerën më të madhe të debitorëve e ka Nja Golem e cila zë 69% të të vlerës totale të debitorëve e ndjekur nga Bashkia Kavajë (qytet) me 15% të totalit.

- Debitorët “Biznes” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore
Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga drejtoria e të ardhurave, ecuria e debitorëve për vitin 2022, për taksat dhe tarifave vendore, në mënyrë të përmbledhur dhe sipas NJA paraqiten të tabelat e mëposhtme:

Debitorë në mënyrë të përmbledhur Biznesi i Madh dhe i Vogël në lekë

Njësia Administrative	Në fillim të vitit 2022		Krijuar brenda vitit 2022		Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2021	Shtesa debitorë për periudhën 2011-2022	Progresive deri në 31.12.2022
	Numri	Vlerë	Numri	Vlerë	Vlerë		
Golem	846	145,882,772	138	36,237,228	20,136,420		161,983,580
Helmas	26	5,122,611	20	1,323,901	1,261,134		5,185,378
Kavajë	677	69,945,795	235	10,811,893	1,804,255		78,953,433
Luz i Vogël	69	6,509,206	22	747,608	306,767		6,950,047
Synej	66	5,961,370	18	755,921	0	1,050,901	7,768,192
Total	1684	233,421,754	433	49,876,551	23,508,576	1,050,901	260,840,630

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Debitorë në principal plus kamatvonesë Biznesi i Madh dhe i Vogël sipas NJA në lekë

Njësia Administrative	Krijuar brenda vitit 2022		Kamatvonesë	Gjithësej
	Numri	Principal		
B.V Gjithësej	287	17,220,319	1,574,123	18,794,442
Golem	108	11,651,612	929,802	12,581,414
Helmas	12	363,115	39,216	402,331
Kavajë	152	4,394,604	511,532	4,906,136
Luz i Vogël	19	460,790	52,806	513,561
Synej	12	350,233	40,767	391,000
B.M Gjithësej	146	28,599,743	2,482,366	31,082,109
Golem	30	21,907,586	1,748,228	23,655,814
Helmas	8	854,888	66,682	921,570
Kavajë	83	5,300,330	605,427	5,905,757
Luz i Vogël	3	210,066	23,981	234,047
Synej	6	326,873	38,048	364,921
TOTAL (B.M+B.V)	433	45,820,062	4,056,489	49,876,551

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelave të mësipërme vihet re se nga fillimi i vitit 2022 në përfundim të tij kemi rritje të debitorëve të kategorisë “Biznes”, për vlerën 49,876,551 lekë. Peshën kryesore të debitorëve e zë biznesi i madh me rreth 62 % të vlerës debitorë në total. Sa i përket debitorëve sipas NJA, rezulton se peshën kryesore e zënë debitorët në NJA Golem me 73% të vlerës në total, duke vijuar me Qytetin e Kavajës me 22 % ndaj totalit.

Pra në vitin 2022 në Bashkinë Kavajë dhe NJA, janë krijuar 433 subjekte debitor për vlerën 49,876,551 lekë⁶, e ndarë si më poshtë vijon:

-146 subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 31,082,109 lekë

-287 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 18,794,442 lekë

Në mënyrë progresive në fund të vitit 2022, vlera debitorë e krijuar nga kategoria “Biznes” është **260,840,630 lekë**. Për debitorët e mësipërm, janë përlllogaritur në çdo rast kamatvonesë për subjektet debitorë.

⁶ Lista analitike e debitorëve bashkëlidhur akt-konstatimit.

- Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifave vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrënguese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB), Bashkia Kavajë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifave vendore.

Për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë dhe dërguar 427 njoftime se do të merren masa shtërnguese, duke nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Gjithashtu, për debitorët e NJA Golem janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare për 158 tatimpagues debitorë për vitin 2022. Në mënyrë të përmbledhur masat e marra për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve taksapagues paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NJA	Lloji I njoftimit	Nr.	Likujduar	Mbetur pa likujduar	SHUMA E DERGUAR	SHUMA E LIKUJDUAR	diferenca
Kavajë	Njoftim për marrjen e masave shtërnguese	333	98	235	16,139,379	6,025,624	10,113,755
Luz I Vogel	Njoftim për marrjen e masave shtërnguese	28	6	22	1,158,738	514,025	644,713
Synej	Njoftim për marrjen e masave shtërnguese	41	23	18	1,543,470	811,657	731,813
Helmas	Njoftim për marrjen e masave shtërnguese	25	5	20	1,685,408	414,057	1,271,351
Golem	Urdher bllokime	158	81	77	32,434,974	12,577,395	19,857,579
		585	213	372	52,961,969	20,342,758	32,619,211

Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët që rezultonin se gjatë vitit 2022 kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë **213 subjektinë vlerën 32,619,211 lekë.**

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitorë strukturat e Drejtuese dhe DTTVAB, Bashkia Kavajë, nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

Titulli gjetjes: Mbi planifikimin e të ardhurave dhe menaxhimi nivelit të borxhit tatimor dhe masat e marra për uljen e tij.

Situata:

Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 505,034 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 564,214,030 lekë ose në masën 112%, Nga analiza në nivel zërash

konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, ndërkohë që edhe në vitin paraardhës realizimi i disa taksave ka qenë më në nivel më të lartë se plani. Referuar krijimit dhe realizimit të të ardhurave, tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, nuk pasqyron saktë bazën e taksueshme, e cilandikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2021 vlera e debitore është 681,029,206 lekë. Gjatë vitit 2022 vlera e debitore taksave dhe tarifave e krijuar është 104,306,503 lekë për 11,138 subjekte gjithësej. Në fund të vitit 2022 vlera debitorëve në mënyrë progresive për taksa dhe tarifa është në vlerën 705,827,865 lekë.**

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore strukturat e Drejtuese dhe DTTVAB, Bashkia Kavajë, nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal.

Kriteri:

Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr.9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Shkaku:

DTTV e Bashkisë Kavajë nuk kanë bërë punë të mjaftueshme për uljen e borxhit.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

-Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale, i studiuar dhe i argumentuar, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimit të tyre.

- Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë, për arkëtimin nga tatimpaguesit të vlerës debitore prej 705,827,865 lekëtë marrë të gjitha masat, që përvec nxjerrjes së njoftimit të vlerësimit tatimor, paralajmërimin e masave shtërnguese si dhe njoftimet e bllokimit bankar në bankat e nivelit të dytë për një pjesë të debitorëve të ndjekë të gjitha rrugët ligjore si:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare për pjesën tjetër të debitorëve të krijuar.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të

tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Të bashkërendojë punën me QKB dhe DRTT, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

Përsa me sipër mbajnë përgjegjësi, z R.I me detyrë Drejtor I Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB), zj.M.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhura nga Taksat dhe Tarifave Vendore, z. G.T me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave nga Taksat e Turizmit dhe z. M.C me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit të të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit.

Sqarim dhe shpjegime: Lidhur me observacionin sjellë me shkresën nr. 955/23, datë 05.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 207/8 prot., datë 10.07.2023 nga z R I, zj.M.H, z. M.C dhe z. G.T sqarohet se: arsyetimet për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nuk argumentojnë mbi baza reale planifikimin në nivel takse dhe tarife, pasi nuk jepen të dhëna se si është përllogaritur plani dhe nuk jepen detaje mbi të dhënat mbi të cilën është llogaritur baza e tatueshme. Gjithashtu nga na juaj jepen tregues të përmisuar të realizimit të planit dhe të uljes së masës së debitorëve ngakrahasimi i disa viteve, por niveli i debitorëve në fund të vitit 2022 përsëri është në masë të konsiderueshme. Ndërsa për arkëtimin e taksave dhe tarifave nga familjarët, në shpjegimet e juaja paraqitet puna që po bëhet nëpërmjet OSHEE për saktësimin dhe përditësimin e rregjistrimit të familjarëve, por akoma mbetet në nivelin e përpjekjeve dhe jo të finalizimit të këtij procesi, duke muos sjellë akoma rezultatet e kërkuara për rritjen e planit dhe realizimit të të ardhurave nga familjarët dhe minimizimin e debitorëve nga kjo kategori. Si përfundim observacioni ka karakter justifikues dhe nuk ka sjellë apo mbështetet në prova të reja ligjore ,për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

➤ **Analiza e disa zërave kryesore të detyrimeve fiskale (taksa/ tarifa vendore):**

- **Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.**

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Kavajë dhe NJA taksohen gjithësej 10817 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohet si më poshtë:

Nr	Njësi Administrative	2022	
		Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022	
		Nr	
1	Luz I Vogel	2560	
2	Helmas	891	
3	Golem	3231	
4	Kavajë	1718	
5	Synej	2614	
	TOTAL	11014	

Burimi: DAV Bashkia Kavajë

-Me qëllim vlerësimin nëse nga DAV Bashkia Kavajë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë "familjar", u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Kavajë me informacionin e administruar nga Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Kavajë e NJA.

-Nga përllorarijtet e kryera rezultoi se gjithësej nuk janë përfshirë në taksat dhe tarifave vendore 13774 familje, ku diferenca më e lartë është në Qytetin e Kavajës për 11,329 familje, duke vijuar me NJA Helmas për 1093 familje, si dhe NJA Golem për 312 familje.

Nr	Njësi Administrative	2022		
		Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuar për vitin 2022	Familje sipas Gj.Civile	Diferenca
		Nr	Nr	Nr
1	Luz i Vogël	2560	2690	130
2	Helmas	891	1293	402
3	Golem	3231	3543	312
4	Kavajë	1718	13047	11329
5	Synej	2614	2798	184
	TOTAL	11014	23371	12357

Burimi: DAV Bashkia Kavajë dhe Zyra e Gjendjes Civile Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së
Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kavajë nga kategoria “Familjar”, përshëmbull, nëse do të bënim përllorarijtet për Qytetin e Kavajës vetëm për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 1,200 lekë (tarifë pastrimi dhe shërbimi) * 12357 familje diferencë = **14,828,400 lekë më pak planifikuar për tarifën vendore të pastrimit dhe shërbimit, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Kavajë**.

-Situata e mësipërme, kryesisht është krijuar për arsye se në vitin 2020 është ndërprerë marrëveshja e bashkëpunimit me UK Sh.A Kavajë⁷, i cili ka patur rolin e agentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Praktikisht sa i takon taksimit të kategorisë “Familjar”, për Qytetin e Kavajës, DAV Bashkia Kavajë takson vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik, pasi vetëm tek kjo kategori e ka të mundur indentifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DAV Bashkia Kavajë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 7.3.2018⁸, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Kavajë.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, tokës bujqësore:

Tabela nr.4 Numër familje debitore sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksat/tarifa

Nr	Njësi Administrative	2022			
		Familje Debitorë në fillim të vitit 2022	Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuar për vitin 2022	Familje Debitorë krijuar brenda vitit 2022	Progresive deri në vitin 2022
		Nr	Nr	Nr	Nr
1	Luz i Vogël	1939	2560	1469	1506
2	Helmas	1763	891	228	1763
3	Golem	3847	3231	2611	3806
4	Kavajë	483	1718	389	872
5	Synej	1724	2614	1720	1724
	TOTAL	9262	11014	6417	9671

Burimi: DAV Bashkia Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

⁷Me vendimin nr. 94, datë 21.08.2020, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 1276/2 prot., datë 04.09.2020

⁸Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 janë 9671 familje debitore, nga të cilat brenda vitit 2022 janë krijuar gjithësej 6417 familje debitore për një ose disa taksa dhe tarifa vendore, ç'ka do të thotë se 66,3 % e familjeve që taksohen janë debitor.

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se numri i familjeve debitore në mënyrë të grupuar, ndarë sipas Njësive Administrative, në fund të vitit 2022 është:

-389 familje nga 1718 gjithësej të taksuara për Qytetin e Kavajës, ose 22.6 % e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-228 familje nga 891 gjithësej të taksuara për NJA Helmas, ose 25.6% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-1720 familje nga 2614 gjithësej të taksuara për NJA Synej, ose 65.8% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-2611 familje nga 3231 gjithësej të taksuara për NJA Golem, ose 80% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-1469 familje nga 2560 gjithësej të taksuara për NJA Luz i Vogël, ose 57.4% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

Të dhënat për familjet debitore sipas llojit të taksës/tarifës në vlerë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Loji i Taksës dhe Tarifës	Debitor deri në fillim të vitit	Maturimi	Arkëtimet	Debitorët krijuar brenda vitit	Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2021	Totali Debi
		2022	2022	2022	2022	2011-2022	Progressive
1	Ndërtesë	21,549,398	19,659,990	8,205,645	11,454,345	15,741,008	17,262,735
2	Tarife Pastrimi	10,131,450	11,014,000	4,597,000	6,417,000	6,877,450	9,671,000
3	Tarife Ndricim	4,877,300	2,202,800	919,400	1,283,400	358,100	5,802,600
4	Tarife Gjelbërimi	3,328,300	0	0	0	0	3,328,300
5	Tarife Arsimit	5,971,000	5,507,000	2,298,500	3,208,500	4,344,000	4,835,500
6	Takse Trualli	7,365,386	2,202,800	919,400	1,283,400	6,714,586	1,934,200
Totali		53,222,834	40,586,590	16,939,945	23,646,645	34,035,144	42,834,335

Burimi: DAV Bashkia Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitore e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifatat vendore, në krahasim me fillimin e vitit 2022 është ulur me 10,388,499 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se në fund të vitit 2022 në Bashkinë Kavajë dhe NJA, janë gjithësej 9671 familje debitore për vlerën 42,834,335 lekë, nga të cilat 6417 familje për vlerën 23,646,645 lekë janë debitor të krijuar brenda vitit 2022.

Nga zyrat e taksave në çdo njësi, taksa familjare është maturuar bashkë me taksën e biznesit, si dhe është maturuar për fshatrat bashkë me taksën e tokës bujqësore.

Familje debitore në fshatrat turistike sipas llojit të taksës/tarifës në vlerë

Nr.	Loji i Taksës dhe Tarifës	Debitor deri në fillim të vitit	Maturimi	Arkëtimet	Debitorët krijuar brenda vitit	Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2021	Totali Debi
		2022	2022	Viti 2022	Viti 2022	2011-2022	Progressive
1	Taksë ndërtesë	220,607,895	4,812,514	1,353,290	3,487,224	34,251,512	189,843,606
2	Tarifë pastrimi	20,474,000	2,582,000	632,000	1,950,000	3,256,000	19,168,000
3	Tarifë shërbimi	8,779,500	1,291,000	316,000	975,000	1,682,300	8,072,200
4	Taksë trualli	2,569,200	516,400	126,800	389,600	126,200	2,832,600
Totali		252,430,595	9,201,914	2,428,090	6,801,824	39,316,012	219,916,406

Konkluzion: Nga auditimi i arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”, rezulton edhe për 1006 familje që banojnë në fshatrat turistike në NJA Golem, të cilat prej vitit 2011 deri në vitin 2022 nuk kanë likuiduar detyrimet që kanë ndaj Bashkisë Kavajë për taksën e ndërtesës, truallit, si dhe tarifën e pastrimit dhe shërbimit, duke krijuar një vlerë debitore prej 219,916,606 lekë, nga të cilat 6,801,824 lekë, janë krijuar brenda vitit 2022. Për familjet debitore

në vitin 2022, nga zyra e taksave në NJA Golem nuk është përlogaritur edhe kamatvonesë për moslikujdimin e detyrimeve, ku sipas përlogaritjeve vlera e kamatvonesës (150 ditë vonesë) për vitin 2022 është 703,840 lekë. Lista me familjet debitore i është përcjellë DAV, Sektori i Borxhit, Bashkia Kavajë nga zyra e taksave në NJA Golem dhe janë dërguar Njoftime për marrjen e masave shtrënguese si dhe urdhër bllokimi të llogarive bankare, por ndaj këtyre masave arkëtimi i detyrimeve të prapambetura ka arritur në masën 15.6%.

Titulli gjetjes: *Mbi plotësimin dhe saktësimin e rregjistrit të taksapaguesve familjarë. Planifikimi dhe arkëtimi i detyrimeve debitorëve nga kategoria “Familjar” për taksat dhe tarifave vendore.*

Situata:

Për planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga kategoria “familjar për taksën e ndërtesës, dhe tarifave pastrim-shërbimi, DAV Bashkia Kavajë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”. Pra planifikimi i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar” nuk është bërë i saktë, pasi nga informacionin i Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë Kavajë rezultoi se, në rregjistrin e kësaj kategorie tatimpaguesish nuk janë përfshirë 12357 familje për Qytetin e Kavajës 11,329 familje, Nga përlogaritjet për Qytetin e Kavajës vetëm për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, për numrin e prej 11,329 familjeve të pataksuara, është planifikuar 30,398,220 lekë më pak të ardhura.

Përsa i përket arkëtimin për familjarët për taksën e ndërtesës e truallit, tarifave pastrim-ndricim-gjelbërim-arsim konstatohet se vlera debitorëve progresive në Bashkinë Kavajë dhe NJA në celje të vitit 2022 është 305,659,846 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 262,750,741 lekë, që i përket 10,677 familjeve debitore, nga të cilat 6417 familje për vlerën 30,448,469 lekë janë debitorë të krijuar brenda vitit 2022. Situata e mësipërme, është krijuar për arsye se në vitin 2020 është ndërprerë marrëveshja e bashkëpunimit me UK Sh.A Kavajë, i cili ka patur rolin e agentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” si dhe mungesat e një regjistri të përditësuar të kategorisë “Familjar” me të dhënat e plota për taksapaguesin: adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, etj. Praktikisht Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit takson vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik si dhe ato individë, që paraqiten për marrjen e shërbimeve në Bashki, pasi vetëm tek kjo kategori e ka të mundur identifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Kriteri:

VKB nr.nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” Kreu II, e ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, neni 42/2 me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 dhe neni 24.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Shkaku:

Punë e pamjaftueshme nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë për arkëtimin e të ardhurave nga kategoria “Familjar” nga moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë marrë masa për plotësimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme të regjistrimit të taksapaguesve vendorë të kategorisë “Familjar” për Bashkinë Kavajë dhe NJA si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real. Gjithashtu të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare.

- **Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.**

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore sipas DAV Bashkia Kavajë janë 9818.4 Ha, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë. Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAV Bashkia Kavajë, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.6 Planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAV Bashkia Kavajë për vitin 2022

Kategoria e tokës	Sip/HA-Luz i Vogël	Sip/HA-Helmas	Sip/HA-Golem	Sip/HA-Synej	Vlera/Ha	Zbritja 30%	Plani/Lekë
Kategoria I	151	78		0	5,600	3,920.0	897,680
Kategoria II	588	48.6		0	4,900	3,430.0	2,183,538
Kategoria III	1166	190	2980.8	700	4,200	2,940.0	8,763,542
Kategoria IV	197	700		1400	3,600	2,520.0	5,788,440
Kategoria V	39	340		260	3,000	2,100.0	1,341,900
Kategoria VI	18	307		80	2,400	1,680.0	680,400
Kategoria VII-X	0	575			1,800	1,260.0	724,500
e. Totali sip. ha sipas planifikimit	2159	2238.6	2980.8	2440			20,380,000

Burimi: DAV Bashkia Kavajë

Konkluzion: Me qëllim vlerësimin nëse nga DAV Bashkia Kavajë është bërë planifikimi saktë i taksës së tokës bujqësore, u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Kavajë me informacionin e administruar nga agronomët e NJA mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, familjet që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore dhe kategorinë e bonitetit, sipas NJA.

Nga përllogaritjet e kryera, bazuar në kategorinë e bonitetit, sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo familje, rezultoi se planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të bëhet për vlerën 26,198,107 lekë/ 5,818,107 lekë janë planifikuar më pak nga DAV Bashkia Kavajë, për t’u arkëtuar nga taksat e tokës bujqësore. Planifikimi sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur⁹ si më poshtë:

Kategoria e tokës	Sip/HA-Luz I Vogel	Sip/HA-Helmas	Sip/HA-Golem	Sip/HA-Synej	Ha gjithësej	Vlera /Ha ¹⁰	Plani/Lekë	DIF ne ha plan/ agronom
Kategoria I		78		839.5	917.5	3920	3,596,747	688.5
Kategoria II	150.6	48.6	0	299.2	498.4	3430	1,710,082	-138.2
Kategoria III	588.4	183	2999	344.3	4114.7	2940	12,098,031	-922.1
Kategoria IV	1165.5	567.8	0	262.3	1995.6	2520	5,029,197	-301.4
Kategoria V	196.6	323.5	0	276.7	796.8	2100	1,673,544	157.8
Kategoria VI	39.3	321	0	199.2	559.5	1680	940,269	154.5
Kategoria VII	18	609.8	0	285	912.8	1260	1,150,237	337.8
e. Totali sip. ha sipas planifikimit	2158.4	2131.7	2999	2506.2	9795.3		26,198,107	-23.1

Burimi: DAV Bashkia Kavajë dhe agronomët sipas NJA

Referuar tabelës së planifikimit të të ardhurave nga taksat e tokës sipas informacionit që administrohet nga DAV Bashkia Kavajë në lidhje me tokën bujqësore gjithësej krahasuar me të

⁹Analistikisht plani i taksës së tokës bujqësore për çdo NJA pasqyrohet bashkëlidhur akt-konstatimit.

¹⁰Përllogaritjet edhe efekti i zbritjes -30%.

dhënat që disponojnë agronomët e NJA rezultojnë se janë planifikuar 23.1 Ha më pak. Diferencat rezultojnë në sipërfaqe toke bujqësore të kategorive të ndryshme të bonitetit, të cilat kanë taksë të ndryshme, duke ndikuar në planifikimin të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore. Konkretisht:

-NJA Luz i Vogël diferencat rezultojnë në kategorinë e IV për sipërfaqen 968.5 Ha, kategorinë e V për sipërfaqen 157.6 Ha, kategorinë e VI për sipërfaqen 21.3 Ha, si dhe kategorinë e VII për sipërfaqen 18 Ha.

-NJA Helmas diferencat rezultojnë në kategorinë VI të tokës për sipërfaqen 14 Ha dhe në kategorinë e VII të tokës për sipërfaqen 34.8 Ha;

-NJA Golem diferencat rezultojnë në sipërfaqen e tokës bujqësore për 18.2 Ha;

-NJA Synej diferencat rezultojnë në kategorinë e I të tokës për 840 Ha, kategorinë e II të tokës për 299 Ha, kategorinë e V për 16.7 Ha, kategorinë e VI për 119 Ha dhe kategorinë e VII për 285 Ha. Gjithashtu duhet theksuar se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi, pasi në këtë regjistrer nuk janë kryer përditësimet për cdo vit ushtrimor. Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.

Në fund të vitit 2022 rezultojnë se vlera debitoare për taksën e tokës bujqësore është 197,571,584 lekë në NJA të Bashkisë Kavajë, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2022 është rritur me 23,728,080 lekë.

Gjatë vitit 2022 janë gjithsej 6846 familje debitoare për vlerën 31,947,682 lekë, ku peshën më të madhe të familjeve debitoare e ka NJA Golem, duke vijuar me NJA Synej .

Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në Bashkinë Kavajë, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre. me qëllim arkëtimin e kësaj takse. DAV Bashkia Kavajë arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Kavajë për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar. Më poshtë pasqyrohet ecuria e debitorëve të rezultuar për taksën e tokës bujqësore:

Debitor toka bujqësore 2022					
NJA.	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2022	Debitorë krijuar në vitin 2022 (Lekë)			DEBIA PROGRESIVE
		Familje me tokë bujqësore	Familje debitoare (Nr)	Familje debitoare (vlerë)	
Luz i Vogel	30,747,390	2,214	1,497	6,314,090	33,861,565
Helmas	24,282,201	1,164	1,143	3,762,926	23,485,404
Synej	27,684,459	2273	1,597	8,483,609	36,168068
Golem	91,129,454	3231	2609	13,387,057	104,056,547
TOTALE	173,843,504	8,882	6,846	31,947,682	197,571,584

Burimi: DAV Bashkia Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 3 neni 4, pikat 1 dhe 7, neni 23 dhe neni 24, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”i ndryshuar neni 12 pika 1 dhe me VKB nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, Kreu I, shkronja “b”.

Titulli gjetjes: Mbi planifikimin dhe arkëtimin e taksës bujqësore

Situata:

Në vitin 2022 realizimi i taksës së tokës bujqësore për Bashkinë Kavajë paraqitet në vlerën 17,2523 mijë lekë nga 20,380 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85%. Në lidhje me planifikimin e kësaj takse u bë kryqëzimi i bazës së të dhënave mbi të cilin është kryer planifikimi nga DAV Bashkia Kavajë dhe informacionin e administruar nga agronomët e NJA mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, familjet që kanë në pronësi/përdorim tokë

bujqësore dhe kategorinë e bonitetit, sipas NJA, nga ku rezultoi se planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të bëhet për vlerën 26,198,107 lekë, ndërkohë që nga DAV planifikimi është bërë për 5,818,107 lekë më pak. Gjithashtu duhet theksuar se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi, pasi në këtë regjistër nuk janë kryer përditësimet për çdo vit ushtrimor.

Përsa i përket arkëtimit të taksës bujqësore u konstatua se detyrimet debitoare progresive për Bashkinë Kavajë dhe NJA në celje të vitit 2022 janë në vlerën 173,843,504 lekë dhe në fund të vitit 2022 janë në vlerën 197,571,584 lekë, ndërsa vetëm **gjatë vitit 2022** janë krijuar detyrime debitorë **në vlerën 31,947,682 lekë**, që i përkasin 6846 familje fermere debitoare. Krijimi dhe rritja e debitorëve në lidhje me arkëtimin e taksës bujqësore, ka ardhur për arsye se familjet fermerë nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre.

Praktikisht arkëtimi i kësaj taksemundësohet vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore aplikon në Bashki për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar dhe realisht DAV familjet fermere të cilat taksohen për tokën bujqësore nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre.

Kriteri:

ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 3 neni 4, pikat 1 dhe 7, neni 23 dhe neni 24, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 12 pika 1 dhe me VKB nr. 95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, Kreu I, shkronja “b”.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Shkaku:

Punë e pamjaftueshme nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e tokës nga fermeret si rezultat i moszbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë në bashkëpunim dhe me specialistët në NJA të Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike të marrë masa për saktësimin e të dhënave për tokën bujqësore e dhënë në përdorim/pronësi si dhe përditësimin e regjistrit të taksapaguesve fermerë për taksën bujqësore për Bashkinë Kavajë dhe NJA, si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real dhe të argumentuar. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitoare nga taksat e tokës ndaj familjeve fermere debitorë.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi z.R.I, Drejtor i DAV Bashkia Kavajë, z.SH.K, specialist për taksat familjare në NJA Golem, z.TH D specialist për taksat në NJA Helmas, z.A Ç specialist për taksat familjare në Luz i Vogël, zj.E Ç specialist për taksat në NJA Synej.

➤ **Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e ndërtimeve informale**

Të ardhurat nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë për lejet e zhvillimit të miratuara dhe ndërtimet informale të legalizuara për vitin 2022 rezultojnë se janë planifikuar 166,912 mijë lekë dhe janë realizuar 159,972 mijë ose në masën 96%. Në VKB nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e

paketës fiskale për vitin 2022” nuk është përfshirë parashikimi taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale, por vetëm për ndërtimet e reja. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës rezulton se Bashkia Kavajë ka korespondencë zyrtare me Drejtorinë Vendore e ASHK Zonat e Stimuluara (bregdetare) për legalizimet e kryera për ndërtimet informale në zonat e Stimuluara (bregdetare). Ndërkohë Bashkia Kavajë nuk ka informacion dhe nuk disponon dokumenta me të dhëna për të gjitha legalizimet e kryera në vitet 2021-2022 të ndërtimeve informale të ndodhura në territorin nën juridiksionin e saj, pasi nuk ka korespondencë me DVASHK Kavajë, me qëllim vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje nga individë të ndryshëm. Nga auditimi dokumentacionit për periudhën e vitit 2022, i paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës rezultoi se nga DVASHK Zonat e Stimuluara, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI). Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kavajë, nuk janë marrë masat në mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Kavajë, me qëllim që subjektet, të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t’i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitorë progresive dhe e ndarë sipas viteve¹¹.

TNI për legalizimin e objekteve informale - Viti 2022

Debitor TNI 2019-2022	Subjekte	Vlera
Gjithësej progresive	1278	59,177,496
Nga të cilat në 2022 - Zonat e Stimuluara	204	6,490,083
Nga të cilat në 2021 - Zonat e Stimuluara	159	3,295,585
Nga të cilat në 2020 - Zonat e Stimuluara	161	2,964,730
Nga të cilat në 2019 - Zonat e Stimuluara	73	4,735,860
Nga të cilat në 2019 - 2020 - DVASHK Kavajë	885	41,691,238

Burimi: Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të Drejtorisë e Urbanistikës, Bashkia Kavajë rezulton se borxhi tatimor në lidhje me mos arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje në zonat e stimuluara **për vitin 2022 për 204 individë në vlerën 6,490,083 lekë** dhe në **mënyrë progresive** (vitet 2019-2022) **për 1278 individë në vlerën 59,177,496 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Mos marrja e masave për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe mos arkëtimi i saj nga individët që kanë përfituar legalizimin është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2, neni 22/5, pika 1 shkronjën “c”, me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89 pika 2 dhe me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.

Gjithashtu nga Drejtoria e Urbanistikës nuk ka korespondencë zyrtare me Drejtorinë e Takasave dhe tarifave Vendore brenda Bashkisë Kavajë, për dhënien e të dhënave për lejet e zhvillimit të miratuara nga kjo Drejtori firmave ndërtuese (seli brenda dhe jashtë Bashkisë Kavajë) apo individëve që pajisen me leje me qëllim

¹¹Tabela analitike, subjekt, sipërfaqe, objekt, vlera e detyrimit, bashkëlidhur akt-konstatimit.

taksim, ndjekjen në terren dhe arkëtimin e tarifës së shërbimit dhe pastrimit për aq kohë sa kryejnë punime ndërtimi.

Titulli gjetjes: *Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).*

Situata:

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës rezulton se, Bashkia Kavajë ka korespondencë zyrtare me Drejtorinë Vendore e ASHK Zonat e Stimuluara (bregdetare) për legalizimet e kryera për ndërtimet informale në zonat e Stimuluara (bregdetare). Ndërkohë Bashkia Kavajë nuk ka informacion dhe nuk disponon dokumenta me të dhëna për të gjitha legalizimet e kryera në vitet 2021-2022 të ndërtimeve informale të ndodhura në territorin nën juridiksionin e saj, pasi nuk ka korespondencë me DVASHK Kavajë, me qëllim vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje nga individë të ndryshëm.

Referuar të dhënave të Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia Kavajë rezulton se borxhi tatimor në lidhje me mos arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje në zonat e stimuluara **për vitin 2022 për 204 individë është në vlerën 6,490,083 lekë** dhe në **mënyrë progresive** (vitet 2019-2022) **për 1278 individë është në vlerën 59,177,496 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë. Për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informaleka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Kavajë, me qëllim që subjektet, debitorë për TNI nga legalizimi, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj).

Kriteri:

Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksavevendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjinnr. 95/2018 "për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksavevendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksavevendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim" pika 5 dhe me VKB nr.95 datë 25.11.2021 "Për miratimin e paketës Fiskale për vitin 2022" Kreu I, pika 8.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kavajë nga mos arkëtimi i vlerës prej 59,177,496 lekë për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku:

Mos marrje e masave efektive nga Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit dhe DAV për të bërë të mundur pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga përfituesit e legalizimeve.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtorja e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 59,177,496 lekë të taksës së ndikimit

në infrastrukturë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Kavajë të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), që krahas legalizimeve në zonat e stimuluar të marrë informacion periodik për të gjitha legalizimet, që kryhen në territorin e Bashkisë Kavajë si dhe të sigurojë një marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Përsa më sipër në bazë të VKB nr.95 datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës Fiskale për vitin 2022” Kreu I, pika 8 ngarkohet me përgjegjësi zj.D.Q, Drejtore e Drejtorisë së Urbanistikës.

➤ Auditimi i procedurave të kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë,të Bashkisë Kavajë.

Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, rezulton se në në territorin e Bashkisë Kavajë kanë seli dhe ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të karburanteve shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë 22 subjekte private.

Të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Adresa	Nipt	Tarifa	Afati I autorizimit Dat e fillimit e mbarimit	Konferma e bankare e pageses	Shuma e paguar
1	AP OIL (DAS OIL)	Lagja Nr.2 Kavajë	L.....G	1.000.000	09.02.2022-09.02.2027	03.02.2022	1.000.000
2	G.C	Stacioni Trenit Kavajë	K.....T	1.000.000	06.09.2022-06.09.2023	12.08.2022	200.000
3	G.C	Rruga Egnatia,Kavajë	K.....T	1.000.000	15.03.2023-15.03.2024	13.03.2023	200.000
4	G.C	Prokuroria	K.....T	1.000.000	06.09.2022-06.09.2023	09.08.2022	200.000
5	G.C	Stadiumi B	K.....T	1.000.000	06.09.2022-06.09.2023	15.08.2022	200.000
6	Sh petrol	Lagja.Nr.6 Kavajë	K.....B	1.000.000	11.11.2022-11.11.2023	07.11.2022	200.000
7	M OIL	Agjensia Kavajë	L.....H	1.000.000	Pa autorizim		
8	K 1	Autostrad KJ-Rrogozhinë	J.....P	1.000.000	22.02.2022-22.02.2027	22.02.2022	1.000.000
9	K 2	Helmas	J.....P	1.000.000	19.09.2022-19.09.2023	Pa pagese	200,000
10	K 3	Lgj.Nr.2,rruga Josif Buda	J.....P	1.000.000	19.09.2022-19.09.2023	08.09.2022	200.000
11	K 4	Autostrad KJ-Rrogozhinë (Majtas)	J.....P	1.000.000	09.10.2018-09.10.2023	19.01.2019	1.000.000
12	O SHPK	Golem Kavajë	J.....I	1.000.000	25.10.2022-25.10.2027	18.10.2022	1.000.000
13	P	Qerret Kavajë	K.....Q	1.000.000	06.04.2021-06.04.2026	11.05.2021 10.02.2022	200.000 800.000
14	K sh.p.k	Golem Kavajë	K.....Ë	1.000.000	25.10.2022-25.10.2023	18.10.2022	200.000
15	V A	Luz I Vogël Kavajë	K.....Ë	1.000.000	28.09.2022-28.09.2023	28.09.2022	200.000
16	B GAZ	Blerimaj Kavajë	J.....M	1.000.000	19.07.2018-19.07.2023	19.07.2018	100.000
17	L oil	Alia Kavajë	L.....P	1.000.000	20.01.2022-20.01.2027	20.01.2022	1.100.000
18	G.C	Luz I Vogël ,Kavajë	K.....T	1.000.000	06.09.2022-06.09.2023	15.08.02022	200.000
19	K sh.p.k	Ura Leshniqs Kavajë	K.....H	1.000.000	30.11.2022-30.11.2023	30.11.2022	200.000
20	A GAZ	Golem Kavajë	L.....I	1.000.000	17.12.2014-17.12.2019	Mbyllur	
21	M shpk	Synej Kavajë	K.....A	1.000.000	Pa autorizim		
22	A OIL	Pranë spitalit Kavajë	M.....K	1.000.000	Pa autorizim		

Burimi: Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Subjekteve të licencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezultoi se në 7 raste të subjekteve, që operojnë në territorin nën Juridiksionin e Bashkisë Kavajë ushtrojnë aktivitetin në mungesë të autorizimit të licencimit për ushtrim aktiviteti, pavarësisht njoftimeve, gjë që ka sjellë mosarkëtimin e të ardhurave nga tarifa e licencimit **në vlerën prej 5,800,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Kavajë.** Të dhënat për subjektet të licencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Nipt	Debitor	
	A GAZ	L.....I	800,000	I mbyllur
1	M shpk	K.....A	1,000,000	Debitor
2	A OIL	M.....K	1,000,000	Debitor

3	A	L.....G	600,000	Debitor
4	D A	K.....P	200,000	Debitor
5	K PETROL	L.....O	1,000,000	Debitor
6	M OIL	L.....H	1,000,000	Debitor
7	K	J.....P	200,000	Debitor
			5,800,000	

- Përsa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, më datë 17.11.2022 me shkresën nr.3917 prot., i është drejtuar subjektit K Petrol, A Oil, M shpk, për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe pajisjen me licencë për tregëtimin e karburantit;

Me shkresën nr.840/2 prot., datë 29.03.2023 lista me subjektet debitore i është përcjellë drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore.

- **Gjatë vitit 2022** nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet në mungesë të autorizimit për lejim aktiviteti.

Kjo procedurë është në kundërshtim në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve përdhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017“Për disa ndryshime dhe shtesa nëVKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 9¹².

Titulli gjetjes: *Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregëtojnë lëndë djegëse.*

Situata:

Në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Kavajë kanë seli dhe ushtrojnë aktivitet në fushën e tregëtimin të karburanteve dhe shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë 22 subjekte private. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit rezulton se, Bashkia Kavajë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet, që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe në pjesën më të madhe ka dhënë autorizime 1 vjecare, ndërkohë që autorizimi sipas dispozitave ligjore është 5-vjecar, për krijimin e mundësisë që subjektet për detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Nga subjektet e licencuara për ushtrimin e aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve **për vitin 2022** në 7 raste të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në mungesë të autorizimit të licencimit për ushtrimin e aktivitetit dhe 1 subjekt është i mbyllur por ka detyrim të prapambetur, gjë që ka sjellë mosarkëtimin e të ardhurave nga tarifa e licencimit pavarësisht njoftimeve, **duke sjellë të ardhura të munguara në vlerën prej 5,800,000 lekë.**

Kriteri:

Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe me VKM nr.

¹²9. *Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*

970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3 i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, = kapitulli II, pika 1; gërma “b”, dhe pika 9.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Shkaku:

Puna jo efektive dhe mosbashkëpunimi i Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit dhe DAV në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetet pa autorizim.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Mbrojtjes të Konsumatorit dhe Mjedisit të shqyrtojë dokumentacionin e 8 subjekteve debitore dhe të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur të tarifës së autorizimit prej 1000,000 lekë ndaj Bashkisë Kavajë për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022, si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur arkëtimet e plota brenda afateve. Për rastet e mosparaqitjes të subjekteve për paisje me autorizim/licencë të bëhet njoftimi i Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve, që ushtrojnë aktivitetet në mungesë të autorizimit për lejim aktiviteti.

Përsa më sipër në bazë të VKB nr.95 datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës Fiskale për vitin 2022” Kreu II pika 12 ngarkohet me përgjegjësi z. S.M me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes të Konsumatorit dhe Mjedisit.

➤ Të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e objekteve tregtimi, banesave sociale, tokave bujqesore, kontratat e lidhura dhe procedurat e ndjekura për arkëtimin e detyrimeve.

• **Dyqanet e dhëna me qira**

Bashkia Kavajë për vitin 2022 ka dhënë gjithësej 14 dyqane me qira, të cilët variojnë në një sipërfaqe 12 m² – 20 m². Çmimi dysHEME i tarifës së qirasë 150 lekë për m² është përcaktuar në paketën fiskale të vitit 2022, bazuar në përcaktimin e bërë në shkronjën “a” të pikës 1 në Kreun III në VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I ndryshuar. Nga shqyrtimi i kontratave të qirasë dhe pagesave të kryera për detyrimet kontraktore nga subjektet qiramarrës rezulton se 1 subjekt nuk ka bere pagesen e qerases per vitin 2022 në vlerën 23,940 lekë, sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emer Mbiemer	Afati kontrates , Nr Prot	Sip ne m ²	lek/m/vit	Pagese viti 2022	Data e pagesave	Debitor
1	SH.LL	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 3078	12.00	150.00	21,600	19.03.2022	
2	E.H	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 1033	16.80	150.00	30,240	23.03.2022	
3	Sh.H	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 3929	12.90	150.00	23,220	16.11.2022	
4	F.Z	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 663	12.80	150.00	23,040	24.01.2022	
5	A.H	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 3235	12.90	150.00	23,220	21.09.2022	
6	N.M	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 2456	12.67	150.00	22,806	23.06.2022	
7	F.Q	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 315	16.94	150.00	30,492	20.01.2022	
8	Xh.B	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 613	13.00	150.00	23,400	11.02.2022	

9	V.B	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 216	13.00	150.00	23,400	19.01.2022	
10	D.K	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 4237	12.60	150.00	22,680	02.11.2022	
11	B.I	01.01.2022-31.12.2022 Prot 1032	12.80	150.00	23,040	17.02.2022	
12	S.B	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 260	12.90	150.00	23,220	20.01.2022	
13	M.L	01.01.2022 - 31.12.2022 Prot 316	17.00	150.00	30,600	25.01.2022	
14	P.R	Zhvillon aktivitet pa lidh kontrat 2022	13.30	150.00		Pa paguar	23,940
Burimi drejtoria e kadastres, bashkia kavaje				Shuma	320,958		23,940

- **Banesat Sociale.**

Nga bashkia Kavajë janë lidhur kontrata qiraje me individë, që kanë përfituar nga program i strehimit që nga viti 2016. Banesa sociale me qera jane dy pallate te cilat kane 24 apartamente secila ne total 48 apartamente per vitin 2022 jane lidhur 35 kontrata, të cilat rinovohen cdo vit. Nga këto në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga bashkia Kavajë për secilin qiramarrës rezulton se janë debitorë (vlerë e mbetur) në vite 14 individë në vlerën 3,975,040 lekë, të cilët paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emer Mbiemer	Deri ne 31.12.2021	Principal/lek kotrata 2022	Detyrim	Akt Marveshje per shlyerje detyrimesh
1	D.XH	286,248	7,530	293,778	Nr.3500/1 prot dt 13.10.2022
2	D. B	308,298	42,624	350,922	
3	I.A	144,505	-	144,505	Nr.3754 prot dt 04.09.2020
4	M.M	402,921	61,164	464,085	
5	A.L	449,739	61,164	510,903	
6	N.X	343,323	45,180	388,503	
7	A.E	117,327	-	117,327	Kontrate e prishur
8	I.K	337,338	60,696	398,034	
9	E.K	205,746	42,168	247,914	
10	E.Sh	264,492	43,320	43,320	Nr 3207 prot dt. 19.10.2021
11	Al A	313,659	60,468	374,127	
12	M L	89,686	42,168	131,854	Nr.243 prot date 19.01.2021
13	Y R	256,878	60,468	317,346	Nr.525 prot date 05.02.2020
14	An B	21,894	47,788	69,682	
15	L A	-	32,490	32,490	
16	Ç d	46,930	43,320	90,250	
Total		3,588,984	650,548	3,975,040	

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve për administrimin dhe qiradhenien e banesave sociale nga personat perfitues nga programi i strehimit rezulton se nuk kanë paguar në vite 16 familje në vlerën debitore 3,975,040 lekë, ku për 5 raste është lidhur aktmarrëveshje për likuidimin e borxhit me këste, për të cilët debia është vlera e mbetur pas pagesave të një pjesë të tij dhe në 1 rast kontrata është mbyllur. Në të gjitha rastet për mospagesat në kohë të tarifës së qirasë si detyrim kontraktor nuk është përlogaritur si detyrim penaltetit prej 0.001% për çdo ditë vonesë të parashikuar në kontratë. Meqenëse familjarët debitorë kanë paguar këstet e aktmarrëveshjeve dhe duke qenë shtresa tepër të varfra nuk është aplikuar ky penaltetit dhe vazhdohet me arkëtimin e principalit të mbetur pa paguar. Këto veprime janë në kundërshtim me me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar neni 32, me ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, për banesat sociale”neni 31 dhe me nenin 5 të kontratës.

➤ Të ardhurat nga qiradhënia e parcelave nga fondi i tokës bujqësore të pandarë dhe parcelave nga fondi pyjor dhe kullosor.

- **Menaxhimi i fondit të tokës bujqësore të pandarë**

Bashkia Kavajë ka në administrim 19 kontrata qiraje për tokë bujqësore/pa frut (të pa ndarë). Në mënyrë të detajuar kontratat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emer mbiemer subjekti	Nipt	Zona Kadastr	Njes. Adm	lloji pas.	sip m2	Data e fillimi te kontrates	Afati I kontrat ne vite	Cmimi (lek/ha/vit)	Pagesa viti 2022	Data pageses	Debitor
1	Y.C		1415	Helmas	Pemishte	6,500	15.03.2012	35	3,900	3,900	27.01.2022	
2	H.K		1947	Helmas	Are	45,300	27.09.2013	99	27,180	27,180	16.02.2022	
3	SH.K		1915	Helmas	Are	10,050	27.09.2013	99	6,030	6,030	23.11.2022	
4	M.K		1947	Helmas	Are	6,700	27.09.2013	35	3,720	3,720	20.06.2022	
5	I.GJ		1915	Habilaj	are	10,000	01.01.2013	99	7,000	7,000	09.01.2023	
6	A Gj		2909	Synej	Are	25,000	13.08.2013	99	25,000	25,000	04.07.2022	
7	B H		2909	Synej	Are	22,850	13.08.2013	99	22,800	22,800	12.09.2022	
8	N K		1072	Synej	Are	11,000	13.08.2013	99	11,000	11,000	07.03.2022	
9	M C		2721	Helmas	pa frut	44,100	09.03.2020	20	28,000	123,480	10.05.2022	
10	E K		2291	Golem	Pa frut	4,169.26	16.01.2017	10		208,463	09.02.2022	
11	G K sh.p.k	L.....V	3961	Golem	Pa frut	22,000 3,000	10.03.2020	20	28,000	70,000	02.06.2022	
12	B sh.p.k	L.....I	3939	Helmas	pa frut	43,000	22.07.2020	20	28,000	120,400.00	09.02.2022	
13	B sh.p.k	L.....I	3939	Helmas	Are	13,600 63,000	22.07.2020	20	6,500	49,790.00	08.02.2022	
14	T kontabel	L.....S	3939	Helmas	Are	20,000 8,000	22.07.2020	20	6,500	18,200.00	08.02.2022	
15	B sh.p.k	K.....N	3101	Qerret	PF	15,400			29,000	446,600.00	17.01.2022	
16	A D sh.p.k	M.....C	3939	Zikularaj	Are	11,625	15.11.2021	35	10,500	120,356.25	07.03.2022	
17	A D sh.p.k	M.....C		Zikularaj	Are	14,250						
18	K shpk	M.....E	2071	Kanaparaj	vresht	34,200	06.10.2022	35	15,100	12,910.00	06.10.2022	
19	V Mamoci		1072	Synej	Are	15 000	13.08.2018	99	15 000	0	Pa pag 3vit	45000
T O T A L I										1,294,641.75		

Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e tokave bujqësore rezultoi se është debitor z. V.M për vlerën 45,000 lekë, i cili nuk ka paguar për tre vitet e fundit 2020-2022 dhe për këtë subjekt është bërë njoftim-detyrimi.

- **Menaxhimi i fondit pyjor**

Bashkia Kavajë ka në administrim 11 kontrata qiraje për parcela nga fondi pyjor. Në mënyrë të detajuar kontratat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti	Fillim, mbarimi kontrates	Sip m ²	Nipt	Tarifa vjetore e kontrates	Pagesa per 2022	Data e pageses	Debitore
1	"V 1 dhe2" F	24.03.2013-24.07.2023	11 025	K.....0	112,185	112,185	24.01.2021	
2	E,SH	8.10.2013-7.10.2051	17430	J.....B	209,610	209,610	03.03.2021	
3	"V Da C	19.12.2011-04.01.2024	3673	Ska	44,076	44,076	24.01.2021	
4	"D Sh M	19.12.2011-13.04.2026	982	K.....1	11,784	11,784	15.03.2022	
5	Sh sh.p.k	04.02.2021- 03.02.2046	15000	M.....H	141,512	141,512	24.02.2021	
6	K R	25.06.2013-24.06.2023	5220	K.....D	54,810	54,810	06.06.2021	
7	"E" F D	21.12.2012-20.12.2022	4000	K.....A	40,000	40,000	21.12.2011	
8	V sh.a	20.07.2001-20.12.2031	200	K.....L	225,000	225,000	02.12.2021	
9	T sh.a	28.03.2020-27.03.2029	200		200,000	200,000	12.10.2021	
10	H V	26.06.2013-25.06.2023	8400	J.....D	87,360	0	Pa paguar	886,848
11	A V	18.06.1997-18.06.2022	90000	Ska	900,000	0	Pa paguar	8,100,000
Shuma								8,986,848

Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e parcelave nga fondi pyjor rezultoi se janë debitorë për 9 vitet e fundit deri me 31.12.2022 2 janë subjektet: z. H.Vpër vlerën 886,848 lekë dhe z. A.V për vlerën 8,100,000 lekë, të cilët nuk kanë paguar për 9 vitet e fundit deri në 31.12.2022, pavarësisht se për këto subjekte janë dërguar njoftim-detyrimet.

Në 6 raste kontratash: me subjektin "SH M(afati 14 vjet), me subjektin ""V" D C (afati 12 vjet), me subjektin "V" sh.a (afati 30 vjet), me subjektin "A" (afati 25 vjet), me subjektin "Ed Sh" (afati 38 vjet) dhe me subjektin"Sh-4 sh.p.k" (afati 25 vjet) ndërkohë që, afati për dhënien në përdorim me qiradhënie të parcelave pyjore afati është deri në 10 vjet. Në rastin e dytë e dhënies me qira të parcelës pyjore si dhe lidhjes së kontratës është bërë në bazë të VKB nr.124, datë 10.12.2020, ku përcaktohet afati 25 vjet dhe sipërfaqja 1.5 ha, ndërkohë që në kontratë sipërfaqja është 12635 m2

ose 1.26 ha sipa kartelës së pasurisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr .1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” Shtojca “Për tarifën në sektorin e pyjeve dhe të kullotave tarifën bazë të lëndës drusore në këmbë” Lidhja 1/a,pika 5 “Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.” dhe pikës 2, e cila përcakton se: “Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullor publik, zbatohen tarifën dysHEME, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Konkluzion: Nga dhëna me qira e parcelave të tokës bujqësore të pandarë rezultojnë debitor 1 rast në vlerën 45,000 lekë dhe nga dhenia me qira e parcelave nga fondi pyjor në 2 raste subjektet qiradhënës rezultojnë debitorë në vlerën 8,986,848 lekë, gjithsej debitorë në vlerën **9,031,848 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë.**

Për këto raste nga Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve është bërë Memo Drejtorise se Taksave, Tarifave Vendore te Ardhurave dhe Borxhit me shkresën nr.prot 3516 datë 13.10.2022 mbi bazë të së cilës ka dalë Urdher Bllokimi i Llogarive Bankare me shkresat nr.prot. 3532 dhe 3533, datë 14.10.2022 . Drejtorise se Taksave, Tarifave Vendore te Ardhurave dhe Borxhit për subjektet H.V dhe A.V janë bërë bllokime të llogarive bankare pikën 2 në nenin 89 të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, por nuk është arritur arkëtimi.

Gjithashtu për prishjen e kontratës i është bërë Drejtorise Ligjore Memo me shkresën nr.prot.546 ,datë 06.02.2023, por nga kjo e fundit nuk është ndërmarrë hap i mëtejshëm, pasi Memos I mungojnë dokumentet ligjore të dosjes së këtij subjekti.

Për debitorët nuk është ndjekur procedurë e plotë administrative si dhe asnjë procedurë ligjore për arkëtimin e detyrimeve sipas nenit 5, neni 6 dhe 7 i kontratës së qirasë ku thuhet: Qiramarrësi paguan 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasësi dhe neni 6 Zgjidhja e Marrëveshjes : Palët i zgjedhin ndërmjet gjykatës”, pra nuk kemi asnjë rast të kaluar në gjykatë për mos plotësim të kushteve kontraktuale.Nga NJA përkatëse për debitorët janë bërë njoftime me shkresë zyrtare për detyrimet që kanë për tarifën e pa paguara të qirasë, por nga Bashkia Kavajë nuk janë ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për detyrimin e shlyerjes së detyrimeve kontraktore të qiramarrësve të tokës bujqësore , veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Pjesa IV, Kreu I “Kuptimi dhe lindja e detyrimeve” nenet 420-422, Pjesa V “Kontratat” Titulli I, Kreu I neni 662¹³, Kreu III, neni 690¹⁴ neni 693¹⁵, neni 698¹⁶-704, dhe me Ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 32,

Titulli gjetjes: Mbi administrimin e të ardhurave nga kontratat e qiradhënies të aseteve.

¹³Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës.

¹⁴Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

¹⁵Kontrata detyron palët jo vetëm përsa është parashikuar në atë, por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i ligji

¹⁶Në kontrata me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit

Situata:

Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kavajë me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe DAV Bashkia Kavajë, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj), duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën 13,009,282 lekë, konkretisht:

a. Nga mosarkëtimi për vitin 2022 i vlerës së qirasë takuese prej 23,940 lekë për përdorim të pasurisë llojit “Dyqan” nga moslidhja e 1 kontrate qiraje nga Bashkia Kavajë me përdoruesin.

b. Nga mospagesa e tarifës së qirasë nga 16 individë sipas kontratave të qiradhënies të banesave sociale për vlerën debitore të mbetur prej 3,975,040 lekë, ku në 5 raste është lidhur aktmarrëveshje për likuidimin e borxhit me këste dhe 1 rast kontrata është prishur;

c. Nga mospagesa e vlerës debitore prej 45,000 lekë të tarifës së qirasë për tre vjet (2020-2022) në 1 rast prej kontratave të lidhura për dhenien me qira të parcelave të fondit të tokave të pandara.

d. Nga mospagesa e vlerës debitore prej 8,986,848 lekë të tarifës së qirasë (për periudhë 10 vjet) në 2 raste prej kontratave të lidhura për dhenien me qira të parcelave të fondit pyjor. Gjithashtu në 6 raste kontratash janë lidhur me afat nga 12 vjet deri në 38 vjet, ndërkohë që, afati për dhenien në përdorim me qiradhënie të parcelave pyjore afati është deri në 10 vjet.

Nga NJA përkatëse për debitorët janë bërë njoftime me shkresë zyrtare për detyrimet që kanë për tarifën e pa paguara të qirasë, por nga Bashkia Kavajë nuk janë ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për detyrimin e shlyerjes së detyrimeve kontraktore të qiramarrësve.

Kriteri:

Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Pjesa IV, Kreu I “Kuptimi dhe lindja e detyrimeve” nenet 420-422, Pjesa V “Kontratat” Titulli I, Kreu I neni 662, Kreu III, neni 690. neni 693, neni 698-704, dhe me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 32, VKM nr .1064 datë datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” Shtojca “Për tarifën në sektorin e pyjeve dhe të kullotave tarifën bazë të lëndës drusore në këmbë” Lidhja 1/a, pika 5 dhe me me ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, për banesat sociale” neni 31 dhe me nenin 5 “Çmimi dhe mënyra e pagesës” të kontratës.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Shkaku:

Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Kavajë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën**

13,009,282 lekë dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave dhe nëse në rastet ku është e pamundur arkëtimi i debitorëve të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke parë dhe si mundësi anulimin e kontratave, Ndersa në rastet e kontraktimit të parcelave pyjore me afat mbi 10 vjet të shikohet mundësia e rishikimit dhe amendimit të tyre me palët për korrektimin e këtyre kontratave sipas dispozitave ligjore në fuqi.

➤ **Hapësira e plazhit e dhënë me qira.**

- Parashikimi i tarifës në paketën fiskale dhe planifikimi i të ardhurave nga dhënia për zhfrytëzim i hapësirave të plazhit.

Në paketën fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2022, konkretisht në Kreun II.5 “Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit”, është përcaktuar niveli i tarifës 300 lekë/m²/3 muaj. Sipas këtij përcaktimi një subjekt, që lidh kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, do të paguajë qira/tarifë të zënies së hapësirës vetëm për 3 muaj në vit. Nga auditimi i faturave për arkëtim lëshuar nga Drejtoria e Kadastrës Urbane, për kontratat e qirasë të lidhura në vitin 2022, vlera e faturuar është llogaritur për 3 muaj shfrytëzim. Nga Bashkia Kavajë sezonin turistik e ka konsideruar vetëm 3 muaj ndërkohë që me ndryshimet e VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e ndryshuar VKM nr.424, datë 27.5.2020 (neni 3/1), konkretisht në pikën 11 të nenit 5 përcaktohet se:

*“Stacioni i plazhit duhet të mbahet i hapur nga subjektet të paktën gjatë afatit nga data **1 maj deri më 30 shtator** çdo viti dhe gjatë kësaj periudhe duhet të ofrojë të gjitha shërbimet e të përmbushë të gjitha kushtet minimale të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti”.*

Pra në vijim të përcaktimit të bërë, rezulton se aktiviteti i stacionit të plazhit minimalisht duhet të zgjasë 5 muaj në vit, që do të thotë 2 muaj më tepër nga çfarë ka përcaktuar Bashkia Kavajë në paketën fiskale, ose nga Bashkia Kavajë nuk arkëtohet detyrimi për shfrytëzimin e hapësirës së plazhit për 5 muaj por vetëm për 3 muaj, pasi e ka hequr detyrimin e mësipërm nëpërmjet paketës fiskale. Kjo situatë ndikon në planifikimin e gabuar të kësaj takse, por edhe ndikon negativisht në reduktimin e të ardhurave, që mund të arkëtojnë Bashkia Kavajë nga dhënia me qira e hapësirës së plazhit.

Nga auditimi i kontratave të lidhura në vitin 2022 (ku subjektet kanë kryer rregullisht likuidimin e vlerës së qirasë për 3 muaj sezon turistik), nëse Bashkia Kavajë do të kishte rritur nivelin e tarifës për kohëzgjatjen 5 muaj dhe jo për 3 muaj, do të rriste mundësitë e saj për të arkëtuar 26,797,800 lekë më tepër. Pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Subjekte që kanë lidhur kontratë në vitin 2021	Sipërfaqe e kontraktuar (m ²)	Niveli i taksës sipas paketës fiskale/3 muaj	Vlera e detyrimit	Vlera e arkëtuar	Diferenca për kohëzgjatjen e taksës	E përkthyer në vlerë monetare
96	133989	300	40,196,700	40,196,700	200	26,797,800

Burimi: Drejtoria e Kadastrës, Bashkia Kavajë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.68/2017 datë 24.07.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar neni 14 dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2.

Titulli gjetjes: Mbi administrimin e të ardhurave nga kontratat e qiradhënies për sezonin turistik së hapësirave të plazhit publik (përgjatë vijës bregdetare).

Situata:

Në paketën fiskale për vitin 2022, konkretisht në Kreun II.5 “Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit”, është përcaktuar niveli i tarifës 300 lekë/m²/3 muaj, ku sipas këtij dokumenti Bashkia Kavajë e ka konsideruar sezonin turistik 3 muaj, ndërkohë që me ndryshimet e dispozitave ligjore rezultoi se aktiviteti i stacionit të plazhit minimalisht duhet të zgjasë 5 muaj në vit, që do të thotë 2 muaj më tepër nga çfarë ka përcaktuar Bashkia Kavajë në paketën fiskale. Kjo situatë ka ndikuar në planifikimin e gabuar të kësaj takse, e për pasojë ka sjellë reduktimin e të ardhurave në fakt nga dhënia me qira e hapësirës së plazhit në vlerën 26,797,800 lekë e përlogaritur sipas sipërfaqes së kontraktuar. Në paketën fiskale të vitit 2023 është korriguar sezoni turistik nga 3 muaj në 5 muaj, por nuk është ndryshuar tarifa prej 300 lekë/m²/5 muaj, ndërkohë që janë rritur cmimet në treg në krahasim me vitet e mëparshme, duke mos i shërbyer rritjes së të ardhurave nga tarifa e zënies së hapësirës së plazhit.

Kriteri:

Ligjin nr.68/2017 datë 24.07.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar neni 14 dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2.

Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Shkaku:

Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Kadastrës Urbane e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke bërë ndryshimin në paketën fiskale të kohëzgjatjes së qiradhënies së hapësirës së plazhit (minimalisht 4-5 muaj me çmimin 100 lekë/m²/muaj) me qëllim rritjen e të ardhurave që arkëtohen nga tarifa e qiradhënies për objektin e mësipërm, si dhe eliminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

- *Procedura e ndjekur për aplikimin dhe dhenien për zhfrytëzim të hapësirave të plazhit e lidhjes së kontratave*

Subjektet e interesuara për zhfrytëzimin e hapësirave publike (Stacion plazhi) kanë aplikuar në sistem elektronik të krijuar nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit, ku aplikimet janë shqyrtuar nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA). Subjektet e kualifikuara kanë lidhur kontrata me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, duke u pajisur me certifikatat e përdorimit të stacioneve të plazheve, ku sipas pikës 12 të nenit të 14 të ndryshuar me VKM nr. 424 datë 27.05.2020 përcaktohet se përfitues i tarifës së qirasë nga kontrata e lidhura janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve mbi bazën e informacionit që ka marrë në rrugë zyrtare për kontratat e lidhura ka hartuar databazen me të dhënat e kontratave për çdo subjekt të certifikuar si stacion plazhi, për ndjekjen e plotësimit të detyrimeve që lindin nga kontrata si dhe vjeljen e tarifës së qirasë në favor të Bashkisë. Sipas kësaj databaze të vënë në dispozicion rezultoi se për vitin 2022 janë 104 subjekte që u është dhënë e drejta për shfrytëzimin e hapësirave publike në zonën e plazhit prej 144,544m² kundrejt pagesës së tarifës së qirasë të miratuar në paketën fiskale. Me Urdhrin nr.42 date 20.01.2022 është ngritur grupi i punës për dhenien në dorëzim të parcelave të hapësirës publike (Stacion plazhi) subjekteve që i shfrytëzojnë si dhe kryen procesin

e matjes në terren të parcelave dhe verifikon respektimin e kushteve teknike të miratuara nga stacionet e plazhit të ngritura nga subjektet.

Sipas të dhënave të databazes detyrimi i evidentuar është në vlerën 43,363,200 lekë dhe pagesat e kryera janë në vlerën prej 43,363,200 lekë, pasi një nga kushtet për finalizimin e kërkesave të apikuesve për qiramërrje në lidhje kontrate është që pas njoftimit paraprak për kualifikim nga procesi i shqyrtimit të kontratave, aplikuesi duhet të kryejë pagesën në bazë të faturimit nga njësia vendore si dhe gjenerimin në sistem *on-line* nga subjekti të konfirmës bankare për likuidimin e kryer.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z.P. P, ish-Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës Urbane, (për periudhen 01.01.2022-29.09.2022), dhe z.R.I, me detyrë Drejtor i DAV Bashkia Kavajë (si pjestarë të hartimit të paketës fiskale viti 2022) si dhe J.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike (për periudhen 22.09.2022 e në vazhdim).

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë;

3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2022 të shoqëruar me formatet 1-9.

2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.

3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2022, libri i aktiveve.

4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2022.

6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Kavajë në mbyllje të vitit buxhetor 2022.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Kavajë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Kavajë për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.4916 prot, datë 31.03.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Në përgjithësi janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore etj.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat

arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon forHasi i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoriae Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është në vlerën 8,364,614,111 lekë dhe për vitin 2022 është 8,670,246,662lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2022 Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	8,549,548,464	8,364,614,111
2		I.Aktivët Afat shkurtër	2,385,539,978	2,999,688,928
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	632,510,197	566,790,055
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	630,530,197	563,982,055
7	50	Letra me vlere	1,980,000	2,808,000
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	18,752,353	21,478,713
12	31	Materiale	7,531,853	11,579,176
13	32	Inventar I imet	11,220,500	9,899,537
14	33	Prodhim ne proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	1,119,035,067	1,591,371,869
22	411	Kliente e llogari te ngjashme	2,839,350	1,907,396
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	91,540,628	91,540,628
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		

32	468	Debitore te ndryshem	708,667,017	681,029,205
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	315,988,072	816,894,640
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	615,242,361	820,048,291
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	615,242,361	820,048,291
42		II.Aktivet Afat gjata	3,937,894,045	5,364,925,183
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	123,926,424	122,396,352
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	123,926,424	122,396,352
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	3,813,967,621	3,541,887,909
48	210	Toka, T,roje, Terene	35,028,041	31,446,218
49	211	Pyje, Plantacione	10,971,000	0
50	212	Ndertesa e Konstruksione	1,170,611,175	953,152,977
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,531,822,925	2,507,343,643
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	6,880,442	6,688,442
53	215	Mjete Transporti	17,267,009	13,436,609
54	216	Rezerva Shteterore		0
55	217	Kafshe pune e prodhimi		0
56	218	Inventar ekonomik	41,387,028	29,197,556
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		622,464
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		0
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	713,829,000	525,916,831
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	713,829,000.0	525,916,831
62		4.Investime	1,512,285,441	1,174,724,091
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	1,512,285,441	1,174,724,091

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 566,790,055lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 632,510,197lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim te vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 563,982,055lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 630,530,197lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022” të pasqyrave financiare.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 21,478,713lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,752,353lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej 2,726,360 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 4,047,323 lekë në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”, pasi është e gabuar gjendja e llog.32 “Inventar i imët”.

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 11,579,176 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 7,531,853 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 4,047,323lekë, e cila përfaqëson zbritje të gjendjes së mallrave në magazinë gjatë vitit 2022.

Kokluzion: Gjendja e llogarisë 32 “*Inventari i imët*” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,899,537 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 11,220,500 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor 1,320,537 lekë, e cila përfaqëson vlerën e përfshirë gabim në këtë llogari nga klasifikimi I gabuar I aktiveve që I përkasin llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 dhe Nomenklatura e llogarive të planit kontabël publik.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,591,371,869 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 1,119,035,067 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes së debitorëve krahasuar me vitin paraardhës.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 411 “*Personeli, paradhenie, deficite, gjoba*” paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 1,907,396 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,839,350 lekë. Gjendja e kësaj llogarije në rastin konkret paraqet vlerat debitoare për kopshtet, cerdhet dhe ujsjellësi. Llogaria 411 “*Klientë dhe llogari të ngjashme*” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitoare të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në kredi të llog.4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II dhe Aneksi 1.

Titulli gjetjes: *Mbi gjendjen dhe kontabilizimet e pasakta në llog. 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 411 “Personeli, paradhenie, deficite, gjoba” paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 1,907,396 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,839,350 lekë. Gjendja e kësaj llogarije në rastin konkret paraqet vlerat debitoare për kopshtet, cerdhet dhe ujsjellësi. Llogaria 411 “*Klientë dhe llogari të ngjashme*” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitoare të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në kredi të llog.4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në pasiv të bilancit.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” I ndryshuar, Kreu II “*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*”, pikat 3.3 dhe 4.2

Impakti:

Pozicionimi në llog.411 e gabuar i gjendjes së debitorëve në llogarinë klientë ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me detyrimet e debitorëve që kanë ndaj Bashkisë, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: *I lartë*

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 1,907,396 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2023 me artikujt kontabël në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 91,540,628 lekësi në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022, për të cilin nuk ekziston asnjë analizë dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson kjo vlerë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 15/b,59 /a, Kreu III. pika 32, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Titulli gjetjes: *Mbi gjendjen dhe kontabilizimet e pasakta në llog. 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 91,540,628 lekësi në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022, për të cilin nuk ekziston asnjë analizë dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson kjo vlerë.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 15/b,59 /a, Kreu III. pika 32, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Impakti:

Pozicionimi dhe veprimet e gabuara kontabël në llogaritë e arkëtueshme në aktiv të bilancit dhe të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit kanë sjellë një ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e njëjësive shpenzuese në marrëdhënie me shtetin, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: *I lartë*

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël, pasi të realizojë analizën e gjendjes së kësaj llogarije nëpërmjet shqyrtimit dhe zbërthimit të dokumentave financiare të viteve të kaluara.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 681,029,205 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë me një rritje në vlerën 27,637,812 lekë. Analiza e kësaj llogarije në mënyrë të përmbledhur paraqitet në tabelëne mëposhtme:

Nr	Pershkrimi	Gjendje 31.12.2022	Nr	Pershkrimi	Gjendje 31.12.2022
1	Debitorë subjektet e medha	112,180,591	6	Debitore IMTV	12,700,000
2	Debitorë subjekte e vogla	148,660,039	7	Debitore Mbrojtja Konsumatorit	2,800,000
3	Debitorë taksa toke	197,571,584	8	Debitor Kopsht& Cerdhe	2,093,932
4	Debitore Fshatrat Turistik	219,916,406	9	Debitor UKKA	745,420
5	Debitore Qera Toke	11,999,045		Totali	708,667,017

Konkluzion: Referuar analizës së kësaj llogarije rezulton se në gjendjen e saj janë përfshirë debitorët nga taksat dhe tarifat për të gjithë taksapaguesit, debitorë nga kopshte e cerdhe dhe tarifat e licencimit të karburanteve si dhe debitorë nga gjobat e IMTV, por nuk janë kontabilizuar debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1.

Titulli gjetjes: *Mbi kontabilizimet e gabuara në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 681,029,205 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë me një rritje në vlerën 27,637,812 lekë. Referuar analizës së kësaj llogarije rezulton se në gjendjen e saj janë përfshirë debitorët nga taksat dhe tarifat për të gjithë taksapaguesit, debitorë nga kopshte e cerdhe dhe tarifat e licencimit të karburanteve si dhe debitorë nga gjobat e IMTV, por nuk janë kontabilizuar debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Impakti:

Pozicionimi dhe veprimet e gabuara kontabël në llogaritë e arkëtueshme në aktiv të bilancit.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: *I lartë*

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë

të saktë, duke përfshirë në gjendjen e llog.468 “debitorë të ndryshëm” debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

- **Llogaria 4342** “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” nëaktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 315,988,072lekë, e cila rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit që përbëhet nga shuma e : llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 150,519,732 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 26,886,944 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1,547,676 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 7,922,424 lekë, llog.436“Sigurime shëndetësore” për vlerën 1,091,356 lekë, llog.466 “Mjete në ruajtje” në vlerën 128,019,940 lekë.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 820,048,291lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 615,242,361 lekë, gjendje e cila rakordon me situacionin e thesarit për detyrimet e prapambetura.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale.

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata Materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse;
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivët e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivët e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivët e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifikë, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,364,925,183 lekë (pasi nuk është zbritur gjendja e llog.231) dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,937,894,045 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,108,940,902 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,401,479,838 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo Materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën prej 122,396,352 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 123,926,424 lekë.

Inventari i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”

Nr.	Emertimi	Gjendja 31.12.2021	shtesat viti 2022	Gjendja date 31.12.2022
1	Hartim projektim I godines se nenprefektures		1,022,300	
2	Hartim projektim I kopeshit Luz I Vogel		431,652	
3	Studim projektim te rrjetit te ujerave te zeza Kavaje		76,120	
	Totali	122,396,352	1,530,072	123,926,424

Konkluzion: Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Për këto vlera duhet të detajohen sipas investimeve dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b.

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimet e aktiveve jo materiale në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” në aktiv të bilancit dhe mos llogaritja e amortizimit për to.

Situata:

Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar

në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, I ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 16/b.d, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik “pika 2 Klasa 2.

Impakti:

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve. Gjithashtu nuk janë kryer veprimet e llogaritjes së amortizimit për aktivet afatgjata jo materiale dhe të kryerjes së veprimeve kontabël përkatëse.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë vlerën prej 122,396,352 lekë AA jo materiale duhet të realizojë inventarin kontabël sipas investimeve përkatëse dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve Materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2022.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 3,738,486,200 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 3,813,967,621 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,986,544,550 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,277,553,414 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 31,446,218 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 35,028,041 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqiten në vlerën prej 32,324,425 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 35,906,248 lekë, ku diferenca në rritje prej 3,581,823 lekë përfaqëson blerje trualli për varreza publike.

- **Gjendja e llog. 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,971,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqiten në vlerën prej 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 10,971,000 lekë, vlerë e cila përfaqëson blerje pemesh për lulishtet e rrugët e qytetit.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,003,318,923 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,170,611,175 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,293,233,999 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,522,137,366 lekë. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”, sipas inventarit kontabël përfshihen të gjithë aktivet “Ndërtesa e konstruksione” të Bashkisë Kavajë dhe Njësi Administrative Golem, Luz i Vogel, Synej, Helmes. Diferenca në rritje prej 228,903,367 lekë përfaqëson vlerën e dhurimit të apartamenteve për strehim në ndihme të shtresave në nevojë.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,639,309,098 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,531,822,925 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,411,133,885 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,436,901,550 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 25,767,665 lekë, ku janë kryer investime në rrugë si dhe pagesa nga detyrimet e prapambetura etj.

Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 8,360,553 leke dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 6,880,442 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 64,880,148 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 65,120,148 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 240,000 lekë, ku është blerë 1 aparat fotografik etj.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 16,795,762 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 17,267,009 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 76,133,253 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 80,921,253 lekë, vlera e amortizimit të akumuluar 63,654,244 leke. Gjatë vitit 2022 janë shtuar 4,788,000 lekë ngablerja e 4 automjeteve.

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 38,425,696 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 41,387,028 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 105,077,334 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 121,834,343 lekë, pra kemi një rritje të vlerës së këtyre aktiveve në vlerën 16,757,009 lekë, që përfaqësojnë blerje me pagesë të inventarit ekonomik për ambientet e zyrave, shkollave e kopshteve.

Gjendja e llogarisë 24 “Aktive të qendrueshme të trupezuara të demtuara” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 me vlerën 829,951 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, pas perllogaritjes së amortizimit total të tyre.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerë bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

b	EMERTIMI c	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksi met		Teprica në fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim			Kosto Historike	Amortiz.Akumul.	Teprica Neto
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	122,396,352	0	122,396,352	1,530,072	0	0	0	123,926,424	0	123,926,424
202	Studime dhe kerkime	122,396,352		122,396,352	1,530,072				123,926,424	0	123,926,424
203	Koncesi patent,licenca tjera ngjashm			0					0	0	0
21	II. AAGJ/ MATERIALE	4,986,544,550	1,248,058,350	3,738,486,200	291,008,864	215,527,443	0	0	5,277,553,414	1,463,585,793	3,813,967,621
210	Toka,troje,Terene	32,324,425	878,207	31,446,218	3,581,823		0		35,906,248	878,207	35,028,041
211	Pyje,Kullota Plantacione	0	0	0	10,971,000		0		10,971,000	0	10,971,000
212	Ndertime e Konstruksione	1,293,233,999	289,915,076	1,003,318,923	228,903,367	61,611,114	0	0	1,522,137,366	351,526,191	1,170,611,175
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	3,411,133,885	771,824,787	2,639,309,098	25,767,665	133,253,838	0	0	3,436,901,550	905,078,625	2,531,822,925
214	Instali teknik,makine,pais,vegla pune	64,880,148	56,519,595	8,360,553	240,000	1,720,111	0	0	65,120,148	58,239,706	6,880,442
215	Mjete transporti	76,133,253	59,337,491	16,795,762	4,788,000	4,316,752	0	0	80,921,253	63,654,244	17,267,009
216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	105,077,334	66,651,638	38,425,696	16,757,009	13,795,676	0	0	121,834,343	80,447,315	41,387,028
24	Aktive te Qend.te trupezuara demtuar	3,761,506	2,931,555	829,951	0	829,951	0	0	3,761,506	3,761,506	0
28	Caktime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI (I+II)	5,108,940,902	1,248,058,350	3,860,882,552	292,538,936	215,527,443	0	0	5,401,479,838	1,463,585,793	3,937,894,045

Amortizimi i Aktiveve Afagjatë Materiale është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Për aktivet e llogarive: 202 “Studim-Projektme”; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar Ekonomik”, në të cilat përfshihen pajisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo aktiv për aktiv, dhe nuk mund të verifikoheshin se si janë grupuar dhe llogaritur amortizimi për pajisjet kompjuterike.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Kavajë

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Klos dhe Njësitë Administrative në varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2022 ka dalë urdhri nr. 325/1, datë 26.10.2022 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve të Bashkisë dhe institucioneve përkatëse”, ku janë ngritur 5 komisione inventarizimi me nga 3 veta për objektet që do inventarizohen.

Në bazë të këtyre urdhrave është kryer procedura e inventarizimit në zyrat e Bashkisë, 2 magazinave dhe në NJA, në5 shkolla, 6 kopshte, 1 cerdhe, Bibliotekë, Klubi Sportiv B, Muzeu Etnografik, Pallati i Kulturës. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati i inventarizimit për mungesat dhe tepricat, janë bërë shënimet përkatëse, ku nuk kanë rezultuar diferenca.Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2022. Nuk është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit, pasi gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit nga komisioni i i inventarizimit janë dhënë propozime për aktive të cilat kanë humbur vlerën e përdorimit sipas objekteve ku është kryer inventarizimi. Për vlerësimi e aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi është ngritur komisioni me 5 vetë në bazë të Urdhrit të Titullarit nr. 54 datë 24.02.2023 “Për ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të

aktiveve të Bashkisë dhe NJA”. Ky komision ka mbajtur procesverbalet përkatëse për çdo aktiv të emërtuar dhe në vlerë, të propozuar për dalje jashtë përdorimi, duke përshkruar aktivin e dëmtuar. Më pas nga komisioni është hartuar relacioni shpjegues dhe është përgatitur projektvendimi “Për propozimin e nxjerrjeve jashtë përdorimit të materialeve të Bashkisë dhe institucioneve në varësi të Bashkisë” i paraqitur pranë Këshillit Bashkik në të cilin janë përshkruar aktivet të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi sipas llogarive dhe vendndodhjes të shprehura në vlerë. Pas shqyrtimit në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak të datës 23.03.2023 është marrë VKB mbi miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve:

Bashkia Kavajë:

1. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 19,006,448 lekë.
2. Llog. 327 “Inventar i imët” në vlerën 291,202 lekë.

Institucionet Arsimore Bashkia Kavajë:

3. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 12,618,329 lekë.
4. Llog. 327 “Inventar i imët” në vlerën 927,452 lekë.

Njësitë Administrative:

5. Llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 2,543,715 lekë
6. Llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 18,000,000 lekë (Shkolla 9 vjec Synej dëmtuar nga tërmeti)
7. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 9,121,716 lekë.
8. Llog. 327 “Inventar i imët” në vlerën 3,614,071 lekë.

Procesi për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimi nuk është kryer akoma. Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi nuk ka hartuar akoma relacionin mbi kryerjen e procesit të nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në të cilin ka bërë klasifikimin : aktive për asgjësim përfundimtar dhe aktive për me vlerë të mbetur përdorimi dhe hyrjen e tyre në magazinë. Meqenëse kjo procedurë nuk është realizuar përfundimisht me të gjitha fazat, dhe nuk është finalizuar me relacion përfundimtar brenda vitit 2022, atëherë efektet në vlerat e aktiveve nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2022, por do të gjejnë reflektim në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor 2023.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) ta klasës 21 për vitin 2021 është në vlerën 5,108,940,902 lekë dhe për vitin 2022 është në vlerën 5,401,479,838 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2022 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Për Inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 35,028,041 lekë; llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 10,971,000 lekë, llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,522,137,366 lekë ; llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,436,901,550 lekë; llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 65,120,148 lekë; llog. 215 “Mjete Transporti” në vlerën 80,921,253 lekë; llog. 218 “Inventar Ekonomik” në vlerën 121,834,343 lekë nuk ka analiza të sakta e të plota dhe konstatohen gabime në klasifikimet kontabël të aktiveve llogaritë respektive. Gjithashtu ka paqartësi në përcaktimet e emertesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktiv, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve dhe pakësimet të secilit aktiv. Në këto inventare kontabël janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2022 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas amertesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Mungon rregjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe

vlerën e mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar “pika 1/b “Klasifikimi kontabël” dhe Nomenklatura e llogarive te planit kontabël publik.

Titulli gjetjes: *Mbi kontabilizimet e aktiveve afatgjata materiale në llogaritë e klasës 21 në aktiv të bilancit, gabimet në klasifikimin përkatës kontabël dhe rakordimit me inventarin kontabël të tyre si dhe mungesa e librit të aktiveve.*

Situata:

Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) ta klasës për vitin 2022 është në vlerën 5,401,479,838 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2022 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Për Inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 35,028,041 lekë; llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 10,971,000 lekë, llog.212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,522,137,366 lekë ; llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 3,436,901,550 lekë; llog.214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 65,120,148lekë; llog.215 “*Mjete Transporti*” në vlerën 80,921,253lekë; llog.218 “*Inventar Ekonomik*” në vlerën 121,834,343 lekë nuk ka analiza të sakta e të plota dhe konstatohen gabime në klasifikimet kontabël të aktiveve në gjendjet e llogarive respektive. Gjithashtu ka paqartësi nëpërcaktimet e emertesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktiv, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve dhe pakësimet të secilit aktiv. Në këto inventare kontabël janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2022 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas amertesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Mungon regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Kriteri:

UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” I ndryshuar Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), dhe Nomenklatura e llogarive te planit kontabël publik.

Impakti:

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara..

Shkaku:

Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të AAGM, rakordimin me inventarët si dhe mos hartimit të librit të aktiveve.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të marrë masa që të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit dhe duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve në llogaritë përkatëse sipas nomenklaturës llogarive te planit kontabël publik, të bëjë rakordimin e inventareve të tyre si dhe përcaktimin e plotë të vlerës së plotë të cdo aktivi që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe pakësimet, shoqëruar me korrektimet kontabël për amortizimet, si dhe duke i finalizuar me evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.

-Gjendja e llogarisë 26 “Pjesmarrje në kapitalin e vet” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 525,916,831 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 713,829,000 lekë. Kjo gjndje paraqet pjesmarrjen në investime kapitale nëpërmjet zoterimit të aksioneve në shqëritë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Pershkrimi	Gjendje 31.12.2022
1	Sport Club B	60,260,000
2	Ekipi Luz i Vogel 2008	175,000
3	Ushelles Kanalizime Kavaje	653,394,000
	Totali	713,829,000

-Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet me vlerën prej 1,174,724,091lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 1,512,285,441 lekë,vlerë e cila përfaqëson vlerën e pagesave pjesore të kryera për blerjen e AAGJM.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i vitit Paraardhes
			viti 2022	viti 2021
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	968,838,645	967,107,323
66		I.Pasivet Afat shkurtra	933,210,433	931,479,111
67		1. Llogari te Pagushme	933,210,433	931,479,111
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	150,519,732.00	241,841,533
69	42	Detyrime ndaj personelit	26,886,944	22,893,922
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,547,676	1,433,550
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	7,922,424	7,161,477
76	436	Sigurime Shendetsore	1,091,356	985,612
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie mes institucione apo njesi ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	1,980,000	2,808,000
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	128,019,940	111,776,471
82	467	Kreditore te ndryshem	615,242,361	542,578,546
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	708,667,017	
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera passive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		

87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	35,628,212	35,628,212
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata	35,628,212	35,628,212
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	7,580,709,819	7,397,506,788
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	7,580,709,819	7,397,506,788
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti akumuluar	6,950,179,622	6,833,524,733
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	630,530,197	563,982,055
101	111	Rezerva	0	0
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	0	0
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime	0	0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		0
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	0	0
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	8,549,548,464	8,364,614,111

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 931,479,111 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 933,210,433 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 241,841,533 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 150,519,732 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje, pasi vlera e mbetur e faturave të palikujduara në fund të vitit 2021 si detyrime ndaj të tretëve është më vogël se në vitin 2021. Analiza e kësaj llogarije është e përfshirë në analizat e llogarive të tjera të detyrimeve të klasës së katërt.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 26,886,944 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 1,547,676 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet e tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 7,922,424 lekë, detyrime të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 1,091,356 lekë, detyrime të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 111,776,471 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 128,019,940 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekt i investimit	5 % ne ruajtje	Te hyra	Te dala	5 % ne ruajtje
		31.12.2021	2022	2022	31.12.2022
1	Ndertim muaji mbajtes fshati Kryemedhenj	0	186,702		186,702
2	Vazhdim punimeve shetitorja nr.2	350,000	463,747		813,747
3	Rikualifim i rruges kryesore fshati qerret		50,000		50,000
4	Rik i rrugeve te qytetit	139,858	200,000		339,858

5	Blerje pemesh	0	548,550		548,550
6	Furnizim me uje plazhi gjeneralit -bardhor -synej	3,250,003	1,918,297		5,168,300
7	rik rrjetit shperndares Kj faza II	9,500,000	2,000,000		11,500,000
8	Riparim impiantit ujerave te zeza	1,750,344	750,000		2,500,344
9	Ndricimi Led	1,928,429	900,000		2,828,429
10	Rik i qendres Aleksander Moisiu	578,648	1,473,697		2,052,345
11	Ndertimi shkolles 9 vjecare Golem	683,660	500,000		1,183,660
12	Ndertimi shkolles 9 vjecare Qamil Xhani	4,272,199	810,592		5,082,791
13	Rik i shkolles Aleksander moisiu	7,408,142	120,560		7,528,702
14	Rik i shkolles R.C	4,820,287	988,706		5,808,993
15	Rindertimi Godines Bordit Kullimit	0	1,479,104		1,479,104
16	Rindertimi stacionit te Zjarrfikeses	0	793,011		793,011
17	Riforcimi njesive individuale	0	4,455,856		4,455,856
18	Riforcimi banesave faza II	0	5,158,744		5,158,744
19	Rik i mjediseve ne bashkepronesi	16,455,670	650,117		17,105,787
20	Rik i rruges Panairi	0		99,687	99,687
21	Ndertimi shkolles 9 vjecare Golem			6,837,627	6,837,627
	Ndertimi shkolles 9 vjecare Qerret`	454,251	-	-	454,251
	Shuma	51,591,491	23,447,683	6,937,314	68,101,860

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 542,578,546 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 615,242,361 lekë, vlerë e cila plus faturat e palikujduara gjendje në llog. 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 150,519,732 lekë, në total në bilanac është paraqitur vlere prej 765,762,093 lekë, që përfaqësojnë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Analiza e detajuar për cdo faturë paraqitet në akt-konstatimin mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit. Ndërsa në mënyrë sintetike gjendja e detyrimeve të palikukujduara sipas zërave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Gjendja date 31.12.2022
4864100	Vendime Gjyqesore	45,616,172.00
	Detyrime Vendime Gjyqesore	45,616,172.00
4864200	Sherbime	19,973,095.00
4864600	Mallra	1,687,040.00
4864201	Detyrim Fshu	651,369,856.00
	Shuma	673,029,991.00
4864400	Investime	83,243,425.40
	TOTALI DETYRIME PRAPAMBETURA ME GRANT	801,889,588.40

Konkluzion: Referuar tabelës së mësipërme detyrimet e prapambetura për fatura të palikujduara për mallra, shërbime dhe investime dhe vendime gjyqësore të raportuara në MFE në vlerën 837,517,800 lekë nuk rakordojnë me gjendjen e paraqitur llogaritë e klasë 4 në bilanc për vlerën 71,755,707 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 3.3,

- **Gjendja e llogarisë 16 “Huatë Afat gjata”** paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 35,628,212 lekë, e cila përfaqëson vlerën e mbetur të kësteve kredisë nga CEB për programin e strehimit kredi e butë për individë përfitues të këtij programi, të pa paguar për vitet 2020-2021 dhe 2022 (principal dhe interes).

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”(bashkelidhur këtij RPA në Aneksin nr. B/9) të PF të vitit 2022.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 2,196,400,248 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Kavaje paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 561,988,130 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,119,429 lekë e cila përfshin *Taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 148,535,225 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 251,085,072 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 131,406,605 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 7,914,111 lekë, e cila përfshin qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 123,492,494 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 933,210,433lekë, vlerë kjo, e cila rakordon me shumën e gjendjevetë llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 315,988,072lekë dhe llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në vlerën 615,242,361lekë të bilancit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 1,565,870,051 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli”** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 372,056,611 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 372,056,611 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 62,026,311 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 62,026,311 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 548,762,865 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 548,762,865 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 583,024,264, lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 2,196,400,248 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,565,870,051 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 630,530,197 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 *“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”* është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën 4,047,323 lekë .

- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 *“Transferime per Buxhetet familjare e Individe”* paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 366,087,687lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 668,932,529 lekë dhe totali shpenzimeve është 661,887,686 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 7,044,843lekë rakordon me gjendjen e llog.85 *“Rezultatit e ushtrimit”*.

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 *“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”* është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën 3,002,139 lekë .

Nga testi kontrollit për vitin2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet e arkëtimit kryhen me arkë,për të gjitha rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, pagesat e konviktit, ujit të pijshëm, tarifave të biznesit, pagesa për lëndë drusore, tarifata për sistemin e vditjes, tarifata familjare, taksë toke dhe ndërtese...etj, dhe sipas rasteve brënda ditës apo në fund të çdo jave derdhjet e arkës bëhen në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germa a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *“Për limitin e arkës”*.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore.Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave Materiale, veprimet me magazinën.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-

hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari dhe Kryetari.

- Janë hapur kartela e zyrave për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. A.T me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartues i pasqyrave financiare.

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Në dosjet e prokurimit nuk administrohen dokumente që të vërtetojnë që nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave nuk është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, por në dosje administrohen listat prioritare për investime, të cilat janë miratuar me Vendim të KB vitit 2021 dhe 2022 bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon*: Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Kavajë (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh
Viti 2021				
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh
<i>Procedurë e hapur;</i>	10	1,482,943,689	1,449,814,937	33,128,752
<i>Procedurë e hapur e thjeshtuar</i>	14	44,685,587	37,642,127	7,043,460
<i>Prokurim me vlerë të vogël.</i>	47	17,372,773	14,080,931	3,291,842
SHUMA	71	1,545,002,049	1,501,537,995	43,464,054
Viti 2022				
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh
<i>Procedurë e hapur;</i>	7	1,525,634,842	1,519,656,133	5,978,709

Procedurë e hapur e thjeshtuar	9	38,006,724	34,115,650	3,891,074
Prokurim me vlerë të vogël.	52	14,543,755	12,291,674	2,252,081
SHUMA	68	1,578,185,321	1,566,063,457	12,121,864

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Kavajë

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, janë realizuar gjithsej **139** procedura me fond limit 3,123,187 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 3,067,601 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 55,586 mijë lekë ose 1.78%, nga e cila: për **vitin 2021** janë realizuar gjithsej **71** procedura me fond limit 1,545,002 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,501,538 mijë lekë dhe për **vitin 2021** janë realizuar gjithsej **68** procedura me fond limit 1,578,185 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,566,063 mijë lekë.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **17** procedura me fond limit 3,008,578 mijë lekë ose 96.3% e fondit të prokuruar dhe në të tjera janë **122** procedura me fond limit 114,609 mijë lekë, ose 3.7% e fondit të prokuruar.

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, janë audituar procedura e prokurimit si më poshtë:

Nr	Objekti	Fondi limit	Operatori fitues
1	“Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi I fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, bashkia Kavajë”	153,589,733	A.K SHPK
2	Furnizimi me karburant	6,143,200	G SHPK
3	Blerje automjesh 4,166,667	4,166,667	OE A.L SHPK
4	Blerje pemësh	15,781,200	GJ SHPK
5	Furnizimi me karburant	6,143,200	“K” SHPK
6	Rikonstruksion I rrugëve të qytetit	8,166,666	B SHPK
7	Shërbimi I pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz I Vogël dhe Helmas	550,395,505	A A I G SHPK
8	“Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””	116,739,459	B P E SHPK
9	“Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””	150,717,562	B P E SHPK
10	Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I- ^{re}	594,823,787	G SH N SHPK
11	“Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, Qyteti Kavajë	528,843,954	F G B SHPK

1. Procedura e prokurimit me objekt “Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi i fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, Bashkia Kavajë”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi i fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, Bashkia Kavajë”, Nr. REF-88397, datë 02-25-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 58, datë 08.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 58, datë 08.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 85, datë 02.03.2021
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	Njësia e Prokurimit 1. E.A. (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste	G. K , Kryetar A.M G.T

	3. H.S, Ekonomiste	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 153,589,733 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE A.K SHPK me ofertë 151,463,880 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 508/3 prot, dt. 23.04.2021 me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,125,853 lekë ose 1.38 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 04.04.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) S'kualifikuar 3 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 153,589,733 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit, me afat katëvjeçar 2021 - 2024.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohen shkresat e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve me nr. 2986 prot., datë 23.11.2020 për miratimin e objektit dhe nr. 2986/1 prot., datë 23.11.2020, sipas të cilës është bërë ndarja e fondeve për ndërtimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e objektit.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “A M” ShPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kavajë, z. R.K në vitin 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 365 ditë nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Kavajë, z. R.K

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 22.02.2021

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 25.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

- 1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 7 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier gjeolog, inxhinier elektronik) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021, si dhe staf mbështetës 1 inxhinier, 3 teknikë të tjerë të ndryshëm, etj. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
- 2- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
- 3- Janë kërkuar makineri 1 (një) sondë për shpime horizontale për kalim tubash nën trasenë e rrugës, 2 (dy) sisteme wellpoint/ekuivalent për heqje ujërash, 2 (dy) frezë asfalti, 2 (dy) sharrë asfalti, 1 (një) aparaturë për testimin e ngjashmërisë së materialit me metodë me goditje (me pjatë), të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. J.H Inxhinier.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve në muajin Shkurt 2021. Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 12.04.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE E CO SHPK	151,017,194
2	OE A SHPK	151,463,880
3	OE P SHPK	151,981,721
2	BOE A SHPK	Me dy oferta

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 12.04.2021, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. R.K

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE “E” ShPK, “P” ShPK dhe “A” ShPK kanë mungesa në dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe janë skualifikuar me të drejtë nga KVO.

- Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues A SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:
- Dokumentet e paraqitura për sondat, nuk tregojnë që plotësojnë kërkesat e DT;
- Për dy sistemet eëllpoint të kërkuara, është paraqitur vetëm një pompë thithëse;
- Për aparaturat për ngjitje tubacionesh me metodën “Elektro fusion joint” janë paraqitur vetëm dy aparate nga 5 të kërkuara, të cilat nuk tregojnë që bëjnë ngjitjen e tubave me metodën e kërkuar në DT.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 174,282,456 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së G. K., Kryetar, A.M dhe G.T.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kavajë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Furnizimi me karburant”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizimi me karburant”, Nr. REF-05845 datë 09-20-2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 322, datë 20.09.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 322, datë 20.09.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 349, datë 05.10.2021
2. Lloji i Procedurës – “E hapur e thjeshtuar”	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M G.T
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,143,200 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE G SHPK me ofertë 5,923,800 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2812/4 prot, dt. 25.102021.2021 me afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 219,400 lekë ose 3.57 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 04.10.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Kavajë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur e thjeshtuar”, me vlerë 6,143,200 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Kavajë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohen kërkesa për karburant në vlerën totale prej rreth 2,400,000 lekë, ndërsa fondi limit është 6,143,200 lekë. Diferenca e këtyre vlerave është shtuar pa u argumentuar shkresërisht. Kërkesat e drejtorive nuk janë të argumentuara dhe të detajuara sipas mjeteve që do të përdorin. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje E.A, M.D dhe H.S

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 02.02.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 20.09.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2.2, sipas të cilës “2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se kriteret e vendosura janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Njësia e Prokurimit. Në dosjen e prokurimit administrohen kërkesa për karburant nga drejtoritë e ndryshme të Bashkisë Kavajë, si dhe një llogaritje e çmimit të karburantit për litër, bazuar në çmimin e bursës për datën 13.09.2021 dhe kursin e këmbimit të datës 01.09.2021.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”.

Është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit në datën 14.10.2021, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (TAK) z. R.K

Nisur nga ky Raport dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në këtë procedurë dhe janë kualifikuar nga KVO 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “K” ShPK	6,121,260
2	OE G SHPK	5,923,800

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se dy operatorët ekonomikë që kanë paraqitur ofertat, kanë plotësuar kriteret e kualifikimit dhe janë kualifikuar me të drejtë, në përputhje me

nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje automjesh”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje automjesh”, Nr. REF-15904 datë 12-20-2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 439, datë 17.12.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 439, datë 17.12.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 450, datë 22.12.2021
2. Lloji i Procedurës – “E hapur e thjeshtuar”	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M G.T
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,166,667 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “A” ShPK me ofertë 3,990,000 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 45/1 prot, dt. 14.02.2022 me afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 176,667 lekë ose 4.24 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 31.12.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Kavajë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur e thjeshtuar”, me vlerë 4,166,667 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Kavajë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij prokurimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për iniciimin e këtij prokurimi.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 20.12.2021:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 20.09.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2.2, sipas të cilës “2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se kriteret e vendosura janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Hartimi i specifikimeve teknike është hartuar nga Njësia e Prokurimit. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për përlogaritjen e fondit limit. Në specifikimet teknike janë përcaktuar ngjyra, cilindrata, kilometrazhi, etj, pa asnjë argument teknik. Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”.

Është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit në datën 06.01.2022.

Nisur nga ky Raport dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në këtë procedurë dhe janë kualifikuar nga KVO 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “S.C” ShPK	4,000,000
2	OE “A L” ShPK	3,990,000

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se dy operatorët ekonomikë që kanë paraqitur ofertat, kanë plotësuar kriteret e kualifikimit dhe janë kualifikuar me të drejtë, në përputhje me nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pemësh”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje pemësh”, Nr. REF-15997 datë 12-21-2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 445, datë 21.12.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 445, datë 21.12.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 451, datë 22.12.2021
2. Lloji i Procedurës – “E hapur e thjeshtuar”	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M G.T
5. Fondi Limit (pa TVSh) 15,781,200 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE GJ SHPK me ofertë 13,430,000 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2884/1 prot, dt. 29.08.2022 me afat 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,351,200 lekë ose 14.9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 07.01.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Kavajë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 6 OE/BOE b) S’kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 5 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë

Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 15,781,200 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e Bashkisë Kavajë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij prokurimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një një kërkesë nga Drejtoria e Shërbimeve për blerje pemësh dekorative, që ka shërbyer si dokument për iniciimin e këtij prokurimi.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 21.12.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 20.09.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2.2, sipas të cilës “2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

...

c) *argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit.”.*

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se janë vendosur kritere konform legjislacionit të prokurimit.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Hartimi i specifikimeve teknike është nënshkruar nga Njësia e Prokurimit. Në specifikimet teknike është përcaktuar që pemët duhet të jenë të njoma dhe të vendosura në vazo, do të mbillen nga sipërmarrja e gjelbërimit dhe do të mbikëqyren nga Bashkia. Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë nga Drejtoria e Shërbimeve për blerje pemësh dekorative dhe një preventiv (ku janë përcaktuar edhe gjatësitë e pemëve), bashkelidhur të cilit janë ofertat e marra në treg për pemët “P.W”.

Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”.

Me shkresën nr. 2884, datë 09.08.2022, ose 7 muaj pas hapjes së procedurës së prokurimit, është bërë formulari i njoftimit të fituesit. Ky veprim bie ndesh me me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82, pika 1 dhe 5 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, sipas të cilit “1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla” dhe “...Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit” dhe Neni 83, pika 2 “Njoftimi i fituesit”, sipas të cilit “Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit, në

përputhje me nenin 97, të LPP-së. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje G. K , A.M dhe G.T.

Është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit në datën 09.08.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (TAK) z. R.K Lidhja e kontratës është bërë me shkresën nr. 2884/1, datë 29.08.2022, ose 11 ditë pas lajmërimit të bërë nga paërfaqësuesi i paautorizuar i AK, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 85, pika 1 “Lidhja e kontratës”, sipas të cilit “...Operatori ekonomik i shpallur fitues është i detyruar t’i përgjigjet kërkesës së autoritetit/entit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.

Nisur nga ky Raport dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në këtë procedurë 6 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “De” ShPK	12,820,000
2	OE SHPK	13,430,000
3	OE “A” ShPK	13,750,000
4	OE “Li” ShPK	14,000,000
5	OE “II” PF	14,597,600
6	OE “B” ShPK	14,839,000

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se është skualifikuar OE “D” ShPK, i cili nuk paraqitur dokumentet e kërkuara në DT (vetëm ofertën dhe Deklaratën e konfliktit të interesit) dhe janë kualifikuar 5 OE pjesëmarrës

Nga auditimi në SPE të operatorit ekonomik të shpallur fitues SHPK u konstatua se ky OE ka plotësuar kriteret e kualifikimit dhe është kualifikuar me të drejtë, në përputhje me nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Furnizimi me karburant”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Furnizimi me karburant”, Nr. REF-19152 datë 02-08-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 59, datë 09.02.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 59, datë 09.02.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 66, datë 10.02.2022
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M G.T
5. Fondi Limit (pa TVSh) 17,892,708 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “K” ShPK me ofertë 17,718,787.5 lekë pa TVSH me marzh fitimi 15 lekë/litër, sipas kontratës nr. 509/6 prot, dt. 17.03.2022, me afat 10 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 173,920.5 lekë ose 0.97 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 25.02.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Kavajë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE

		b) S'kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 17,892,708 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Kavajë.

Mbi përcaktimin e krerjes së këtij prokurimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohen kërkesa për karburant për periudhën e lëvrimet sipas kontratës, të detajuara sipas mjeteve që do të përdorin karburantin. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje E.A, M.D dhe H.S

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 09.02.2022, të ndryshuara me shtojcën e datës 17.02.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 09.02.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2.2, sipas të cilës “2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

...

c) *argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;*”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se kriteret e vendosura janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Njësia e Prokurimit. Në dosjen e prokurimit nuk administrohen kërkesa për karburant nga drejtoritë e ndryshme të Bashkisë Kavajë, por vetëm një llogaritje e çmimit të karburantit për litër, bazuar në çmimin e bursës për datën 26.01.2022 dhe kursin e këmbimit të datës 08.02.2022.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”.

Është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit në datën 01.03.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (TAK) z. R.K.

Nisur nga ky Raport dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në këtë procedurë dhe janë kualifikuar nga KVO 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “K” ShPK	17,718,787.5
2	OE G SHPK	17,830,037.5

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se dy operatorët ekonomikë që kanë paraqitur ofertat, kanë plotësuar kriteret e kualifikimit dhe janë kualifikuar me të drejtë, në përputhje me nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që

përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

6. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të qytetit”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të qytetit”, Nr. REF-16400 datë 12-27-2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 444, datë 21.12.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 444, datë 21.12.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 457, datë 28.12.2021
2. Lloji i Procedurës – “E hapur e thjeshtuar”	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M G.T
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,166,666 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE B SHPK me ofertë 5,551,050 lekë pa TVSH, me afat 1 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,615,616 lekë ose 32 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 07.01.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Kavajë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE b) S’kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 6 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur e thjeshtuar”, me vlerë 8,166,666 lekë pa TVSH, i cili do të finanohet nga Buxheti i Bashkisë Kavajë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet dokument për iniciimin e këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Kontrollit, me grup projektimi D.Q, S.V, G.T dhe H.Z.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Kavajë, z. R.K

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 24.12.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 24.12.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2.2, sipas të cilës “2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

...

c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

2-Janë kërkuar licenca nga QKL me kode III.2.B (Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane), e cila nuk është e argumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.

3-Është kërkuar 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë. Kjo kërkesë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilës “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”, duke ngarkuar me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Kontrollit, me grup projektimi D.Q, S.V, G.T dhe H.Z.

Nga verifikimi i disa zërave të preventivit të ofertës (me vlerë më të madhe), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”. Në dosje administrohet Raporti Përmbledhës (paraprak) për vlerësimin e ofertave, datë 10.03.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. R.K

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE B SHPK	5,551,050
2	OE “S” ShPK	5,628,340

3	OE "N" ShPK	5,967,162
4	OE "A" ShPK	5,990,337
5	OE "Sh" ShPK	6,007,540
6	OE "SH" ShPK	7,000,000
7	OE "B" ShPK	8,086,874

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i Formularit të Njoftimit të Fituesit të administruar në dosje, u konstatua se është skualifikuar (pas kualifikimit për shkak të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar në DT) OE "B" ShPK, për shkak se është i përjashtuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik nga APP. Për këtë arsye, ky OE është skualifikuar me të drejtë.

Konstatohet se janë kualifikuar të gjithë OE e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues B SHPK, rezultoi se është konform DT të hedhura në sistem dhe kualifikimi i këtij OE është në përputhje me nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme".

Me shkresën pa nr prot., datë 16.03.2022 të anëtarit të KVO-së z. A.M, është bërë kërkesë OE B SHPK, si OE i suksesshëm, për paraqitjen e sigurimit të kontratës. Ky veprim bie ndesh me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 75, pika 4 "Komisioni i vlerësimit të ofertave", sipas të cilit "...Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla".

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kavajë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit.

7. Procedura e prokurimit me objekt "Shërbimi I pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz I Vogël dhe Helmas", Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shërbimi I pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz I Vogël dhe Helmas", Nr. REF-39822 datë 08-25-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 259, datë 25.07.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 259, datë 25.07.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 319, datë 19.09.2022
2. Lloji i Procedurës – "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M D.H
5. Fondi Limit (pa TVSh) 550,395,505 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) A A I G SHPK me ofertë 549,298,645lekë pa, me afat 5 vjeçar nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,096,860 lekë ose 0.2 %
8. Data e hapjes së tenderit	9. Burimi Financimit	10. Operoret Ekonomike

Datë 03.10.2022	Buxheti i Shtetit dhe Bashkisë Kavajë	a) Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE b) S'kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 6 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me vlerë 550,395,505 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Kavajë, me afat pesëvjeçar Shtator 2022 – Gusht 2027.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 06.08.2020, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 25.08.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Dokumentimi i procesit”, pika 2.2, sipas të cilës “2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

...

c) *argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;*”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se këto kriteret janë vendosur përgjithësisht sipas volumit dhe natyrës së objektit që prokurohet.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Për përgatitjen në analizës së koston, me urdhrat nr. 84, datë 11.03.2022 dhe nr. 85, datë 11.03.2022 është ngritur komisioni i përgatitjes së analizës së koston për shërbimin e pastrimit respektivisht për qytetin e Kavajës dhe për Njësitë Administrative Synej, Luz i Vogël dhe Helmas.

Nga auditimi i Analizës së Koston të administruar në dosje, konstatohet se:

- Për të njëjtin zë pune “Fshirja e rrugëve me mjet teknologjik” janë përcaktuar pa argument bindës dy çmime të ndryshme dhe konkretisht 0.26 lekë/m²/ditë në qytetin e Kavajës dhe 0.45 lekë/m²/ditë në Njësitë Administrative. Gjithashtu edhe për zërin “Larja e rrugëve natën” janë përcaktuar dy çmime të ndryshme dhe konkretisht 0.17 lekë/m²/ditë në qytetin e Kavajës dhe 0.29 lekë/m²/ditë në Njësitë Administrative.

- çmimi i karburantit është marrë (pa argumentim) 190 lekë/litër, ndërkohë që blerja e naftës në institucionin e Bashkisë Kavajë në këtë periudhë është 160 lekë/litër.

- Në koston e transportit është marrë konsumi i karburantit 158.4 litër/ditë për 4 makina transporti me 88 km në ditë (gjithsej 352 km) me shpejtësi mesatare të lëvizjes 60 km/orë. Nga llogaritja rezulton që konsumi i karburantit është marrë në vlerën e pajustificuar 45 litra/100 km (158.4x100/352).

- Në analizën e koston për Kavajën, për shoferët është llogaritur paga orare 684 lekë, ndërsa në Njësitë Administrative 427.5 lekë.

- Tek fshirja e rrugëve me mjet teknologjik, është vendosur konsumi i karburantit 8 litër/orë, ndërkohë që tek analiza e kostos për njësitë administrative është 5 litër/orë. Sa sipër, llogaritja e kostos nuk është reale dhe ngarkon me përgjegjësi grupin e punës për hartimin e fondit limit.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”. Nga verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 3 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE “A” A I ShPK	549,298,645
2	BOE “K” ShPK& “C” ShPK	437,642,303.2
3	OE “P.C” ShPK	Pa ofertë

Burimi i të dhënave: SPE dhe dosja e prokurimit
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës paraprak me shkresën pa nr. prot, datë 14.10.2022. Nga auditimi i vlerësimin të ofertave, u konstatua se janë skualifikuar 2 OE pjesëmarrës, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
2	BOE “C” ShPK& “C” ShPK	437,642,303.2
3	OE “P.S” ShPK	Pa ofertë

Burimi i të dhënave: SPE dhe dosja e prokurimit
Punoi: KLSH

1. OE “P.S” ShPK ka paraqitur vetëm një formular oferte për një objekt tjetër dhe është skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.
2. BOE “K” ShPK& “C” ShPK është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

1.1. Mbështetur në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 82/2 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” nenin 26 pika 7 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, është kërkuar informacion shtesë dhe dokumente mbështetëse siç përcaktohet në pikat 1/e të kritereve të përgjithshme (Vërtetim nga OSHEE) dhe 2.3.8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarde të Tenderit. Informacioni i kërkuar duhej të paraqitej në rrugë shkresore brenda datës 12.10.2022 ora 15:00. **Nga BOE K shpk dhe C shpk, nuk është paraqitur asnjë dokument sic përcaktohet mësipër dhe nuk ka patur ndonjë përgjigje të kërkesës së mësipërme në SPE.**

1.2. Referuar DST pikës 2.3.3 për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe CV për një mjek të përgjithshëm.

Operatori ekonomik C shpk anëtar I BOE, nuk ka paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar këtë fakt.

1.3. Referuar DST pikës 2.3.6 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht

70 (shtatëdhjetë) punonjës listpagesat, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore, për periudhën Qershor – Gusht 2022.

Bazuar në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe vërtetimit për fuqinë punëtore të lëshuar nga Administrata Tatimore, operatori ekonomik C shpk ka mesatarisht 43 punëtorë. Nisur nga Kontrata e Bashkëpunimit midis K shpk dhe C shpk, në të cilën është përcaktuar se operatori ekonomik C shpk do të realizojë 28% të shërbimeve objekt I kontratës, konkretisht zërin “Fshirja e rrugeve, trotuareve dhe shesheve me krahe” në qytetin Kavajë dhe njësitë administrative. Gjatë hartimit të kostos së shërbimit të pastrimit me të njëjtin objekt, Autoriteti Kontraktor ka llogaritur numrin e nevojshëm të punëtorëve për realizimin e këtij procesi, 46 (dyzet e gjashtë) punonjës, reflektuar edhe në “Procesverbalin e argumentimit të kërkesave për kualifikim” të publikuar në SPE. Operatori ekonomik C shpk nuk ka në dispozicion numrin e nevojshëm të punëtorëve për realizimin e shërbimeve që merr përsiper të realizojë në kontratën e bashkëpunimit.

Me shkresën e protokolluar me nr. 3753, datë 28.10.2022, BOE “C” ShPK& “C” ShPK ka bërë ankesën drejtuar AK Bashkia Kavajë dhe Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), sipas të cilës refuzon skualifikimin nga kjo procedurë prokurimi, duke sjellë argumente tekniko-juridike.

Pas Urdhrit nr. 319/1, datë 31.10.2022 të TAK z. R.K për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të ankesës së përbërë prej z. A.M, z. SH.B dhe z. E.G, është bërë shqyrtimi i ankesës dhe me Vendimin nr. 40, datë 07.11.2022 është rrëzuar kërkesa e BOE “K” ShPK& “C” ShPK.

Gjithashtu, edhe nga KPP është marrë në shqyrtim kjo ankesë dhe me Vendimin nr 1208/2022, datë 02.12.2022 është bërë refuzimi i ankesës për shkak të mospërgjigjes në kohë të kërkesës së bërë nga AK nga BOE “K” ShPK& “C” ShPK. Dy arsytet e tjera nuk janë marrë në konsideratë nga KPP, pasi ka mjaftuar vetëm arsyeja e parë. Në këtë vendim lejohet AK të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Pas kësaj faze, AK ka nënshkruar kontratën me BOE të shpallur fitues “A.I.C” ShPK& “A I G ” ShPK, me vlerë të kontratës 549,298,645 lekë pa TVSH, ose 659,158,374 lekë me TVSH, me afat 5 vjeçar.

Është kualifikuar dhe shpallur fitues, OE me të dhënat si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE “A.I.C” ShPK& “A I G ” ShPK	549,298,645

Burimi i të dhënave: SPE dhe dosja e prokurimit
Punoi: KLSH

- Nga verifikimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit të dokumentacionit të BOE fitues “A.I.C” ShPK& “A I G ” ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Nisur nga kontrata e bashkëpunimit datë 01.10.2022 ndërmjet “A.I.C” ShPK dhe “A I G ” ShPK, ku rezulton se ndarja e shërbimit është respektivisht 90% dhe 10%, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 88, pika 2.3 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, sipas të cilës “...Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”, rezulton se për 14 mjetet dhe 300 kazanët metalikë për grumbullimin e mbetjeve

të kërkuara në DT, OE “A.I.C” ShPK duhet të zotërojë në pronësi/qera 13 mjete dhe 270 kazanë. Nga auditimi në SPE të shtojcës 9 dhe dokumentacionit të paraqitur para lidhjes së kontratës, rezultojnë se ka paraqitur 11 mjete (**në shtojcën e mjeteve nuk është vendosur numri i shasisë, siç kërkohet në DT**), të cilat janë 3 kamionë të cilësuar për largimin e mbetjeve, 1 cisternë, që nuk e ka të përcaktuar dhe të verifikueshme në foto si autobot i pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, vetëm 1 kamion vetëshkarkues, 3 mjete me pajisje për desinfektim (kërkohet vetëm dy) dhe 3 kamionë që nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DT, si dhe 210 kazanë. Gjithashtu, për makinën e pastrimit, është paraqitur vetëm faturë doganore.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 93 “Sigurimi i konkurrencës”, pika 2.b, sipas të cilës “Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:

a).....

b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 659,158,374 lekë me TVSH lekë me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së G. K , Kryetar, A.M dhe D.H.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kavajë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

8. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, Nr. REF-87357, datë 02-16-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 73, datë 15.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 73, datë 08.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 76, datë 17.02.2021
2. Lloji i Procedurës – “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi)	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M G.T

5. Fondi Limit (pa TVSh) 116,739,459 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "B" ShPK & "P & " E.S" ShPK me ofertë 116,413,160 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 508/3 prot, dt. 23.04.2021 me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 326,299 lekë ose 0.28 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 01.03.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit me VKM nr. 26, datë 20.01.2021	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 6 OE/BOE b) S'kualifikuar 3 BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E kufizuar" (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi), me vlerë 116,739,459 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit, sipas VKM Nr. 26, datë 20.01.2021.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohen VKM nr. 26, datë 20.01.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për objektet arsimore", sipas të cilës është bërë ndarja e fondeve për rikonstruksionin e kësaj shkolle.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga struktura projektuese e Bashkisë Kavajë (preventivi është firmosur nga ing. D.Q, ing. S.Vu dhe ing. L.XH) dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kavajë, z. R.K në vitin 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 365 ditë nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit administrohet leje ndërtimi me nr. 3131, datë 27.07.2021 e dhënë nga Bashkia Kavajë.

Në dosjen e prokurimit administrohet Oponenca Teknike, me shkresën e Institutit të Ndërtimit me nr. 780/2, datë 20.05.2021, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 22.02.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 15.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i

vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 7 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier elektronik etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Korrik 2020 - Dhjetor 2021. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët t jenë në licencën e shoqërisë.

2- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

3- Janë kërkuar makineri 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve, 2 (dy) kamionë me vinç; 1 (një) vinç kullë 6-10ton, 1 (një) mjet me kosh, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. E.A, jurist dhe J.H, i cili ka nënshkruar si spacialist i fushës.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve në muajin Shkurt 2021. Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se ka gabime të konsiderueshme në vlerat e zërave të punës. Kështu vetëm nga auditimi i dy kapitujve “Punime dritare” dhe “Punime të sistemit të sheshit”, është shtuar fondi limit në shumën 7,248,258 lekë pa TVSH, duke shkaktuar përdorim pa ekonomikitet të fondeve. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi hartuesit e preventivit ing. D.Q, ing. S.Vu dhe ing. L.XH. Nga verifikimi i preventivit, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit

Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë “E kufizuar” (Procedurë e përshpejtuar-Rindërtimi), Marrëveshje kuadër. Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42, pika 6. Në dosje nuk administrohet procesverbali për hapjen e ofertave. Për këtë mosveprim, ngarkohet me përgjegjësi KVO dhe Njësia e Prokurimit. Nisur nga verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE "P" ShPK & "B" ShPK	skualifikuar
2	BOE "B" ShPK&"P" & "E" ShPK	116,413,160
3	BOE "SH" ShPK & "M" ShPK	116.500,000
4	BOE "V" ShPK & "E" ShPK	Skualifikuar
5	BOE "T" ShPK & "B" ShPK	116,721,129
6	OE "L" ShPK	Skualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO nuk është hartuar Raporti Përmbledhës.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se në fazën e parë, atë të vlerësimit të dokumentacionit teknik, janë skualifikuar BOE "P" ShPK & "B" ShPK, BOE "V.C" ShPK & "E.A" ShPK dhe OE "L" ShPK kanë mungesa në dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe janë skualifikuar me të drejtë nga KVO

-Autoriteti Kontraktor, ka kualifikuar tre ofertues, të cilëve u ka bërë ftesë për paraqitjen e ofertave ekonomike.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues "B" SH.E ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Ka bërë ndryshime thelbësore në preventivin e punimeve të hedhur në SPE, duke hequr gjithë kapitullin "Punime Betoni", në vlerë 21,957,653 lekë dhe duke shtuar zëra pune që nuk ndodhen në Preventivin e hedhur në sistem (3 zëra pune në kapitullin N "Punime të sistemit të sheshit" që kanë të bëjnë me nivelimin dhe shtrimin e sheshit me vlerë totale rreth 13,500,000 lekë pa TVSH), si dhe duke ndryshuar sasinë e zërave të punës.

Përsa sipër, ky ofertues nuk ka plotësuar kriterin bazë, atë të Formularit të ofertës ekonomike, Shtojca nr. 3 (Preventivi, si pjesë integrale e dokumenteve të tenderit).

- Dokumentet e paraqitura për punimet e ngjashme të OE "E.S" ShPK, nuk tregojnë që plotësojnë kërkesat e DT;

- OE "E.S" ShPK nuk plotëson kriterin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", pasi nuk ka paraqitur vërtetimin që ka paguar taksat në Kavajë;

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit."

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë lidhjen e kontratës me OE të klasifikuar i dyti. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 116,413,160 lekë pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së G. K , Kryetar, A.M dhe G.T.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kavajë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

9. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M”, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, Nr. REF-86258, datë 02-08-2021.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 55, datë 04.02.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 55, datë 04.02.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 63, datë 09.02.2021
2. Lloji i Procedurës – “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi)	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M G.T
5. Fondi Limit (pa TVSh) 151,236,283 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “B” ShPK & “P & “ E.S” ShPK me ofertë 150,717,562 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 508/3 prot. dt. 23.04.2021 me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 518,667 lekë ose 0.34 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.02.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit me VKM nr. 26, datë 20.01.2021	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 10 OE/BOE b) S’kualifikuar 8 BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi), me vlerë 151,236,283 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit, sipas VKM Nr. 26, datë 20.01.2021.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohen VKM nr. 26, datë 20.01.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për objektet arsimore”, sipas të cilës është bërë ndarja e fondeve për rikonstruksionin e kësaj shkolle.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga struktura projektuese e Bashkisë Kavajë (preventivi është firmosur nga ing. D.Q, ing. S.Vu dhe ing. L.XH) dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kavajë, z. R.Knë vitin 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 365 ditë nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit administrohet leje ndërtimi me nr. 3131, datë 27.07.2021 e dhënë nga Bashkia Kavajë.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 04.02.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 04.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 7 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier elektronik etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Korrik 2020 - Dhjetor 2021. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët t jenë në licencën e shoqërisë.

2- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrim profesioni. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

3- Janë kërkuar makineri 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve, 2 (dy) kamionë me ving; 1 (një) ving kullë 6-10ton, 1 (një) mjet me kosh, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kane **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. E.A, jurist dhe J.H, i cili ka nënshkruar si spacialist i fushës.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve në muajin Shkurt 2021. Nga verifikimi i preventivit, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi), Marrëveshje kuadër. Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42, pika 6. Në dosje administrohet raporti pjesor për fazën e parë parakualifikuese të ofertave. Nisur nga verifikimi i këtij raporti dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE “P” ShPK & “B” ShPK	skualifikuar
2	BOE “B” ShPK&”P” & “E.S” ShPK	150,717,562
3	BOE “A” &”Et”&”K” ShPK	Skualifikuar
4	BOE “M” ShPK & “E.A” ShPK	Skualifikuar
5	BOE “T” ShPK & “B” ShPK	151,236,229
6	OE “L” ShPK	Skualifikuar
7	OE “D” Shpk	Skualifikuar
8	OE “E” ShPK	Skualifikuar
9	BOE “E” ShPK	Skualifikuar
10	BOE “C” ShPK & “N” ShPK	Skualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se

- OE “L” ShPK është skualifikuar pasi nuk plotëson eksperiencën e ngjashme (duke vlerësuar edhe mungesën e një objekti të ngjashëm në masën 50% të vlerës së objektit që prokurohet, edhe 200% të vlerës së objektit për të gjitha objektet e realizuara të marra së bashku), nuk plotëson numrin e punonjësve (duke hequr numrin e punonjësve që kanë punuar nga 1-10 dp në muaj), nuk plotëson kriterin e rimorkiatorit (pasi nga fotot nuk është për mjetet e rënda por për mallra), nuk plotëson kriterin për 6 automakinistët (pasi përveç 3 makinistëve, të tjerët nuk i kanë ditët e plota të punës, sipas listepagesave) dhe për 2 bojaxhinjtë (pasi njëri nuk i ka patur ditët e plota të punës).

Nga auditimi i arsyeve të skualifikimit të këtij OE, konstatohet se objekti “Restaurim i ansambllit arkitektonik Pazari Gjirokastër”, i cili në dokumentet e paraqitura në SPE rezulton të ketë vlerën 137,774,433 lekë, nga të cilat 80% të punimeve, ose 110,219,546 lekë me TVSH (91,849,622 lekë pa TVSH) i ka kryer OE “L” ShPK, e ka periudhën e punimeve 24.09.2018 – 24.09.2019 dhe nuk ka të bëjë me fatura tatimore të periudhës 11.10.2016 – 31.12.2017, për të cilën është skualifikuar nga KVO. Sa sipër, ky objekt plotëson kushtin e parë (50% një objekt i vetëm) të kriterit të eksperiencës së ngjashme dhe arsyeja e kualifikimit nuk qëndron.

Në arsyetimin e bërë nga KVO për numrin e punonjësve, i cili sipas vlerësimit ka dalë 78 persona, nuk është bërë llogaritja e ditëve të punës së personave që nuk kanë punuar me ditë të plota, pasi në periudhën e kërkuar në DT, ky OE ka patur në listëpagesa nga 136 punonjës deri në 179 punonjës të siguruar.

Refuzimi nga KVO për rimorkiatorin e sjellë, nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

Refuzimi i dokumentacionit të automakinistëve dhe bojaxhinjve nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

Sa sipër ky OE nuk duhej skualifikuar dhe duhej ftuar për dhënien e ofertës ekonomike.

-Autoriteti Kontraktor, ka kualifikuar dy ofertues, të cilëve u ka bërë ftesë për paraqitjen e ofertave ekonomike.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues “B” SH.E ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila nuk përmbush kërkesat e nenit 74, pika 2 të VKM 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit **dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi**. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokurë duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi”. Operatorët ekonomikë pjesë e këtij bashkimi nuk kanë përcaktuar elementet konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi (*Ky paragraf është kopiuar nga Raporti pjesor i KVO-së në pjesën e vlerësimit të BOE “A” & “E” & “K” ShPK, si një nga arsyet e skualifikimit*).

- Për mjekën L.X, me kontratë pune me OE “E.S” ShPK, nuk janë paraqitur Libreza e punës, diploma dhe CV, siç e kërkojnë DT, si dhe nuk figuron në listëpagesa për periudhën e kërkuar.

- Dokumentet e paraqitura për punimet e ngjashme të OE “E.S” ShPK, nuk tregojnë që plotësojnë kërkesat e DT, pasi janë paraqitur kontrata me ente jopublike (Shoqëria M, “R” Shpk, “A” ShPK dhe shtëpi private në Himarë) dhe mungojnë aktet e kolaudimit, situacionet përfundimtare, formularët e vlerësimit, etj;

- OE “E.S” ShPK nuk plotëson kriterin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, pasi nuk ka paraqitur vërtetimin që ka paguar taksat në Kavajë;

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit*”.

Sa sipër, KVO ka skualifikuar OE me devijime, që mund të përkufizoheshin si devijime të vogla në zbatim të nenit 53, pika 4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ka kualifikuar OE me devijime thelbësore të DT (mungesa e eksperiencës).

Është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit në datën 23.03.2021, i cili është miratuar nga titullati i AK z. R.K, pas të cilit është bërë Formulari i njoftimit të fituesit për publikim, me shkresën nr. 479/4, datë 23.03.2021.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë lidhjen e kontratës me OE të klasifikuar i dyti. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 150,717,236 lekë pa TVSH me një

OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së G. K , Kryetar, A.M dhe G.T.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kavajë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

10. Procedura e prokurimit me objekt “Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë, Bashkia Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë., Nr. REF-33283, datë 17.06.2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 228, datë 16.06.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 228, datë 16.06.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 244, datë 29.06.2022
2. Lloji i Procedurës – “E kufizuar” (Procedurë e përshpejtuar-Rindërtimi)	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M D.H
5. Fondi Limit (pa TVSh) 594,823,787 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) G SH N SHPK me ofertë 594,114,139 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2296/8 prot, dt. 26.09.2022 me afat 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 709,648 lekë ose 0.12 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 30.06.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit me VKM nr. 239, datë 20.04.2022	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E kufizuar” (Procedurë e përshpejtuar-Rindërtimi), me vlerë 594,823,787 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit, sipas VKM Nr. 239, datë 20.04.2022.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet VKM nr. 26, datë 20.01.2021, sipas të cilës është bërë ndarja e fondeve për objektet e dëmtuara nga tërmeti.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga BOE “N”, “ A M” ShPK dhe “T” ShPK në vitin 2021. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 18 muaj nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit administrohen leje ndërtimi për nënobjekte të ndryshme dhe procesi i dhënies së tyre, është në vazhdim.

Në dosjen e prokurimit administrohet Oponenca Teknike për nënobjektet të veçanta. Procesi për pajisjen me oponencë teknike, është në vazhdim.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, pa datë 04.02.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, pa datë, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “2.Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushë, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 10 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier strukturist, inxhinier transporti, inxhinier markshejdhër etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Mars 2022 - Maj 2022, si dhe staf mbështetës edhe 5 inxhinierë të tjerë të ndryshëm dhe 3 teknikë ndërtimi. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët të jenë në licencën e shoqërisë.

2- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhet vendosur në KVK, pasi siç është cilësuar edhe në procesverbal, është detyrë e Inspektoratit Shtetëror të punës që të bëjë kontrollin e këtij detyrimi ligjor.

3- Janë kërkuar makineri 1 (një) rimorkiator, 4 (katër) ekskavatorë, 2 (dy) fadroma, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

4- Është kërkuar që Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar**. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. E.A, jurist, M.D, H.S dhe J.H, i cili ka nënshkruar si specialist i fushës.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga BOE “N”, “A M” ShPK dhe “I” ShPK, në vitin 2021.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se analizat për zërat e punës “Instalime elektrike” dhe “Instalime hidro mekanike” janë bërë në m² dhe sasia e tyre (sipërfaqja mbi të cilën do të kryhen këto punime) nuk është përcaktuar se si është llogaritur, gjatë hartimit të fondit limit. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi hartuesit e projektpreventivit. Nga verifikimi i preventivit, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi), Marrëveshje kuadër. Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42, pika 6. Në dosje administrohet raporti pjesor për fazën e parë parakualifikuese të ofertave. Nisur nga verifikimi i këtij raporti dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE “G ShPK & “Sh” ShPK “N	594,114,139
2	OE “A” Shpk	594,306,095

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

-Autoriteti Kontraktor, ka kualifikuar dy ofertues, të cilëve u ka bërë ftesë për paraqitjen e ofertave ekonomike.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues “G” ShPK & “SH” ShPK “N, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila nuk përmbush kërkesat e nenit 88, pika 1 të VKM 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet “Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. Operatorët ekonomikë, pjesë e këtij bashkimi, nuk kanë përcaktuar elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

- Dokumentet e paraqitura për punimet e ngjashme të këtij BOE janë për objektin “Rikonstruksion i mjedisëve në bashkëpronësi, ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në kuadër të procesit të rindërtimit”, Bashkia Kurbin, me vlerë të situacionuar 355,778,388 lekë pa TVSH. Ky objekt është realizuar nga po i njëjti BOE, me përqindjet respektive G” ShPK 50%, “SH” ShPK 25% dhe “N

25%, ose në vlerë G” ShPK 177,888,707 lekë, “SH” ShPK dhe “N nga 88,944,354 lekë. Nisur nga vlera e objektit që prokurohet, marrëveshja e bashkëpunimit (G” ShPK 58%, “SH” ShPK 26% dhe “N 16%) dhe kriteret e vendosura për eksperiencë të ngjashme, anëtarët e BOE duhet të plotësojnë për një objekt të ngjashëm në 5 vitet e fundit respektivisht në vlerat: G” ShPK 297,411,894 lekë (ose 50% të vlerës së objektit që prokurohet, si anëtari me % më të madhe në BOE), “SH” ShPK 154,654,185 lekë (ose 26% e vlerës së objektit) dhe “N nga 95,171,806 lekë (ose 16% e vlerës së objektit). Nga sa sipër, asnjë nga anëtarët e këtij BOE, nuk plotëson kriterin e vendosur në DT.

- Asnjë nga anëtarët e BOE nuk plotëson kriterin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, pasi nuk kanë paraqitur vërtetimin që ka paguar taksat në Bashkinë Kurbin, në të cilën kanë punuar në vitin 2021, sipas dokumenteve të paraqitur si eksperiencë e ngjashme. Nga auditimi i ekstraktit historik të shoqërive, konstatohet se Bashkia Kurbin nuk ekziston as si vendodhje tjetër e aktivitetit të tyre.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”*.

Është hartuar Formulari i Nofimit të Fituesit në datën 04.08.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. R.K dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 2296/6, datë 04.08.2022.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, KVO nuk do të kishte bërë ftesën për ofertë me këtë BOE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 594,114,139 lekë pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në pajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së G. K , Kryetar, A.M dhe D.H.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kavajë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

11. Procedura e prokurimit me objekt “Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, Qyteti Kavajë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, Qyteti Kavajë, Nr. REF-33283, datë 17.06.2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 283, datë 10.08.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. Nr. 283, datë 10.08.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 314, datë 13.09.2022
2. Lloji i Procedurës – “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi)	Njësia e Prokurimit 1. E.A, (Personi përgjegjës), Jurist 2. M.D, Juriste 3. H.S, Ekonomiste	G. K , Kryetar A.M D.H
5. Fondi Limit (pa TVSh) 529,517,613 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) F G B SHPK me ofertë 528,843,954 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2891/4 prot, dt. 24.10.2022 me afat 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 673,659 lekë ose 0.13 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 16.09.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit me VKM nr. 239, datë 20.04.2022	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi), me vlerë 594,823,787 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit, sipas VKM Nr. 239, datë 20.04.2022.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet VKM nr. 26, datë 20.01.2021, sipas të cilës është bërë ndarja e fondeve për objektet e dëmtuara nga tërmeti.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga BOE “N, “ A M” ShPK dhe “I” ShPK në vitin 2021. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 18 muaj nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit administrohe leje ndërtimi për nënobjekte të ndryshme dhe procesi i dhënies së tyre, është në vazhdim.

Në dosjen e prokurimit administrohet Oponenca Teknike për nënobjektet të veçanta. Procesi për pajisjen me oponencë teknike, është në vazhdim.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, pa datë.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, pa datë, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “2.Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 10 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier trukturist, inxhinier transporti, inxhinier markshejdër etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Maj 2022 - Korrik 2022, si dhe staf mbështetës edhe 5 inxhinierë të tjerë të ndryshëm dhe 3 teknikë ndërtimi. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët të jenë në licencën e shoqërisë.

2- Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrim profesioni. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhet vendosur në KVK, pasi siç është cilësuar edhe në procesverbal, është detyrë e Inspektoratit Shtetëror të punës që të bëjë kontrollin e këtij detyrimi ligjor.

3- Janë kërkuar makineri 1 (një) rimorkiator, 4 (katër) ekskavatorë, 2 (dy) fadroma, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

4- Është kërkuar që Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. E.A, jurist, M.D, H.S dhe J.H, i cili ka nënshkruar si specialist i fushës.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga BOE “N, “ A M” ShPK dhe “I” ShPK, në vitin 2021.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se analizat për zërat e punës “Instalime elektrike” dhe “Instalime hidro mekanike” janë bërë në m² dhe sasia e tyre (sipërfaqja mbi të cilën do të kryhen këto punime) nuk është përcaktuar se si është llogaritur, gjatë hartimit të fondit limit. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi hartuesit e projektpreventivit. Nga verifikimi i preventivit, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë “E kufizuar” (Procedurë e përsheptuar-Rindërtimi), Marrëveshje kuadër. Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42, pika 6. Në dosje administrohet raporti pjesor për fazën e parë parakualifikuese të ofertave. Nisur nga verifikimi i këtij raporti dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	F G B SHPK	528,843,954
2	BOE “NG” ShPK & B SHPK	529,502,793
3	OE “2” ShPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se KVO i ka kualifikuar të tre OE pjesëmarrës dhe i ka ftuar për të dhënë ofertën ekonomike me shkresën nr. 2891/2, datë 22.09.2022.

Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në sistem, rezulton se BOE “NG” ShPK & B SHPK dhe OE “2” ShPK, nuk kanë licencën profesionale, numrin e punojësve, eksperiencën e ngjashme dhe nuk duheshin ftuar për të dhënë ofertën ekonomike.

Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues “F G B SHPK” ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila nuk përmbush kërkesat e nenit 88, pika 1 të VKM 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet “Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. Operatorët ekonomikë, pjesë e këtij bashkimi, nuk kanë përcaktuar elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

- Dokumentet e paraqitura për punimet e ngjashme të këtij BOE janë për shumë objekte, të cilat përgjithësisht nuk janë punime të ngjashme, pasi ato me vlerë më të madhe janë rrugë apo rivitalizime sheshesh. OE “D C” ShPK, e cila ka përqindjen më të madhe të punimeve (29%) sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk ka asnjë objekt me vlerë sa 50% e objektit që prokurohet (ose 264,758,806 lekë pa TVSH), siç kërkohet ne DT. Asnjë nga anëtarët e BOE nuk plotëson eksperiencën e ngjashme, sipas përqindjeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

- OE “G K” ShPK nuk plotëson numrin e punonjësve, sipas përqindjes së përcaktuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Është hartuar Formulari i Noftimit të Fituesit në datën 05.10.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. R.K dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 2891/3, datë 05.10.2022.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 98, pika 1/a, KVO nuk do të kishte bërë ftesën

për ofertë me këta OE dhe duhet të kishte bërë anulimin e kësaj procedure prokurimi. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 528,843,954 lekë pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së G. K., Kryetar, A.M dhe D.H.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kavajë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Lidhur me procedurat e prokurimit, me shkresën nr. 955/23, datë 05.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 207/8 prot., datë 10.07.2023, është observuar nga antarët e Njësisë së Prokurimit dhe antarët e KVO-së, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Procedura me objekt “Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi i fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, Bashkia Kavajë”

a. Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1.1. Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 7 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier gjeolog, inxhinier elektronik) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Gusht 2020 - Janar 2021, si dhe staf mbështetës 1 inxhinier, 3 teknikë të tjerë të ndryshëm, etj.. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

● **Argument.** Kërkesa për stafin e teknik lidhen ngushtë me natyrën e objektit të prokurimit, shpërndarjen në një terren të gjërë të këtyre punimeve dhe specifikisht më zërat e preventivit me të njëjtin objekt. Për vendosjen e këtyre kapaciteteve i jemi referuar dokumentit shqëruar të projektit me të njëjtin objekt të hartuar nga shoqëria projektuese. Bashkangjitur dokumenti me emertimin “*Makineri-Pajisjet dhe Burimet Njerezore te Nevojshme per Realizimin e Punimeve te Projektit*”.

1.2. Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesionali. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

● **Argument.** Kërkesa për mjekun e shoqërisë, ndryshe nga pretendimi i audituesve të KLSH, është argumentuar dhe për më tepër ka dhe një link referuar lidhur me kërkesën që cdo shoqëri që ushtron aktivitet në territorin e Shqipërisë e ka detyrim ligjor që të ketë mjekun e shoqërisë në një nga format e parashikuara në VKM Nr. 632, datë 15.7.2015. Për më tepër shoqëruar argumentimit është paraqitur dhe linku përkatës i faqes së ëeb-it të Inspektoriatit Shtetëror të Punës në të cilin përcaktohet se pavarësisht përcaktimeve të pikës 6 të VKM Nr. 632, datë 15.7.2015, cdo subjekt duhet të ketë mjekun e shoqërisë pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve.

Linku <https://inspektoriatipunes.gov.al/sherbimet-e-mjekesise-se-punes/>

1.3. Janë kërkuar makineri 1 (një) sondë për shpime horizontale për kalim tubash nën trasenë e rrugës, 2 (dy) sistem eëllpoint/ekuivalent për heqje ujrash, 2 (dy) frezë asfalti, 2 (dy) sharrë asfalti, 1 (nje) aparaturë për testimin e ngjashmërisë së materialit me metodë me goditje (me pjate), të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

- **Argument.** Për vendosjen e këtyre kapaciteteve i jemi referuar dokumentit shqëruar të projektit me të njëjtin objekt të hartuar nga shoqëria projektuese. Bashkangjitur dokumenti me emertimin “Makineri-Pajisjet dhe Burimet Njerezore te Nevojshme per Realizimin e Punimeve te Projektit”.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se:

1. Në rastin e kërkesës për 8 inxhinierë, 3 teknikë dhe pajisjeve, kemi sqaruar se i jemi referuar dokumentin të hartuar nga shoqëria projektuese, e cila është dhe ka staf më të specializuar për përcaktimin e kapaciteteve të nevojshme që nevojiten për realizimin e projektit të hartuar nga kjo shoqëri.
2. Në rastin e kërkesës për mjekun e shoqërisë, mund të themi se analogjia e sjellë nga ana juaj nuk është e barazvlefshme me kërkesën për mjekun. Në rastin e kontabilistit sic citoni ju, i cili nevojitet për mbylljen e pasqyrave financiare, këta persona apo shoqëri sipas rastit janë subjekte të licencuara dhe të pajisura me nipt, të cilët paguajnë detyrime tatimore njësoj si shoqëritë në favor të të cilave kryejnë shërbimin përkatës. Këta persona apo shoqëri paguajnë detyrime të sigurime shoqërore sipas listpagesave të veta. Megjithatë themi që VKM Nr. 632, datë 15.7.2015 përcakton qartë se cdo subjekt duhet te kete mjekun e shoqërisë pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve, ndryshe nga kontabilisti për të cilin nuk përcaktohet një kërkesë e tillë.

Opinionit i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit ka dalë në këtë konkluzion pas shqyrtimit të preventivit të objektit që prokurohet dhe këto kritere nuk janë konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet. Kërkesat për 8 inxhinierëvhtë ndryshëm dhe 3 teknikë, pajisje që nuk janë të justifikuara teknikisht dhe mjeku i shoqërisë, janë të ekzagjeruara. Analogjia e bërë nga grupi i auditimit, ka qenë për të treguar që kërkesa për mjekun nuk është konform natyrës së objektit. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

b. Vlerësimi procedurës

....

Argument. Në DST është kërkuar që OE pjesëmarrës të vërtetojnë që disponojnë: “1 (një) sondë për shpime horizontale për kalim tubash nën trasenë e rrugës, 1 (një) sondë për shpime vertikale për kalim tubash nën trasenë e rrugës”. Për plotësimin e këtij kriteri OE ka paraqitur fatura tatimore të cilat janë dokument i vlefshëm pronësie. Sondat janë pajisje të cilat nuk regjistrohen nëpër regjistra publikë dhe si pasojë fatura tatimore e blerjes mjafton për të vërtetuar pronësinë.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se, nga ana jonë janë paraqitur faturat tatimore të blerjes së këtyre pajisjeve. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të rënditura mësipër.

Opiniononi i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit ka dalë në këtë konkluzion pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE, ku rezultojnë mangësitë e cituara në aktkonstatim. Faturat tatimore nuk tregojnë nëse sondat janë sipas specifikimeve në DT. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të qytetit”

Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

2.1. Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

- **Argument.** Kërkesa për mjekun e shoqërisë, ndryshe nga pretendimi i audituesve të KLSH, është argumentuar dhe për më tepër ka dhe një link referuar lidhur me kërkesën që çdo shoqëri që ushtron aktivitet në territorin e Shqipërisë e ka detyrim ligjor që të ketë mjekun e shoqërisë në një nga format e parashikuara në VKM Nr. 632, datë 15.7.2015. Për më tepër shoqëruar argumentimit është paraqitur dhe linku përkatës i faqes së ëeb-it të Inspektoriatit Shtetëror të Punes në të cilin përcaktohet se pavarësisht përcaktimeve të pikës 6 të VKM Nr. 632, datë 15.7.2015, çdo subjekt duhet të ketë mjekun e shoqërisë pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve.

Linku <https://inspektoriatipunes.gov.al/sherbimet-e-mjekesise-se-punes/>

2.2. Janë kërkuar licenca nga QKL me kode III.2.B (Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane), e cila nuk është e argumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.

- **Argument.** Kërkesa e mësipërme është hartuar në përputhje me ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, ligjit 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, VKM 229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme”.

2.3. Është kërkuar 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë. Kjo kërkesë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.

Argument. Kërkesa për 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë është e rregullt dhe e domosdoshme. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër që mjetet të cilat nuk lëvizin vetë në rrugë të vijnë në kantier. Kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë i kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin. E objektit të kontratës.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se, problematikat e trajtuara në këtë pikë nuk janë të njëjta me ato të pikës 1 të cilës ju i referoheni. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të rënditura mësipër.

Opiniononi i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit sqaron se kur nga grupi i auditimit është cituar që ka të njëjtin sqarim si në pikën 1, ka të bëjë me faktin që edhe kriteret e vendosura në këtë procedurë, nuk janë sipas natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

3. Procedura me objekt “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz I Vogël dhe Helmas”

Mbi vlerësimin e ofertave

3.1. Nga verifikimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit të dokumentacionit të BOE fitues “A.I .C” Shpk & “A I G ” Shpk, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi nisur nga kontrata e bashkëpunimit datë 01.10.2022 ndërmjet “A.I.C” ShPK dhe “A I G ” Shpk, ku rezulton se ndarja e shërbimit është respektivisht 90% dhe 10%, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 88, pika 2.3 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, sipas të cilës “...Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”, rezulton se për 14 mjetet dhe 300 kazanët metalikë për grumbullimin e mbetjeve të kërkuara në DT, OE “A.I .C” Shpk duhet të zotërojë në pronësi/qera 13 mjete dhe 270 kazanë. Nga auditimi në SPE të shtojcës 9 dhe dokumentacionit të paraqitur para lidhjes së kontratës, rezultojnë se ka paraqitur 11 mjete (**në shtojcën e mjeteve nuk është vendosur numri i shasisë, siç kërkohet në DT**), të cilat janë 3 kamionë të cilësuar për largimin e mbetjeve, 1 cisternë, që nuk e ka të përcaktuar dhe të verifikueshme në foto si autobot i pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, vetëm 1 kamion vetëshkarkues, 3 mjete me pajisje për desinfektim (kërkohet vetëm dy) dhe 3 kamionë që nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DT, si dhe 210 kazanë. Gjithashtu, për makinën e pastrimit, është paraqitur vetëm faturë doganore.

- **Argument.** Pavarësisht se në kontratën e bashkëpunimit proceset e punës janë ndarë 90% me 10% mjetet nuk mund të përpjestohen në mënyrë precize thjesht duke mbledhur totalin e mjeteve të kërkuara dhe përlllogaritur përqindjen që i takon gjithsecilit pasi në DST janë kërkuar mjete të ndryshme dhe ka procese të ndryshme pune që duhen kryer. Nisur nga kjo për procese konkrete ku është kërkuar vetëm një mjet në total rezulton se njëri nga operatorët duhet të paraqesi 10% të mjetit dhe tjetri 90% të tij. Operatorët në total i plotësojnë të gjitha mjetet e përcaktuara në DST dhe si pasojë duhen kualifikuar.

Jo cdo detaj i secilit mjet mund të verifikohet nëpërmjet fotove. Në cdo rast autoriteti kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit në vend të mjetet të cilat pjesëmarrësit në një procedurë prokurimi i prezantojnë si të disponueshme për realizimin e shërbimit të kërkuar. Në rastin konkret KVO ka patur bindjen e mjaftueshme që mjetet janë në përputhje me kërkesat e vendosura dhe si pasojë është mjaftuar me vetëdeklarimin e operatorit dhe dokumentacionin e paraqitur pasi cdo mjet i vetëdeklaruar është shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se, mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar konform ligjit, nuk përbën devijim të vogël. Para së gjithash tregon se shoqëria në fjalë nuk ka vullnetin të përgjigjet Autoritetit Kontraktor që në fazën e procedurës së tenderimit. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të rënditura mësipër.

Opinionit i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit sqaron (ashtu si edhe në Projektraport) se ka dalë në konkluzionin e mësipërm, pasi për OE të skualifikuar më një ofertë rreth 112 mln lekë më të ulët se oferta fituese, janë kërkuar sqarime nga KVO që në fazën e parë, duke e skualifikuar për devijime të cilat mund të ishin quajtur devijime të vogla, ndërsa për ofertën fituese “ka patur bindjen e mjaftueshme”

duke bërë një vlerësim subjektiv. Grupi i auditimit gjykon që fakti i paraqitur nga observuesit ku në rastin që është kërkuar një mjet, nuk mund të ndahen në 10% dhe 90%, është i vërtetë, por që kjo logjikë duhet përdorur në vlerësimin e të gjitha ofertave pa përjashtim. Edhe mungesat e evidentuara dhe përmendura në aktkonstatim për BOE fitues, nuk duhet të vlerësoheshin në bazë të vullnetit pozitiv të këtij ofertuesi, por siç shpreheni edhe në observacion “mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar konform ligjit, nuk përbën devijim të vogël “. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

4. Procedura me objekt “Rikonstruktion i shkollës 9 vjeçare “R.C”

Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

4.1. Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 7 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier elektronik etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Korrik 2020 - Dhjetor 2021. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët t jenë në licencën e shoqërisë.

- **Argument.** Kërkesa e mësipërme është vendosur konformë akteve ligjore në fuqi, kërkesës për stafin teknik të nevojshëm për realizimin e objektit të kontratës dhe në raport me zërat e punimeve të preventivit.

Kërkesa për stafin teknik janë në raport me kategoritë e licencave të kërkuara

NP 1 - A; NP 2-B; NP 3-C; NP 4 - B; NS 1 – A; NS 4 – B; NS 8 – A; punime ndertimi

NP 7 - A; NS 2 – A; punime hidroteknike

NP 12 - A; punime të inxhinierisë së mjedisit

NS 12 – A; punime të inxhinierisë mekanike dhe elektrike

NS 14 – A; punime të inxhinierisë elektrike dhe elektronike

NS 18 – A. punime të inxhinierisë topogjeodezike

për të cilat është i nevojshëm stafi teknik i përbërë nga 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier elektronik, 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder.

Kërkesa që këta inxhinierë të jenë në licencën e shoqërisë buron nga procedura e licencimit të shoqërive të ndërtimit sipas VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, të cilat për marrjen e secilës kategori licence i duhet domosdoshmërisht si kusht kryesor të ketë inxhinierin e profilit përkatës, rrjedhimisht me marrjen e pikës së licences i shtohet si drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

4.2. Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrim profesioni. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhet vendosur në KVK.

- **Argument.** Kërkesa për mjekun e shoqërisë, ndryshe nga pretendimi i audituesve të KLSH, është argumentuar dhe për më tepër ka dhe një link referuar lidhur me kërkesën që cdo shoqëri që ushtron aktivitet në territorin e Shqipërisë e ka detyrim ligjor që të ketë mjekun e shoqërisë në një nga format e parashikuara në VKM Nr. 632, datë 15.7.2015. Për më tepër shoqëruar argumentimit është paraqitur dhe linku përkatës i faqes së ëeb-it të Inspektoriatit

Shtetëror të Punes në të cilin përcaktohet se pavarësisht përcaktimeve të pikës 6 të VKM Nr. 632, datë 15.7.2015, cdo subjekt duhet të ketë mjekun e shoqërisë pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve.

Linku <https://inspektoriaqipunes.gov.al/sherbimet-e-mjekesise-se-punes/>

D PUNIME BETONI				
9	2.166	Hekur betoni I zakonshem	Ton	85

Në Manualin nr.2 të punimeve të ndërtimit, analiza teknike përkatëse me nr.2.166 është si më poshte:

2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm																
	ton																
Sp + p	op	60	185	11100													
Sigurime shoqërore 16.7%	leke	11100	0.167	1854													
Transport	T*km				10	21	210										
Vinc kulle 6 - 10 ton	op							0.63	210	132.3							
Hekur i përgatitur	ton										1	82000	82000				
Tel bari	kg										6	100	600				
Shuma :				12954			210			132.3			82600	95896	7672	9590	113157

Kërkesa për 2 (dy) kamionë me vinç është e nevojshme për shkarkimin e materialeve të ndërtimit, si dhe për transportin e tyre në lartësi të vogla.

Kërkesa për 1 (një) mjet me kosh është i nevojshëm ndër të tjera për montimin ndricueseve LED apo për montimin e aksesorëve të fasadës, logove të parashikuara në preventiv.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se, problematikat e trajtuara në këtë pikë nuk janë të njëjta me ato të pikës 1 të cilës ju i referoheni. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të rënditura mësipër.

Opinion i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit sqaron se citimi që “ka të njëjtin sqarim si në pikën 1”, ka të bëjë me faktin që edhe kriteret e vendosura në këtë procedurë, nuk janë sipas natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

5. Procedura me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M”

Pretendimi i subjektit

Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

5.1. Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 7 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier elektronik etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Korrik 2020 - Dhjetor 2021. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët t jenë në licencën e shoqërisë.

- **Argument.** Kërkesa e mësipërme është vendosur konformë akteve ligjore në fuqi, kërkesës për stafin teknik të nevojshëm për realizimin e objektit të kontratës dhe në raport me zërat e punimeve të preventivit.

Kërkesa për stafin teknik janë në raport me kategoritë e licencave të kërkuara

NP 1 - A; NP 2-B; NP 3-C; NP 4 - B; NS 1 – A; NS 4 – B; NS 8 – A; punime ndertimi

NP 7 - A; NS 2 – A; punime hidroteknike
 NP 12 - A; punime të inxhinierisë së mjedisit
 NS 12 – A; punime të inxhinierisë mekanike dhe elektrike
 NS 14 – A; punime të inxhinierisë elektrike dhe elektronike
 NS 18 – A. punime të inxhinierisë topogjeodezike

për të cilat është i nevojshëm stafi teknik i përbërë nga 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier mjedisi, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier elektronik, 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder.

Kërkesa që këta inxhinierë të jenë në licencën e shoqërisë buron nga procedura e licencimit të shoqërive të ndërtimit sipas VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të cilat për marrjen e secilës kategori licence i duhet domosdoshmërisht si kusht kryesor të ketë inxhinierin e profilit përkatës, rrjedhimisht me marrjen e pikës së licences i shtohet si drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

5.2. Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesioni. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

- Kërkesa për mjekun e shoqërisë, ndryshe nga pretendimi i audituesve të KLSH, është argumentuar dhe për më tepër ka dhe një link referuar lidhur me kërkesën që çdo shoqëri që ushtron aktivitet në territorin e Shqipërisë e ka detyrim ligjor që të ketë mjekun e shoqërisë në një nga format e parashikuara në VKM Nr. 632, datë 15.7.2015. Për më tepër shoqëruar argumentimit është paraqitur dhe linku përkatës i faqes së ëeb-it të Inspektoriatit Shtetëror të Punës në të cilin përcaktohet se pavaresisht përcaktimeve të pikës 6 të VKM Nr. 632, datë 15.7.2015, çdo subjekt duhet të ketë mjekun e shoqërisë pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve.

Linku <https://inspektoriatipunes.gov.al/sherbimet-e-mjekesise-se-punes/>

5.3. Janë kërkuar makineri 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve, 2 (dy) kamionë me vinç; 1 (një) vinç kullë 6-10ton, 1 (një) mjet me kosh, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

- **Argument.** Kërkesa për 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë është e rregullt dhe e domosdoshme. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër që mjetet të cilat nuk lëvizin vetë në rrugë të vijnë në kantier. Kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë i kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin. E objektit të kontratës. Kërkesa për 1 (një) vinç kullë 6-10ton është e argumentuar sepse parashikohet në Manualin Teknik të Cmimeve të Punimeve të Ndërtimit, manuali 2. Po ti referohemi preventivit me të njëjtin objekt kemi:

D	PUNIME BETONI			
9	2.166	Hekur betoni I zakonshem	Ton	85

Në Manualin nr.2 të punimeve të ndërtimit, analiza teknike përkatëse me nr.2.166 është si më poshte:

2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm															
		ton														
	Sp + p	op	60	185	11100											
	Sigurime shoqërore 16.7%	leke	11100	0.167	1854											
	Transport	T*km				10	21	210								

	Vinc kulle 6 - 10 ton	op						0.63	210	132.3							
	Hekur i pergatitur	ton									1	82000	82000				
	Tel bari	kg									6	100	600				
	Shuma :				12954			210			132.3		82600	95896	7672	9590	113157

Kërkesa për 2 (dy) kamionë me vinq është e nevojshme për shkarkimin e materialeve të ndërtimit, si dhe për transportin e tyre në lartësi të vogla.

Kërkesa për 1 (një) mjet me kosh është i nevojshëm ndër të tjera për montimin ndricueseve LED apo për montimin e aksesorëve të fasadës, logove të parashikuara në preventiv.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se, problematikat e trajtuara në këtë pikë nuk janë të njëjta me ato të pikës 1 të cilës ju i referoheni. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të rënditura mësipër.

Opinionit i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit sqaron se citimi që “ka të njëjtin sqarim si në pikën 1”, ka të bëjë me faktin që edhe kriteret e vendosura në këtë procedurë, nuk janë sipas natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se:

5.4. OE “L” Shpk është skualifikuar pasi nuk plotëson eksperiencën e ngjashme (duke vlerësuar edhe mungesën e një objekti të ngjashëm në masën 50% të vlerës së objektit që prokurohet, edhe 200% të vlerës së objektit për të gjitha objektet e realizuara të marra së bashku), nuk plotëson numrin e punonjësve (duke hequr numrin e punonjësve që kanë punuar nga 1-10 dp në muaj), nuk plotëson kriterin e rimorkiatorit (pasi nga fotot nuk është për mjetet e rënda por për mallra), nuk plotëson kriterin për 6 automakinistët (pasi përveç 3 makinistëve, të tjerët nuk i kanë ditët e plota të punës, sipas listepagesave) dhe për 2 bojaxhinjtë (pasi njëri nuk i ka patur ditët e plota të punës). Nga auditimi i arsyeve të skualifikimit të këtij OE, konstatojmë se objekti “Restaurim i ansambllit arkitektonik Pazari Gjirokastër”, i cili në dokumentet e paraqitura në SPE rezulton të ketë vlerën 137,774,433 lekë, nga të cilat 80% të punimeve, ose 110,219,546 lekë me TVSH (91,849,622 lekë pa TVSH) i ka kryer OE “L” Shpk, e ka periudhën e punimeve 24.09.2018 – 24.09.2019 dhe nuk ka të bëjë me fatura tatimore të periudhës 11.10.2016 – 31.12.2017, për të cilën është skualifikuar nga KVO. Sa sipër, ky objekt plotëson kushtin e parë (50% një objekt i vetëm) të kriterit të eksperiencës së ngjashme dhe arsyeja e kualifikimit nuk qëndron.

- **Argument.** Nga verifikimi i dokumentacionit dhe analizës tuaj na rezulton se në arsyen e skualifikimit të shprehur në raportin përmbledhës të procedurës jemi shumë të qartë duke argumentuar se kjo punë në masën 90% të saj është kryer në periudhën 2016-2017 e vërtetuar nga faturat tatimore të paraqitura nga vetë operatori. Si pasojë këto punime janë realizuar jashtë periudhës kohore për punime të ngjashme të kërkuara në DST dhe nuk mund të merren parasysh.

6.5. Në arsyetimin e bërë nga KVO për numrin e punonjësve, i cili sipas vlerësimit ka dalë 78 persona, nuk është bërë llogaritja e ditëve të punës së personave që nuk kanë punuar me ditë të plota, pasi në periudhën e kërkuar në DT, ky OE ka patur në listëpagesa nga 136 punonjës deri në 179 punonjës të siguruar.

- **Argument.** Punonjësit që punojnë nga një ditë nuk mund të merren paraqysh pasi gjatë pjesës tjetër të muajin këta njerëz mund të jenë të angazhuar me punë të tjera dhe si pasojë nuk mund të jenë të disponueshëm për operatorin në rast se shpallet fitues.

6.6. Refuzimi nga KVO për rimorkiatorin e sjellë, nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

- **Argument.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për rimorkiatorin dhe fotove përkatëse rezulton se bëhet fjalë për një kamion të thjeshtë për transport materialesh dhe jo për rimorkiator për transport mjetesh. Nuk ka se si të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht ky fakt. (Bashkëngjitur foto e mjetit të paraqitur).

6.7. Refuzimi i dokumentacionit të automakinistëve dhe bojaxhinjve nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

- **Argument.** Personat e paraqitur si automakinistë dhe bojaxhinj nuk janë të disponueshëm për operatorin në rast se ai shpallet fitues pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se ata punojnë nga 1-2 ditë në muaj për këtë operator. Ose këta persona janë të punësuar diku tjetër dhe si pasojë nuk janë të disponueshëm ose operatori nuk deklaroi sic duhet në mënyrë që të shmangë pagesën e sigurimeve shoqërore për këta persona. Në të dyja rastet ky operator nuk mund të kualifikohet më tej.

Gjithsesi ky OE ka patur të gjitha mundësitë ti kundërshtonte pretendimet e KVO të cilat janë të shumta dhe nuk e ka bërë këtë pasi është i bindur që të gjitha qëndrojnë.

Autoriteti Kontraktor, ka kualifikuar dy ofertues, të cilëve u ka bërë ftesë për paraqitjen e ofertave ekonomike.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues “B” SH.E Shpk, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

6.8. Dokumentet e paraqitura për punimet e ngjashme të OE “E.S” Shpk, nuk tregojnë që plotësojnë kërkesat e DT, pasi janë paraqitur kontrata me ente jopublike (Shoqëria M, “R” Shpk, “A” Shpk dhe shtëpi private në Himarë) dhe mungojnë aktet e kolaudimit, situacionet përfundimtare, formularët e vlerësimit, etj;

- **Argument.** Referuar ligjit 163 “Për prokurimin publik” neni 82 “shqyrtimi i ofertave” citohet: Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit. Nisur nga sa më sipër konstatojmë se nga ana e KVO është krijuar bindja se ky operator është mjaftueshëm i aftë për të realizuar përqindjen e punimeve që ka marrë përsipër me dokumentacionin që ka paraqitur për punime të ngjashme të cilat janë të shumta.

6.9. OE “E.S” Shpk nuk plotëson kriterin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, pasi nuk ka paraqitur vërtetimin që ka paguar taksat në Kavajë;

- **Argument.** Në periudhën në fjalë shoqëria E.S nuk ka patur fare aktivitete në territorin e Bashkisë Kavajë dhe si rrjedhojë nuk ka detyrime tatimore për të paguar.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se:

1. Në rastin e eksperiencës për punë të ngjashme, themi se operatori ekonomik “E.S” Shpk ka paraqitur punë të ngjashme dhe i plotëson ato. Fakti që është paraqitur kontrata

e punës dhe faturat tatimore për realizimin e punëve në këtë objekt nuk cenon faktin e mospërbushjes së kërkesës për punë të ngjashme.

2. Lidhur me pikat tjera ju nuk jeni shprehur konkretisht. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të rënditura mësipër.

Opinionit i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit, siç ka përmendur edhe në projektraport, ka dalë në këtë konkluzion pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe në dosjen e prokurimit. Është për tu habitur fakti, që observuesit pretendojnë që devijimet e cituara nga ana e grupit të auditimit për OE fitues, konsiderohen si të vogla, ndërsa ato të OE të skualifikuar quhen devijime që ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Devijimet që kanë të bëjnë me eksperiencën e ngjashme nuk mund të quhen devijime të vogla. Përsa i përket pikave të tjera, grupi i auditimit ka argumentuar në aktkonstatim se cilat janë shkeljet në vlerësimin e ofertave të skualifikuara dhe u qëndron atyre argumenteve. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

7. Procedura e prokurimit me objekt “Riforcimi I njërive individuale të banimit dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë”

Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

7.1. Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 10 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier strukturist, inxhinier transporti, inxhinier markshejdhër etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhën Mars 2022 - Maj 2022, si dhe staf mbështetës edhe 5 inxhinierë të tjerë të ndryshëm dhe 3 teknikë ndërtimi. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët të jenë në licencën e shoqërisë.

- **Argument.** Kriteri për stafin drejtues teknik sic citohet edhe në Procesverbalin e Argumentimit të Kërkesave për Kualifikim, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. . Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.2 të kriterëve teknike , kërkesa për licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Konkretisht 1 (një) inxhinier ndërtimi, i cili nevojitet për zbatimin e punimeve të ndërtimit objekt i kontratës. Riparimet e parashikuara në preventiv nuk janë vetëm në elementë strukturorë, por edhe në elementë jo-strukturorë. Kryesisht punime prishje, punime shtrim me pllaka, punime suvatimi, punime të terracës etj. 1 (një) inxhinier ndërtimi profili strukturist. Riparimet e parashikuara janë kryesisht në elementë strukturorë. Qëllimi kryesor i objektit të kontratës është riaftësimi strukturor I ndërtesave sic parashikohen në preventiv dhe ekspertizën e thelluar. Referuar preventivit me të njëjtin objekt të gjitha volumet e punimeve (shuma A) janë punime

strukture. 1 (një) inxhinier ndërtimi profili transport, Referuar preventivit me të njëjtin objekt të gjitha volumet e punimeve realizohen nëpërmjet mjeteve të rënda të shumta në numër meqenëse dhe volume e punimeve janë të shumta, të shpërndarë në zonë të banuar në largësi nga njera tjetra. 1 (një) inxhinier elektrik, Referuar preventivit me të njëjtin objekt punimeve të instalimeve elektrike. 1 (një) inxhinier hidroteknik, Referuar preventivit me të njëjtin objekt punimeve të instalimeve hidrosanitare. 1 (një) inxhinier mjedisi, për ruajtjen e raporteve midis zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe ruajtjes së mjedisit, kryesisht në përdorimin e materialeve të padëmshme mjedisore, menaxhimin e mbetjeve ndërtimore, lëvizjen e orientuar të mjeteve në rrugë etj. 1 (një) inxhinier mekanik, Referuar preventivit me të njëjtin objekt punimeve të instalimeve mekanike. 1 (një) inxhinier topograf dhe 1 (një) inxhinier markshajder të nevojshem për matjet dhe piketimet. 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik është I domosdoshëm sepse për ndërhyrjet që do të bëhen, është kryer një studim i thelluar gjeologjik dhe për implementimin e punimeve që lidhen me këtë studim.

Stafi mbështetës për punimet kryesore të parashikuar në preventiv është i domosdoshëm duke qenë se janë parashikuar të riaftësohen një numër i madhe godinash 17 pallate dhe 10 shtëpi banimi, të shpërndara në të gjithë territorin e Njësisë Administrative Golem.

7.2. Është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës, diploma, license ushtrimi profesionali. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK, pasi siç është cilësuar edhe në procesverbal, është detyrë e Inspektoratit Shtetëror të punës që të bëjë kontrollin e këtij detyrimi ligjor.

- **Argument.** Kërkesa për mjekun e shoqërisë, ndryshe nga pretendimi i audituesve të KLSH, është argumentuar dhe për më tepër ka dhe një link referuar lidhur me kërkesën që cdo shoqëri që ushtron aktivitet në territorin e Shqipërisë e ka detyrim ligjor që të ketë mjekun e shoqërisë në një nga format e parashikuara në VKM Nr. 632, datë 15.7.2015. Për më tepër shoqëruar argumentimit është paraqitur dhe linku përkatës i faqes së ëeb-it të Inspektoriatit Shtetëror të Punës në të cilin përcaktohet se pavarësisht përcaktimeve të pikës 6 të VKM Nr. 632, datë 15.7.2015, cdo subjekt duhet të ketë mjekun e shoqërisë pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve.

Linku <https://inspektoriatipunes.gov.al/sherbimet-e-mjekesise-se-punes/>

7.3. Janë kërkuar makineri 1 (një) rimorkiator, 4 (katër) ekskavatorë, 2 (dy) fadroma, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

- **Argument.** Kërkesa për 1 (një) rimorkiator për lëvizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë është e rregullt dhe e domosdoshme. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër që mjetet të cilat nuk lëvizin vetë në rrugë të vijnë në kantier. Kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë i kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin. E objektit të kontratës. Kërkesa për 4 (katër) ekskavatorë, 2 (dy) fadroma është vendosur për të realizuar zërat e punimeve prishje shtresa betoni, prishje struktura prej guri dhe grumbullimin ngarkimin e mbetjeve ndërtimore. Sasia e këtyre mjeteve është kërkesë që buron nga numri i madh i objekteve dhe shpërndarja e tyre.

7.4. Është kërkuar që Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra

Kombëtare e Licencimit. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përputhje me natyrën e punimeve.

- **Argument.** Kërkesa e mësipërme është hartuar në përputhje me ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, ligjit 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, VKM 229 date 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme”.

Lidhur me konkluzionet grupit të auditit, mund të themi se, problematikat e trajtuara në këtë pikë nuk janë të njëjta me ato të pikës 1 të cilës ju i referoheni. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të renditura mësipër.

Opinionit i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit sqaron se citimi që “ka të njëjtin sqarim si në pikën 1”, ka të bëjë me faktin që edhe kriteret e vendosura në këtë procedurë, nuk janë sipas natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

Autoriteti Kontraktor, ka kualifikuar dy ofertues, të cilëve u ka bërë ftesë për paraqitjen e ofertave ekonomike.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE fitues “G” Shpk & “SH” Shpk “N, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

7.5. Ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila nuk përmbush kërkesat e nenit 88, pika 1 të VKM 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet “Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. Operatorët ekonomikë, pjesë e këtij bashkimi, nuk kanë përcaktuar elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Dokumentet e paraqitura për punimet e ngjashme të këtij BOE janë për objektin “Rikonstruksion i mjediseve në bashkëpronësi, ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në kuadër të procesit të rindërtimit”, Bashkia Kurbin, me vlerë të situacionuar 355,778,388 lekë pa TVSH. Ky objekt është realizuar nga po i njëjti BOE, me përqindjet respektive G” Shpk 50%, “SH” Shpk 25% dhe “N 25%, ose në vlerë G” Shpk 177,888,707 lekë, “SH” Shpk dhe “N nga 88,944,354 lekë. Nisur nga vlera e objektit që prokurohet, marrëveshja e bashkëpunimit (G” Shpk 58%, “SH” Shpk 26% dhe “N 16%) dhe kriteret e vendosura për eksperiencë të ngjashme, anëtarët e BOE duhet të plotësojnë për një objekt të ngjashëm në 5 vitet e fundit respektivisht në vlerat: G” Shpk 297,411,894 lekë (ose 50% të vlerës së objektit që prokurohet, si anëtari me % më të madhe në BOE), “SH” Shpk 154,654,185 lekë (ose 26% e vlerës së objektit) dhe “N nga 95,171,806 lekë (ose 16% e vlerës së objektit). Nga sa sipër, asnjë nga anëtarët e këtij BOE, nuk plotëson kriterin e vendosur në DT.

Asnjë nga anëtarët e BOE nuk plotëson kriterin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, pasi nuk kanë paraqitur vërtetimin që ka paguar taksat në Bashkinë Kurbin, në të cilën kanë punuar në vitin 2021, sipas dokumenteve të paraqitura si

eksperiencë e ngjashme. Nga auditimi i ekstraktit historik të shoqërive, konstatohet se Bashkia Kurbin nuk ekziston as si vendodhje tjetër e aktivitetit të tyre.

- **Argument.** Procedurat e rindërtimit janë procedura të përshpejtuara me qëllim kryerjen e punimeve në një kohë sa më të shpejtë për të ulur kostot edhe për institucionet shtetërore që paguajnë bonuse qeraje gjatë kësaj kohe, por edhe për banorët të cilën nuk mund të jetojnë në banesat e tyre. G.P.G Company është një shoqëri me kapacitete shumë të mëdha. Nëse i referohemi buletinit të APP vërejmë se kjo kompani ka përfituar shumë punë publike të ngjashme.

Ky BOE ka punë të ngjashme të sukseshme të mëparshme edhe me vetë Bashkinë Kavajë pavarësisht se kjo nuk është reflektuar në SPE nga vetë operatorët.

Gjithashtu këta operatorë kanë paguar rregullisht taksavet vendore në Bashkinë Kavajë për të gjithë periudhën që kanë punuar në territorin e saj.

Për shkaqe të ngjashme ligjvënësit me rishikimin e fundit të kuadrit ligjor përfshinë formularin e vetëdeklarimit që nënkupton se jo cdo dokument është i domosdoshëm për tu ngarkuar në SPE.

- Nisur nga sa më sipër referuar ligjit 163 “Për prokurimin publik” neni 82 “shqyrtimi i ofertave” citohet: Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se nuk është bërë vlerësim mbi bazë reputacioni. Vlerësimi është bërë në bazë të dokumentacionit që disponon vetë Autoriteti Kontraktor referuar kontratave të ngjashme të realizuara me operatorin ekonomik në fjalë. Për këtë arsye, për të mos kundërshtuar veten, i qëndrojmë argumentave të renditura mësipër.

Opinionimi i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit ka dalë në këtë konkluzion pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe në dosjen e prokurimit. Në asnjë rresht të legjislacionit të Prokurimit Publik nuk citohet që KVO duhet të bëjë vlerësime mbi bazën e kontratave të ngjashme të realizuara me operatorin ekonomik, pasi nëse do të ishte kështu, OE mund të mos sillte asnjë dokument dhe KVO ta vlerësonte në bazë të dokumenteve të paraqitura në procedurat e mëparshme. Ritheksojmë se mosplotësimi i kriterit për punime të ngjashme, nuk mund të quhet devijim i vogël. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit

8. Procedura e prokurimit me objekt “Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, qyteti Kavajë”.

Edhe për këtë procedurë, nga observuesit ka patur pothuajse të njëjtat argumente si për provedurën paraardhëse dhe mbyllet me paragrafin “Lidhur me konkluzionet grupit të audit, mund të themi se, problematikat e trajtuara në këtë pikë nuk janë të njëjta me ato të pikës 1 të cilës ju i referoheni. Për këtë arsye, i qëndrojmë argumentave të renditura mësipër”.

Opiniononi i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit sqaron se citimi që “ka të njëjtin sqarim si në pikën 1”, ka të bëjë me faktin që edhe kriteret e vendosura në këtë procedurë, nuk janë sipas natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Auditim i procedurave të blerjeve të vogla për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2022.

Objekti i aktkonstatimit është: Auditimiti ushtruar në subjektin Bashkia Kavajë, në zbatim të pikës nr.4 në programin e auditimit nr.207/1, datë 10.03.2023, i ndryshuar.

Drejtimi: Auditim mbi planifikimin edhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, që nga data 01.01.2021-31.12.2022. Për këtë qëllim u shqyrtua dokumentacioni i administruar me zgjedhje sa më poshtë:

1-Rregjistri parashikimit me (shtesa e pakësime) dhe rregjistri i realizimit të procedurave të prokurimit me “vlerë e vogël” për; (blerje mall, shërbime dhe punë publike) për periudhën objekt auditimi (nga data 01 janar 2021 deri 31 dhjetor 2022).

2-Dosjet fizike të procedurave të prokurimit të realizuara me “vlerë e vogël” të marra me zgjedhje për auditim me objekt; (blerje mallra, shërbime, punë publike) nëperiudhën (nga data 01 janar 2021 deri 31 dhjetor 2022).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Nga auditimi mbi dokumentacionin evendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2021) u konstatua se;Autoriteti Kontraktor (bashkia Kavajë)në cilësinë njësi shpenzuese publike vendore në **0** raste ka kryer shpenzime me fonde publike me objekt për; (blerje mall, punëdhe shërbime publike) me natyrë të njëjtë.

Për periudhën objekt auditimi periudha raportuese (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2021), AK ka realizuar gjithësej **47 blerje me vlerë fondi limit për 17,372,773 lekë, për të cilat edhe ka lidhur 47 kontrata me vlerë 14,080,931 lekë, ku më hollësisht të procedura te analizuara dhe të realizuara me “vlerë e vogël”, sipas urdhër prokurimit sa më poshtë;**

Me analizë të hollësishme për blerjet e realizuara me procedurë “Vlerëe vogël”, për secilin urdhër prokurimi dhe urdhër shpenzimmë periudhën raportuese ushtrimore (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2021), periudhë objekt auditimi në lidhje me dokumentacioni autorizues dhe vërtetues bashëlidhur procedurës së prokurimit e urdhër shpenzimit në mënyrë kronologjike u konstatua sa më poshtë;

1-Me urdher prokurimi nr.01, datë 01.02.2021, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 748,800 leke pa tvsh me objekt; “Blerje dru zjarri”, në datën 03.02.2021 ora 10⁰⁰. Me urdhër të brendshëm nr.19, datë 05.01.2021 është ngritur KBVV i përbërë nga E.A, M.D dhe H.S i cili ka hapur procedurën, ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarie gjithsej **13 OE** konkurrues dhe në procesverbalin datë 03.02.2021 ka kualifikuar 7 OE, ndërsa ka skualifikuar 6 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit, në përfundim është shpall fitues oferta e radhitur 1 (e para) pas fteses se bere per hedhje shorti meqë 2 operatorët e pare kane qene me oferta te barabarta, nga KBVV është pasqyruar me shkresa ftesa që i është bere OE per hedhje shorti, në përfundim me procesverbalin datë 04.02.2021 (1 dite pas hapjes) është shpallur fituese oferta e merenditje në vend të parë nga OE “D.XH” shpk me NIPT L56503401V me vlere oferte për **700.000 lekë pa tvsh**. Nëdokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese

të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me operatorët konkurrues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj).

-Me U/Shpenzimin nr.1157, datë 23.06.2021 është likujduar subjekti “D.XH” me vlerën e kontratës **840,000 lekë me tvsh** për shpenzimin relalizuar me procedurë “vlerë e vogël”, bashkëlidhur së cilit janë dokumentat autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (urdhër prokurimi; ftesa për ofertë;njoftimi fituesit;kerkesa per mallin, QKB, fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr.1, datë12.02.2021; fletë hyrja e magazinës nr.03, datë12.02.2021 për artikujt). Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

2-Me urdhër prokurimi nr.14, datë14.06.2021, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 798,167 leke pa tvsh me objekt; “Blerje materiale pastrimi”. Me urdhërin e brendshëm nr.19, datë05.01.2021është ngritur KBVV i përbërë nga : E.A, M.D dhe H.S i cilinë datën17.06.2021, ora 10⁰⁰ka hapur procedurën ku kanë paraqitur interes me pjesmarrje gjithsej **34 OE** konkurrues, në procesverbalin datë17.06.2021 ka kualifikuar 30 OE, ndërsa ka skualifikuar 4 OE nga keta 3 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit dhe 1OE me argumentin se eshte ulur me shume se 50% e fondit limit, në përfundim është shpall fitues oferta e radhitur 4 (e katerta) paraqitur për lidhje të kontratës dhe klasifikimi përfundimtar është deklaruar në SPE, ku për të gjithë OE konkurrues të cilët janë tërhequr nga lidhja e kontratës, nga KBVV rastpas rasti janë pasqyruar me procesverbal cdo fazë ku OE “S ” i renditur i eshte terhequr nga procedura, OE “B. K.” i renditur i II nuk eshte paraqitur brenda afatit dhe OE”XH-N-SH Group” i renditur i III eshte terhequr nga procedura dhe në përfundim me procesverbalin datë21.06.2021 (5 dite pas hapjes) është shpall fituese oferta e e mbetur në renditje në vend të parënga OE “M.S”shpk me NIPT L.....C me vlerë oferte prej **520,400 lekë pa tvsh**. Në dokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike tëkësaj procedure janë përfshirë; (urdhër prokurimi, preventivi përlllogaritjes së vlerës limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike,kerkesa per artikujt, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me OE konkurrues dhe operatori i ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj).

-Me U/Shpenzimin nr.452, datë 30.03.2022 është likujduar subjekti “M.S”me vlerën e kontratës **624,480 lekë me tvsh** për shpenzimin relalizuar me procedurë “vlerë e vogël”, bashkëlidhur së cilit janë dokumentat autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (urdhër prokurimi; ftesa për ofertë;njoftimi fituesit; preventivi artikujve;fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr.74, datë28.06.2021; fletë hyrja e magazinës nr.23, datë28.06.2021për artikujt;Iban i OE). Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

3-Me urdhër prokurimi nr.30, datë 21.10.2021, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 525,250 leke pa tvsh me objekt; “Akomodim ne hotel dhe trajnim me ushqim”. Me urdhër të brendshëm nr.19, datë 05.01.2021është ngritur KBVV i përbërë nga E.A, M.D dhe H.S i cili në datën 22.10.2021 ora 14⁰⁰ kanë hapur procedurën, ku kanë paraqitur interes me pjesmarrje gjithsej **6 OE** konkurrues, ndërsa në procesverbalin datë22.10.2021, ka kualifikuar 1 OE, ndërsa ka skualifikuar 5 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit dhe ka shpall fitues ofertën e radhitur 1 (e para), është shpallur fituese oferta e renditur në vend të parë nga OE “F.R” shpk me NIPT M.....G me vlerë oferte prej **521,400 leke pa tvsh**. Në dokumentet vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (urdhër prokurimi, preventivi përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me OE konkurrues operatori ekonomik shpallur fitues, oferta fituese, etj).

-Ky Shpenzim nuk është likujduar, ndërsa subjekti “F.R”shpk për kontratën e realizuar me vlerë **625,680 lekë me tvsh** për shpenzimin me procedurë “vlerë e vogël” ka dorëzuar dokumentat

bashkëlidhur të cilit janë dokumentat autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; *(urdhëri prokurimit, ftesa përofertë; njoftimi i fituesit; preventivi me zërat e mallrave; fatura tatimore e shitjes së furnitorit nr.35 datë 12.11.2021.*

4-Me urdhër prokurimi nr.43, datë 16.11.2021, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 552,750 leke pa tvsh me objekt; “*Blerje materiale elektrike*”, në datën 25.11.2021 ora 12.³⁰. Me urdhër të brendshëm nr.19, datë 05.01.2021 është ngritur KBVV i përbërë nga E.A, M.D dhe H.S i cili ka hapur procedurën, ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarie gjithsej **36 OE** konkurrues dhe në procesverbalin datë 25.11.2021 ka kualifikuar 17 OE, ndërsa ka skualifikuar 19 OE nga keta 13 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit, 4 OE me argumentin se është ulur me shume se 50% e fondit limit dhe 2 OE me argumentin se nuk janë paraqitur ne procedura te meparshme pa justifikim, në përfundim është shpall fitues oferta e radhitur 2 (e dyta) paraqitur për lidhje të kontratës dhe klasifikimi përfundimtar është deklaruar në SPE, ku për të gjithë OE konkurrues të cilët janë tërhequr nga lidhja e kontratës, nga KBVV rast pas rasti janë pasqyruar me procesverbal cdo fazë ku OE “S.G” i renditur i I nuk është paraqitur brenda afatit te percaktuar ne ftesen per oferte dhe nuk ka derguar mesazh ne SPE per mosparaqitje, në përfundim me procesverbalin datë 26.11.2021 (*I dite pas hapjes*) është shpallur fituese oferta e me renditje në vend të parë nga OE “T”shpk me NIPT K.....P me vlere oferte për **385,000 lekë pa tvsh**. Në dokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; *(urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me operatorët konkurrues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj).*

- **Me U/Shpenzimin nr.2410, datë 14.12.2021** është likujduar subjekti “T”shpk me vlerën e kontratës **462,000 lekë me tvsh** për shpenzimin relalizuar me procedurë “vlerë e vogël”, bashkëlidhur së cilit janë dokumentat autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; *(urdhër prokurimi; ftesa për ofertë;njoftimi fituesit;kërkesa per mallin, QKB, fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr.46, datë 07.12.2021; fletë hyrja e magazinës nr.75, datë 07.12.2021 për artikujt, Iban i OE dhe flete daljet nr.363 date 20.12.20.12.2021 dhe nr.366 date 20.12.2021).* Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

5-Me urdhër prokurimi nr.53, datë 17.12.2021, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 416,500 leke pa tvsh me objekt; “*Blerje lodrash me rastin e festave te fundvitit*”. Me urdhërin e brendshëm nr.19, datë 05.01.2021 është ngritur KBVV i përbërë E.A, M.D dhe H.S i cili në datën 21.12.2021, ora 12.³⁰ ka hapur procedurën ku kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej **30 OE** konkurrues dhe në procesverbalin datë 21.12.2021 ka kualifikuar 20 OE, ndërsa ka skualifikuar 10 OE nga keta 5 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit, 4 OE me argumentin se është ulur me shume se 50% e fondit limit dhe 1 OE me argumentin se nuk janë paraqitur ne procedura te meparshme pa justifikim, në përfundim është shpall fitues oferta e radhitur 2 (e dyta) paraqitur për lidhje të kontratës dhe klasifikimi përfundimtar është deklaruar në SPE, ku për të gjithë OE konkurrues të cilët janë tërhequr nga lidhja e kontratës, nga KBVV rast pas rasti janë pasqyruar me procesverbal cdo fazë ku OE “A.O” i renditur i I nuk është paraqitur dhe ka derguar mesazh ne SPE per mosparaqitje per shkak te nje gabimi ne llogaritjen e kostos, në përfundim me procesverbalin datë 22.12.2021 (*I dite pas hapjes*) është shpallur fituese oferta e me renditje në vend të parë nga OE “XH”shpk me NIPT M.....P me vlere oferte për **348,000 lekë pa tvsh**. Në dokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; *(urdhër prokurimi, preventivi përlllogaritjes së vlerës limit, ftesa për*

ofertë me specifikime teknike, kerkese per artikujt, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me OE konkurrues dhe operatori i ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj).

-Me U/Shpenzimin nr.2132, datë 20.10.2022 është likujduar subjekti “XH” shpk me vlerën e kontratës **417,600 lekë me tvsh** për shpenzimin relalizuar me procedurë “vlerë e vogël”, bashkëlidhur së cilit janë dokumentat autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (urdhër prokurimi; ftesa për ofertë; njoftimi fituesit; preventivi artikujve; fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr.53, datë 24.12.2021; fletë hyrja e magazinës nr.79, datë 24.12.2021 për artikujt; Iban i OE dhe flete dalja nr.374 date 24.12.2021,). **Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2022 konstatohet se:

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2022) u konstatua se; Autoriteti Kontraktor (bashkia Kavajë) në cilësinë njësi shpenzuese publike vendore në **0** raste ka kryer shpenzime me fonde publike me objekt për; (blerje mall, punë dhe shërbime publike) me natyrë të njëjtë. Për periudhën objekt auditimi periudha raportuese AK ka realizuar gjithësej **52 blerje me vlerë fondi limit për 15,505,812 lekë, për të cilat edhe ka lidhur 52 kontrata me vlerë 12,291,674 lekë**, ku më hollësishtë procedurat e analizuara dhe të realizuara me “vlerë e vogël”, sipas urdhër prokurimeve sa më poshtë;

Me analizë të hollësishme për blerjet e realizuara me procedurë “Vlerë e vogël”, për secilin urdhër prokurimi, marrë me zgjedhje dhe urdhër shpenzim në periudhën raportuese ushtrimore (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2022), periudhë objekt auditimi në lidhje me dokumentacioni autorizues dhe vërtetues bashkëlidhur procedurës së prokurimit e urdhër shpenzimit në mënyrë kronologjike u konstatua sa më poshtë;

1-Me urdhër prokurimi nr.3, datë 07.02.2022, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 1,000,000 leke pa tvsh me objekt; “Blerje pajisje të ajrit të kondicionuar”. Me urdhërin e brendshëm nr.03/1 datë 05.01.2022 është ngritur KBVV i përbërë nga E.A, M.D dhe H.Si cili në datën 10.02.2022, ora 14:45 ka hapur procedurën ku kanë paraqitur interes me pjesmarrje gjithsej **31 OE** konkurrues, ndërsa në procesverbalin datë 10.02.2022 ka kualifikuar 22 OE konkurrues, ndërsa ka skualifikuar 9 OE nga keta 6 OE me argumentimin per mosperputhje objekti QKB me objektin e prokurimit, 1 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit dhe 2 OE me argumentin se eshte ulur me shume se 50% e fondit limit ndërsa ka shpall fitues ofertën e radhitur II (i dyti) me vleren me te vogel, nga KBVV është shpall fituese oferta e mbetur në renditje në vend të parë nga OE “S” shpk me NIPT K.....L me vlerë oferte prej 852,000 lekë pa tvsh. Në dokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (urdhër prokurimi, preventivi përlllogaritjes së vlerës limit, formulari deklarimit të konfliktit të interesit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me OE konkurrues dhe operatori i ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj). Kjo blerje është likujduar me anë të urdhër-shpenzimit nr.1695 datë 26.08.2022, bazuar në faturën tatimore nr.131/2022 date 15.02.2022, në vlerën 327,400 (treqind e njëzet e shtatë mijë) lekë me TVSH, dhe fletë-hyrjes nr.03 datë 15.02.2022. **Mungon procedura e komisionit të marrjes në dorëzim.**

2-Me urdhër prokurimi nr.43, datë 28.09.2022, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 823,000 leke pa tvsh me objekt; “Blerje hekur, cemento dhe materiale te tjera”. Me urdhërin e brendshëm nr.03/1, datë 05.01.2022 është ngritur KBVV i përbërë nga E.A, M.D dhe H.Si cili në datën 03.10.2022, ora 13.00 ka hapur procedurën ku kanë paraqitur interes me

pjesmarrje gjithsej **25 OE** konkurrues, ndërsa në procesverbalin datë 03.10.2022 ka kualifikuar ka kualifikuar 13 OE konkurrues, ndërsa ka skualifikuar 12 OE nga keta, 10 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit dhe 2 OE me argumentin për shkak të mosparaqitjes në procedura të mëparshme pa justifikim, ndërsa ka shpall fitues ofertën e radhitur 5 (e pesta) me argumentin se; 4 OE nuk janë paraqitur për lidhje të kontratës dhe klasifikimi përfundimtar është deklaruar në SPE, ku për të gjithë OE konkurrues të cilët janë tërhequr nga lidhja e kontratës, nga KBVV rast pas rasti janë pasqyruar me procesverbal cdo fazë ku konkretisht “D”shpk ” i renditur i I është tërhequr nga procedura, “O.H” i renditur i II është tërhequr nga procedura, “S.R” i renditur i III nuk është paraqitur brenda afatit të caktuar dhe “S.XH” i renditur i IV është tërhequr nga procedura dhe në përfundim me procesverbalin datë 12.10.2022 është shpall fituese oferta e V (e pestë) e mbetur në renditje në vend të parë nga OE “B”shpk me NIPT M.....U me vlerë oferte prej 788,800 lekë pa tvsh. Në dokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (urdhër prokurimi, kërkesa për mallrat, preventivi përlllogaritjes së vlerës limit, formulari deklarimit të konfliktit të interesit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, procesverbalet e kalimit të OE, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me OE konkurrues dhe operatori i ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj). Kjo blerje është likuaduar me anë të 2Urdhër Shpenzime ku I) urdhër-shpenzimi nr.2646 datë 28.12.2022, bazuar në faturën tatimore nr.87/2022 date 24.10.2022, në vlerën 473,280(katërqind e shtatëdhjetë e tremijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë me TVSH, dhe fletë-hyrjes nr.49 datë 24.10.2022 dhe II) urdhër-shpenzimi nr.424 datë 13.03.2023, bazuar në faturën tatimore nr.136/2022 date 30.12.2022, në vlerën 473,280 (katërqind e shtatëdhjetë e tremijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë me TVSH, dhe fletë-hyrjes nr.63 datë 30.12.2022. ***Mungon procedura e komisionit të marrjes në dorëzim.***

3-Me urdhër prokurimi nr.17, datë 04.04.2022, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 999,825 leke pa tvsh me objekt; “Blerje tonera dhe artikuj kancelarie”. Me urdhërin e brendshëm nr.03/1, datë 05.01.2022 është ngritur KBVV i përbërë nga E.A, M.D dhe H.S i cili në datën 06.04.2022, ora 11:15 ka hapur procedurën ku kanë paraqitur interes me pjesmarrje gjithsej 26 OE konkurrues, ndërsa në procesverbalin datë 20.12.2021 ka kualifikuar ka kualifikuar 25 OE konkurrues, ndërsa ka skualifikuar 1 OE me argumentin se është ulur me shume se 50% e fondit limit, ndërsa ka shpall fitues ofertën e radhitur 4 (e katërta) me argumentin se; 3OE nuk janë paraqitur për lidhje të kontratës dhe klasifikimi përfundimtar është deklaruar në SPE, ku për të gjithë OE konkurrues të cilët janë tërhequr nga lidhja e kontratës, nga KBVV rast pas rasti janë pasqyruar me procesverbal cdo fazë ku konkretisht “M.M”shpk ” i renditur i I është tërhequr nga procedura, “P.O” i renditur i II nuk është paraqitur brenda afatit të caktuar, “E” i renditur i III nuk ka paraqitur të gjitha mostrat sipas ftesës për ofertë duke bërë të pamundur vlerësimin e të gjithë artikujve dhe në përfundim me procesverbalin datë 11.04.2022 është shpall fituese oferta e IV (e katërta) e mbetur në renditje në vend të parë nga “Librari Dyrrahu”shpk me NIPT L.....J me vlerë oferte prej 777,777 lekë pa tvsh. Në dokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (urdhër prokurimi, kërkesa për shërbimet, preventivi përlllogaritjes së vlerës limit, formulari deklarimit të konfliktit të interesit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me OE konkurrues dhe operatori i ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj). Kjo blerje është likuaduar me anë të urdhër-shpenzimit nr.1256 datë 27.06.2022, bazuar në faturën tatimore nr.120/2022 date 14.04.2022, në vlerën 933,333 (nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë me TVSH, fletë-hyrjes nr.18 datë 14.04.2022. **Mungon procedura e komisionit të marrjes në dorëzim.**

4-Me urdhër prokurimi nr.57, datë 01.12.2022, është kryer procedura blerje me “vlerë e vogël” me fond limit 43,500 leke pa tvsh me objekt; “Blerje Letër A4”. Me urdhërin e brendshëm nr.

03/1, datë 05.01.2022 është ngritur KBVV i përbërë nga E.A, M.D dhe H.Si cili në datën 07.12.2020, ora 15:15 ka hapur procedurën ku kanë paraqitur interes me pjesmarrje gjithsej 21 OE konkurrues, ndërsa në procesverbalin datë 07.12.2022 ka kualifikuar 11 OE konkurrues, ndërsa ka skualifikuar 10 OE me argumentin se kanë ofertuar mbi fondin limit, ndërsa ka shpall fitues ofertën e radhës 2 (i dyti) me argumentin se; OE nuk janë paraqitur për lidhje të kontratës dhe klasifikimi përfundimtar është deklaruar në SPE, ku për të gjithë OE konkurrues të cilët janë tërhequr nga lidhja e kontratës, nga KBVV rast pas rasti janë pasqyruar me procesverbal cdo fazë ku konkretisht “O.C ” i renditur i I nuk është paraqitur brenda afatit të caktuar, dhe në përfundim me procesverbalin datë 19.12.2021 është shpallur fituese oferta e e mbetur në renditje në vend të 2 nga OE “L.D”shpk me NIPT L.....J me vlerë oferte prej 36,666 lekë pa tvsh. Në dokumentat vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (urdhër prokurimi, preventivi përlllogaritjes së vlerës limit, formulari deklarimit të konfliktit të interesit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, procesverbali me OE konkurrues dhe operatori i ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj). Kjo blerje nuk është likuaduar, bazuar në faturën tatimore nr.403/2022 date 20.12.2023, në vlerën 43,999.2 (dyzet e tremijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pike 2) lekë me TVSH, fletë-hyrje nr.60 datë 20.12.2022. Mungon procedura e komisionit të marrjes në dorëzim.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i kërkesave ligjore mbi marrjen në dorëzim të mallrave.

Situata: Në përfundim të procesit të auditimit në lidhje me 9 procedurat e prokurimit të marra me zgjedhje, dhe të realizuara me “vlerë e vogël” u konstatua se; Në të gjitha rastet e blerjeve mall, shërbime e punë publike, me OE i shpallur fitues, është lidhur kontrata e shërbimit dhe blerjes me afate dhe kushte të realizimit ndërsa në rastet për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është ngritur komision nga titullari dhe o në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar.

Kriteri: Veprime në mospërputhje me Pikën 42, 43, 52, 53, 54 të UMF 30 datë 27.11.20212 ku qartësishtë citohet se; Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara per sasinë, cilësinë, llojin, plotesine e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushes sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës in me përgjegjësi material.

Veprimet që kryejnë strukturat e Nepunesit Zbatues:

52. *Strukturat e Nepunesit Zbatues para marrjes në dorezim të dokumentave nga personat me përgjegjësi materiale, kryejne kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.*

53. *Kontrollohet numri rendor i dokumentit, si për flete hyrje dhe flete dalje, të cilat duhet tëndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jo kronologjike, nepunesi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon cdo parregullsi.*

54. *Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse per financat duhet të kontrollojnë në se flete hyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës qe verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve te kontrates si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.*

Ndikimi/efekti: Ka rritur nivelin e riskut të keqpërdorimit kundrejt humbjeve apo abuzimeve të mundshme me mallrat e blera me fonde publike.

Shkaku: Mos ngritja e komisioneve për marrjen e mallrave në dorëzim.

Rëndësia: E Lartë

Për këtë rekomandojmë: Titullari i njesise vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për cdo rast urdherin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqerues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të përgjegjës material.

Megjithatë në këto procedura prokurimi të realizuara për; Bashkinë Kavaje (*blerje, punë e shërbime*) me “*vlerë e vogël*” në këtë periudhë raportuese u konstatua se;

Vlera e fondit të prokuruar sipas urdhër prokurimit, nuk ka qenë mbi 1,000,000 lekë pa tvsh, pra mbi kufirin monetar, ndërsa kërkesa për prokurim në të gjitha rastet është miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK, si është përcaktuar në ligj.

Sa më sipër për mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi:

1-R.K me detyrë Kryetar Bashkie

2- A.T me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike (Nëpunës Zbatues).

2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në Bashkinë Kavajë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, është përzgjedhur për auditim në bazë të vlerës së kontratës objekti:

Nr	Objekti	Vlera e kontrates	Kontraktori
1	“Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.L””	116,413,160	BOE “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK
2	“Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””	150,717,562	BOE “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK
3	“Rikualifikimi i qendrës Kulturore “A.M	41,046,891	BOE “D” & “Z” SHPK
4	“Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”	23,275,216	OE “B” ShPK

1. “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, Bashkia Kavajë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Kryetari z. R.K dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B” & “E.S” SHPK & “P”, me përfaqësues ligjorë respektivisht z. Bashkim Dulla me licencë profesionale NZ 5433/16, z. G.B, me licencë profesionale NZ 7327/2 dhe SH.D me licencë profesionale NZ 6804. Vlera e kontratës është 116,413,160 lekë. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7 muaj, nga data e fillimit të punimeve. Pas kërkesës së sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të moslirimit të sheshit, është hartuar Amendamenti nr. 1, me nr. 646/5 prot., datë 14.10.2021, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve deri në datën 20.12.2022 (375 ditë).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 812/4, datë 10.05.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “I” SHPK, me përfaqësues znj. F.V, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 6130/10 & “A” ShPK me përfaqësues znj. I.M dhe nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 6423/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 956,148 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 32/1 prot., datë 04.07.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “S” SHPK, me administrator z. E.L, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3728 & “M” ShPK me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 146,860 lekë me tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 12.07.2022.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 13.07.2022, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesi i paautorizuar i investitorit z. A.M me profesion jurist dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. R.K Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar kapitulli “Marrja ne dorezim e aktiveve të furnizuara” pika 41, 42, sipas të cilave “42. Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.

43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushes sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm.....”.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 3131, datë 27.07.2021 të Bashkisë Kavajë është miratuar leja e ndërtimit të objektit. Është bërë shtesë palestere me dy kate, me sipërfaqe rreth 176 m², për të cilën nuk është azhurnuar leja e ndërtimit. Ky mosveprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Kavajë z. R.K, mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga Drejtoria e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja të Bashkisë Kavajë në vitin 2021. Nga shqyrtimi i projektit të zbatimit të administruar në dosjen teknike, rezulton se ky projekt është i paplotë, pasi mungojnë prerjet e objektit, projekti elektrik, projekti hidraulik, projekti i MNZ, detaje të sistemimit të oborrit., etj., të cilat në situacionin e objektit rezultojnë të kenë vlera të konsiderueshme. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi grupi i projektimit i përbërë nga E.H, G.T, L.H dhe I.C.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe

disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Kavajë, z. R.K

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se shumë zëra pune, kryesisht “FV hekurbetoni” dhe “Konstruksione metalike” nuk janë të detajuara ose mungojnë në librin e masave. Në projektin e zbatimit nuk rezultojnë të jetë trajtuar konstruksioni metalik i mbulesës së palestrës, nga ku lë vend për vendosjen e paargumentuar të sasisë së këtij zëri pune (e preventivuar 25 ton dhe e situacionuar 16.61 ton).

Po kështu, rezultojnë të ketë shifra të fryra dhe të pajustificueshme në preventivin e këtij objekti në sipërfaqen e çatisë, shtresë pllakash, shtresë parketi, FV hekurbetoni, mbulim çatie me panele, etj., si dhe specifikime “luksi” për detaje arkitektonike si, veshje e murit të jashtëm dhe xokolit me pllaka guri (rreth 5 mln lekë) dhe shtrimi i oborrit me pllaka graniti (rreth 11 mln lekë).

Nga verifikimi edhe në terren të objektit, rezultojnë se në këtë shkollë funksionojnë vetëm 6 klasa fizike nga 15 klasa që kishte gjithë shkolla, për 80 nxënës gjithsej.

Nga sa sipër, nisur edhe nga ndryshimet e bëra në fazën e zbatimit, projektpreventivi i këtij objekti është i paplotë, me mangësi të theksuara dhe me vlerë joreale dhe ngarkon me përgjegjësi grupin e projektimit.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultojnë se punimet kanë nisur me datë 10.05.2021 dhe kanë përfunduar me datë 12.06.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

-Me shkresën nr. 646/3 prot., datë 07.10.2021, nga ana e Investitorit Bashkia Kavajë, është kërkuar përmirësimi i projektit nga Mbikëqyrësi i punimeve. procesverbalin datë 01.11.2021 sipërmarrësi i punimeve “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve shoqërisë BOE “I” SHPK & “A” SHPK dhe titullari i Bashkisë Kavajë, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për rishikimin e volumeve të punimeve”, i cili është miratuar nga AK, me punime që shtohen prej 36,725,401 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 36,865,326 lekë pa TVSH, duke u përdorur fondi rezervë prej 5,337,580 lekë pa TVSH. Janë negociuar 6 zëra të rinj pune.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, Bashkia Kavajë		
14. Lidhja e kontratës Nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 116,413,160 lekë BOE fitues “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK	16. Likuiduar deri dt 02.09.2022 shuma 116,179,865
17- Situacioni Përfundimtar Vlera pa tvsh 116,138,694 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 7 muaj, Zbatuar 375 ditë. Fillimi punimeve: 10.05.2021	19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr. 1, me nr. 646/5 prot., datë 14.10.2021

	Perfundimi punimeve : 12.06.2022		shtyrja 165 ditë.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "I" SHPK "A" SHPK	Licenca Nr: MK 6130/10 MK. 6423/8	Kontrata nr. 812/4, datë 10.05.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve BOE ""S" SHPK & "M"" SHPK	Licenca Nr: MK 3728 & MK. 3119/8	Kontrata nr. 32/1 prot., datë 04.07.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 12.07.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim dt 13.07.2022		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,579,457 lekë pa tvsh**.

Zërat e punës P-21 dhe P-22, respektivisht "FV hekur me diametër 6-10 mm" dhe "FV hekur me d>12 mm" me vlerë totale 3,046,176 lekë (1,449,387 + 1,596,789), nuk janë pasqyruar në librezën e masave të administruar në dosje dhe rezultojnë me vlerë 0 lekë në librin e masave të ardhur në formatin elektronik (excel)

Zëri i punës Q4 "FV hekur me diametër 6-10 mm për murin rrethues" me vlerë totale 1,564,267 lekë, janë pasqyruar në librezën e masave në mënyrë të padetajuar (me nga një shifër të vetme, për çdo segment të murit, pa patur një projekt konstruktiv të murit rrethues.

Zërat e punës T-12.8 dhe T-12.9, respektivisht "FV hekur me diametër 6-10 mm" dhe "FV hekur me d>12 mm" me vlerë totale 3,820,140 lekë (720,734 + 3,099,406), janë pasqyruar në librezën e masave të administruar në dosje dhe të detajuara në librin e masave të ardhur në formatin elektronik (excel), por nuk ka asnjë projekt mbi të cilin të mund të vlerësojmë saktësinë e këtij volumi.

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "R.C""", Bashkia Kavajë, nga zbatuesi i punimeve BOE "E.S" SHPK & "P" & "B" SHPK, për zërat e punimeve N.4, 9, 26, 27, P.45, Q.7, S.1, 2, 5, 6, T.2.1, T.4.11, T.5.2, etj.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "FV zgara hekuri me figuracin mesatar Shtresë betoni C 12/15", "Shtresë lustër çimento 1:2", "Suva xokoli me granil e çimento të bardhë (suvatim i murit rrethues)", "FV veshje terreneve me tartan përfshirë vijëzimet", "Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil+rjetë+grafiato", etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave anë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 812/4, datë 10.05.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 32/1 prot., datë 04.07.2022.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kavajë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,579,457 lekë pa tvsh nga BOE “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021 me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, *Bashkia Kavajë*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 2,579,457 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. F.V, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E.L, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 7/10/1, datë 10.07.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 207/9 prot, datë 11.07.2023, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve “I” ShPK, si më poshtë:

1. Zëri 4. Pusetë b/a shiu 40 x 40 h=100 cm, me kapak gize.

Pretendimi i Subjektit

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar pesetë b/a shiu 40x40 h=100 cm me kapak gize. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë dhe proces verbalin e mbajtur, bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe numri i pusetave b/a shiu 40x40 h=100 cm me kapak gize është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje.

Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi te gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.

Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune, në prani të përfaqësuesit të mbikëqyrësit. Bashkelidhur procesverbalit, nuk gjendet asnjë foto që ka të bëjë me këtë zë pune. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. Zëri 45. FV rrjetë nailoni 10 x 10 mm (palestra).

Pretendimi i Subjektit

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar për rrjeta najlonit 10x10cm. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë dhe proces verbalin e mbajtur, bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe rrjeta e duhur është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje.


Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi te gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.



Foto e rrjetave te najlonit te depozituara ne ambientet e shkollës.

Foto e rrjetave te najlonit te depozituara ne ambientet e shkollës.



Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të punimeve të kryera. Grupi i auditimit po njihet me fotot e bëra (por jo gjatë kryerjes së punimeve), por në procesverbalin e mbajtur duhet bërë konfirmimi i kryerjes së këtyre punimeve, në rrugë shkresore nga Bashkia Kavajë (grup pune/person i caktuar me urdhër, procesverbal i vulosur, etj.). Sa sipër, ky pretendim merret në konsideratë, me rezervë. Grupi i auditimit do ti rekomandojë Bashkisë Kavajë ndjekjen e kryerjes së këtij zëri pune.

3. Zëri 7. Suva xokoli me granil e çimento të bardhë (suvatim i murit rrethues).

Pretendimi i Subjektit

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar për punimet, suva xokoli me granil e çimento të badhe (suvatim i murit rrethues) , punimet janë realizuara përpara punimeve per veshje me pllaka , sipas projektit të miratuar.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren nga ku rezultoi se muri për të cilin është llogaritur ky zë pune, është i veshur me pllaka dhe realizimi i suvasë me çimento të bardhë, është i pakuptimtë dhe i paargumentuar teknikisht. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

4. Zëri 1. FV veshje terreneve me tartan përfshirë vijëzimet.

Pretendimi i Subjektit

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar veshje terrene sportive me tartan përfshire dhe vijëzimet. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë dhe proces verbalin e mbajtur, bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe shtresa me tartan e munguar ne pisten e vrapimit është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje.

Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi te gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune. Bashkelidhur procesverbalit, nuk gjendet asnjë foto që ka të bëjë me këtë zë pune. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

5. Zëri 2. Strukturë monolite betoni C 25/30.

Pretendimi i Subjektit

Ky konstatim nuk qendron. Në fakt, sasia e volumit të llogaritur në librezën e masave rezulton e saktë.

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

6. Zëri 5. Rrethim fushe me rrjet gabioni.

Pretendimi i Subjektit

Ky konstatim nuk qendron. Në fakt, sasia e volumit të llogaritur në librezën e masave rezulton e saktë.

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

7. Zëri 6. FV rrjetë nailoni 10 x 10 mm (terrenet sportive të jashtme).

Pretendimi i Subjektit

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar për rrjeta nailonit 10x10cm. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë dhe proces verbalin e mbajtur, bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe rrjeta e duhur është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje.

Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi të gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të punimeve të kryera. Grupi i auditimit po njihet me fotot e bëra (por jo gjatë kryerjes së punimeve), por në procesverbalin e mbajtur duhet bërë konfirmimi i kryerjes së këtyre punimeve, në rrugë shkresore nga Bashkia Kavajë (grup pune/person i caktuar me urdhër, procesverbal i vulosur, etj.). Sa sipër, ky pretendim merret në konsideratë, me rezervë. Grupi i auditimit do të rekomandojë Bashkisë Kavajë ndjekjen e kryerjes së këtij zëri pune.

8. Zëri 2.1. Mur tulle të lehtësuara dopio deri në 3 m me ll.p. M-15 (shtesa e palestrës).

Pretendimi i Subjektit

Ky konstatim nuk qendron. Në fakt, sasia e volumit të llogaritur në librezën e masave rezulton e saktë.

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

9. Zëri 4.11. Shtresë parketi.

Pretendimi i Subjektit

Ky konstatim nuk qendron. Në fakt, sasia e volumit të llogaritur në librezën e masave rezulton e saktë.

Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

10. Zëri 5.2. Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil+rrjetë+grafiato.

Pretendimi i Subjektit

Ky konstatim nuk qendron. Në fakt, sasia e volumit të llogaritur në librezën e masave rezulton e saktë.

Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune. Ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. “Rikonstruktion i shkollës së mesme “A.M””, Bashkia Kavajë

Kontratata

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Kryetari z. R.K dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B” & “E.S” SHPK & “P”, me përfaqësues ligjorë respektivish z. B. D. me licencë profesionale NZ 5433/16, z. G.B, me licencë profesionale NZ 7327/2 dhe SH.D me licencë profesionale NZ 6804. Vlera e kontratës është 150,717,562 lekë. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 10 muaj, nga data e fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 810/4, datë 09.04.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “I” SHPK, me përfaqësues znj. F.V, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 6130/10 & “A” ShPK me përfaqësues znj. I.M dhe nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 6423/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,206,389 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 31/1 prot., datë 28.07.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “S” SHPK, me administrator z. E.L, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh M & “M” ShPK me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 181,377.21 lekë me tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 02.08.2022, ose 6 muaj pas përfundimit të objektit.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 03.08.2022 dhe certifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit nga Bashkia Kavajë me datë 09.02.2023, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesi i paautorizuar i investitorit z. A.M me profesion jurist dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. R.K Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndrshuar kapitulli “Marrja ne dorezim e aktiveve të furnizuara” pika 41, 42, sipas të cilave “42. *Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara per sasinë, cilësinë, llojin, plotesine e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues.*

43. *Komisioni përbëhet nga specialistë te fushes sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm.....”.*

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 3019, datë 07.05.2021 të Bashkisë Kavajë është miratuar Deklarata për kryerje punimesh në këtë objekt.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga Drejtoria e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja të Bashkisë Kavajë në vitin 2021. Në dosjen teknike nuk gjendet projekti i zbatimit.

Në dosjen teknike, administrohet shkresa e përcjelljes së Oponencës Teknike të projektzbatimit të këtij objekti me Nr. 458/2 prot., datë 22.03.2021, në të cilën është konkluduar që “Projekti duhet të plotësohet me konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna në këtë oponencë teknike, para zbatimit të punimeve”. Në dosjen teknike nuk administrohet asnjë dokument, ku të jetë reflektuar nga ana e Bashkisë Kavajë në lidhje me rekomandimin e dhënë nga Instituti i Ndërtimit.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 09.04.2021 dhe kanë përfunduar me datë 09.02.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

-Me procesverbalin datë 29.09.2021 sipërmarrësi i punimeve “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve shoqërisë “N. S.” Shpk dhe titullari i Bashkisë Kavajë, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për rishikimin e volumeve të punimeve”, i cili është miratuar nga AK, me punime që shtohen prej 23,030,228 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 16,022,109 lekë pa TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën 7,008,120 lekë pa TVSH. Janë negociuar dhe miratuar nga Investitori 5 zëra të rinj pune.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, Bashkia Kavajë				
14.Lidhja e kontratës Nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 150,717,562 lekë BOE fitues “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK		16.Likuiduar deri dt 30.08.2022 shuma 150,573,991 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera pa tvsh 150,548,655 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 10 muaj, Zbatuar 304 ditë. Fillimi punimeve: 09.04.2021 Perfundimi punimeve : 09.02.2022		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “I” SHPK “A” SHPK	Licenca Nr: MK 6130/10 MK. 6423/8	Kontrata nr. 810/4, datë 09.04.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve BOE “S” SHPK & “M” SHPK	Licenca Nr: MK 3728 & MK. 3119/8	Kontrata nr. 31/1 prot., datë 28.07.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 02.08.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 03.08.2022		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje

me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,933,868 lekë pa tvsh**.

Zëri i punës 4.11, “FV hekur me $d > 12$ mm” me vlerë totale 839,366 lekë, është pasqyruar në librezën e masave të administruar në dosje i padetajuar dhe nuk na jep mundësinë për tu shprehur për saktësinë e këtij volumi.

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, Bashkia Kavajë, nga zbatuesi i punimeve BOE “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK, për zërat e punimeve 3.I.6, 3.II.1, 2, 3, 5, 4.20, 7.6, 7, 9.8, 9, 13, 15, 12.6 dhe 13.15.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Veshje fasade me pllaka grez porcelanato”, “Fasadë e ventiluar me veshje listela druri tip “Louvre” me dimensione 4 x 220 cm”, “Galvanizim i konstruksioneve metalike (shkallët e emergjencës)”, “Brez b/a C 16/20, h-8”, “Shtresë binderi me granil gurë kave 6 cm”, “Veshje terrene sportive me tartan, përfshi vijëzimet”, “FV Rrjetë najloni 10 x 10 për mbulesë fushe+aksesorë”, “FV Rrjetë najloni 10 x 10 për palestrës” etj., për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 810/4, datë 09.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 31/1 prot., datë 28.07.2022.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kavajë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,933,868 lekë pa tvsh nga BOE “E.S” SHPK & “P” & “B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021 me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M”, Bashkia Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 2,933,868 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. F.V, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E.L, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 15/01, datë 15.05.2023, e protokolluar në KLSH me nr. 207/5 prot, datë 18.05.2023, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve "I" ShPK, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

1. Zëri 2. Veshje fasade me pllakë gres porcelanato teksturë druri.

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar për veshjen e fasadës me pllakë gres porcelanato teksturë druri. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe pllaka e duhur është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje. Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi te gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.



Opinionimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të këtij zëri pune, ku rezultoi se dhoma polivalente në krahun perëndimor, nuk është veshur me këtë pllakë. Grupi i auditimit po njihet me fotot e bëra (por jo gjatë kryerjes së punimeve), por

për realizimin e këtij zëri pune duhet bërë konfirmimi në rrugë shkresore nga Bashkia Kavajë (grup pune/person i caktuar me urdhër, procesverbal i vulosur, etj.). Sa sipër, ky pretendim merret në konsideratë, me rezervë. Grupi i auditimit do ti rekomandojë Bashkisë Kavajë ndjekjen e kryerjes së këtij zëri pune.

2. Zëri 8. Shtresë binderi me granil gurë kave 6 cm..

Pretendimi i Subjektit

Ky konstatim është pjesërisht i saktë pasi volumi punimeve të realizuara është "Fusha e basketbollit me dimensione 29,71 m x 17,64 m = 524,08 m². Vlera e punimeve të realizuara me Shtresë binderi me granil gurë kave 6 cm, është 524,08 m² x 1.664 lek/m² = 872.069,12 lekë. Pra diferenca nga vlera e zërit të punimeve me shtresë binderi me granil gurë kave 6 cm është 1,657,146 lekë - 872.069,12 lekë = 785.076,88 lekë.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, merr në konsideratë argumentin dhe do të bëjë reflektimin në tabelën e dëmit ekonomik.

3. Zëri 9. Veshje terrene sportive me tartan, përfshi vijëzimet.

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar veshje terrene sportive me tartan përfshire dhe vijëzimet. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë dhe proces verbalin e mbajtur, bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe shtresa me tartan e munguar ne pisten e vrapimit është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje. Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi te gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të punimeve të kryera. Bashkëlidhur observacionit nuk ka as procesverbal, as foto mbi kryerjen e këtij zëri pune. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

4. Zëri 13. FV Rrjetë najloni 10 x 10 për mbulesë fushe+aksesorë.

Pretendimi i Subjektit

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar për rrjeta najlonit 10x10cm. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë dhe proces verbalin e mbajtur, bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe rrjeta e duhur është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Proces-verbalin e dorëzimit të rrjetës së najlonit 10 x 10 për palestrën dhe rrjetës së najlonit 10 x 10 për mbulesën e fusheve të objektit "Rikonstruksioni i shkollës së mesme Aleksander Moisiu", kanë nënshkruar të gjitha palët e përfshira në kontratë, edhe perfituesi.

Sipërmarrësit e Punimeve, BOE "E.S" shpk, "P" shpk dhe "B.B" shpk, , kanë bërë dorëzimin e rrjetës së najlonit 10 x 10 për palestrën dhe rrjetës së najlonit 10x10 për mbulesën e fusheve, në prani të paleve.

Mbikeqyrësi i Punimeve, përfaqësuar nga "I" shpk, , ka pranuar dorëzimin e rrjetës së najlonit 10x10 për palestrën dhe rrjetës së najlonit 10x10 për mbulesën e fusheve, duke konstatuar se materialet janë rivendosur në objekt në përputhje me specifikatën dhe standardet e kontratës.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kavajë, përfaqësuar nga Z. A.M dhe zonja B.G, drejtoreshë e shkollës "Aleksander Moisiu", kane pranuar dorëzimin e rrjetës së najlonit 10 x 10 për palestrën dhe rrjetës së najlonit 10 x 10 për mbulesën e fusheve, dhe kane vlerësuar këto materiale si elemente të domosdoshme për funksionimin e objektit të rikonstruktuar.

Proces-verbalin e dorëzimit e kanë nënshkruar të gjithë palët e përfshira në kontratë, si shenjë pranimit dhe pajtimit me vendimet e marra në lidhje me dorëzimin e rrjetës së najlonit 10 x 10 për palestrën dhe rrjetës së najlonit 10 x 10 për mbulesën e fusheve. Ky dokument se bashku me fotot i bashkëngjitet këtij observacioni.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje.

Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi te gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.



Foto e rrjetave te najlonit te depozituara ne ambientet e shkollës.

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të punimeve të kryera. Grupi i auditimit po njihet me fotot e bëra (por jo gjatë kryerjes së punimeve), por në procesverbalin e mbajtur duhet bërë konfirmimi i kryerjes së këtyre punimeve, në rrugë shkresore nga Bashkia Kavajë (grup pune/person i caktuar me urdhër, procesverbal i vulosur, etj.). Sa sipër, ky pretendim merret në konsideratë, me rezervë. Grupi i auditimit do ti rekomandojë Bashkisë Kavajë ndjekjen e kryerjes së këtij zëri pune.

5. Zëri 6. FV hekur betoni D 6-10 mm, zgarë hekuri.

Pretendimi i Subjektit

Ky konstatim rezulton pjeserisht i sakte pasi volumi punimeve të realizuara është 12.82 ton x 10% (gjatësi gjymtimi te shufrave te zgarës) = 1.28 ton, sasia totale punimeve te realizuara është 12.82 ton + 1.28 ton = 14.1 ton. Sasia totale punimeve të realizuara është 14.1 ton ose 1.42 ton më pak se sasia e situacionuar.

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, merr në konsideratë argumentin dhe do të bëjë reflektimin në tabelën e dëmit ekonomik në vlerën 160,683 lekë (1.42 x 113,157 lekë/ton).

6. Zëri 15. FV Rrjetë najloni 10 x 10 për palestrën.

Pretendimi i Subjektit

Ne dëshirojmë të theksojmë se kemi ndjekur plotësisht dokumentacionin e projektuar për rrjeta najlonit 10x10cm. Detyrat dhe mangësitë e konstatuara gjatë fazës së kontrollit janë identifikuar dhe raportuar menjëherë, sipërmarrësi i punimeve ka reaguar menjëherë për të adresuar dhe rregulluar çdo moskryerje.

Në fotografinë dhe proces verbalin e mbajtur, bashkëngjitur mund të shihni se puna në fjalë është rregulluar dhe rrjeta e duhur është vendosur në sasinë dhe vendin e munguar. Ky veprim

tregon përkushtimin dhe përgjegjësinë e sipërmarrësit të punimeve për të kryer punën në përputhje me kërkesat dhe standardet e kontratës.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se objekti ndodhet në fazën e garancisë dhe sipërmarrësi i punimeve vazhdon të kryejë rregullime të nevojshme për të adresuar çdo difekt apo moskryerje. Bazuar në të gjitha këto faktorë, ne rekomandojmë që të pranohet puna e kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe të konfirmohet se detyrat dhe mangësitë e konstatuara janë adresuar dhe rregulluar me sukses. Në rast se ka nevojë për inspektim shtesë ose dokumentacion të shtuar për të vërtetuar këtë, jemi të gatshëm të ofrojmë mbështetje dhe informacion shtesë.

Shpresojmë që puna e kryer të vlerësohet dhe pranohet në përputhje me standardet dhe specifikatën e kontratës.



Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e evidentuar në aktkonstatim, pas verifikimit në terren të punimeve të kryera. Grupi i auditimit po njihet me fotot e bëra (por jo gjatë kryerjes së punimeve), por në procesverbalin e mbajtur duhet bërë konfirmimi i kryerjes së këtyre punimeve, në rrugë shkresore nga Bashkia Kavajë (grup pune/person i caktuar me urdhër, procesverbal i vulosur, etj.). Sa sipër, ky pretendim merret në konsideratë, me rezervë. Grupi i auditimit do të rekomandojë Bashkisë Kavajë ndjekjen e kryerjes së këtij zëri pune.

3. “Rikualifikimi i Qendrës Kulturore “A.M”, Bashkia Kavajë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Kryetari z. R.K dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “D” & “Z” SHPK me përfaqësues ligjorë respektivish z. E.D me licencë profesionale NZ 6928/2 dhe z. D. S., me licencë profesionale NZ 5900/5. Vlera e kontratës është 41,046,891 lekë. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj nga data e

fillimit të punimeve. Pas kërkesave së sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të moslirimit të sheshit dhe pandemisë, është hartuar Amendamenti nr. 1, me nr. 507/5 prot., datë 03.09.2021, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve deri në datën 15.12.2021 (101 ditë) dhe Amendamenti nr. 2, me nr. 507/6 prot., datë 15.12.2022, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve deri në datën 31.01.2022 (46 ditë).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 12/1, datë 04.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “G” SHPK, me përfaqësues z. G.S, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 550,200 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 26/1 prot., datë 21.09.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “AS” SHPK, me administrator znj. K.C, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3678 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 66,000 lekë me tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 12.07.2022, ose 6 muaj pas përfundimit të objektit.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 13.07.2022, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesi i paautorizuar i investitorit z. A.M me profesion jurist dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. R.K Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndrshuar kapitulli “Marrja ne dorezim e aktiveve të furnizuara” pika 41, 42, sipas të cilave “42. *Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara per sasinë, cilësinë, llojin, plotesine e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues.*

43. *Komisioni përbëhet nga specialistë te fushes sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm.....”.*

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 3019, datë 07.05.2021 të Bashkisë Kavajë është miratuar deklarata për kryerje punimesht të objektit..

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga Drejtoria e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë z. R.K

Nga verifikimi i preventivit dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e zbatimit, rezulton se nuk ka specifikime teknike të plota për sistemet audio-video, të cilat në situacionin përfundimtar rezultojnë në vlerën 19,000,000 lekë. Në dosjen e prokurimit, administrohen të dhëna teknike për këtë kapitull (2 oferta për çmimin e tregut), të cilat janë në gjuhë të huaj, por nuk janë hedhur në sistem. Sa sipër ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e projektpreventivit.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 04.06.2021 dhe kanë përfunduar me datë 31.01.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

-Me shkresën nr. 646/3 prot., datë 07.10.2021, nga ana e Investitorit Bashkia Kavajë, është kërkuar përmirësim projekti nga Mbikëqyrësi i punimeve.procesverbalin datë 01.11.2021 sipërmarrësi i punimeve “D” & “Z” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve shoqërisë OE “G” SHPK dhe titullari i Bashkisë Kavajë, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për rishikimin e volumeve të punimeve”, i cili është miratuar

nga AK, me punime që shtohen prej 4,184,627 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 4,184,627 lekë pa TVSH. Janë negociuar 11 zëra të rinj pune.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikualifikimi i qendrës Kulturore "A.M", Bashkia Kavajë				
14. Lidhja e kontratës Nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 41,046,891 lekë BOE fitues "D" & "Z" SHPK		16. Likuiduar deri dt 07.04.2022 shuma 41,046,891	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera pa tvsh 41,046,891 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 muaj, Zbatuar 207 ditë. Fillimi punimeve: 04.06.2021 Përfundimi punimeve : 31.01.2022		19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr. 1, me nr. 507/5 prot., datë 03.09.2021 shtyrja 101 ditë. Amendamenti nr. 2, me nr. 507/6 prot., datë 15.12.2021 shtyrja 46 ditë.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE G" SHPK	Licenca Nr: MK 2928/8	Kontrata nr. 12/1, datë 04.06.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE "AS" SHPK	Licenca Nr: MK 3678	Kontrata nr. 26/1 prot., datë 21.09.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 12.07.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim dt 13.07.2022		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,179,291 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikualifikimi i qendrës Kulturore "A.M", Bashkia Kavajë, nga zbatuesi i punimeve BOE "D" & "Z" SHPK, për zërat e punimeve 1.5+6, 6.4 dhe 9.3.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Veshje fasade me pllakë terrakotë", "Veshje fasade me alukobond", "Suva e zakonshme fasade + suvatim grafiato" dhe "H/izolim me dy shtresa k/katrama", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 12/1, datë 04.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 26/1 prot., datë 21.09.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kavajë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,179,291 lekë pa tvsh nga BOE “D” & “Z” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021 me objekt “Rikualifikimi i Qendrës Kulturore “A.M”, Bashkia Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,179,291 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G.S, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. K.C, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4. “Vazhdim i punimeve për rikonstrukcionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë, të përfaqësuar nga Kryetari z. R.K dhe Operatorit Ekonomik “B” SHPK me përfaqësues ligjor z. B. B me licencë profesionale NZ 4319/7. Vlera e kontratës është 23,275,216 lekë. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 15 ditë nga data e fillimit të punimeve. Në dosje administrohen kërkesat e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 15 ditë, për shkak të motit me lagështi. Në dosje nuk administrohet Amendamenti për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 4075/1, datë 01.10.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “D” SHPK, me përfaqësues z. V.T, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1676/9 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 287,812 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 52/1 prot., datë 23.12.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE M.K PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1230/4 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 30,000 lekë me tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 29.12.2021, ose 1 vit pas përfundimit të objektit.

-Në dosjen teknike nuk administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet leje infrastrukturore.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 23.11.2020 dhe kanë përfunduar me datë 30.12.2020.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit,
2. Preventivi bazë,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë				
14. Lidhja e kontratës Nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 23,275,216 lekë OE fitues “B” SHPK		16. Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera pa tvsh 23,275,216 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 muaj, Zbatuar 207 ditë. Fillimi punimeve: 04.06.2021 Përfundimi punimeve : 31.01.2022		19. Zgjatja e kontratës Nuk administrohet	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE D” SHPK	Licenca Nr: MK 1676/9	Kontrata nr. 4075/1, datë 01.10.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve M.K PF	Licenca Nr: MK 1230/4	Kontrata nr. 52/1 prot., datë 23.12.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 29.12.2021	23. Akt i marrjes në dorëzim dt Nuk ka		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,914,240 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë, nga zbatuesi i punimeve OE “B” SHPK, për zërat e punimeve 1.1 dhe 2.12.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçe t=5 cm” dhe “Vijëzim shirita gjaësorë dhe anësorë me gjerësi 15 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4075/1, datë 01.10.2020.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 52/1 prot., datë 23.12.2021.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kavajë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,914,240 lekë pa tvsh nga OE “B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021 me objekt “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,914,240 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. V.T, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. M.K, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Këshilli Kombëtar i Territorit në përputhje me ligjin nr. 107/2017, datë 31.07.2014 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Bashkia Kavajë me Vendim të Këshillit të Bashkisë me Vendim nr.150, datë 29.12.2016 te Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT-së). Ky Plan mbulon Territorin e Bashkisë Kavajë, ku përfshihen pesë Njësi Administrative. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë së bashku me tarifat që aplikohen në aplikimet që kryhen në sistemin e-leje, janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, në paketën fiskale vjetore.

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Kavajë ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së Nr.408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në Nr.271 Datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në Nr. 408 Datë 13.05.2015”.

Titulli i Gjetjes 1:	Lartësia e katit përdhe është më e madhe se ajo e lejuar në planin e përgjithshëm vendor.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat: - “Leja me nr.prot 4174 me ZHVILLUESIT: BONITA KONSTRUKSION “Strukturë Turistike 5 Kat, me 2 Kate Nëntokë dhe Ambiente Teknike ” , me vendndodhje në GOLEM, Bashkinë Kavajë. -Leja me nr.prot 3828 ZHVILLUESIT: L I LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATESHE +AMBJENTE TEKNIKE DHE 1 KAT NENTOKE PARKIM ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë. -3.3601 leja e ndërtimit 3601 zhvilluesi I.D, STRUKTURE AKOMODUESE DHE AMBJENTE SHERBIMI 5 KATE ME 1 KAT NENTOKE ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë” lartësia e katit përdhe në projektin e miratuar është më madhe se lartësia e lejuar në planin e përgjithshëm vendor.

Kriteri:	Rregullorja e planit të përgjithshëm vendor, neni 19, pika 3 ku citohet se “Lartësia e katit përdhe në cdo rast nuk duhet të kalojë lartësinë 5m nga kuota e sistemimit. Në këtë lartësi përfshihet edhe diferenca e kuotës 0.00 me kuotën e sistemimit.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me planin e përgjithshëm vendor sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

R.Kme detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

D.Q me detyrë drejtor i DPZHTK bashkia Kavajë

S.VU me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

Projektuesi: D.S

Lidhur me gjetjet në drejtimin e auditimit “Për planifikimin e territorit”, me shkresën nr. 955/23, datë 05.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 207/8 prot., datë 10.07.2023, është observuar nga personat përgjegjës për Planifikimin e Territorit, si më poshtë:

Pretendimi e subjektit të audituar.

Sqarojmë se lartësia sipas sipas nenit 37 të VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” pika c kucitohet specififikisht:

-pika 3, germa c

-kati përdhe në rast se kur shfrytëzohet për qëllim shërbim lartësia minimale dysheme -dysheme është 5 m e në rastin konkret struktura është me funksion hoteleri dhe kati përdhe është në funksion të turizmit kjo për gjithë arsyet e rritjes së standarteve të hotelierive europiane. Arsyja që lartësia e katit shërbim duhet të jetë mbi 5m e kjo është arsyeja që lartësia 5.6 është e mbështetur dhe në VKM 408 date 13.05.2015 dhe ne standartet e zhvillimit të turizmit lartësia 5.6 m është e mbështetur në bazën ligjore të cituar më sipër. Ky konstatim i cituar nga ana juaj është dërguar dhe për korrigjim në rishikimin e PPV i cili është miratuar më vendim të KKT me nr.4 date 25.04.2023 pasi nuk përputhet Rregullorja e PPV të Bashkisë Kavajë me VKM 408 date 13.05.2015 dhe me standartet e zhvillimit të hotelierisë e turizmit në përgjithësi.

Vërtet në PPV është e specifikuar që në nenin 19 të rregullores së PPV është cituar lartësia e katit jo më e madhe se 5 m nga kuota e sistemuar por nuk e parashikon apo specifikon që për strukturat akomoduese në funksion të turizmit lartësia 4 m (kjo ngaqë 1 m nga kuota e sistemuar është e lejuar në rregulloren e zhvillimit të territorit) sic e përcakton rregullorja është e pamundur të kryejë funksionin si kat shërbim (restorant apo recepsion etj). Mendojmë se duhet të merret në konsideratë si arsyetim por dhe nga Bashkia duhet të kërkohet në rishikimin e PPV ky problem ndëmrjet Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së zhvillimit të Territorit.

Opinion i grupi të auditimit.

Grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë këtë koment pasi miratimi i lejeve të ndërtimit duhet të bazohet mbi planin e përgjithshëm vendor. Pretendimi juaj merret në konsideratë nëse plani i përgjithshëm vendor do të ishte rishikuar sic citoni edhe më sipër.

Titulli i Gjetjes 2:	Numri i kateve për lejet e ndërtimit të miratuara është më i madh se numri i kateve të lejuar sipas planit të përgjithshëm vendor.
Situata:	<p>Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:-</p> <p>-“Leja me nr.prot 4174 me ZHVILLUESIT: B. KONSTRUKSION “Strukturë Turistike 5 Kat, me 2 Kate Nëntokë dhe Ambiente Teknike ” , me vendndodhje në GOLEM, Bashkinë Kavajë.</p> <p>-Leja me nr.prot 3828 ZHVILLUESIT: L I LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATESHE +AMBJENTE TEKNIKE DHE 1 KAT NENTOKE PARKIM ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë</p> <p>-Leja 3827 ZHVILLUESIT: Shoqëria ABLEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: Objekt Banimi, 6 Kat (Kati përdhe Apartamente + Dyqane) + 1 kat Nëntokë ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë</p> <p>- leja me nr.prot 3298 ZHVILLUESIT: E-2021 JA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURA SHERBIMI AKOMODUESE DHE HOTELERI 1,2,3,4 KATE KU KATI PERDHE DUPEKS+1 KAT NENTOKE</p> <p>-Leja me nr.prot 3045 ZHVILLUES : B.BNE PRONE : TE B/PRONAREVE GJ. OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIMI ME 8 KATE MBI TOKË, 2 KATE PARKIM NËNTOKË” (FAZA 1) : Qerret , Kavajë.</p> <p>-Leja më nr 3936 ZHVILLUESIT: LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “Strukturë Turistike 8 Kat, me 3 Kate Nëntokë” ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Kryemëdhenj , Njësia Administrative Golem , Kavajë” u konstatua se lejet e ndërtimit të miratuara më sipër janë në mospërputhje me planin e përgjithshëm vendor konkretisht me numrin e lejuar të kateve ose numrin maksimal.</p>
Kriteri:	Rregullorja e planit të përgjithshëm vendor,numri i lejuar i kateve sipas njësive strukturore përkatëse.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me planin e përgjithshëm vendor sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajn përgjegjësi:

R.K me detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

S.V me detyrë drejtor i DPZHTK bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

A.H me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

Projektues:E.XH

Projektues: DS

Projektues: F
Projektues: A.S

Pretendimi e subjektit të audituar.

Subjekti pretendon se është respektuar plani I përgjithshëm vendor konkretisht numri i lejuari kateve të lejuara sipas njësive strukturore përkatsë dhe në rastet kur kemi ambiente teknike apo projekti teknik nga prerjet duket të jetë në përputhje më planin e përgjithshëm vendor apo projekti i mirtuar nga KKT.

Për sa sipër sqarohet se lartësia e objekteve të miratuar është 5 kate apo 6 kate dhe 1 kat nentoke apo 2 kate nëntokë dhe ku në kafazin e shkallëve është parashikuar ambiente teknike në lartësi 2.5 m për të vendosur të gjithë sistemet e aparaturave dhe të sigurimit teknik apo të vendosjes së fotovoltaike me sipërfaqe prej 25 % të soletes kjo e mbështetur në rregulloren e PPV të Bashkisë Kavajë neni 20, pika 3 citohet si më poshtë: Këto struktura teknike nuk duhet të kalojnë përmasat minimale të nevojshme për funksionimin e tyre dhe duhet të jenë të grupuara. Për strukturat teknike lejohet një lartësi totale shtesë prej 2,5 metrash me kusht që këto të mos zënë më shumë se 25% të sipërfaqes së katit të objektit, për sa sipër sqarohet se kemi zbatuar bazen ligjore në fuqi. Kjo domosdoshmëri dhe për shkak të ligjit Nr.124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” (ndryshuar me ligjin nr.5/2019, datë 7.2.2019)

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë koment pasi për rastet e mësipërme është konkluduar bazuar mbi projektet e miratuara. Për lejet të cilat leja e zhvillimit është miratuar nga KKT dhe leja e ndërtimit nga DPZHTK bashkia Kavajë bazuar mbi shkresën e delegimit e kompetencave citohet se leja e ndërtimit duhet të jetë konform ligjit 107/2014 dhe VKM nr. 408 dhe Planit të Përgjithshëm Vendor.

Referuar observacionit, sqarohet se rastet për të cilat bëhet fjalë janë kate normale dhe jo ambiente teknike.

Titulli i Gjetjes 3:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se nuk është respektuar distanca nga kufiri i pronës.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- -Leja me nr.prot 3828 ZHVILLUESIT: L I LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATESHE +AMBJENTE TEKNIKE DHE 1 KAT NENTOKE PARKIM ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë -Leja me nr.prot 3298 ZHVILLUESIT: E JA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURA SHERBIMI AKOMODUESE DHE HOTELERI 1,2,3,4 KATE KU KATI PERDHE DUPEKS+1 KAT NENTOKE -Leja me nr.3176 ZHVILLUESIT: E.B, STRUKTURE TURISTIKE 5 KATE ME 1 KAT NENTOKE ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Mali I Robit ,Kavajë. -Leja me nr.prot 3045 ZHVILLUESIT: B PRONE : TE B/PRONAREVE GJ. OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIMI ME 8 KATE MBI TOKË, 2 KATE PARKIM NËNTOKË” (FAZA 1) : Qerret , Kavajë. -Leja me nr.3266 ZHVILLUESIT: Shpk STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATE + 1 KAT SHERBIME+ 1 KAT NENTOKE DHE SISTEMIM KANALI Njësia Administrative Golem , Kavajë

	-Leja me nr. 2794 ZHVILLUESIT: ELEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: HOTEL 7 KAT (DUPLEX) + PISHINE + 2 KATE NENTOKE ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Golem, Kavajë.” u konstatua se nuk është respektuar distanca midis objektit dhe kufirit të pronës.
Kriteri:	Vkm Nr. 408, datë 13.5.2015 Neni 35 ku citon “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve”.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtimlegjisacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjisacionin në fuqi konkretisht vkm 408 datë 13.05.2015

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajn përgjegjësi:

R.Kme detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

D.Q me detyrë drejtor i DPZHTK bashkia Kavajë

S.VU me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

Projektues: A.S

Projektues: AS

Projektues: N I

Projektues: E.XH

Titulli i Gjetjes 4:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se planvendosja e miratuar nuk është e saktë.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- - ZHVILLUESIT: L I LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATESHE +AMBJENTE TEKNIKE DHE 1 KAT NENTOKE PARKIM ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë u konstatua se planvendosja e miratuar nuk është e saktë pasi nuk është pasqyruar objekti kufitar 5 katësh që ndodhet në perëndim të këtij objekti.
Kriteri:	Në mospërputhje më kushtet teknike të projektimit dhe me vkm 408 neni Neni 15 Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi c) Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;

Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtimlegjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi konkretisht vkm 408 datë 13.05.2015

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

R.Kme detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

D.Q me detyrë drejtor i DPZHTK bashkia Kavajë

S.VU me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

Projektues: A.S

Pretendimi e subjektit të audituar.

Në plan vendosjen e hartuar nga aplikanti dhe miratuar nga Bashkia është paraqitur saktë parametrat sipas rregullores së zhvillimit të territorit si dhe rilevimit të saktë sipas sistemit koordinativ shtetëror të miratuar nga GIS

Opinionit i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë koment pasi, që planvendosja e një projekti të jetë e saktë, duhet të pasqyrojë të gjithë objektet që janë rreth objektit të ri që do ndërtohet të konturuar dhe përmasuar si dhe me distancat përkatëse nga objekti i ri.

Titulli i Gjetjes 5:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se ka mospërputhje në kontratën midis pronarit të tokës dhe sipërmarrsit dhe projektit të miratuar.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- -“Leja me nr.prot 4170 SHOBJEKT BANIMI 4-KATE + 1 Kat SHERBIME(perdhe) + 1 KAT PODRUM NENTOKE ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë. -Leja me nr.prot 3828 ZHVILLUESIT: L I LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATESHE +AMBJENTE TEKNIKE DHE 1 KAT NENTOKE PARKIM ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem , Kavajë= -Leja me nr.prot 3298 ZHVILLUESIT: E JA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURA SHERBIMI AKOMODUESE DHE HOTELERI 1,2,3,4 KATE KU KATI PERDHE DUPEKS+1 KAT NENTOKE” u konstatua se kontrata e lidhur mes palëve dhe projekti i miratuar nuk përputhen. Konkretisht në kontratë citohet se kemi të bëjme me objekt banimi+shërbim ndërkohë projekti dhe leja e miratuar janë strukturë akomoduese përdorim dhe vetëm kjostrukturë është e lejuar.
Kriteri:	Plani i përgjithshëm Vendor konkretisht përdorimet e lejuara sipas njësive strukturore përkatëse si dhe kontratat e lidhura mes palëve.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtimlegjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.

Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi konkretisht vkm 408 datë 13.05.2015 dhe planin e përgjithshëm vendor.
---------------------	---

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajn përgjegjësi:

R.Kme detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

D.Q me detyrë drejtor i DPZHKT bashkia Kavajë

S.VU me detyrë specialist i DPZHKT bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHKT bashkia Kavajë

Pretendimi e subjektit të audituar.

Subjekti pretendon se kontarta e lidhur mes pronarëve të truallit dhe investitorit ,proejkti i miratuar dhe leja e ndërtimit është në përputhje me planin e përgjithshëm vendor.

Opinionit i grupi të auditimit:

Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë koment pasi pasi gjetja për të cilën po flitet është bërë bazuar mbi kontratat e firmosura mes palëve ku bëhet fjalë për apartamente ndërkohë në atë zonë përdorimi i lejuar është struktura akomoduese(hoteleri)

Titulli i Gjetjes 6:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua nuk është respektuar koeficienti i shfrytëzimit të territorit.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- -Leja 3690 ZHVILLUESIT: E.F Kumrija LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: STRUKTURE AKOMODUESE 4-KAT+PODRUM ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Golem,Kavajë -Leja me nr.3266 ZHVILLUESIT: shpk STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATE + 1 KAT SHERBIME+ 1 KAT NENTOKE DHE SISTEMIM KANALI Njësia Administrative Golem , Kavajë u konstatua se nuk është respektuar koeficienti I shfrytëzimit të territorit.
Kriteri:	vkm 408 Neni 39 Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim 1. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (Ksht) për ndërtim është raporti i sipërfaqes së gjurmës së ndërtimit me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës së ndërtueshme. 2. Ksht-ja për ndërtim matet në përqindje (%). 41 3. Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërtueshme. 4. Në rastin e infrastrukturave për shërbime publike, Ksht-ja për ndërtim përcaktohet e pavarur nga ndërtimet e tjera dhe sipas nevojave të funksionit dhe legjislacionit të posaçëm
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtimlegjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi konkretisht vkm 408 datë 13.05.2015

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajn përgjegjësi:

R.K me detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

D.Q me detyrë drejtor i DPZHTEK bashkia Kavajë

S.VU me detyrë specialist i DPZHTEK bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHTEK bashkia Kavajë

Projektues:A GJ

Projektues:N.I

Pretendimi e subjektit të audituar

Ne sa është konstatuar në gjetjen nga audituesit sqarojmë se leja 3690 zhvilluesit: E.F.K leja e ndërtimit për objektin: strukture akomoduese 4-kat + podrum, adresa e realizimit të punimeve: Golem,kavajë dhe leja e ndërtimit dhe plan vendosja bashkangjitur tregon që koeficienti i shfrytëzimit është 45% sic është ë specifikuar në rregulloren e PPV te Bashkisë Kavajë.

Opinionit i grupi të auditimit:

Grupi i auditimit merr në konsideratë argumentin për këtë leje.

Titulli i Gjetjes 7:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se në projektin teknik ka një ngritje 1.5m nga kuota e sistemimit.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- -Leja me nr.3266 ZHVILLUESIT: shpk STRUKTURE AKOMODUESE 5 KATE + 1 KAT SHERBIME+ 1 KAT NENTOKE DHE SISTEMIM KANALI Njësia Administrative Golem , Kavajë. u konstatua se ka një ngritje të kuotës 0.00 në 1.5 metër nga kuota e sistemimit.
Kriteri:	vkm 408 neni Neni 37 Lartësia e ndërtimeve ku citohet se: b) Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe "Bodrum", është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshtet e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të strukturës.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtimlegjisacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjisacionin në fuqi konkretisht vkm 408 datë 13.05.2015

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajn përgjegjësi:

R.Kme detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

D.Q me detyrë drejtor i DPZHTEK bashkia Kavajë

S.VU me detyrë specialist i DPZHTEK bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHTEK bashkia Kavajë

Projektues:N.I

Titulli i Gjetjes 8:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se në projektin teknik nuk ka marrë miratimin nga insitucionet përkatëse
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- - Leja me nr3903 ZHVILLUESIT: K.H LEJA E NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: SHTESE ANESORE HOTEL 5-KAT+PODRUM ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Njësia Administrative Golem, Kavajë. U konstatua se projekt propozimi nuk ka marrë miratimin nga AZHT.
Kriteri:	vkm 408 datë 13.05.2015 neni 15 Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi,pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtimlegjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Kavajë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi konkretisht vkm 408 datë 13.05.2015

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajn përgjegjësi:

R.Kme detyrë kryetar e bashkisë Kavajë

D.Q me detyrë drejtor i DPZHTK bashkia Kavajë

S.VU me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

H.Z me detyrë specialist i DPZHTK bashkia Kavajë

V. Zbatimi i ligjit dhe procedures ligjore nga IMTV Bashkia Kavajë si dhe shtrirja e efekteve te saj.

Organizimi dhe funksionimi i IMTV për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022.

Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Kavajë është i organizuar në nivel qendër dhe njësie administrative sipas tabelës së mëposhtme;

Tabela nr.1

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV)	Emër Mbiemër	Periudha Kohore
Kryeinspektor	S.M	17.09.2020 - 01.04.2022
Kryeinspektor	G.T	01.04.22-23.06.2022
Kryeinspektor	Y.N	23.06.2022-në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	J.M	15.09.2020 - në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	F O	19.02.2020 - në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	K C	24.09.2020- 01.04.2022
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	I M	11.04.2022-në vazhdim
Specialist Inxhinier/Arkitekt	E.H GJ	01.01.2022-26.04.2022
Specialist Inxhinier/Arkitekt	T M	26.04.2022- në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit Nj/A Golem	Sht K	26.02.2020 - në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit Nj/A Golem	VK	03.11.2017 - 19.05.2021
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit Nj/A Golem	D H G	13.10.21- në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit Nj/A Synej	A L	06.04.2020 - në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit Nj/A Luz i Vogël	A T	15.01.2020 - 21.10.2021
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit Nj/A Luz i Vogël.	M H	03.12.2021 - në vazhdim
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit Nj/A Helmes	S G	01.11.2019 - në vazhdim

Arsimimi i kryeinspektorit të IMTV Bashkia Kavajë për vitin 2021 deri më 01.04. 2022 është kundërshtim me ligjin 9780, Neni. 11 ku përcaktohet se: *Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.*

Në bazë të process-verbaleve të kundravajtjes, vendimeve të gjobave, vendimeve të prishjeve të objekteve të kundraligjshme, të vëna në dispozicion nga IMTV bashkia Kavajë janë ilustruar si më poshtë.

6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

Bazuar në korespondencën shkresore me IKMT, konstatohet se për periudhën shkurt 2021 shkurt 2023 kanë dalë me vendim prishje objekteve 45 raste, nga të cilat janë ekzekutuar vetëm 8 raste prej tyre dhe janë pa u ekzekutuar 34 raste të tjera të ndërtimeve pa dokumentacion tekniko ligjor (pa leje ndërtimi, dhe shkelje të lejes) dhe 3 raste kanë sigurim padie dhe 1 rast është në process gjyqësor. Objekte të cilat 4 prej tyre janë të pa identifikuar se nga kush janë ndërtuar ndërsa 4 të tjera janë të identifikuar. Në total janë ekzekutuar (vendim prishje) 17.7 % e rasteve të konstatuara për një periudhë dy vjecare, cka tregon nivel të ulët të zbatueshmërisë së kërkesave të ligjit.

6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Në 97 raste është konstatuar se kanë mbajtur process-verbal kundravajtje dhe kanë dalë me vendime gjobe, në 94 raste është mbajtur proves-verbal kundravajtje është mbajtur dhe vendim me gjobë por në tre raste nuk është mbajtur vendim prishje në kundërshtim me ligjin 9780 për për inspektimin dhe kontrollin e territorit, Neni 5 Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore. Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

- a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;
- ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati;
- ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;
- f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni.

Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes 4 aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit”.

-Për periudhën 2021-2022 vetëm në një rast është mbajtur mbajtur vlera e gjobës sipas vlerës së punimeve të kryera, ndërsa për rastet e tjera nuk është ndjekur kjo praktikë, në kundërshtim me ligjin 107/2014 Neni 52/e Kundërvajtjet administrative) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Në asnjë rast për periudhën e vitit Janar 2021 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2022, process-verbali i kundravajtjes nuk është shoqëruar me imazhe fotografike apo sqarim të detajuar të situatës së konstatuar nga ana e inspektorëve të IMTV dhe Kryeinspektorit, për të provuar qartësisht shkeljet. Në rubrikën (*Anekse*) dhe saktësisht në *aneksin nr.6.2/1* bashkëlidhur PRA paraqiten rastet e konstatuara në kundërshtim me ligjin, masat administrative dhe lloji i shkeljes.

- Nga të dhënat e IMTV, vënë në dispozicion grupit të auditimit është konstatuar se: Në total shuma e gjobave rezulton në vlerën 23,048,000 lekë, nga e cila janë arkëtuar 850,000 lekë në total.

Për vlerat e pa arkëtuara janë bërë kërkesa në Gjykatën Administrative Durrës për lëshimin e titullit ekzekutiv me qëllim vjeljen e gjobave sipa tabelës *Aneks.nr 6.3/1*

6.3 Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejev të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me DPKZHT (Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë).

Titulli i gjetjes: Mungesë profesionale nga Kryeinspektorët e i IMTV nga mos njohja e ligjit për shkak të arsimimit

Situata:

Puna e kryer nga IVMT është bazuar më shumë gjatë kontrolleve në territor nga ky inspektoriat dhe nuk ka evidence shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundëshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m2 të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijojnë aktivitetin e ndërtim kryesisht në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare si në planin urbanistik apo atë të ruajtjes së mjedisit. Për një periudhë 18 mujore nga fillim viti 2021 e deri në korrik 2022 rastet e konstatuara nga ndërtimet në kundërshtim me ligjin janë shumë të larta, *shkak ky i menaxhimit të dobët nga drejtuesit e IVMT*-së për këtë periudhë e që për pasojë ka sjellë efekte negative në këtë drejtim. Mos mbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksat e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.

Kriteri: Në kundërshtim me, ligjin 9780, Neni. 11 ku përcaktohet se: Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. Ligjin 107/2014 Neni 52/e Kundërvajtjet administrative kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Ndikimi/Efekti: Vijueshmëria e fenomenit të ndërtimeve jashtë lejeve të miratuara dhe atyre pa leje ndërtimi, e cila ka sjellël dhe mund të sjellë pasoja sociale, ekonomike, dhe është në kundërshtim me planet e miratuara urbanistike e mjedisore.

Shkaku: Mos marrja në kohë e masave me qëllim parandalimin e fenomenit të ndërtimeve pa leje. Rekrutimi i Kryeinspektorit pa formimin e duhur arsimor sipas kërkesave të ligjit. Mos bashkëpunimi ndërsektorial me DPZHKT për aplikantët për leje zhvillimore e ndërtimore.

Rëndësia: E Lartë.

Për këtë rekomandojmë: Kryeinspektori i IMTV të marrë masa që: në bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepleq apo dhe cdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektive të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare si: bregdet, pyje apo zona të mbrojtura.

Sa më sipër për mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi:

1-S.M me detyrë ish/Kryeinspektor i MTV për periudhën 01.01.2021 deri më datë 01.04.2022. Për mungesë profesionale dhe mosmarrjen e masave në kohë me qëllim parandalimin e fenomenit të ndërtimeve në kundërshtim me ligjin.

2- G.T me detyrë Kryeinspektor i MTV për periudhën 01.04.2022 deri më datë 23.06.2022. Për mosmarrjen e masave të prishjeve të ndërtimeve në kundërshtim me ligjin me qëllim parandalimin e fenomenit të ndërtimeve.

3- Y N me detyrë Kryeinspektor i MTV për periudhën 23.06.2022 deri më datë 31.12.2022. Për mos marrjen e masave për prishjen në kohë të objekteve të konstatuara në periudha para ardhëse.

2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Auditimi i fundit në Bashkinë Kavajë është kryer në vitin 2022 për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 511/7 datë 20.09.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- **21** masa organizative, pranuar nga subjekti;

- **17** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.

- **1** masë disiplinore.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve. Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Bashkia Kavajë duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Kavajë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së nuk ka kthyer përgjigje në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditësh.

Pa zbatuar.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Referuar shkresës nr. nr. 687/15 datë 13.12.2021 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve nuk është dërguar sipas afatit 6 mujor për të raportuar, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të*

auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Pazbatuar.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Kavajë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.70, datë 14.11.2022, ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2021-2023 dhe buxhetin vjetor 2021, u konstatua se:

- Nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Kavajë;
- Kryetari i Bashkisë Kavajë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në këshillin bashkiak, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;
- Nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;
- Nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kavajë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Nuk janë planifikuar fonde për investime për shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” e nenit 5, pika 1 e nenit 33, pika 1 e nenit 35, pika 1 e nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 5 e nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrëjë Grupin e Menaxhimit Strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Kavajë.

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kavajë.

Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për planifikimin e buxhetit afatmesëm dhe vjetor por nuk është ngritur GMS..

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të lidhura nga Bashkia Kavajë për kryerjen e punëve publike dhe listës së projekteve sipas PBA 2021-2023, u konstatua se në 2 raste për vlerën totale të kontratave 5,813 mijë lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore pas datës 15 tetor të vitit 2021, për projekte të cilat nuk janë pjesë e PBA 2021-2023. Këto projekte janë: “Ndërtim muri mbajtës, fshati Kryemëdhenj” në vlerën 3,111 mijë lekë, si dhe “Blerje bojë për lysterje godinash” në vlerën 2,701,800 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “c” në pikën 4 të nenit 36 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

dhe pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, i ndryshuar.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike dhe njësia e prokurimit, të marrë masa për eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor, për projekte të cilat nuk janë planifikuar në PBA.

Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat për vazhdimin e eliminimit të angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor, për projekte të cilat nuk janë planifikuar në PBA.

Statusi: Proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2021 paraqitet masën 82%. Kjo diferenc është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kavajë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Nga verifikimi rezultoi se, realizimi i të ardhurave për vitin 2022, është më i lartë se 2021, ka ndikuar në rritjen e financimit të buxhetit.

Statusi: Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se në fund të vitit 2021 rezultojnë të pa likuiduara gjithsej 103 fatura tatimore (investime, mallra dhe shërbime) të krijuara përgjatë periudhës 2012-2021 për vlerën 241,841,533 lekë, nga të cilat 14,621,420 lekë i përkasin vitit 2021, ndërsa 148 fatura për detyrimin ndaj OSHEE në vlerën 482,050,135 lekë, si dhe 57 vendime gjyqësore me vlerën 57,083,541 lekë, nga të cilat 6,253,498 lekë i përkasin vitit 2021. Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2021, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kavajë ndaj palëve të treta raportuar në MFE, përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore dhe shpenzime korrente, shpenzime kapitale në vlerën **730,464,832 lekë**. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2021, që duhej të raportohet në MFE duhet të ishte në vlerën **1,223,857,303 lekë**. Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë në raportin e shkallës së vështirësisë financiare, nuk ka përfshirë vlerën e detyrimeve për likuidimin e kamatë-vonesave ndaj OSHEE, detyrimin për shpronësimet përgjatë vitit 2021, gjithësej në vlerën 493,392,471 lekë raportuar më pak në MFE. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e

vetëqeverisjes vendore”; Kreun XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”; Pikat 8 dhe 184 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

4.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për rakordimin e detyrimit dhe lidhjen e një akt-marrëveshje me OSHEE për likuidimin pjesor të detyrimeve për faturat e energjisë elektrike, duke shmangur rritjen e vijueshme të kamatë-vonesave. Gjithashtu të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Nga verifikimi rezultoi se, nga verifikimi i pagesave rekomandimi është i zbatuar.

Statusi: Zbatuar.

4.2. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 4864.

Nga verifikimi rezultoi se, nga verifikimi i p.f rekomandimi është i zbatuar.

Statusi: Zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Kavajë për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak, për vlerën 223,179,324 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, si vijon:

-92,227,145 lekë më pak për detyrimet e biznesit të vogël dhe të madh;

-58,736,713 lekë më pak për detyrimet e kategorisë “Familjar”;

-52,687,413 lekë më pak për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale;

-30,176,258 lekë për gjoba të IMTV;

-6,049,341 lekë detyrimi i UK Sh.A Kavajë;

-38,770 lekë për tarifa të Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit;

-Debitorët e fshatrave turistik në NJA Golem janë mbivlerësuar për vlerën 6,358,315 lekë;

Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pikën 1 në nenin 11 në ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Nga verifikimi rezultoi se, është bërë pjesërisht kontabilizimin i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm.

Statusi: Pjesërisht I zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë, për vlerën 64,977,455 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Nga verifikimi rezultoi se, është bërë pjesërisht kontabilizimin i të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Statusi: Pjesërisht i zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak për vlerën 48,996,073 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1.1.5 “Grupi i llogarive 15 – Shuma të parashikuara për rreziqe e shfrytëzime” në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në llogarinë nr. 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” duke e debituar atë në momentin e njohjes dhe kredituar llogarinë nr. 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime.

Nga verifikimi rezultoi se, janë kryer veprimet kontabël për llogarinë 633.

Statusi: Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.467 “Kreditor të tjerë” me kundërparti llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 26,313,337 lekë, e ndarë si vijon:

-vendimet gjyqësore në vlerën 7,886,046 lekë (një pjesë e këtyre vendimeve janë likuiduar pjesërisht në periudhën Prill-Maj 2022);

-detyrime të ndryshme të Bashkisë Kavajë ndaj palëve të treta në vlerën 3,292,919 lekë;

-detyrimet për shpronësim në vlerën 15,134,372 lekë¹⁷. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar - “funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4”.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë

ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Nga verifikimi rezultoi se, është bërë pjesërisht kontabilizimin i të llogarisë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Statusi: Pjesërisht i zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 231 “Investime në proces” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, e cila përfaqëson shpenzime për investime të pa përfunduara, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më tepër për vlerën 911,470,146 lekë, investime të përfunduara por të pasqyruara në llogaritë financiare të klasës 2. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun 2, klasa 2 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces. **Nga verifikimi rezultoi se,** është kryer sistemimi në pasqyra.

Statusi: Zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 62,500,169 lekë gjithsej, e ndarë si vijon: 46,500,169 lekë diferencë e pa kontabilizuar si rrjedhojë e shtesave në pjesëmarrjen në kapital në Klubin Sportiv “B” të bëra në fillim të vitit 2021, 16,000,000 lekë financime të Bashkisë Kavajë për Klubin e Futbollit B gjatë vitit 2021, të cilat nuk janë bërë shtesa në pjesëmarrjen në kapital.

-Gjithashtu konstatohet se Bashkia Kavajë vazhdon të zotërojë aksione në 2 klubet sportive “B dhe Luz i Vogël 2008”, në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”.

-Pra sa më sipër Bashkia Kavajë duhet të kishte nxjerrë në shitje aksionet e saj, si dhe në rast se nuk realizohej procesi i shitjes së tyre, atëherë me Vendim të Këshillit Bashkiak, klubet e mësipërme duhet të krijoheshin nga e para, në formën e një shoqate sportive amatore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 8 në ligjin nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”; Urdhri i Ministrisë së MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjatë Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të marrë masat e nevojshme për shitjen e aksioneve që zotëron në dy klubet e futbollit B dhe Luz i Vogël. Në rast se nuk realizohet procesi i shitjes së tyre, atëherë me Vendim të Këshillit Bashkiak, klubet e mësipërme duhet të krijohen nga e para, në formën e një shoqate sportive amatore.

Nga verifikimi rezultoi se, nuk janë marrë masat e nevojshme për shitjen e aksioneve.

Statusi: Pazbatuar.

10.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Nga verifikimi rezultoi se, është kryer sistemimi ne pasqyra.

Statusi: Zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, u konstatua se nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 18,359,452 lekë sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, Klasa 2 “Trajtimi kontabël për AAGJ jomateriale, shkronja “d” në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe pikën 36 “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogarit me metodën lineare me normë amortizimi 15%” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, për vlerën 18,359,452 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se, nuk ka marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, për vlerën 18,359,452 lekë.

Statusi: Pazbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari pasqyrohet në vlerën 0 lekë. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Kadastrës Urbane, rezulton se Bashkisë Kavajë dhe ish komunave, aktualisht NJA të Bashkisë Kavajë, nëpërmjet dy VKM¹⁸ i kanë kaluar në pronësi sipërfaqe pyje dhe kullota, të cilat nuk janë të kontabilizuara në llogarinë nr.211. Konkretisht me VKM nr.193, datë 21.02.2008 kanë kaluar 25 prona me sipërfaqe 528.25 Ha gjithsej/5.282.500 m² * 165 lekë/m² (çmimi referencë për tokën pyjore në zonën e Helmas¹⁹) = 871,612,500 lekë. Për këto sipërfaqe nuk është ngritur një grup pune, me qëllim kryerjen e verifikimit fizik të tyre dhe përcaktimin e vlerës kontabël. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1.2 në nenin 9 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; si dhe pikën 30 në kapitullin III në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

¹⁸ VKM nr.193, datë 21.2.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna helmës të qarkut të Tiranës”. VKM nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-omunave/bashkive”, të ndryshuar.

¹⁹ Përcaktuar në VKM nr.89, datë 03.0.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH”.

Nga verifikimi rezultoi se, ka marrë masa për ngritjen e grupit të punës.

Statusi: Zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kavajë, në vitin për llogaritë nr.210 “Toka, troje, terrene”, nr.211 “Pyje Plantacione”, nr.212 “Ndërtesa e Konstruksione”, nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nr.214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe aktivet afatshkurtra, nuk është hartuar regjistri kontabël, ku të specifikohen të dhënat e nevojshme, si data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kapitullin III, neni 9, pika 1.2 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Nga verifikimi rezultoi se, nuk ka regjistër aktivesh.

Statusi: Pazbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Rregullorja e brendshme nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Në rregulloren e brendshme nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, si shkëmbimi i informacionit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet të cilat janë pajisur me leje për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitetet në Bashkinë Kavajë.

-Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Nuk është hartuar “Harta e procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore”.

-Për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

-Nuk është hartuar regjistri dhe strategjia e menaxhimit të riskut.

-Në Bashkinë Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin “EXCEL” dhe jo me program kontabiliteti. Drejtoria e të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin “EXCEL”.

-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

-Sipas verifikimit të grupit të auditimit, faqja Eëb e bashkisë është jashtë funksionit, pra nuk sigurohet transparenca e institucionit dhe e drejta për informim.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

-Nuk është raportuar në MFE pyetësi i vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklarata e cilësisë për vitin 2021.

-Në Bashkinë Kavajë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, drejtorët e drejtorive, si dhe përgjegjësat e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Nga verifikimi rezultoi se, është bërë hartimi dhe miratimi I strategjisë së riskut..

Statusi: Zbatuar.

14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, të marrë masa për vendosjen në funksion të faqes zyrtare të institucionit me qëllim rritjen e transparencës dhe raportimit të aktivitetit të Bashkisë Kavajë.

Nga verifikimi rezultoi se, është vënë në funksion Web i Bashkisë..

Statusi: Zbatuar.

14.3. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investim në program kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

Nga verifikimi rezultoi se, nuk është bërë investim lidhur me programet kompjuterike.

Statusi: Pazbatuar.

14.4. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Juridike të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim shmangien e mbivendosjes dhe përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

Nga verifikimi rezultoi se, nuk është bërë rregullorja e re..

Statusi: Pazbatuar.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e NJAB Bashkia Kavajë përgjatë vitit 2021, u konstatua se:

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se nuk është planifikuar kryerja e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2021 nuk është dhënë opinion i auditimit.

-Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kavajë, të cilat janë vlerësuar nga vetë NJAB me risk të lartë, si Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, prokurimet publike etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve tui dhena nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

15.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kavajë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore nga zyra e taksave në NJA Golem etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.

Nga verifikimi rezultoi se, janë kryer auditimet e lëna në rekomandim.

Statusi: Zbatuar.

15.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë masë për ngritjen e komitetit të AB.

Statusi: Pazbatuar.

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 83 rekomandime të lëna, 24 prej tyre, ose 30%, janë zbatuar pjesërisht 4, ose 4%, janë në proces zbatimi 18, ose 21%, si dhe nuk janë zbatuar 30, ose 36% prej tyre.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 7 rekomandime për 11 subjekte në vlerën 30,998 mijë lekë. Nga 7 masa, 3 rekomandime nuk janë zbatuar për vlerën 3,465 lekë dhe 4 për vlerën 27,533 lekë janë në proces zbatimi.

-Për arkëtimin e të ardhurave të munguara janë lënë 7 rekomandime për 951 subjekte në vlerën 65,088 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht. Nga 7 rekomandime 3 janë zbatuar për 17 subjekte për 17,100 mijë lekë, 1 rekomandim për vlerën 42,713 mijë lekë nuk është zbatuar, si dhe 3 rekomandime për vlerën 5,274 mijë lekë, janë në proces zbatimi.

Pra janë zbatuar 26% e masave, 65% e tyre pa u zbatuar dhe 8% në proces zbatimi.

-Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 5 rekomandime në vlerën 731,827 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 5 rekomandime, 1 prej tyre është zbatuar, 2 janë në proces zbatimi për vlerën 674,786 mijë lekë dhe 2 rekomandim për vlerën 57,041 mijë lekë nuk janë zbatuar.

-Për eliminimin e borxhit tatimor janë lënë 5 rekomandime për 1665 subjekte në vlerën 375,042 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 5 rekomandime 4 prej tyre janë në proces zbatimi për 1623 subjekte në vlerën 366,242 mijë lekë, si dhe 1 është i pazbatuar për 42 subjekte në vlerën 8,800 mijë lekë.

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si

dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

Nga verifikimi rezultoi se, nuk janë bërë zbatimi I rekomandimeve.

Statusi: Pazbatuar.

B.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Kavajë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 23,330 mijë lekë, për 50 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për 20 praktika likuidimi të vendimeve gjyqësore të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u konstatua se janë kryer likuidime pjesore, megjithëse Bashkia Kavajë ka pasur disponibilitete në thesar. Gjithashtu në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbartimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Kavajë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore.

Statusi: Proces zbatimi

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Nga verifikimi rezultoi se, janë në proces analizimi rastet e vendimeve gjyqësore.

Statusi: Proces Zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës për planifikimin e tarifës së dhënies me qira të hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit “Stacion plazhi”, u konstatua se periudha për të cilën

është përlllogaritur vlera e qirasë për subjekt është 3 muaj (Qershor-Korrik-Gusht) me çmimin 300 lekë/m²/3 muaj, ose 100 lekë/m²/1 muaj. Në vijim, nga shqyrtimi i VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, konkretisht pikën 11 të nenit 5²⁰, rezulton se aktiviteti i stacionit të plazhit minimalisht duhet të zgjasë 5 muaj në vit, që do të thotë 2 muaj më tepër nga çfarë ka përcaktuar Bashkia Kavajë në paketën fiskale, pra nga Bashkia Kavajë nuk arkëtohet detyrimi për shfrytëzimin e hapësirës së plazhit për 5 muaj, por vetëm për 3 muaj, pasi e ka hequr detyrimin e mësipërm nëpërmjet përcaktimit të bërë në paketën fiskale të vitit 2021. Kjo situatë ka ndikuar në planifikimin e gabuar të të ardhurave nga tarifa e qirasë, rrjedhimisht edhe në reduktimin e të ardhurave që mund të arkëtojnë Bashkia Kavajë nga dhënia me qira e hapësirës së plazhit. Nëse Bashkia Kavajë do të kishte përcaktuar nivelin e tarifës për kohëzgjatjen 5 muaj dhe jo për 3 muaj, për 96 subjekte që kanë marrë me qira hapësirën e plazhit për vitin 2021, do të rriste mundësitë e saj për të arkëtuar 26,797 mijë lekë më tepër. *Për sa më sipër Bashkia Kavajë nuk ka administruar asetet me eficiencë dhe efektivitet dhe vlera prej 29,797 mijë lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, për shkak të mos planifikimit të tyre në paketën fiskale.* Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 24 dhe 25 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 2 në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Kadastrës Urbane Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke bërë ndryshimin në paketën fiskale të kohëzgjatjes së qiradhënies së hapësirës së plazhit (minimalisht 4-5 muaj me çmimin 100 lekë/m²/muaj) me qëllim rritjen e të ardhurave që arkëtohen nga tarifa e qiradhënies për objektin e mësipërm, si dhe eliminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Nga verifikimi rezultoi se, lidhur me planifikimin e tarifës për dhenien me qira të hapsirës publike” ”rere”, bëhet me dije se hapësirat publike menaxhohen nga drejtoria e pronave dhe asetëve publike. Prej vitesh kjo tarifë është vendosur në masën 300 leke/m². perseri për vitin 2022 me vendim të keshillit bashkiak u la në masën 300 leke/m²

Statusi: Proces

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2021, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Kavajë dhe NJA në mënyrë progresive janë 1668 subjekte debitore të kategorisë së taksapaguesve privat në vlerën 323,261 mijë lekë, nga të cilët brenda vitit 2021 janë krijuar 494 subjekte në vlerën 42,109 mijë lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

-120 subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 24,249 mijë lekë;

-374 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 17,859 mijë lekë.

Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga DAV Bashkia Kavajë, rezulton se nga fillimi i vitit 2021 deri në përfundim të tij kemi rritje të debitorëve të kategorisë “Biznes”, për vlerën 42,109 mijë lekë. Për debitorët e mësipërm, përjashtuar DAV pranë Bashkisë Kavajë, zyrat e taksave dhe tarifave vendore në NJA Golem, Helmas, Synej dhe Luz i Vogël, nuk kanë përlllogaritur rast pas rasti kamatë vonesë për subjektet debitore.

-Në raport me numrin e subjekteve debitore të krijuar brenda vitit 2021 janë zbatuar masa shtrënguese (vetëm bllokim të llogarisë bankare) për 11% të tyre, për më tepër nuk është vazhduar

²⁰ “Stacioni i plazhit duhet të mbahet i hapur nga subjektet të paktën gjatë afatit nga data 1 maj deri më 30 shtator të çdo viti dhe gjatë kësaj periudhe duhet të ofrojnë të gjitha shërbimet e të përmbushë të gjitha kushtet minimale të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti”.

me marrjen e masave të tjera shtrënguese në rend shterues, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, vendosje e barrës hipotekore, barrë sigurorese, deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, nenin 114 dhe nenin 117 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSh”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Nenin 64 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Paketën fiskale të vitit 2021.

3.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 323,261 mijë lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Nga verifikimi rezultoi se Nga ana e DAV Kavaje, jane nxjerre njoftim vleresimi tatimor per debitorët dhe kete vit, rezultatet kane qene me te mira se cdo vit tjetër paraardhës, , lidhur me uljen e numrit te debitorëve, duke ndjekur te gjitha rruget ligjore, proces i cili do te vazhdoje edhe kete vit dhe ne vazhdim.

Statusi: Proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kavajë për taksimin dhe tarifimin e subjekteve me aktivitet “Hoteleri”, u konstatua se ndjekja e taksës së fjetjes në hotel aplikohet bazuar në akt-rakordimet e sektorit të kontrollit në terren me subjektet tregtare përgjatë periudhës Korrik-Shtator (2 akt rakordime për hotel) me tarifën 70 lekë/natë/personi për hotele nën 4 yje dhe 175 lekë për hotele 4-5 yje. Ky dokument nuk është i saktë, pasi nuk paraqitet panorama e plotë e lëvizjes (akomodimit) të personave në hotel, por thjeshtë bëhet një konfirmim i deklaratës së subjektit (vetëdeklarim). Gjithashtu, në 8 raste u konstatua se subjekte të ndryshme me aktivitet “Hoteleri” nuk janë të regjistruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore të DAV Bashkia Kavajë dhe për rrjedhojë nuk janë taksuar dhe tarifuar në përputhje me përcaktimet e bëra në paketën fiskale të vitit 2021. Përveç rasteve të mësipërme, për 10 subjekte të tjera, megjithëse administrohej informacion për bazën e taksës së fjetjes, ndërtesës, truallit, pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, konstatohet se nuk është aplikuar saktë niveli i taksës dhe tarifës sipas paketës fiskale të vitit 2021. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerë 3,430 mijë lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun I, shkronja “a” dhe “c” pika I.3 dhe Kreun II në Paketën Fiskale të Bashkisë Kavajë për vitin 2021; Pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-25 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

4.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 3,430 mijë lekë.

Nga verifikimi rezultoi se lidhur me taksën e fjetjes ne Hotel, bëhet me dije se ne paketën fiskale te vitit 2022, eshte ndryshuar dhe taksimi behet mbi bazen e numrit te dhomave (15 mije leke/dhome ne vit dhe 10 mijë lekë/dhomë) dhe jo per nr.shtreterish. kjo ka dhene rezultat, pasi per vitin 2022, janë mbledhur 30 milion leke vetem nga taksa e fjetjes ne hotel.

Statusi: Zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Kavajë dhe NJA janë 9756 familje debitorë për vlerën **55,814 mijë lekë**, nga të cilat 6704 familje për vlerën 17,257 mijë lekë janë debitorë të krijuar brenda vitit 2021. Për arkëtimin e vlerës debitorë, nga sektori i mbledhjes së borxhit nuk

është marrë asnjë masë (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj). Gjithashtu ndaj Bashkisë Kavajë rezultojnë të jetë debitor edhe UK Sh.A Kavajë për kohën kur ka pasur rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”. Detyrimi që ka UK Sh.A Kavajë në fund të vitit 2021 ndaj Bashkisë Kavajë është në vlerën prej 6,049 mijë lekë. Nga DAV Bashkia Kavajë për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor UK Sh.A Kavajë.

-Problematikë e konstatuar nga auditimi i arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”, rezultojnë edhe për 1081 familje që banojnë në fshtrat turistike në NJA Golem, të cilat prej vitit 2011 deri në vitin 2021 nuk kanë likuiduar detyrimet që kanë ndaj Bashkisë Kavajë për taksën e ndërtesës, truallit, si dhe tarifën e pastrimit dhe shërbimit, duke krijuar një vlerë debitorësh prej **246,072 mijë lekë**, nga të cilat 8,524 mijë lekë, janë krijuar brenda vitit 2021. Për familjet debitorë në vitin 2021, nga zyra e taksave në NJA Golem nuk është përlloritur kamatë-vonesë. Lista me familjet debitorë është përcjellë DAV Bashkia Kavajë nga zyra e taksave në NJA Golem, por nga sektori i mbledhjes së borxhit pranë DAV Bashkia Kavajë, në vitin 2021 nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e detyrimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, nenin 114 dhe nenin 117 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Nenin 64 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Paketën fiskale të vitit 2021.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore nga abonentët familjarë, si rrjedhojë e bllokimit të llogarive bankare të UK Sh.A., Kavajë, vlerësimin e detyrimit dhe aplikimin e penalteteve ndaj UK Sh.A Kavajë

Nga verifikimi rezultoi se lidhur me ndermarrjen e UK Kavaje, janë likuiduar të gjitha detyrimet ndaj Bashkisë Kavaje. Prej vitit 2020, nuk është me agjent tatimor për vjeljen e taksës familjare. Kjo taksë mbledhet nga strukturat perkatese të DAV Kavaje.

Statusi: Zbatuar.

5.2. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorësh nga taksat familjare prej 307,936 mijë lekë.

Nga verifikimi rezultoi se, janë marrë masat e nevojshme lidhur me taksat familjare.

Statusi: Proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kavajë në planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Kavajë dhe NJA taksohen gjithësej 9399 familje. Me qëllim vlerësimin nëse nga DAV Bashkia Kavajë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Kavajë me informacionin e administruar nga Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Kavajë e NJA. Nga përlloraritjet e kryera, rezultoi se nuk janë përfshirë në taksat dhe tarifave vendore, gjithësej 13972 familje, ku diferenca më e lartë është në Qytetin e Kavajës për 11675 familje, duke vijuar me NJA Synej për 1074 familje, si dhe NJA Golem për 942 familje. Kjo situatë ka ndikuar negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kavajë nga taksat dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”, sepse nëse do të bënim përlloraritjet për Qytetin e Kavajës vetëm për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, për numrin e familjeve të pataksuara, do të

kishim 1,300 lekë (tarifë pastrimi dhe shërbimi) * 11675 familje të pa taksuara dhe tarifua = 15,177,500 lekë, më pak planifikuar për tarifën vendore të pastrimit dhe shërbimit.

-Situata e mësipërme, është krijuar edhe për arsye se në vitin 2020 është ndërprerë marrëveshja e bashkëpunimit me UK Sh.A Kavajë, ku ky i fundit ka pasur rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Praktikisht sa i takon taksimit të kategorisë “Familjar” për Qytetin e Kavajës, DAV Bashkia Kavajë takson vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik, pasi vetëm tek kjo kategori e ka të mundur identifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DAV Bashkia Kavajë nuk ka një regjistër të përditësuar të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”, duke patur në konsideratë këtu edhe gjeneralitetet (adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr.132, datë 7.3.2018, i ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-25 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr.132, datë 07.03.2018 Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar; Kreun II, pika II.1 në Paketën Fiskale për vitin 2021.

6.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë në bashkëpunim me Administratorët e Njërive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksat dhe tarifave vendore dhe përditësimin e regjistrin të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familjar”.

Nga verifikimi rezultoi se Per hartimin e regjistrin data base per te gjitha familjet ne territorin e bashkise Kavaje, eshte realizuar per te gjitha njesite administrative, Golem, Luz i Vogel, Synej dhe Helams, eshte ne proces vetem per njesine Kavaje.

Statusi: Proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kavajë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore në fund të vitit 2021 është 160,889 mijë lekë, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2021 është rritur me 18,953 mijë lekë. Përgjatë vitit 2021 janë gjithsej 6758 familje debitore për vlerën 18,953 mijë lekë, ku peshën më të madhe të familjeve debitore e ka NJA Golem, duke vijuar me NJA Helmas. Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në Bashkinë Kavajë, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore nuk njoftohen ose të merren masa të tjera, me qëllim arkëtimin e kësaj takse. DAV Bashkia Kavajë arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari ose personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Kavajë për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 2 në nenin 89 në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreun I, shkronja “b” në Paketën Fiskale për vitin 2021.

7.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 160,889 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Nga verifikimi rezultoi se po merren masat e nevojshme.

Statusi: Proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kavajë në planifikimin e taksës për tokën bujqësore, rezultoi se në Bashkinë Kavajë dhe NJA taksohet gjithsej 9764.4 Ha sipërfaqe tokë bujqësore. Me qëllim vlerësimin nëse nga DAV Bashkia Kavajë është bërë planifikimi saktë i taksës së tokës bujqësore, u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Kavajë me informacionin e administruar nga agronomët e NJA mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, familjet që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore dhe kategorinë e bonitetit. Nga përlllogaritjet e kryera, bazuar në kategorinë e bonitetit, sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo familje, rezultoi se planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të bëhet për vlerën 26,198 mijë lekë/6,198 mijë lekë janë planifikuar më pak nga DAV Bashkia Kavajë, për t'u arkëtuar nga taksa e tokës bujqësore. Gjithsej tokë bujqësore sipas agronomëve në krahasim me informacionin që administrohet nga DAV Bashkia Kavajë rezulton se janë 886 Ha më pak, por diferencat rezultojnë në sipërfaqe sipas kategorisë së bonitetit, fenomen i cili ndikon në rritjen e planifikimit të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore. Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në përditësimin e numrit të subjekteve objekt taksimi.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Kreun I, shkronja “b” në Paketën Fiskale për vitin 2021

8.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, Specialistët e taksave familjare, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të agronomëve të Bashkisë Kavajë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Nga verifikimi rezultoi se Lidhur me vjeljen dhe arketimin e taksës së tokës bujqësore, është një detyrë në proces që do zgjase në kohe, për vetë specifikat dhe veshitësitë që paraqet vjelja e taksës së tokës.

Statusi: Proces

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Kavajë për taksimin e familjeve që kanë në pronësi ose përdorim tokë bujqësore u konstatuan mangësi në taksimin e tyre në NJA Luz, Golem dhe Synej. Duke qenë numri i lartë i personave që kanë në pronësi ose përdorim tokë bujqësore, vlerësimi i taksimit nga grupi i auditimit u bë mbi bazë grupimi, pra familjet në një fshat me të njëjtin mbiemër. Konkretisht diferenca e krijuar si rrjedhojë e taksimit të gabuar është në vlerën 3,047 mijë lekë që përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë, e ndarë si më poshtë vijon:

-Në NJA Luz rezultuan diferenca për 44 familje/443 persona për vlerën 1,857 mijë lekë, taksuar më pak, në krahasim me familjet që disponojnë tokë bujqësore;

-Në NJA Golem rezultuan diferenca për 40 familje për vlerën 1,175 mijë lekë;

-Në NJA Synej rezultuan diferenca për 40 persona për vlerën 14 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikën 1 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Kreun I, shkronja “b” në Paketën Fiskale për vitin 2021.

9.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme për vlerësimin e detyrimit tatimor dhe njoftimin e subjekteve me qëllim arkëtimin e vlerës prej 3,047 mijë lekë, si rrjedhojë e taksimit jo të drejtë dhe të plotë të familjeve që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore.

Nga verifikimi rezultoi se Agronomet e njesive administrative me bashkepunim me specialiste e DAV Kavaje, kane rakorduar dhe kane evidentuar te gjitha familjet bujqesore, qe jane furnizuar me toke sipas ligjit 7501, 19.07.1991.

Statusi: Zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive është 52,687 mijë lekë për 1278 subjekte, nga të cilat 159 subjekte për vlerën 3,295 mijë lekë janë krijuar në vitin 2021. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtorja e Urbanistikës Bashkia Kavajë, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Kavajë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e kësaj takse.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 në nenin 89 në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

10.1. Rekomandimi: Drejtorja e Urbanistikës t'i përcjellë Drejtorisë së të Ardhurave listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAV Bashkia Kavajë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 52,687 mijë lekë.

Nga verifikimi rezultoi se është bërë arkëtimi i vlerës 52,687 mijë lekë.

Statusi: Zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Kavajë, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 30,176 mijë lekë, nga të cilat 18 gjoba në vlerën 10,080 mijë lekë i përkasin vitit 2021. Gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i IMTV Bashkia Kavajë nuk është bërë kërkesë Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Kavajë, për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të tyre nëpërmjet përmbarimit gjyqësor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenit 164 dhe 165 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSh”, neni 14 në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

11.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 30,176 mijë lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Nga verifikimi rezultoi se janë në proces së ndjekjes së rrugëve administrative.

Statusi: Proces zbatimi

11.2. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtitimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Kavajë. Për çdo rast,

kur nga përmbauesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, Kryeinspektori i IMTV Bashkia Kavajë t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penaltitetet ndaj përmbauesve.

Nga verifikimi rezultoi se është ndjekur ecuria e arkëtimit të gjobave.

Statusi: Proces Zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezultoi se përgjatë vitit 2021 në territorin e Bashkisë Kavajë dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregëtimin e karburantit nga 22 stacione shitje. Nga numri i stacioneve të mësipërme u konstatua se në 5 prej tyre për një periudhë 2-3 vite është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse. Gjithashtu, rezultoi se 3 subjekte të tjerë, të cilët në vitin 2021 kanë mbyllur aktivitetin e tyre, nuk kanë paguar tarifën e licencimit të tregëtimin të karburantit për periudhat kur kanë ushtruar aktivitet. Në fund të vitit 2021, gjithsej rezultojnë 8 subjekte debitor për vlerën 7,440 mijë lekë, si rrjedhojë e moslikuidimit të tarifës së licencimit të tregëtimin të karburantit. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë. Për subjektet e mësipërme administrohen masa shtrënguese (bllokim të llogarisë bankare) nga DAV Bashkia Kavajë, vetëm për 1 prej tyre. Gjithashtu nga verifikimi i databasës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, për subjektet që ushtrojnë aktivitet “tregëtimin e karburanteve” në Bashkinë Kavajë, rezultoi se janë 6 subjekte të cilat kanë të regjistruar si aktivitet tregëtimin e karburanteve, por që nuk administrohet informacion në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore të DAV Bashkia Kavajë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 dhe 7 të nenit 4 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregëtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimin me pakicë të karburanteve.

Nga verifikimi rezultoi se është bërë e mundur njoftimi i subjekteve ushtrojnë aktivitet në tregëtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre.

Statusi: Proces Zbatimi

12.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrin të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 7,440 mijë lekë.

Nga verifikimi rezultoi se janë ndjekur procedurat eadminis. dhe gjyqësore për disa subjekte.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e

pastrimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kavajë (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kavajë) u konstatua se përgjatë vitit 2021 kanë kryer punime ndërtimi gjithësej 42 subjekte, të cilët nuk janë pajisur me NIPT sekondar e për rrjedhojë nuk janë tarifuar me tarifën e pastrimit dhe shërbimit, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 1,320 mijë lekë gjithësej.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun II.1 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kavajë.

13.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,320 mijë lekë²¹.

Nga verifikimi rezultoi se janë ndjekur procedurat eadminis. dhe gjyqësore për disa subjekte.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme (banesa sociale, dyqane, tokë bujqësore/pyjore dhe hapësirë e plazhit) të Bashkisë Kavajë me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe DAV Bashkia Kavajë, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mosaplikim i kamatë vonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave etj). Këto veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën 12,489 mijë lekë, nga të cilat 1,847 mijë lekë janë krijuar brenda vitit 2021. Gjithashtu, u konstatua se për dyqanet e dhëna me qira nuk është kryer procedura e konkurrimit, si dhe kontratat e lidhura me qiramarrësit nuk janë sipas formatit të miratuar dhe 3 subjekte kanë në përdorim dyqanet pa lidhur kontratë qiraje. Gjithashtu në 2 raste, është konstatuar se megjithëse subjektet janë debitorë për moslikuidimin e tarifës vjetore të qirasë për hapësirën e plazhit në vitet e mëparshme, përsëri Bashkia Kavajë ka lidhur kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit për vitin 2021.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 32 në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar; Pikën 2 në nenin 89 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikën 1, pikën 12 në Kreun II të VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar; Shkronjat “c” dhe “d” të pikës 3 në nenin 5 dhe shkronjën “b” në pikën 2 në nenin 12 në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e ndryshuar; Nenin 5 “Çmimi dhe mënyra e pagesës” të kontratave të qirasë për dyqanet; Nenin 5 të kontratës së qirasë për tokat pyjore/bujqësore; Nenin 8 në kontratën e qirasë së hapësirës së plazhit të lidhur ndërmjet palëve.

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë e punonjësve përkatës, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 12,489 mijë lekë.

Nga verifikimi rezultoi se janë nxjerrë përgjegjësite e punonjësve.

Statusi: Zbatuar

14.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastës Urbane Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme, që procedura e dhënies me qira të dyqaneve të bëhet nëpërmjet konkurrimit publik. Gjithashtu të bëjë ndryshimin e formatit të kontratave në përputhje me përcaktimet ligjore, si dhe lidhjen e tyre nga e para me 14 subjektet qiramarrës.

Nga verifikimi rezultoi se nuk është marrë masë.

Statusi: Pazbatuar

C. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

zj. A.K, me detyrë Drejtore e Burimeve Ekonomike, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore pas afatit ligjor të lejuar, në raportimin jo të saktë të vlerës së stokut të detyrimeve të prapambetura, si dhe në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021.

zj. D.Q, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së PZHT, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale, mos bashkëpunimin me DAV Bashkia Kavajë për vendosjen në dispozicion të subjekteve të pajisura me leje ndërtimi, me qëllim hapjen e NIPT-eve sekondare për taksimin dhe tarifimin e tyre etj.

z. R.I, me detyrë Drejtor i të Ardhurave Vendore, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penaliteteve, keqmenaxhimin mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimit të taksës së tokës bujqësore, taksën e fjetjes në hotel etj.

z.P.P me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës Urbane, për mangësitë e konstatuara në administrimin e aseteve në pronësi të Bashkisë Kavajë dhe të ardhurave që krijohen prej tyre.

zj. M.C, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Borxhit, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penaliteteve, keqmenaxhimin mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimit të taksës së tokës bujqësore, taksën e fjetjes në hotel etj.

zj. P.M, me detyrë Përgjegjëse e Kontabilitetit, për mangësitë e konstatuara në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021.

zj.S.SH, me detyrë Specialist për taksën e biznesit në zyrën e taksave në NJA Golem, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore për 10 subjektet me aktivitet ekonomik në NJA Golem, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë.

z.J.H, me detyrë Specialist për taksën e biznesit në zyrën e taksave në NJA Golem, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore për 10 subjektet me aktivitet ekonomik në NJA Golem, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë.

z.M.A, me detyrë Inspektor në DAV Bashkia Kavajë, pjesë e grupit të inspektimit ngritur nëpërmjet urdhrin nr.1609 prot., datë 02.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, të cilë janë ngarkuar për të kryer verifikime dhe inspektime në terren për bizneset që ushtrojnë aktivitet në NJA Golem, si dhe përcjelljen e informacionit në zyrën e taksave të NJA Golem, por që nuk e kanë kryer detyrën në 8 raste.

z.A.P., me detyrë Inspektor në DAV Bashkia Kavajë, pjesë e grupit të inspektimit ngritur nëpërmjet urdhrit nr.1609 prot., datë 02.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, të cilë janë ngarkuar për të kryer verifikime dhe inspektime në terren për bizneset që ushtrojnë aktivitet në NJA Golem, si dhe përcjelljen e informacionit në zyrën e taksave të NJA Golem, por që nuk e kanë kryer detyrën në 8 raste. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 27-79, të Raportit të Auditimit)*

z.L.G., me detyrë Inspektor në DAV Bashkia Kavajë, pjesë e grupit të inspektimit ngritur nëpërmjet urdhrit nr.1609 prot., datë 02.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, të cilë janë ngarkuar për të kryer verifikime dhe inspektime në terren për bizneset që ushtrojnë aktivitet në NJA Golem, si dhe përcjelljen e informacionit në zyrën e taksave të NJA Golem, por që nuk e kanë kryer detyrën në 8 raste. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 27-79, të Raportit të Auditimit)*

z.M.B., me detyrë Inspektor në DAV Bashkia Kavajë, pjesë e grupit të inspektimit ngritur nëpërmjet urdhrit nr.1609 prot., datë 02.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, të cilë janë ngarkuar për të kryer verifikime dhe inspektime në terren për bizneset që ushtrojnë aktivitet në NJA Golem, si dhe përcjelljen e informacionit në zyrën e taksave të NJA Golem, por që nuk e kanë kryer detyrën në 8 raste

zj.A.P., me detyrë Inspektor në DAV Bashkia Kavajë, pjesë e grupit të inspektimit ngritur nëpërmjet urdhrit nr.1609 prot., datë 02.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, të cilë janë ngarkuar për të kryer verifikime dhe inspektime në terren për bizneset që ushtrojnë aktivitet në NJA Golem, si dhe përcjelljen e informacionit në zyrën e taksave të NJA Golem, por që nuk e kanë kryer detyrën në 8 raste.

z.Th.D., me detyrë specialist për taksat në NJA Helmas, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore për bizneset dhe familjet.

z.A.C., me detyrë specialist për taksat familjare në Luz i Vogël, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore për bizneset dhe familjet.

zj.E.C., me detyrë specialist për taksat në NJA Synej, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore për bizneset dhe familjet.

Nga verifikimi rezultoi se, është ngritur komisioni dhe vendimi për dhënien e masave disiplinore, është dhënë masa “Vërejtje” për të gjithë punonjësit e përmendur në rekomandimin e dhënë.

Statusi: Zbatuar.

Konkluzion

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Kavajë me shkresën nr. 511/7 datë 20.09 pra më datë 20.03.2023 janë bërë 6 muaj nga data e dërgimit. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se nga Bashkia Kavajë kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Përkatesisht:

- Është hartuar plani i veprimit më datë 70.10.2022 ku është përcaktuar struktura ose punonjësi përgjegjës për zbatimin e rekomandimit si dhe janë shprehur mbi pranimin ose jo të rekomandimeve. Rezultoni se nga 39 rekomandime të lëna në total, janë pranuar plotësisht. Ky nivel i realizimit ka ardhur pasi nga ana e titullarit të bashkisë Kavajë nuk janë marrë masat e duhura, që brenda afateve kohore të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore, të miratohej “Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve”, vënia në dijeni shkresore e KLSH- së, mos caktimit nga ana e tij e personit që do të merrej me ndjekjen e zbatimit të Rekomandimeve si dhe e mos funksionimit me efektivitet të GMS të Bashkisë Kavajë.

-Masa organizative

Nga 21 masa organizative, janë zbatuar 10 rekomandime; janë në proces 1 rekomandime si dhe është zbatuar pjesërisht 4 rekomandim dhe 6 rekomandime të pazbatuara.

-Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, 9 rekomandime në proces, 5 rekomandime të zbatuara, 2 pjesërisht të zbatuar dhe 1 e pazbatuar.

-Masa disiplinore.

Nga 1 masa disiplinore, e zbatuar .

Në përfundim rezulton se:

- **Janë zbatuar gjithsej 16 rekomandime**, 10 rekomandime organizative, përkatësisht 4.1,3.1,4.2,7.1,9.1,1.02,12.1,14.1,14.2,15.1; 5 rekomandim i masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publik përkatësisht 4.1,5.1,9.1,10.1,14.1. si dhe 1rekomandime për masë disiplinore 1.1

- **Janë në proces zbatimi 10 rekomandime**, 1 rekomandime organizative, përkatësisht 2.1 dhe 9 rekomandime te 3E.si:1.1,2.1,3.1,6.1,7.1,8.1,11.1,11.2,12.1,

- **Janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandim** nga ku organizative, përkatësisht me numër 1.1,5.1,6.1,8.1 si dhe 3e :12.2 dhe 13.1

-Janë pazbatuar 7 përkatësisht organizative :10.1,11.1,13.1,16.1,14.315.2 si dhe 3e:14.2

Titulli i gjetjes: Bashkia Kavajë nuk ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin e Auditimit Tematik “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit”.

Situata: Për sa më sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Bashkia Kavajë ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:
a.Nga 21 masa organizative, janë zbatuar 10 rekomandime; janë në proces 1 rekomandime si dhe është zbatuar pjesërisht 4 rekomandim dhe 6 rekomandime të pazbatuara.

b.Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, 9 rekomandime në proces, 5 rekomandime të zbatuara, 2 pjesërisht të zbatuar dhe 1 e pazbatuar.

c.Masa disiplinore. nga 1 masa disiplinore, e zbatuar .

Kriteri: Ligji nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 gërma j; Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”;

Shkaku: Mos ndjekja e gjitha procedurave nga ana e njëjësive përgjegjëse. Të Bashkisë Kavajë, për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna në përgjithësi.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i Rekomandimeve ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe pengon për përmirësimin e tyre në dobi të komunitetit, në mospërdorimin me eficencë të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Kavajë.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 511/7 datë 20.09.2022si dhe Akt Verifikimit nr.1 të datës 05.05.2023, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për

zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

V. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Kavajë nuk ka hartuar një sistem të plotë rregullash të shkruara për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm. Nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.

Nuk është hartuar gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit, pasi nuk është hartuar regjistri i riskut dhe nuk janë vendosur persona apo struktura përgjegjëse për monitorimin e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundëstim me ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 24-41 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria Ekonomike, gjatë planifikimit të buxhetit, të marrë masa për planifikimin e trajnimeve të punonjësve, në mënyrë të tillë për mbarëvajtjen e punës në bashki, sa i përket pozicioneve të punës përkatëse për secilin punonjës.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë Juridike të ngrejë grupin e punës për kryerjen e planit të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në Bashkinë Kavajë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se sektori i Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 24-41 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kavajë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja, për të pasqyruar aktivitetin e drejtorive të ngarkuara për zbatimin, me qëllim mbarëvajtjen e punës në bashki.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit të PBA-ve 2022-2024 si dhe i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit vjetor 2022, u konstatua se:

a. Dokumenti i PBA paraqitet i mangët pasi për PBA 2022-2024 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve; nuk është përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendari i PBA dhe buxhetit vjetor; nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive në rolin e menaxherëve

të programeve buxhetore përkatëse; nuk janë respektuar afatet kohore në miratimin nga KB të PBA; me miratimin e fondeve nuk është bërë detajimi për çdo program i detyrimeve.

b. Buxheti për vitin 2022 është realizuar 2,056,431 mijë lekë nga 2,667,949 mijë lekë të planifikuara ose në masën 77%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i zërit 606 “Transferta tek individët” në masën 81%, pra kemi akordim fondesh me rezervë nga pushteti qendror dhe zërit 230-231 “Shpenzime për investime” në masën 60%, nga mos realizimi i projekteve në vlerë të plotë, marrjes së angazhimeve dhe lidhjeve të kontratave si dhe financimeve me vonesë.

c. Për vitin 2022, të ardhurat janë realizuar në masën 112%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 705,828 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara konstatohet se, financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën 74% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, fondet e rindërtimit dhe transferta e kushtëzuar e transferta specifike) dhe 24% nga të ardhurat e veta.

d. Për vitin 2022 është përgatitur raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit, por jo në mënyrë periodike për çdo 4-mujor.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/ç,33/1,34,35, 36,37,39,40,41,48, me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimit të MFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024, me ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 65, me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 161 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 41-84 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe në bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që planifikimi i shpenzimeve buxhetore PBA dhe të vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesat me publikun me palët e interesit.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të përgatisë raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit (4 mujore),jo vetëm vjetore, duke i paraqitur në KB dhe krahas tyre të paraqesë dhe një material për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e prapambetura të palikujduara të raportuara në MFE në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 837,517,800 lekë, të cilat nuk rakordojnë me gjendjen e llogarive të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit për vlerën 71,755,707 lekë. Gjithashtu në vlerën e detyrimeve të raportuara në MFE nuk është përfshirë vlera e detyrimeve të lindura nga shpronësimet në shumën 12,243,728 lekë. Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e

trashëguara ndër vite dhe gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në celje të vitit buxhetor 2022 detyrimet e prapambetura kanë vlerën 820,048,291 lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime në vlerën 381,192,912 lekë dhe është likuiduar vlera prej prej 363,723,403 lekë, duke mbetur 17,469,509 lekë. Peshën më të madhe të detyrimeve të prapambetura e përbëjnë detyrimet për 177 fatura të palikuiduara për mallra e shërbime në vlerën 673,029,991 lekë, ku 151 fatura janë për furnizimin me energji elektrike në vlerën 651,369,856 lekë të krijuara në vite nga Bashkia dhe ish-Komunat, që pasohet nga detyrimet e për vendime gjyqësore në vlerën 45,616,172 lekë, detyrimet për investime në vlerën 83,243,425 lekë dhe detyrimin e pa shlyer në vlerën 35,628,212 lekë për “Huanë afatgjatë” të marrë për programin e strehimit.

Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 43 % kundrejt fondeve të miratuara dhe kundrejt shpenzimeve faktike është 57%, situatë e cila tregon se, Bashkia Kavajë mund të konsiderohet në vështirësi financiare, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është mbi nivelin prej 25 %. Për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në Buxhetin e Bashkisë janë bërë shtesë fondesh në vlerën 146,128,000 lekë, ku 20,000,000 lekë nga të ardhurat e Bashkisë dhe 126,128,000 lekë shtesë fondi nga Pushteti Qendror, fonde këto, që kanë një peshë specifike të ulët në vlerën e detyrimeve prej 837,517,800 lekë. Pra nga Bashkia Kavajë nuk është bërë një punë e mjaftueshme për daljen nga situata e vështirësisë financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3, me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 52, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 meligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 56.Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, pika 3.3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 41-84 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet. Gjithashtu të përgatitet një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe paraqitja në Këshillin Bashkiak një material për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale dhe sipas programeve, dhe të hartojë një grafik likuidimi, duke zbatuar radhën e pagesave,ku të shqyrtohen të gjitha mundësitë dhe rriten burimet e financimit, duke përdorur fondin rezervë dhe të kontingjencës, rishikimin e buxhetit, rritjen e nivelit të të ardhurave si dhe negociminin me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të palikuiduara.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 411 “Personeli, paradhenie, deficite, gjoba” paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 1,907,396 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,839,350 lekë. Gjendja e kësaj llogarije në rastin konkret paraqet vlerat debitore për kopshtet, cerdhet dhe

ujsjellësin. Llogaria 411 “ Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që, debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitoare të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në kredi të llog.4341“Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” I ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 pikat 3.3 dhe 4.2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.3 faqe 84-103 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 1,907,396 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2023 me artikujt kontabël në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, në kredi të llog.4341“Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në considerate, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Brenda datës 31.03.2024

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 681,029,205 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 708,667,017 lekë me një rritje në vlerën 27,637,812 lekë. Referuar analizës së kësaj llogarije rezulton se në gjendjen e saj janë përfshirë debitorët nga taksat dhe tarifrat për të gjithë taksapaguesit, debitorë nga kopshte e cerdhe dhe tarifrat e licencimit të karburanteve si dhe debitorë nga gjobat e IMTV, por nuk janë kontabilizuar debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.3 faqe 84-103 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë, duke përfshirë në gjendjen e llog.468 “debitorë të ndryshëm” debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërblim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

Brenda datës 31.03.2024

7. Gjetje nga auditimi: Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik.. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II

pika16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi pika 2 Klasa 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.3 faqe 84-103 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë vlerën prej 122,396,352 lekë AA jo materiale duhet të realizojë inventarin kontabël sipas investimeve përkatëse dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

Brenda datës 31.03.2024

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) ta klasës për vitin 2022 është në vlerën 5,401,479,838 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2022 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Për inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: llog.210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 35,028,041 lekë; llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 10,971,000 lekë, llog.212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,522,137,366 lekë ; llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 3,436,901,550 lekë; llog.214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 65,120,148lekë; llog.215 “*Mjete Transporti*” në vlerën 80,921,253 lekë; llog.218 “*Inventar Ekonomik*” në vlerën 121,834,343 lekë nuk ka analiza të sakta e të plota dhe konstatohen gabime në klasifikimet kontabël të aktiveve në gjendjet e llogarive respektive. Gjithashtu ka paqartësi në përcaktimet e emertesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve dhe pakësimet të secilit aktiv. Në këto inventare kontabël janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2022 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emertesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo emertese aktivi. Mungon rregjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), dhe Nomenklatura e llogarive të planit kontabël publik (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.3 faqe 84-103 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të marrë masa që të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit dhe duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve në llogaritë përkatëse, sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, të bëjë rakordimin e inventareve të tyre si dhe përcaktimin e plotë të vlerës së plotë të cdo aktivi, që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe pakësimet, shoqëruar me korrektimet kontabël për amortizimet, si dhe duke i finalizuar me evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.

Brenda datës 31.03.2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi i fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, Bashkia Kavajë”, “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C”, “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M”, “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë”, “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, Qyteti Kavajë”, zhvilluar në periudhën 2021-2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 103-155 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 6 raste, në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjisllacionin e prokurimit publik në vlerën totale 2,095,628,721 lekë, konkretisht si vijon:

1-Në procedurën e prokurimit me objekt “Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi I fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, bashkia Kavajë”, me vlerë të fondit limit 153,589,733 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE A.K SHPK, me ofertë 151,463,880 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C”, Bashkia Kavajë, me vlerë të fondit limit 116,739,459 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021”, është shpallur fitues operatori ekonomik B P E SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 116,413,160 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi I pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz i Vogël dhe Helmas”, me vlerë të fondit limit 550,395,505lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues A A I G SHPK me ofertë 549,298,645 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M”, Bashkia Kavajë, me vlerë të fondit limit 151,236,283 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues B P E SHPK, me ofertë 150,717,562 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

5- Në procedurën e prokurimit me objekt “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë”, Bashkia Kavajë, me vlerë të fondit limit 594,823,787 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022,

është kualifikuar dhe shpallur fitues G SH N SHPK, me ofertë 594,114,139 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

6- Në procedurën e prokurimit me objekt “Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të, Qyteti Kavajë”, me vlerë të fondit limit 528,843,954 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues F G B SHPK, me ofertë 528,843,954 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa (a) dhe Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 103-155 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Kavajë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të auditimit në lidhje me 9 procedurat e prokurimit të marra me zgjedhje, dhe të realizuara me “vlerë e vogël” u konstatua se; Në të gjitha rastet e blerjeve mall, shërbime e punë publike, me OE i shpallur fitues, është lidhur kontrata e shërbimit dhe blerjes me afate dhe kushte të realizimit ndërsa në rastet për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është ngritur komision nga titullari. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar. Veprime e mësipërme janë në mospërputhje me Pikën 42, 43, 52, 53, 54 të UMF 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1, faqe 103-155 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Titullari i Njësise Vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre anëtarë, duke përfshirë edhe punonjës in me përgjegjësi materiale.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e disa prej tyre si vijon:

a. Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se lartësia e katit përdhe në projektin e miratuar është më madhe se lartësia e lejuar në planin e përgjithshëm vendor, për lejet e ndërtimit me të dhënat:

-“Leja me nr.prot 4174 me zhvillues Bonita Konstruksion, me objekt “Strukturë Turistike 5 Kat, me 2 Kate Nëntokë dhe Ambiente Teknike ”, me vendndodhje në Golem, Bashkinë Kavajë.

-Leja me nr.prot 3828, zhvillues “L I”, leja e ndërtimit për objektin “Strukturë akomoduese 5 kateshe +ambjente teknike dhe 1 kat nentoke parkim”, adresa e realizimit të punimeve: Njësia Administrative Golem, Kavajë.

-Leja e ndërtimit me nr. Prot 3601, zhvilluesi I.D, Strukturë akomoduese dhe ambjente shërbimi 5 kate me 1 kat nentoke adresa e realizimit të punimeve: Njësia Administrative Golem , Kavajë”.

b. Nga kontrolli në sistemin e-leje, u konstatua se lejet e ndërtimit të miratuara janë në mospërputhje me planin e përgjithshëm vendor konkretisht me numrin e lejuar të kateve ose numrin maksimal dhe konkretisht për lejet e ndërtimit me të dhënat:

-Leja me nr.prot 4174 me zhvillues Bonita Konstruksion, me objekt “Strukturë Turistike 5 Kat, me 2 Kate Nëntokë dhe Ambiente Teknike” , me vendndodhje në Golem, Bashkinë Kavajë;

-Leja me nr.prot 3828 zhvillues L I, për objektin “Strukturë akomoduese 5 katëshe +ambjente teknike dhe 1 kat nëntokë parkim”, adresa e realizimit të punimeve: Njësia Administrative Golem, Kavajë;

-Leja 3827 zhvillues: Shoqëria ABpër objektin: Objekt banimi, 6 kat (kati përdhe apartamente + dyqane) + 1 kat nëntokë, adresa e realizimit të punimeve: Njësia Administrative Golem, Kavajë;

- Leja me nr.prot 3298 zhvillues e-2021, për objektin: struktura shërbimi akomoduese dhe hoteleri 1,2,3,4 kate, ku kati përdhe duplex+1 kat nëntokë;

-Leja me nr.prot 3045 zhvillues B.Bnë pronë të b/pronarëve Gjerga, objekt banimi dhe shërbimi me 8 kate mbi tokë, 2 kate parkim nëntokë” (faza 1): Qerret, Kavajë.

-Leja më nr 3936 zhvilluesit: B.Bpër objektin: “Strukturë Turistike 8 Kat, me 3 Kate Nëntokë”, adresa e realizimit të punimeve: Kryemëdhenj , Njësia Administrative Golem, Kavajë”.

c. Nga kontrolli në sistemin e-leje, u konstatua se nuk është respektuar distanca midis objektit dhe kufirit të pronës, për lejet e ndërtimit me të dhënat:

-Leja me nr.prot 3828 zhvillues L I për objektin “Strukturë akomoduese 5 katëshe +ambjente teknike dhe 1 kat nëntokë parkim”, adresa e realizimit të punimeve: Njësia Administrative Golem , Kavajë;

-Leja me nr.prot 3298 zhvilluesit: e-2021, për objektin: Struktura shërbimi akomoduese dhe hoteleri 1,2,3,4 kate, ku kati përdhe duplex+1 kat nëntokë;

-Leja me nr.prot 3045 zhvillues : B.Bne prone : te b/pronareve gjerga objekt banimi dhe shërbimi me 8 kate mbi tokë, 2 kate parkim nëntokë” (faza 1) : Qerret , Kavajë.

-leja me nr.3266, zhvilluesi shpk, me objekt Strukturë akomoduese 5 kate + 1 kat shërbime+ 1 kat nëntokë dhe sistemin kanali, Njësia Administrative Golem, Kavajë;

-Leja me nr.2794, zhvilluesi Epidamn-b, për objektin: Hotel 7 kat (duplex) + pishinë + 2 kate nëntokë, adresa e realizimit të punimeve: Golem, Kavajë”.

d. Nga kontrolli në sistemin e-leje lejen e ndërtimit me të dhënat: Leja e ndërtimit me nr.prot 3828 zhvillues L I për objektin “Strukturë akomoduese 5 katëshe +ambjente teknike dhe 1 kat nëntokë parkim”, adresa e realizimit të punimeve: Njësia Administrative Golem , Kavajë, u konstatua se planvendosja e miratuar nuk është e saktë pasi nuk është pasqyruar objekti kufitar 5 katësh që ndodhet në perëndim të këtij objekti;

e. Nga kontrolli në sistemin e-leje, u konstatua se kontrata e lidhur mes palëve dhe projekti i miratuar nuk përputhen, pasi në kontratë citohet se kemi të bëjme me objekt banimi+shërbim, ndërkohë projekti dhe leja e miratuar janë strukturë akomoduese, për lejet e ndërtimit me të dhënat:

-Leja me nr. prot 4170 me zhvillues SH P, Objekt banimi 4-kate + 1 kat shërbime (përdhe) + 1 kat podrum nëntokë, adresa e realizimit të punimeve, Njësia Administrative Golem , Kavajë;

-Leja me nr.prot 3828 zhvillues L I për objektin “Strukturë akomoduese 5 katëshe +ambjente teknike dhe 1 kat nëntokë parkim”, adresa e realizimit të punimeve: Njësia Administrative Golem , Kavajë;

-Leja me nr.prot 3298, zhvilluesi e-2021, për objektin Struktura Shërbimi akomoduese dhe hoteleri 1,2,3,4 kate, ku kati përdhe duplex+1 kat nëntokë”.

f. Nga kontrolli në sistemin e-leje, u konstatua se nuk është respektuar koeficienti i shfrytëzimit të territorit, për lejet e ndërtimit me të dhënat:

-Leja me nr. Prot 3690. zhvilluesit: E.F.K, për objektin Strukturë akomoduese 4-kat+podrum, adresa e realizimit të punimeve Golem, Kavajë;

-Leja me nr.3266 zhvilluesit: Shpk Strukturë akomoduese 5 kate + 1 kat shërbime+ 1 kat nëntokë dhe sistemim kanali Njësia Administrative Golem, Kavajë.

g. Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejen e ndërtimit me të dhënat: Leja me nr.3266, zhvilluesi Shpk, me objkt Struktura akomoduese 5 kate + 1 kat shërbime+ 1 kat nëntokë dhe sistemim kanali Njësia Administrative Golem, Kavajë, u konstatua se ka një ngritje të kuotës +0.00 në +1.5 metër nga kuota e sistemimit.

h. Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat: Leja me nr. 3903, zhvillues k.h për objektin: Shtesë anësore hotel 5-kat+podrum, adresa e realizimit të punimeve Njësia Administrative Golem, Kavajë, u konstatua se projekt propozimi nuk ka marrë miratimin nga AZHT (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1, faqe 177-183 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Nga DPKZHT Kavajë të merren masa që në të ardhmen të trajtojnë leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, të respektohen kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm për distancat nga objektet, nga rrugët kryesore, nga kufitarët, numri dhe lartësitë e kateve, si dhe të merret miratimi nga AZHT .

Menjëherë dhe ne vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV rezulton se në 97 raste është konstatuar se kanë mbajtur proces-verbal kundravajtje dhe kanë dalë me vendime gjobe, në 94 raste është mbajtur proves-verbal kundravajtje është mbajtur dhe vendim me gjobë por në tre raste nuk është mbajtur vendim prishje në kundërshtim me ligjin 9780 për për inspektimin dhe kontrollin e territorit, Neni 5 “Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore”.

Në asnjë rast për periudhën e vitit Janar 2021 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2022, proces-verbali i kundravajtjes nuk është shoqëruar me imazhe fotografike apo sqarim të detajuar të situatës së konstatuar nga ana e inspektorëve të IMTV dhe Kryeinspektorit, për të provuar qartësisht shkeljet. Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve në territor nga ky inspektorat dhe nuk ka evidence shpresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundëshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m2 të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijojnë aktivitetin e ndërtim kryesisht në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare si në planin urbanistik apo atë të ruajtjes së mjedisit. Për një periudhë 18 mujore nga fillim viti 2021 e deri në korrik 2022 rastet e konstatuara nga ndërtimet në kundërshtim me ligjin janë shumë të larta, *shkak ky i menaxhimit të dobët nga drejtuesit e IMTV*-së për këtë periudhë, e që për pasojë ka sjellë efekte negative në këtë drejtim. Mos mbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore bëhet shkak

për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por edhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksat e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja. Këto mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” (ndryshuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010, nr.10 323, datë 23.9.2010; nr. 23/2013, datë 14.2.2013; nr. 183/2014, datë 24.12.2014), neni 12 “Ushtrimi i kontrollit”, pika 5. “Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës të konstatimit dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar” dhe VKM Nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 4. Kryeinspektori/inspektori i inspektoratit të njësisë vendore, pas kontrollit në objekt apo në vendin ku kryhen punimet, mban procesverbalin, ku pasqyrohen gjendja aktuale, mangësitë dhe detyrat për subjektin ndërtues, dhe, për shkeljet e vëna re, zbaton procedurat ligjore në përputhje me nenin 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.6 faqe 183-185 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV të marrë masa që në bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësisë vendore, apo dhe cdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare si bregdet, pyje apo zona të mbrojtura.

Menjëherë dhe në vijimësi.

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezultoi se janë lënë dhe janë pranuar 39 rekomandime për përmirësimin e gjendjes, nga të cilat:

- 21 masa organizative, janë zbatuar 10 rekomandime, është në proces 1 rekomandim, janë zbatuar pjesërisht 4 rekomandime, si dhe 6 rekomandime janë të pazbatuara.

- 17 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.

janë zbatuar 5 rekomandime, janë në proces 9 rekomandim, janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, si dhe 1 rekomandim është i pazbatuar.

- 1 Masë disiplinore, e zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 186-208 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për shpejtimin e masave në proces zbatimi, si dhe zbatimin e plotë të masave të pazbatuara dhe atyre të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Kavajë.

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kavajë.

Menjëherë

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Në vazhdimësi

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Në vazhdimësi

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të marrë masat e nevojshme për shitjen e aksioneve që zotëron në dy klubet e futbollit B dhe Luz i Vogël. Në rast se nuk realizohet procesi i shitjes së tyre, atëherë me Vendim të Këshillit Bashkiak, klubet e mësipërme duhet të krijohen nga e para, në formën e një shoqate sportive amatore.

Menjëherë

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, për vlerën 18,359,452 lekë.

Mejnëherë

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrimit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Në vazhdimësi

14.3. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investim në program kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

Në vazhdimësi

14.4. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Juridike të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim shmangien e mbivendosjes dhe përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

Menjëherë

15.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

12.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 7,440 mijë lekë.

Në vazhdimësi.

13.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Kavajë të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,320 mijë lekë.

Menjëherë.

14.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastës Urbane Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme, që procedura e dhënies me qira të dyqaneve të bëhet nëpërmjet konkurrimit publik. Gjithashtu të bëjë ndryshimin e formatit të kontratave në përputhje me përcaktimet ligjore, si dhe lidhjen e tyre nga e para me 14 subjektet qiramarrës.

Në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve në kontratat publike rezultoi se në 3 raste, konkretisht në objektet e mëposhtëm:

1- “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C”, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës 116,413,160 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021”,

2- “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M”, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës 150,717,562 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021 dhe

3- “Rikualifikimi i Qendrës Kulturore “A.M”, Bashkia Kavajë”, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 41,046,891 lekë,

certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 13.07.2022, është nënshkruar nga përfaqësuesi i paautorizuar i investitorit z. A.M me profesion jurist dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. R.K Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndrshuar kapitulli “Marrja ne dorezim e aktiveve të furnizuara” pika 41, 42, sipas të cilave “42. Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara per sasinë, cilësinë, llojin, plotesine e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues.

43. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushes sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm.....” (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 103-155 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Kavajë, të marrë masa që në të ardhmen, për marrjen në dorëzim të investimeve publike, të ngrejë grupe pune me specialistë të fushës së ndërtimit, në mënyrë që kontrolli i cilësisë së punimeve të bëhet sa më korrekt dhe objektet publike të investuara të vihen në shërbim të komunitetit në kohë dhe me cilësinë e duhur.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 11 procedurave me fond limit 2,135,510 mijë lekë të vlerësuara për auditim, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 6 procedura me vlerë të fondit limit 2,095,110 mijë lekë ose 98.1% e vlerës së fondit limit të audituar, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimi të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO është në paligjshmëri të dispozitave të LPP dhe duhej të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e 6 kontratave në vlerën totale 2,090,851 mijë lekë pa TVSh, me operatorë ekonomikë të shpallur fitues në papajftueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht në procedurat:

1- **Procedura me objekt** *“Riparimi impiantit të ujërave të zeza Kavajë dhe ujësjellesi I fshatit Luz, lidhjet dhe matësat familjare, bashkia Kavajë”*, me fond limit 153,589,733 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 4 OE, ku është kualifikuar 1 OE, duke shpallur fitues shoqërinë “A. K.n” me ofertë 151,463,880 lekë.

2- **Procedura me objekt** *“Shërbimi I pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz I Vogël dhe Helmas”*, me fond limit 550,395,505 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, ku janë kualifikuar 1 OE dhe skualifikuar 1 OE, duke shpallur fitues A A I G SHPK me ofertë 549,298,645 lekë.

3- **Procedura me objekt** *“Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C”*”, me fond limit 116,739,459 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 6 OE/BOE, ku janë kualifikuar 3 OE dhe skualifikuar 3 OE, duke shpallur fitues BOE “B” ShPK & “P” ShPK & “E.S” ShPK me ofertë 116,413,160 lekë.

4- **Procedura me objekt** *“Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M”*”, me fond limit 151,236,283 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 10 OE/BOE, ku janë kualifikuar 8 OE dhe skualifikuar 2 OE, duke shpallur fitues BOE “B” ShPK & “P” ShPK & “E.S” ShPK me ofertë 150,717,562 lekë.

5- **Procedura me objekt** *“Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë”*, me fond limit 594,823,787 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE/BOE, ku janë kualifikuar 2 OE, duke shpallur fitues G SH N SHPK me ofertë 594,114,139 lekë.

6- **Procedura me objekt** *“Riforcimi I njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të”*, me fond limit 529,517,613 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 3 OE/BOE, ku janë kualifikuar 3 OE, duke shpallur fitues F G B SHPK me ofertë 528,843,954 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19/05/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 103-155, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën

edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,606,856 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës 116,413,160 lekë pa TVSH, fituar nga BOE “B” & “E.S” SHPK & “P” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likuiduara në vlerën 2,579,457 lekë pa tvsh, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe BOE “B” & “E.S” SHPK & “P” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 155-177 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,579,457 lekë pa tvsh** nga BOE “B” & “E.S” SHPK & “P” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021, me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës 150,717,562 lekë pa TVSH, fituar nga BOE “B” & “E.S” SHPK & “P” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likuiduara në vlerën **2,933,868 lekë pa tvsh**, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe BOE “B” & “E.S” SHPK & “P” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 155-177 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,933,868 lekë pa tvsh** nga BOE “B” & “E.S” SHPK & “P” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “A.M””, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt

“Rikualifikimi i qendrës Kulturore “A.M”, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 41,046,891 lekë, fituar nga BOE “D” & “Z” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likuiduara në vlerën 1,179,291 lekë pa tvsh, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe BOE “D” & “Z” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 155-177 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,179,291 lekë pa tvsh** nga BOE “D” & “Z” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021, me objekt “Rikualifikimi i qendrës Kulturore “A.M”, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 23,275,216 lekë, fituar nga OE “B” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likuiduara në vlerën 1,914,240 lekë pa tvsh, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe OE “A.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 155-177 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,914,240 lekë pa tvsh** nga OE “B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020, me objekt “Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë”, Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, me fond limit 116,739,459 lekë, u konstatua se Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga struktura projektuese e Bashkisë Kavajë dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kavajë.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se ka gabime të konsiderueshme në vlerat e zërave të punës. Kështu vetëm nga auditimi i dy kapitujve “Punime dyer dritare” dhe “Punime të sistemimit të sheshit”, është shtuar fondi limit në shumën 7,248,258 lekë pa TVSH, duke shkaktuar përdorim pa ekonomikitet të fondeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 111-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përlogaritjen e gabuar të fondit limit, e cila ka sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve në vlerën 7,248,258 lekë pa TVSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 505,034 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 564,214,030 lekë ose në masën 112%. Nga analiza në nivel zërash konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, ndërkohë që edhe në vitin paraardhës realizimi i disa taksave ka qenë më në nivel më të lartë se plani. Referuar krijimit dhe realizimit të të ardhurave, tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, nuk pasqyron saktë bazën e taksueshme, e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë, rezulton se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, fermerët vlerë e cila nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2021 vlera e debitore është 681,029,206 lekë. Gjatë vitit 2022 vlera e debitore taksave dhe tarifave e krijuar është 104,306,503 lekë për 11,138 subjekte gjithsej. Në fund të vitit 2022 vlera debitorëve në mënyrë progresive për taksa dhe tarifa është në vlerën 705,827,865 lekë.**Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore Bashkia Kavajë nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk është kryer sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr.9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-82 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit të merren masa që planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale, i studiuar dhe i argumentuar, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimin të tyre duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga kategoria “familjar për taksën e ndërtesës, dhe tarifave pastrim-shërbimi, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”. Pra planifikimi i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, nuk është bërë i saktë, pasi nga informacionin i Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë Kavajë rezulton se, në regjistrin e kësaj kategorie tatimpaguesish nuk janë përfshirë 12357 familje për Qytetin Kavajë dhe NJA. Nga përlllogaritjet për Qytetin e Kavajës vetëm për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, për numrin e prej 11,329 familjeve të pataksuara, është planifikuar 30,398,220 lekë më pak të ardhura. Përsa i përket arkëtimin për familjarët për taksën e ndërtesës e truallit, tarifave pastrim-ndricim-gjelbërim-arsim konstatohet se vlera debitorë progresive në Bashkinë Kavajë dhe NJA në celje të vitit 2022 është 305,659,846 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 262,750,741 lekë, që i përkasin 10,677 familjeve

debitore, nga të cilat 6417 familje për vlerën 30,448,469 lekë janë debitorë të krijuar brenda vitit 2022. Situata e mësipërme, është krijuar për arsye se në vitin 2020 është ndërprerë marrëveshja e bashkëpunimit me UK Sh.A Kavajë, i cili ka patur rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” si dhe mungesat e një regjistri të përditësuar të kategorisë “Familjar” me të dhënat e plota për taksapaguesin: adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, etj. Praktikisht Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit takson vetëm ato familje të cilat kanë një aktivitet ekonomik si dhe ato individë, që paraqiten për marrjen e shërbimeve në Bashki, pasi vetëm tek kjo kategori e ka të mundur identifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”. Kreu II, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, neni 42/2, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 dhe neni 24 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-82 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë të marrë masa për plotësimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme të regjistrit të taksapaguesve vendorë të kategorisë “Familjar” për Bashkinë Kavajë dhe NJA si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real. Gjithashtu të merren masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2022 realizimi i taksës së tokës bujqësore për Bashkinë Kavajë paraqitet në vlerën 17,2523 mijë lekë nga 20,380 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85%. Në lidhje me planifikimin e kësaj takse u bë kryqëzimi i bazës së të dhënave mbi të cilin është kryer planifikimi nga DAV Bashkia Kavajë dhe informacionin e administruar nga agronomët e NJA mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, familjet që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore dhe kategorinë e bonitetit, sipas NJA, nga ku rezultoi se planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të bëhet për vlerën 26,198,107 lekë, ndërkohë që nga DAV planifikimi është bërë për 5,818,107 lekë më pak. Gjithashtu duhet theksuar se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi, pasi në këtë regjistër nuk janë kryer përditësimet për çdo vit ushtrimor. Përsa i përket arkëtimin të taksës bujqësore u konstatua se detyrimet debitorë progresive për Bashkinë Kavajë dhe NJA në celje të vitit 2022 janë në vlerën 173,843,504 lekë dhe në fund të vitit 2022 janë në vlerën 197,571,584 lekë, ndërsa vetëm **gjatë vitit 2022** janë krijuar detyrime debitorë **në vlerën 31,947,682 lekë**, që i përkasin 6846 familje fermere debitorë. Krijimi dhe rritja e debitorëve në lidhje me arkëtimin e taksës bujqësore, ka ardhur për arsye se familjet fermerë nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre. Praktikisht arkëtimi i kësaj takse mundësohet vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore aplikon në Bashki për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar dhe realisht DAV familjet fermere të cilat taksohen për tokën bujqësore nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 3 neni 4, pikat 1 dhe 7, neni 23 dhe neni 24, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 12 pika 1 dhe me VKB nr.95, datë

25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, Kreu I, shkronja “b” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-82 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë në bashkëpunim dhe me specialistët të Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike në NJA, të marrë masa për saktësimin e të dhënave për tokën bujqësore e dhënë në përdorim/pronë si dhe përditësimin e regjistrit të taksapaguesve fermerë për taksën bujqësore për Bashkinë Kavajë dhe NJA, si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real dhe të argumentuar. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat e tokës ndaj familjeve fermere debitorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës rezulton se, Bashkia Kavajë ka korespondencë zyrtare me Drejtorinë Vendore e ASHK Zonat e Stimuluara (bregdetare) për legalizimet e kryera për ndërtimet informale në zonat e Stimuluara (bregdetare). Ndërkohë Bashkia Kavajë nuk ka informacion dhe nuk disponon dokumenta me të dhëna për të gjitha legalizimet e kryera në vitet 2021-2022 të ndërtimeve informale të ndodhura në territorin nën juridiksionin e saj, pasi nuk ka korespondencë me DVASHK Kavajë, me qëllim vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje nga individë të ndryshëm. Borxhi tatimor në lidhje me mos arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i ndërtimeve pa leje në zonat e stimuluar *për vitin 2022 për 204 individë është në vlerën 6,490,083 lekë dhe në mënyrë progresive (vitet 2019-2022) për 1278 individë është në vlerën 59,177,496 lekë*, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë. Për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit, me qëllim që, subjektet debitorë për taksën së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, t’i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesatë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesatë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vlerat e zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr.95 datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës Fiskale për vitin 2022” Kreu I, pika 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-82 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 59,177,496 lekë të taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Kavajë të bashkëpunojnë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), që krahas legalizimeve në zonat e stimuluar të marrë informacion periodik për të gjitha legalizimet, që kryhen në territorin e Bashkisë Kavajë si dhe të kërkojë nga subjektet kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Kavajë kanë seli dhe ushtrinë aktivitet në fushën e tregimit të karburanteve dhe shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë 22 subjekte private. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit rezultoi se, Bashkia Kavajë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet, që ushtrinë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe në pjesën më të madhe ka dhënë autorizime 1 vjecare, ndërkohë që autorizimi sipas dispozitave ligjore është 5-vjecar, për krijimin e mundësisë që subjektet për detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Nga 22 subjektet që ushtrinë aktivitet si pikë shitjeje me pakicë të hidrokarbureve **për vitin 2022** në 7 raste subjektet ushtrinë aktivitetin në mungesë të autorizimit të licencimit për ushtrim aktiviteti dhe 1 subjekt është I mbyllur që ka detyrim të prapambetur, gjë që ka sjellë mosarkëtimin e të ardhurave **në vlerën prej 5,800,000 lekë** pavarësisht njoftimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, = kapitulli II, pika 1; gërma “b” dhe pika 9 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-82 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit të shqyrtojë dokumentacionin e 8 subjekteve debitore dhe të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur të tarifës së autorizimit prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Kavajë për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022, si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur arkëtimet e plota brenda afateve. Për rastet e mosparaqitjes të subjekteve për paisje me autorizim/licencë të bëhet njoftimi i Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve, që ushtrinë aktivitet në mungesë të autorizimit për lejim aktiviteti.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kavajë me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe DAV Bashkia Kavajë, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj), duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kavajë në vlerën 13,009,282 lekë, konkretisht:

a. Nga mosarkëtimi për vitin 2022 i vlerës së qirasë takuese prej 23,940 lekë për përdorim të pasurisë llojit “Dyqan” nga moslidhja e 1 kontrate qiraje nga Bashkia Kavajë me përdoruesin.

b. Nga mospagesa e tarifës së qirasë nga 16 individë sipas kontratave të qiradhënies të banesave sociale për vlerën debitore të mbetur prej 3,975,040 lekë, ku në 5 raste është lidhur aktmarrëveshje për likuidimin e borxhit me këste dhe 1 rast kontrata është prishur;

c. Nga mospagesa e vlerës debitore prej 45,000 lekë të tarifës së qirasë për tre vjet (2020-2022) në 1 rast prej kontratave të lidhura për dhenien me qira të parcelave të fondit të tokave të pandara.

d. Nga mospagesa e vlerës debitore prej 8,986,848 lekë të tarifës së qirasë (për periudhë 10 vjet) në 2 raste prej kontratave të lidhura për dhenien me qira të parcelave të fondit pyjor. Gjithashtu në 6 raste kontratash janë lidhur me afat nga 12 vjet deri në 38 vjet, ndërkohë që, afati për dhënien në përdorim me qiradhënie të parcelave pyjore afati është deri në 10 vjet.

Nga NJA përkatëse për debitorët janë bërë njoftime me shkresë zyrtare për detyrimet që kanë për tarifafat e pa paguara të qirasë, por nga Bashkia Kavajë nuk janë ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për detyrimin e shlyerjes së detyrimeve kontraktore të qiramarrësve. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Pjesa IV, Kreu I “Kuptimi dhe lindja e detyrimeve” nenet 420-422, Pjesa V “Kontratat” Titulli I, Kreu I neni 662, Kreu III, neni 690, neni 693, neni 698-704, dhe me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 32, VKM nr .1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” Shtojca “Për tarifafat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave tarifafat bazë të lëndës drusore në këmbë” Lidhja 1/a, pika 5 dhe me ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, për banesat sociale” neni 31 dhe me nenin 5 “Çmimi dhe mënyra e pagesës” të kontratës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-82 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Kavajë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 13,009,282 lekë** dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave dhe nëse në rastet ku është e pamundur arkëtimi i debitorëve të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke parë dhe si mundësi anulimin e kontratave. Ndersa në rastet e kontraktimit të parcelave pyjore me afat mbi 10 vjet të shikohet mundësia e rishikimit dhe amendimit të tyre me palët për korrektimin e këtyre kontratave sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në paketën fiskale për vitin 2022, konkretisht në Kreun II.5 “Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit”, është përcaktuar niveli i tarifës 300 lekë/m²/3 muaj, ku sipas këëtij dokumenti Bashkia Kavajë e ka konsideruar sezonin turistik 3 muaj, ndërkohë që me ndryshimet e dispozitave ligjore rezulton se aktiviteti i stacionit të plazhit minimalisht duhet të zgjasë 5 muaj në vit, që do të thotë 2 muaj më tepër nga çfarë ka përcaktuar Bashkia Kavajë në paketën fiskale. Kjo situatë ka ndikuar në planifikimin e gabuar të kësaj takse, e për pasojë ka sjellë reduktimin e të ardhurave në fakt nga dhënia me qira e hapësirës së plazhit në vlerën 26,797,800 lekë e përlllogaritur sipas sipërfaqes së kontraktuar. Në paketën fiskale të vitit 2023 është korrektuar sezoni turistik nga 3 muaj në 5 muaj, por nuk është ndryshuar tarifa prej 300 lekë/m²/5 muaj, ndërkohë që janë rritur cmimet në treg në krahasim me vitet e mëparshme, duke mos i shërbyer rritjes së të ardhurave nga tarifa e zënies së hapësirës së plazhit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017 datë 24.07.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar neni 14 dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-82 të Raport Përfundimtarit të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Kadastrës Urbane e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke bërë ndryshimin në paketën fiskale të kohëzgjatjes së qiradhënies së hapësirës së plazhit (minimalisht 4-5 muaj me çmimin 100 lekë/m²/muaj) me qëllim rritjen e të ardhurave që arkëtohen nga tarifa e qiradhënies për objektin e mësipërm, si dhe eliminimin e efekteve negative financiare në buxhetin e Bashkisë Kavajë.

Brenda datës 31.12.2023

F. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 4 faqe 84-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë** që në zbatim të nenit 132, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, **t’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **10 (dhjetë) punonjësve**, si më poshtë:

1. Z. G. K, me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë Kavajë.

2. Z. A.M, me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Kontratave.

3. Z. G.T, me detyrë specialist ne DPZHKT.

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në procedurat me objekt:

- “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz I Vogël dhe Helmas”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

- “Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, ku OE i shpallur fitues është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST, si dhe ka bërë ndryshime thelbësore në preventivin e punimeve të hedhur në SPE, duke hequr gjithë kapitullin “Punime Betoni”, në vlerë 21,957,653 lekë dhe duke shtuar zëra pune që nuk ndodhen në Preventivin e hedhur në sistem (3 zëra pune në kapitullin N “Punime të sistemimit të sheshit” që kanë të bëjnë me nivelimin dhe shtrimin e sheshit me vlerë totale rreth 13,500,000 lekë pa TVSH), si dhe duke ndryshuar sasitë e disa zërave të punës;

- “Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare “A.M””, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

- “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

- “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

3. Z. D.H, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në procedurat me objekt “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

- “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë dhe NjA Synej, Luz I Vogël dhe Helmas”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

- “Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

4. Z. G.T, me detyrë specialist ne Drejtorinë e Urbanistikës.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në procedurat me objekt:

- “Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare “R.C””, ku OE i shpallur fitues është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST, si dhe ka bërë ndryshime thelbësore në preventivin e

punimeve të hedhur në SPE, duke hequr gjithë kapitullin “Punime Betoni”, në vlerë 21,957,653 lekë dhe duke shtuar zëra pune që nuk ndodhen në Preventivin e hedhur në sistem (3 zëra pune në kapitullin N “Punime të sistemimit të sheshit” që kanë të bëjnë me nivelimin dhe shtrimin e sheshit me vlerë totale rreth 13,500,000 lekë pa TVSH), si dhe duke ndryshuar sasi të disa zërave të punës;

- “*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “A.M”*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar/nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

5. Z. E.A, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve.

6. Znj. M.D, me detyrë specialist i Sektorit të Prokurimeve.

7. Znj. H.S, me detyrë specialist në Drejtorinë e Urbanistikës.

- Në cilësinë e anëtarëve të NjP, për shkeljet e konstatuara në procedurat me objekt:

- “*Blerje automjetesh*”, ku janë vendosur kriterë të veçanta kualifikimi jo në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet;

- “*Rikonstruksion i rrugëve të qytetit*”, ku janë vendosur kriterë të veçanta kualifikimi jo në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet;

8. Z. J.H, në cilësinë e specialistit të fushës për vendosjen e kriterëve teknike të kualifikimit në procedurat e prokurimit:

- “*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C”*”, ku OE i shpallur fitues është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST, si dhe ka bërë ndryshime thelbësore në preventivin e punimeve të hedhur në SPE, duke hequr gjithë kapitullin “Punime Betoni”, në vlerë 21,957,653 lekë dhe duke shtuar zëra pune që nuk ndodhen në Preventivin e hedhur në sistem (3 zëra pune në kapitullin N “Punime të sistemimit të sheshit” që kanë të bëjnë me nivelimin dhe shtrimin e sheshit me vlerë totale rreth 13,500,000 lekë pa TVSH), si dhe duke ndryshuar sasi të disa zërave të punës;

- “*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “A.M”*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

- “*Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e I-rë*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

- “*Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar në shkallë dëmtueshmërie DS4, Faza e II-të*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST;

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar/neni 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

9. Znj. D.Q, me detyrë drejtore e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit (DPZHKT)

10. Z. S.Vu me detyrë specialist në DPZHKT

në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për përllogaritjen e fondit limit, pasi në preventivin e objektit “*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “R.C”*”, në kapitujt “Punime dyer dritare” dhe “Punime të

sistemimit të sheshit”, është shtuar fondi limit në shumën 7,248,258 lekë pa TVSH, duke shkaktuar përdorim pa ekonomikitet të fondeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 84-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

G. MASAT DISIPLINORE

G/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **9 (nëntë) punonjës**, si më poshtë:

a- Masa “Vërejte”, shkronja (a) e nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”

1. Znj. D.Q, me detyrë drejtoreshë e DPZHDK

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për miratim të lejeve zhvillimore dhe lejeve të ndërtimit jo në përputhje me VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, si dhe Planin e Përgjithëm Vendor, konkretisht mosrespektim të distancave të lejuara nga kufiri i pronës dhe nga objekti në objekt, mosrespektimi I numrit të lejuar të kateve,si dhe koeficienti i shfrytëzimit të tokës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Për mos zbatim të kërkesave të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, për objektet që legalizohen, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 1278 persona me vlerë 59,177,496 lekë.

2. Z. S.Vu me detyrë specialist në DPZHDK

3. Z. H.Z me detyrë specialist në DPZHDK

Për shkeljet e mëposhtme:

Për miratim të lejeve zhvillimore dhe lejeve të ndërtimit jo në përputhje me VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, si dhe Planin e Përgjithëm Vendor, konkretisht mosrespektim të distancave të lejuara nga kufiri i pronës dhe nga objekti në objekt, mosrespektimi I numrit të lejuar të kateve,si dhe koeficienti i shfrytëzimit të tokës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4. Zj. M.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhura nga Taksat dhe Tarifave Vendore

Për mangësitë e konstatuara:

- Mos planifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mos pasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhura, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore

- Për mos zbatimimin e kërkesave të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91,93,94 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB për paketën fiskale, duke krijuar gjatë vitit 2022 vlera e debitore për taksa dhe tarifa në vlerën 104,306,503 lekë nga 11,138 subjekte, duke mos realizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore në vlerën 705,827,865 lekë në fund të vitit 2022.

- Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos vjelje e taksës së ndërtesës e truallit, tarifatat pastrim-ndriçim-gjelbërim-arsim të taksapaguesve të kategorisë “Familjar” dhe mos identifikimi i plotë i familjeve që kanë detyrim për këto taksa e tarifa, ku vlera debitorë e progresive në Bashkinë Kavajë dhe NJA në fund të vitit 2022 është në vlerën 262,750,741 lekë, që i përkasin 10,677 familjeve debitore, mangësi këto në kundërshtim me VKB nr.nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” Kreu II, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, neni 42/2, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 dhe neni 24.

5. Z. SH.K, specialist për taksat familjare në NJA Golem,

6. Z.Th.D specialist për taksat në NJA Helmas,

7. Z.A.C specialist për taksat familjare në Luz i Vogël,

8. Zj. E.C specialist për taksat në NJA Synej.

Për mangësitë e konstatuara:

- Planifikim jo i saktë dhe mos vjelje e taksës bujqësore, ku detyrimet debitore progresive në fund të vitit 2022 janë në vlerën 197,571,584 lekë, pasi krijimi dhe rritja e debitorëve ka ardhur për arsye se familjet fermerë nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre dhe arkëtimi i taksës bujqësore mundësohet vetëm kur fermeri aplikon në Bashki për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar, mangësi këto në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, nenet 23,24, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 12/1 dhe me VKB nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, Kreu I, shkronja “b”.

b-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 shkronja (c), për 4 (katër) punonjës si më poshtë:

9. Z. R.Ime detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB),

Për mangësitë e konstatuara:

- Mos planifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mos pasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhura, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.

- Për mos zbatimimin e kërkesave të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91,93,94 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB për paketën fiskale, duke krijuar gjatë vitit 2022 vlera e

debitore për taksa dhe tarifa në vlerën 104,306,503 lekë nga 11,138 subjekte, duke mos realizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore në vlerën 705,827,865 lekë në fund të vitit 2022.

- Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos vjelje e taksës së ndërtesës e truallit, tarifat pastrim-ndriçim-gjelbërim-arsim të taksapaguesve të kategorisë “Familjar” dhe mos identifikimi i plotë i familjeve që kanë detyrim për këto taksa e tarifa, ku vlera debitorë e progresive në Bashkinë Kavajë dhe NJA në fund të vitit 2022 është në vlerën 262,750,741 lekë, që i përkasin 10,677 familjeve debitore, mangësi këto në kundërshtim me VKB nr.nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” Kreu II, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, neni 42/2, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 dhe neni 24.

- Planifikim jo i saktë dhe mos vjelje e taksës bujqësore, ku detyrimet debitore progresive në fund të vitit 2022 janë në vlerën 197,571,584 lekë, pasi krijimi dhe rritja e debitorëve ka ardhur për arsye se familjet fermerë nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre dhe arkëtimi i taksës bujqësore mundësohet vetëm kur fermeri aplikon në Bashki për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar, mangësi këto në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3/3 neni 4/1,7, neni 23,24, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 12/1 dhe me VKB nr.95, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, Kreu I, shkronja “b”.

- Në paketën fiskale për vitin 2022, konkretisht në Kreun II.5 “Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit”, është përcaktuar niveli i tarifës 300 lekë/m²/3 muaj, duke konsideruar sezonin turistik 3 muaj, ndërkohë duhet të zgjasë 5 muaj në vit. Kjo situatë ka ndikuar në planifikimin e gabuar të kësaj takse, e për pasojë ka sjellë reduktimin e të ardhurave në fakt nga dhënia me qira e hapësirës së plazhit në vlerën 26,797,800 lekë e përllëgoar sipas sipërfaqes së kontraktuar. Në paketën fiskale të vitit 2023 është korriguar sezoni turistik nga 3 muaj në 5 muaj, por nuk është ndryshuar tarifa prej 300 lekë/m²/5 muaj, ndërkohë që janë rritur çmimet në treg në krahasim me vitet e mëparshme, duke mos i shërbyer rritjes së të ardhurave nga tarifa e zënies së hapësirës së plazhit. Këto mangësi janë në kundërshtim me ligjin nr.68/2017 datë 24.07.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar neni 14 dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 2.

G/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë**, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënie e masave disiplinore për **2 (dy) punonjës**, si më poshtë:

a- Ndërprerjen e kontratës së punës (largim nga puna), për 1 (një) punonjës si më poshtë:

1. Z. S.M, me detyrë, Kryeinspektor i IMTV prej 17.09.2020 deri në datë 01.04.2022, aktualisht përgjegjës i sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit pranë bashkisë Kavajë, për shkeljet si vijon:

a) Për mungesë profesionale dhe mosmarrjen e masave në kohë me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje, në kundërshtim me ligjin.

b) Për periudhën 2021-2022 vetëm në një rast është mbajtur mbajtur vlera e gjobës sipas vlerës së punimeve të kryera, ndërsa për rastet e tjera nuk është ndjekur kjo praktikë, në kundërshtim me ligjin 107/2014 Neni 52/e Kundërvajtjet administrative) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Në asnjë rast për periudhën e vitit Janar 2021 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2022, procesverbali i kundravajtjes nuk është shoqëruar me imazhe fotografike apo sqarim të detajuar të situatës së konstatuar nga ana e inspektorëve të IMTV dhe Kryeinspektorit, për të provuar qartësisht shkeljet. Nga të dhënat e IMTV, vënë në dispozicion grupit të auditimit është konstatuar se: Në total shuma e gjobave rezulton në vlerën 23,048,000 lekë, nga e cila janë arkëtuar 850,000 lekë në total.

b- Vërejtje, për 1 (një) punonjës si më poshtë:

2. Z. Y N me detyrë, Kryeinspektor i IMTV prej 23.06.2022 e në vazhdim pranë bashkisë Kavajë, për shkeljet si vijon: Për mos marrjen e masave për prishjen në kohë të objekteve të konstatuara në periudha paraardhëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 84-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

G/III. Për punonjësit e larguar.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” përkatësisht:

1. Zj. A.K me detyrë ish-Drejtor e Drejtorisë së Burimeve Ekonomike (për periudhën 01.01.2022-12.06.2022,

2. Z. A.T me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike (për periudhën 18.06.2022 deri me 31.12.2022

3. Z. I.C me detyrë Specialist i Buxhetit në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike (për periudhën 01.01.2022-15.12.2022,

5. Z. P,P, ish-Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës Urbane, (për periudhën 01.01.2022-29.09.2022,

6. Z. M.C me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit të të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit,

7. Z. J.K me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike,

8. Z. L.XH me detyrë ish-specialist në Sektorin e Menaxhimit të Kontratave.

H. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

A Z

I SH

R L

E RR

K F

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
B D

VI. ANEKSE

Aneks.Nr.6.2/1

Bashkëlidhur RPA paraqiten rastet e konstatuara në kundërshtim me ligjin, masat administrative dhe lloji i shkeljes.

Nr.serria p.v k	Data-Viti	Subjekti	Kundravajta	Vendim/gjobe 000/lekë.	Vendim Prishje	Vendim Pezullimi
6194	15.01.2021	L sh.p.k	Shkelje ne pronesin e familjes Rroshi me ndertim.	Ska	Ska	Ka
6195	29.01.2021	A Resort sh.p.k.	Mungese dokumentacioni ne kantier			Ka
6196	19.02.2021	M A	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit.	500		Ka
6197	22.02.2021	Dy H	Objekt druri me permasa6ml/me7ml me lartesi 2.5mlx3 kollona beton arme.	500		Ka
6198	24.02.2021	B H	Ka hapur grope e betonuar perafersisht 18x9 me thellesi 12.metra.	Ska	Ska	
6199	01.03.2021	M sh.p.k	Shkelje te afatit te leje se ndertimit.	100		
6200	12.03.2021	K Re sh.p.k	Shkelje te fatit te lejes se ndertimit.	100		
6201	07.04.2021	M T	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit	100		
6202	19.04.2021	E F	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit.	100	Ska	Ska
6203	22.04.2021	H.N	Shtese anesore ne ne te dy krahet e objektit plus shkalle.	500	Ka	
6204	24.05.2021	Sh K	Shkelje te projektit te deklarates per kryerje punimesh.	50		
6205	24.05.2021	A Sh	Shkelje te projektit te deklarates paraprake per kryerje punimesh.	50		
6206	25.05.2021	E H	Ka shkelje deklarates paraprake	50		
6207	24.05.2021	L S	Shkelje te projektit te deklarates paraprake	50		
6208	25.05.2021	F J	Shkelje te deklarates paraprake.	50		
6209	25.05.2021	F C	Objekt druri te mbyllur me vetrata xhami Kaplus avllis dhe ku ka bllokuar rrrugen.	500	Ka	Ka
6210	28.05.2021	E K	Ka shkelje te njoftimit per deklarim punimesh	500	Ka	
6211	31.05.2021	M 2017	Shkelje ne lartesi ne katin duplex.	1,098		Ka
6212	01.06.2021	Se Rr	Ka vendosur kontinier dhe e ka sovatur me material ndertimi.	500	Prishur	
6213	03.06.2021	A H /L shpk	Shkelje te lejes se ndertimit.	500	Ka	Sigurim padie
6214	04.06.2021	A.	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit.	Ska	Ska	Ska
6215	08.06.2021	Dn H	Ka ber objekt 2 kat me cati konstruksionB/A pa leje ndertimi.	500	Prishur	
6216	08.06.2021	ShQ	Ka mbyllurbalkone pa leje ndertimi .	500	Ka	
6217	08.06.2021	NaIs	Hedhja e soletes se betonit pa dokumentacion tekniko ligjore.	500	Ka	
6218	08.06.2021	P H	Ndertim pa leje ndertimi I objektit 1 katesh .	500	Ka	
6219	11.06.2021	A Se	Ka shkelje te deklarates per cati te pa shfrytezuar, duke ber kat banimi	500	Ka	
6220	11.06.2021	B H	Vazhdimi i pvk 6189 Grope e betonuar 12m.	500	Ka	
6221	22.06.2021	R Xh	Po ndertonte nje objekt me material drusore	Ska	Ska	Ska
6222	07.10.2021	EM	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit .	100	Ska	Ska
6223	12.10.2021	Du -Konstruksion	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit nr 2295	100		
6224	20.10.2021	T A	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit	100		
6225	02.11.2021	B S	Shkelje e projektit	50	Ka	
6226	03.11.2021	Z S	Shtese anesore ne katin e dyte me konstruksion metalik te lehte	Ska	Ska	Ska
6227	10.11.2021	J P	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit	100		
6228	15.11.2021	A sh.p.k	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit	100		
6229	17.11.2021	H Sh	Mungese dokumentacioni tekniko ligjore ne vend	50		Ka
6230	26.11.2021	Di 2019	Shkelje te projektit dhe te lejes.	300	Ska	
6231	01.12.2021	Xhr 2009	Ka shkelje te lejes se ndertimit.	300		
6232	01.12.2021	A K	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit.	100		
6233	02.12.2021	D Xh	Nuk ka dorzuar dokumentacionin ne afatet e duhura .	50	Ka	
6234	08.12.2021	It A	Konstruksion metalik i cmontueshem, i mbuluar me llamarine.	Ska	Ska	Ska
6235	28.12.2021	V.p.k	Mungese te masave te sigurimit teknik pa rrethimit te kantierit	Ka	Ska	Ka
6236	06.01.2022	Pr Constructio	Shkelje te afatit te lejes se ndertimit.	100		
6237	07.01.2022	De 2019	Ka shkelje te projektit te lejes.	Ska	Ska	Ka
6238	19.01.2022	C H	Shkelje te afatit te lejes ndertimit . leje viti 2019	100		
6239	05.02.2022	R K	Ka shkelje te projektit, deklarates	300		Ka
6240	10.02.2022	C	Po ndertonte muret e dy ballkoneve me perafersi 10 m/1 te dy ballkonat pa leje	500	Ka	
6241	21.02.2022	F K	Perforcim shkalleve matalike me beton pa leje	500	Ka	
6242	01.04.2022	M	Po kryente punime me mbyllje ne fasade dhe ka montuar profile hekuri per shtese nga mbrapa pallatit	500	Ka	Ka
6243	07.04.2022	Ro Sh	Tende me konstruksion , druri pa leje ndertimi.	500	Ka	Ka

6244	08.04.2022	K K	Objekt banimi pa leje	Ska	Ska	Ka
6245	09.04.2022	Is A	Vazhdim i procedures 6234 dt08.12.2021	500	Sigurim Padie	Ka
6246	09.04.2022	A B	Derdhje e betonit mbi pishine ekzistuese ,ka shembur muret dhe kollonat .	50	Ska	Ka
6247	11.04.2022	M B	Ka shkelje te projektit e lejes	Ska	Ska	Ka
6248	06.05.2022	D konstruktion	Mungese dokumentacioni ne objekt	50		Ka
6249	11.05.2022	Du Pa	Ka ndertuar nje structure metalike.	50	Sigurim Padie	Ska
0000201	12.05.2022	F J	Shkelje te punimeve gjate ndertimit	Ka	Ka	Ka
0000202	13.05.2022	I pa identifikuar	Objekt nje kat pa leje ndertimi		Prishur	
0000203	17.05.2022	X 2009	Ka shkelur urdherin per pezullimin e punimeve	Ka	-	Ka
0000205	23.05.2022	IA	Po punonte ne objektin 1 kat pa leje ndertimi			
0000206	26.05.2022	I pa identifikuar	Objekti barake 1 kat prej druri pa leje ndertimi		Ka	
0000207	26.05.2022	I pa identifikuar	Objekt kjoske metalike 1 kat pa leje		Ka	
0000208	26.05.2022	I pa identifikuar	Objekt 1 kat me konstrukcion te lehtesuar pa leje		Ka	
0000209	27.05.2022	I pa identifikuar	Objekt beach bar structure druri pa leje		Ka	
0000210	28.05.2022	objekt I pa identifikuar	Objekt beach bar nje kat me konstruksione.		Ka	
0000211	28.05.2022	I pa identifikuar	Objekt 1 kat kontinier me konstruksione.		Ka	
0000212	28.05.2022	I pa identifikuar	Objekt 1 kat me onstrukcion druri dhe meatlik pa leje.		Ka	
0000213	03.06.2022	G A	Po punohet me oborrin e viles nr.12 pa leje ndertimi	Ska	Ska	
0000214	14.06.2022	IDe	Ka shkelur urdherin per pezullimin e punimeve	50		Ka
0000215	14.06.2022	A k	Shkelje te projektit	50		Ka
0000216	14.06.2022	A S	Ka thyer mure te brendeshem pa leje	500		
0000217	21.06.2022	D P	Kishte hapur nje der nga ana lidore pa dokumentacion tekniko ligjor.	200	Ka	
0000218	01.07.2022	M G	Shkelje te punimeve gjat ndertimit	Ka		Ka
0000219	07.07.2022	ArB	Ka rrethur me mure rrethimi po dhe sistemim i hapsires pa leje	500	Ka	Ka
0000220	15.07.2022	Klsh.p.k	Ka thyer urdherine pezullimit per zone turistike	50		Ka
0000221	25.07.2022	ED	Shkelje e lejes me objekt "structure sherbimi"	500	Ka	Ka
0000222	26.07.2022	B E	Ka shkelur projektin	500	Ka	Ka
0000223	08.08.2022	A D	Ka ber cati te shfrytzuar si dhe nje shtese anesore.	50		Ka
0000224	08.08.2022	Yi B	Ngritje kati mbi objektin ekzistues 2 kat pa leje	500	Ka	Ka
0000225	09.08.2022	Aktiv lift elevator ,N V	Strukture ashensori pa lej	500	Ka	Ka
0000226	17.08.2022	R	Ka shkelje te lejes se ndertimit me ndryshim projektin dhe zmadhimin e tij.	500	Prishur	
0000227	22.08.2022	M S	Mushja e sheshit te ndertimit me beton dhe 12 fitila hekuri te dala per kollona.	500	Ka	Ka
0000228	25.08.2022	P	Tende druri pa deklarate paraprake.	50	Ka	
0000229	25.08.2022	Sho T	Shkelje te kushteve te lejes	500	Ka	Ka
0000230	01.09.2022	BConstruction	Ka vazhduar hapja e nje grope dhe pa dale ne siperfaqe pa u miratuar leja.	500		Ka
0000231	02.09.2022	E	Shkelje e kushteve te lejes	100		Ka
0000232	02.09.2022	Im	Shkelje e kushteve te lejes	50		Ka
0000233	02.09.2022	E	Kat shtese ne lejen nr.3298 dt.23.11.2021	500	Ka	Ka
0000234	02.09.2022	M shpk	Ka ndertuar nje pishine pa leje.	500		Ka
0000235	02.09.2022	V shpk	Shkelje te kushteve te lejes se ndertimit dhe projektit.	300		
0000236	02.09.2022	E L	Tende druri e mbylur nga te gjitha anat	50	Ka	
0000237	02.11.2022	K H	Tende me konstrukcion metalik.	50	Ka	
0000238	11.11.2022	A2021	Punime ne ndertim pa dokumentacion tekniko ligjore. PA leje	500	Ka	Ka
0000240	22.11.2022	IG	Ka bere rrethim pa leje me blinda betoni.	500	Proces Gjyqesor	
0000241	05.12.2022	S	Ka bere mure rrethues pa dokumenta tekniko ligjore (pa leje ndertimi).	Ka	Ka	
0000243	22.12.2022	A N	Shtese anesore ne katin e 5 pa leje.	500	Ka	Ka

Aneks.nr 6.3/1

Vlerat e pa arkëtuara për të cilat janë bërë kërkesa në Gjykatën Administrative Durrës për lëshimin e titullit ekzekutiv me qëllim vjeljen e gjobave sipas tabelës në vijim;

4.	H.C	64	15.02.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.77521.02.2023
5.	RK	65	05.02.2022	300.000	Pa likujduar	Nr.773dt21.02.2023
6.	FK	01	04.05.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.791dt21.02.2023
7.	F.M	02	04.05.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.774dt21.02.2023
8.	R.Sh	03	04.05.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.766dt21.02.2023
9.	I.A	04	05.05.2022	500.000	pa likujduar	Nr.794dt21.02.2023
10.	A.B	05	05.05.2022	50.000	pa likujduar	Nr.765dt21.02.2023
11.	Esh.p.k	06	12 .05.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.790dt21.02.2023
12.	Xh 2009 sh.p.k	07	18.05.2022	300.000	Pa likujduar	Nr.778dt21.02.2023
13.	D.P	08	13.05.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.795dt21.02.2023
14.	D.Construction sh.p.k	09	05.05.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.780dt21.02.203
15.	B.C G	10	15.06.2022	50.000	Likujduar	
16.	A.K	11	16.06.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.777dt21.02.2023
17.	D.P	12	22.06.2022	200.000	Pa likujduar	Nr.789dt21.02.2023
18.	A.S	13	22.06.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.776dt21.02.2023
19.	A.B	14	19.07.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.772dt21.02.2023
20.	M Gj	15	19.07.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.763dt21.02.2023
21.	K sh.p.k	16	03.08.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.767dt21.02.2023
22.	B.E	17	08.08.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.788dt21.02.2023
23.	A.D	18	08.08.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.762dt21.02.2023
24.	A sh.p.k	19	09.08.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.768dt21.02.2023
25.	E D	20	09.08.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.770dt21.02.2023
26.	Y.B	21	09.08.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.769dt21.02.2023
27.	L.R	22	17.08.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.771dt21.02.2023
28.	M.S	23	22.08.2022	500.000	Pa likujduar.	Nr.796 dt21.02.2023
29.	Sh.T	24	26.08.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.783dt21.02.2023
31.	I.D	26	03.09.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.797dt21.02.2023
32.	E	27	07.09.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.781dt21.02.2023
33.	V.sh.p.k	28	07.09.2022	300.000	Pa likujduar	Nr.782 dt21.02.2023
34.	A.P	29	07.09.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.799dt21.02.2023
35.	E.L	30	07.09.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.779dt21.02.2023
37.	K. H	32	11.11.2022	50.000	Pa likujduar	Nr.786dt21.02.2023
38.	A	33	21.11.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.785 dt21.02.2023
39.	I.G	35	01.12.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.764.dt21.02.2023
40.	A.S	36	16.12.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.792dt21.02.2023
41.	A.	37	16.12.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.793dt21.02.2023
42.	A.N	38	29.12.2022	500.000	Pa likujduar	Nr.787 dt21.02.2023

Aneks B/9

Formati nr.2 “Pasqyra e përfomancës financiare”

Nr. rresh	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTIMOR	VITI I MEPARSHEM
ti			2022	2021
a	b	c	d	e
1	A	TE ARDHURAT	2,196,400,248	1,721,249,632.00
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	561,988,130	289,738,303.00
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	1,119,429	2,080,954
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	1,119,429	2,080,954
7	7009	<i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>		
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	148,535,225	96,627,342
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	148,535,225	96,627,342
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		

11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	251,089,072	191,030,007.00
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		20,000
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	251,089,072.00	191,010,007
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	131,406,605	93,292,536
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	7,914,111	6,332,812
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	7,914,111	6,332,812
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	123,492,494	86,959,724.00
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	112,712,175	74185639
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	4,566,567	4386245
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	1,341,000	1,280,000
44	7114	Te ardhura nga biletat	20,000	
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	4,852,752	7,107,840
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
53	72	V.GRANTE KORENTE	1,484,079,813	1,338,218,793
54	720	1.Grant korent I Brendshem	1,483,879,813	1,338,218,793
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)		
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	521,031,581	507,480,088
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	10,912,099	
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	933,210,433	816,894,640
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	0	
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme	18,725,700	13,844,065
64	721	2.Grant korent I Huaj	200,000	
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare	200,000	
67		VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
74	B	SHPENZIMET	1,565,870,051	1,157,267,577
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	372,056,611	353,133,581
76	6001	Paga, personel I perhershem	372,056,611	353,133,581
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	62,026,311	58,439,749
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	55,701,354	52,468,271
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	6,324,957	5,971,478
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	548,762,865	368,478,583
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	2,852,507	7,050,085
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	22,035,730	20,368,855
87	6022	Sherbime nga te trete	438,309,103	267,263,110
88	6023	Shpenzime transporti	21,833,756	13,289,177
89	6024	Shpenzime udhetimi	0	
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	9,912,207	2,589,882
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	5,548,493	6,227,419
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	46,879,719	42,633,315
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	7,952,640
94	6029	Shpenzime te tjera operative	1,391,350	1,104,100
95	603	IV.SUBVECIONE	0	0
101		V.TRANSFERIME KORENTE	583,024,264	368,667,617
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	583,024,264	368,667,617
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	583,024,264	368,667,617
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	4,047,323	8,548,047
131		IX.SHPENZIME TE TJERA		
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES	630,530,197	563,982,055
		(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)		